VITI IV-të Nr. 1-2

BULETIN

I INSTITUTIT TË SHKENCAVET

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

BOTIM I INSTITUTIT TË SHKENCAVET

TIRANË 1950

REDAKSIA:

Kryeredaktor : KOL PAPARISTO
Redaktorë : ALEKSANDER XHUVANI, SOTIR ANGJELI,
ALEKS BUDA, ISMAIL OFÇIU

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODER

PAJTIMI:

Për një vit . . . lek 80
Jashtë shtetit . . » 160

INSTITUTI I SHKENCAVET
TIRANË Tel. 23-43

KONSTANDIN NELKO-KRISTOFORIDHI
(1830-1895)

Monografi mi jetën dhe botimet e tij

nga

DH. S. SHUTERIQI

Me të drejtë, Konstandin Kristoforidhi, prekursori i math i rilindjes sonë, mori emnin «baba i gjuhës shqipe». Ai bani gati punën në shekullin e kaluem për themelimin e nji shqipje letrare, qi na dhanë pastaj rilindasit dhe, kryesisht, Naim Frashëri.

Përpara Kristoforidhit, shqipja pat qenë shkrue, hove-hove, thuej se gjatë katërqind vjetëve — të pakën me sa dimë ne sot. Po sekush përdori gjuhën e krahinës së vet. Asht e para herë qi vjen nji lërues shumë i zoti, i cili përpiqet të shkruejë nji gegënishte për tanë gegët dhe nji toskënishte për toskët e tanë, dmth të krijojë nji gegënishte dhe nji toskënishte të vetme letrare. Po jo veç kaq: ai ban edhe nji përpjekje serioze për t'i afrue letrarisht të dy dialektet e shqipes.

Ne qi sot shohim se toskënishtja letrare u krijue dhe gegënishtja letrare thuej se po, ne qi hasim përditë nevojën e afrimit sa ma të math në mes tyne dhe qi koha ka për të na shtrue shpejt çashtjen e nji gjuhe të vetme letrare, me njizimin e math qi ka ilitue dhe do të plotësojë shpejt populli jonë në rrugën e socializmit, — ne mund të mësojmë shum nga puna fort e çmueshme e Kristoforidhit. Linguistëve tanë u bije barra t'ia hynë studimit të veprës së tij të gjanë, duke e kqyrë në zhvillimin e saj, për të njohtë nji eksperiencë të madhe gjuhësore në historinë e shqipes.

Po Kristoforidhi ish edhe nji nga patriotët ma të çquem dhe të herëshëm të popullit tonë në shekullin XIX. I ushqyem me ndjenjat përparimtare të kohës dhe me dashuninë përcatdhe, ai çashtjen e gjuhës, bashkë me gjith prekursorët e rilindjes dhe rilindasit vetë, e vështronte si nji çashtje patriotike themelore. Të lëroje shqipen dhe të përhapje shkrimkëndimin e saj, për Kristoforidhin e shokët e tij, qi mendojin se gjuha

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

asht ajo qi dallon nji komb nga të tjerët, ka qenë mjeti ma i parë i zgjimit të ndërgjegjës kombëtare dhe i afirmimit të kombit shqiptar në sy të botës. Vepra e Kristoforidhit qe pra nji vepër e madhe patriotizmi. Nga ana tjetër, shkrimtari u muer drejt për së drejti me organizimin e lëvizjes sonë kombëtare dhe qe nji propagandist i zoti i ideve të çlirimit nga Turqia.

Si dhe për shumicën e shkrimtarëve tanë të kaluem, edhe për Kristoforidhin ne dimë pak. Jeta tij njihet keq. Po dhe veprat e tij nuk njihen mirë cilat kanë qënë. Qëllimi i këtyne radhëve asht qi të saktësojnë shum gjana mi jetën dhe veprat e Kristoforidhit, duke çfrytëzue shkrimet e njohtuna rreth tij dhe nji seri dokumentesh të panjohtuna.

I. JETA

Emni i vërtetë i shkrimtarit qe Konstandin Nelko. Përse e ndryshoi dhe e bani Kristoforidh, nuk dihet mirë. Me qi ky emën ka formën greke, asht mendue se mos e ketë marrë prej vjerrit të tij grek. Po shum shqiptarë në të kaluemen i kanë pasë greqizue emnat e tyne: kryetari i shoqënisë *Drita* të Bukureshtit, fjala vjen, Anastas Lakçeja, i ka pasë thanë vehtes: Avramidhi. Sidoqoftë, vjerri i Kristoforidhit quhej Panajot. N'Elbasan asht thanë se Konstandini e quejti ashtu vehten sepse përkthenë librat e shenjta: greqisht, Kristofor do të thotë Krisht-sjellës, qi sjell, përhap fjalën e Krishtit. Asht mendue edhe ma naivërisht, se ai e quejti, vehten me emnin e zbuluesit t'Amerikës, Kristofor Kolombit, sepse qe sbuluesi i vërtetë i shqipes, ai qi e suell shqipen në dritë. Doemos, gjith këto nuk janë të vërteta. Që më 1854, Konstandini e quen vehten Kristofor (1). E pra, këte mot, ai vërtet duket t'ia ketë hymë punës përgjuhën shqipe, po jo dhe sa ta quejë vehten «zbulues» të saj. Mendimi jonë asht se duhet kërkue në fis të vet, mos ndonji i parë i tij quhej Kristofor. Këte ne e bamë nëpër kondiqet dhe dokumentet e shumta qi ruhen, mi ortodoksët e Elbasanit, n'Arkivën e Shtetit: sukses nuk patëm. Sidoqoftë, duelën gjana të tjera, të cilat kanë interesin e tyne dhe po i shënojmë shkurt.

Në kondiqet e lagjes Kala t'Elbasanit, prej së cilës qe Kristoforidhi, që më 1723, hasim nji emën Nedelko (2). Ka të ngjamë që emni Nelko të jetë nji shkurtim i tij. Ky Nedelko i lashtë duket të qe nji fëmi, të cilin prindët e shkruen në kondikun e Kishës Sh.Mëri të lagjes, qi t'i kujtohet emni ndër lutjet. Më 1739, hasim prap n'atë emën: Nedelkoja asht kësaj here «hyzmeqar», dmth çirak i gunarit Nikollë Martini (3). Më 1741, e gjejmë «nxanës» (gr «mathiti») të gunarit Gjon (4). Ma tej, nuk përmëndet.

Emnin Nelko e hasim për herë të parë më 1771, në kondikun e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Esnafit t'Argjendarëve t'Elbasanit, ku flitet për nji Nelko nxanës të Dod Bibës (5). Le të vihet re se, në këte kohë ky Nelko i parë s'asht akoma mjeshtër, dmth se asht i ri. Nga ana tjetër, ai asht argjendar, si qe dhe i ati i Kristoforidhit. Mjeshtëria kalonte bres pas brezi te zanatçijt.

Duhet me pritë vitin 1786 për të hasë emnin e Anastasit, babait të Kristoforidhit: ate mot, më 20 gusht, «Anastasi, i biri i Nelkos» ka marrë «testir» (leje ushtrimi zanati) tek argjendarët. (6) Po të kujtojmë se ai vdiq më 1853 dhe se nuk kemi asnji shenjë ose kujtim qi të ketë vdekë fort i motuem, afër qindit, kuptohet se më 1786 Anastasi ishte fëmi dhe se i ati, Nelkoja, mori testir për te. Qe zakoni ahere me ia sigurue fëmisë radhën e mjeshtërinë n'esnaf që në të vogël. Kështu Anastasi, për Konstandinin tonë, do të marri testir edhe te argjendarët edhe te gunarët më 1836, kur djali tij nuk asht ma shum se 6-9 vjeç. Në këte mënyrë, Konstandini ishte pak a shum i siguruem në t'arthmen qi të gjinte radhën në njanën nga dy mjeshtëritë ku i ati e pat shkrue me kohë dhe pat pague. Anastasi, i biri i Nelkos, duhet të ketë lindë rreth vitit 1780.

Më 1793, dy djem të tjerë të Nelkos, Konstandini dhe Mihali, marrin testir te argjendarët (7). Duhet të jenë dy vllezën t'Anastasit. Të parin s'e takojmë ma nëpër kondiqet, kurse për Mihalin kemi edhe nji gjurmë më 1811 (8). Më 1822, hasim për herë të parë në nji fëmi t'Anastasit, në Jakovin, i cili merr testir te gunarët (9). Ma vonë nuk flitet ma për te, pra duket se vdiq shpejt. Më 1836, regjistri i vdekjeve të lagjes Kala ka të shënueme vdekjen e nji Stefani, bir i Iprian (Dibran) terziut, i quejtun Nelko (10). Etj.

Disa gjana dalin prej këtyne shënimeve:

a) Fisi Nelko në lagjen Kala t' Elbasanit nuk përmendet ma herët se pjesa e dytë e shekullit XVIII, dhe emnin duket ta ketë marrë nga nji farë Nelko, i cili asht nxanës argjendar më 1771 dhe ka për djalë Anastasin, t'anë e Kristoforidhit, qi duhet të ketë lindë rreth vitit 1780. Nuk munt të sigurohemi qi ky fis të ketë të bajë edhe ma së lashti me nji farë Nedelko, gunar, qi hasim në kondiqet e Elbasanit, me gjith se, ma vonë, e shohim Anastas Nelkon të ketë lidhje disaherë me Esnafin e Gunarëve, sikur të desh të rikthehej ai ose ndonji djalë i tij në nji mjeshtëri qi e kish pasë të fisit së lashti (11).

b) Ka të ngjamë qi Nelkoja i vitit 1771 të kish për llagap emnin Kristofor dhe prej këndej ta ketë marrë shkrimtari llagapin e tij, tue mos dashë të përdori emnin Nelko, i cili nuk i pat tingëllue vendas. Ky emën sllav, asht i huej n' Elbasan dhe si i tillë tërhoq verejtjen dhe u ba emën fisi: babait të Kristoforidhit i thanë Anastasi i Nelkos dhe jo ma Anasatas Kristofori. Konstandini i thotë vëmes K.A.Kristofor që më 1854; që në të ri ai nuk e përdori emnin Nelko për llagap dhe jo kur nisi botimet e tij, siç ka qenë mendue.

BIBLIOTEKA PUBLIKE SHKOLLORE "MARIN BARLETI"

c) Ka të ngjamë qi Nelkoja i vitit 1771 të ketë qenë nga Dibra, sikundër asht edhe ai i vitit 1836. N'Elbasan ka nji traditë, sipas së cilës Nelkot ishin t'ardhun nga Dibra.

ç) Kristoforidhi nuk qe djalë i vetëm, po ka pasë dhe nji vlla para tij, i cili duket se vdiq fëmijë. Kemi gjurmë edhe për nji vlla të dytë të Kristoforidhit, me emnin Jani, më 1866.

Sikundër nuk jemi të qartë për emnin, ashtu nuk njohim mirë edhe datëlindjen e Kristoforidhit. Në parathanjen greqisht të *Fjalorit* të tij qi u botue më 1904, jepet viti 1827. Nga ana tjetër, nji nga shokët e ngushtë të Konstandinit, Loshi i Papamihalit, bojaxhi dhe shqiptar i flakët në kohë të vet, i cili ka lanë dëshmi të shumta mi Kristoforidhin, edhe ai jepte vitin 1827. Prap, ne kjo datë nuk na duket e vërteta, sepse t'afërmit e shkrimtarit kanë dhanë vitin 1830. Kështu nji i dhandrri (12), kështu dhe nji nga djemt e tij. Ky i fundit, Filipi, qi sot jeton në Francë, dëshmon se Kristoforidhi vdiq 64 vjeç, dmth se duhet të ketë lindë rreth mbarimit të vitit 1830.

Kristoforidhi vetë ka lanë disa shënime qi kanë të bajnë me jetën e tij. Në mes tyne, gjejmë edhe datën 15 gusht 1847, kur, thotë ai, ka plasë kryengritja e Gjolekës dhe Rrapo Hekalit me shokë në Toskëni. Kjo asht data e nisjes së Konstandinit për të studiue në Janinë. Ne dimë se më 1853, vit në të cilin i vdiqën e ama dhe i ati (13), Kristoforidhi asht mësues në Tiranë. Më 1852, ai pat mbarue studimet në nji seminar të Maltës, ku bani dy vjet. Gjatë viteve 1847-50 qe në gjimnazin Zosimea të Janinës, qi ahere ishte me tre vjet (14). Na duket ma e arsyeshme qi Konstandini të këtë hymë në Zosimea shtatëmbëdhjetë vjeç djalë dhe jo njizet.

Për gjith këto, ne si vit të lindjes së Kristoforidhit zamë vitin 1830. Sidoqoftë, Konstandini leu në nji nga çastet e randësishme të historisë së popullit tonë në shekullin XIX, në kohën kur Turqia, tue dashë të vendosi sistemin e monarqisë së centralizueme, theu rezistencën e feudalëve të ndryshëm të Ballkanit dhe, posaçërisht, të Shqipnisë, ku u dallue Ali pashë Tepelena (i vramë më 1822) dhe Mustafa pashë Bushati (i mundun më 1830). Tani zgjedha turke filloi të randonet edhe ma keq mi popullin tonë dhe janë tue u përgatitë lëvizjet e gjana qi u zhvilluen në Shqipni para dhe pas Tanzimatit (Sidomos më 1836-47). Më 1824 dhe 1827 asht botue prej Grigor Gjinokastritit përkthimi i *Dhiatës së re* toskënisht dhe më 1836 Naum Veqilharxhi ka lëshue «Qarkoren» e tij për zgjimin e ortodoksëve shqiptarë kundër propagandës antikombëtare qi bahet prej grekëve dhe turqëve për dam të popullit tonë. N'Elbasan vetë, kujtimi i Dhaskal Thodhrit asht i gjallë dhe shkrimi tij shqip përdoret gjithmonë. Ortodoksët e Elbasanit nuk shkojnë mirë me dhespotlerët e tyne fanariotë, të cilët mbështesin dhe përforcojnë politikën e sunduesit turk (15).

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Në tetor 1853, nji muej pasi i vdes i ati Kristoforidhit, ka plasë lufta ruso-turke. Në mars 1854, Anglia dhe Franca marrin anën e Turqisë dhe, në mes të shtatorit, trupat e tyne zbresin në Krime. Sebastopoli ra në fillim të shtatorit 1855; në shkurt 1856 u arrit marrëveshtja për paqë dhe në mars u nënshkrue traktati i paqës. E pra, ahere Kristoforidhi ka qënë në Krime si «dragoman» (përkthyes) i mercenarëve shqiptarë (kryesisht mirditas) qi luftuen krahas trupave anglo-franceze dhe turke. Pasi i vdiq i ati, Konstandini thuhet se e la punën e mësuesisë qi pat në Tiranë, shiti pasjen e vet me lejen e të dy motrave të martueme qi kish n'Elbasan dhe Berat, e u nis për Patras të Greqisë, ku gjindej nji mik i t'et, nji konsull anglez qi e paske ndihmue për të ndjekë studimet në Maltë (16). Në Durrës e ndali nuni tij, Mimë Xhufka, tregtar elbasanas, dhe Konstandini u muer me tregti duke hapë edhe nji dyqan, gjersa, pas pak muejsh, Mima vdiq (17) Pastaj Konstandini e braktisi tregtinë dhe shkoi në Patras. Po konsulli anglez, në vend qi ta ndihmojë për të studiue, siç kërkonte Kristoforidhi, i gjet punë si dragoman në Krime. Kështu, ai do të fitonte mjaft sa për t'i ndjekë studimet e nalta me paret e veta. Në vitin shkolluer 1856 Kristoforidhi fillon studimet n'universitetin e Londrës, ku duket se ndoq për tre vjet gjuhësinë, d.m.th. gjer më 1859.

Cilat qenë studimet e Kristoforidhit? N'Elbasan, ai kreu shkollën fillore greqishte, ku fare pak gja mësohej: lexim dhe fe, ndofta edhe njohunitë e para t'aritmetikës. Asht e kuptueshme qi, me mjetet dhe metodat e kohës, fëmija shqiptar çonte vjet të tana për të mësue pak fjalë greqisht. Po qe ndryshe në Zosimea të Janinës. Kjo shkollë pat zavendësue, më 1828, dy të tjera me famë në botën greke. Në kohë t'Ali pashë Tepelenës dhe gjer ate mot, ajo pat nji drejtor të zotin, Athànas Psalidhën, dhe ma vonë nji tjetër, Anastas Saqellarin. Ky ishte filolog në za në Greqi dhe qe drejtor në kohën kur studioi Kristoforidhi. Gjer më 1852, vit në të cilin Konstandini mbaroi shollën, në Zosimea punojin pesë profesorë, të cilët epnin mësimet e letërsisë greke dhe latine, të teologjisë, historisë, matematikës, filozofisë, fizikës eksperimentale, frangjishtes dhe italishtes. Teoritë e filozofëve Lock dhe Kant, nga ma të përparuemet e shekujve të kaluem, ishin në krye të programeve; mendimet përparimtare qi u zgjuen nga revolucioni francez mbër Evropë, ishin në rendin e ditës edhe në Janinë (18). Këtu pra, Kristoforidhi bani studime të mesme të shëndosha klasike, njohu shkencat e filosofinë, ra në kontakt me idetë përparimtare të kohës. Po Konstandini pat et për dituni dhe i ati qe njeri i mirëkuptueshëm. Studioi edhe dy vjet të tjera në Maltë, ndofta në ndonji seminar priftënish, ku, sado pak, duhet të ketë plotësue mësimet e tij të mesme. Sidoqoftë, mi këto studime nuk dimë gja. Në se ai seminar nuk qe italisht sikundër asht thanë (19), po anglisht, kjo ka randësi, sepse Kristoforidhi mëson edhe nji tjetër gjuhë të madhe t'Evropës dhe vihet në kontakt me protestanët, të cilët do të

BIBLIOTEKA PUBLIKE
MARIN BARLETI
SHKODËR

luejnë një rol kryesor në jetën e tij të mapastajme. Prap nuk dimë se cilat qenë studimet universitare të Kristoforidhit. Po asht për t'u shënue se studioi në një nga qendrat ma të mëdha t'Europës, se studioi mirë anglishten dhe gjuhët e vjetra, se duhet të ketë njohun edhe ebraishten me sanskritishten, qi mësoheshin fort ahere nëpër fakultetet e gjuhësisë. Më 1859, Kristoforidhi asht nga tepër të rallët shqiptarë me studime universitare.

Në këte kohë, ai njeh një sasi gjuhësh të vjetra dhe të reja dhe me studimet qi ka bamë në Londër, asht gati për t'ia nisë punës për shqipen. Dëshirën e ka të madhe, pa tjetër. Kjo dëshirë i ka qenë zgjue që në Janinë, ku pat fatin e rallë t'i japi mësimet e para të shqipes albanologut Hahn, shkencëtar i zoti për kohën, i cili, tue pamë sa i zgjuet ishte Kristoforidhi, sigurisht e ka nxitë për të studiue edhe ma nalt, në mos dhe e ka ndihmue. Jo vetëm kaq, po Hahn-i e ka futë në punë Kristoforidhin për materialin gegë qi i u nevojit për veprën e tij të famëshme, *Albanesische Studien* (1853-54), sikundër kuptohet nga vepra vetë dhe na e dëshmon albanologu frances Dozon, i cili ka pasë të bajë me Kristoforidhin (20). Doemos, në kontakt të ngushtë me Hahn-in, Kristoforidhi ka njohtë shkrimet e maparëshme shqipe, të pakën ato të shekujve XVIII—XIX, si dhe gjithçka me randësi qi kish qenë shkrue ahere mi vendin dhe popullin tonë dhe qi Hahn-i njihte fort mirë. Më 1854, kur del nga shtypi vëllimi i dytë i veprës s'albanologut, shohim se Kristoforidhi interesohet për te dhe mban shënim për alfabetin e Dhaskal Todhrit dhe shkrimet e këtij (21). Ka fare të ngjamë qi vetë Kristoforidhi ta ketë vumë Hahn-in në gjurmën e Todhrit, të cilin ky e zbuloi më 1849, mot kur Konstandini asht akoma në Zorimea (22). Puna e Todhrit, randësia jashtëzakonisht a madhe qi i dha Hahn-i alfabetit të tij, të cilin e pandehu pelasgjik, gja qi dëshmonte për një traditë mijëvjeçare në kulturën e popullit tonë, ushqyen pa dyshim te Kristoforidhi dëshirën e madhe për studimet gjuhësore, me qëllim qi t'i vihet lërimit të shqipes, kësaj gjuhe qi i paske rrajët në thellësinë e shekujve të prehistorisë. Më 1853—55, janë botue të parat studime me randësi për gjuhën tonë, ato të gjermanëve Stier dhe sidomos Bopp, ky i fundit themelues i shkencës së gjuhësisë së krahasueme. Edhe italo-arbëreshët tani kishin filluë nga botimet e tyne të para me randësi.

Në rrethana të tilla i mbaroi studimet universitare Kristoforidhi më 1859. Me dëshirën e madhe qi t' i vihet punës së shqipes, ai u interesue pranë Shoqënisë Biblike angleze në Londër, qi merrej me përkthimin e librave të shenjta në tanë gjuhët e botës, për të përkthye ato libra shqip. Po shoqënia nuk vendosi menjiherë: vetëm i dha fjalën se do ta shihte këte punë dhe, po të vendoste, do ta thëriste. Më 1858, pat qenë ribotue n' Athinë *Dhiata e re* e Grigorit, e cila, më 1824 dhe 1827, u botue në Korfus prej degës ioniane të Shoqënisë Biblike (23). Pa dyshim, shoqënia nuk mendonte t' i ripërkthejë kaq shpejt Ungjijet, tue

BIBLIOTEKA PUBLIKE
MARIN BARLETI
SHKODËR

mos ditë ndofta se bollmi i Grigorit, në gjuhën e Labovës, nuk qe i përshtatshëm për shumicën e toskëve dhe për gjith gegët.

I mbetun ekonomikisht keq në Londër (24), Kristoforidhi, qi në Shqipni pat shitë pasjen e vet dhe pat lanë edhe borxhë, pranoi të parën punë qi gjet: u ba mësues i greqishtjes dhe italishtes në nji shkollë të Tunizisë. Kjo punë në nji vend kaq të largët nuk duhet ta ketë trembë: ai ish mësue të shetisi botën dhe dëshira e së resë dhe e aventurës nuk i mungoi. Nuk dihet se në ç'qytet të Tunizisë punoi. Po atje u martue me vajzën e nji argjendari grek prej Korfuzi (25). Të shoqen e quejshin Eleni dhe e kish pasë nxanëse të vetën në shkollë, gja qi dëshmon se Kristoforidhi dha mësime në nji shkollë gjysëm të mesme. Vjerri i vdiq kur ish në Tunizi. Atje i leu dhe fëmija e parë, nji vajzë, të cilën e quejti Anastasia, me emnin e t'et (26). Le të shënojmë se në Tunizi ka pasë rastin të mësojë mirë arabishten, sepse qëndroi të pakën katër vjet, gjer nga fillimi i vitit 1864.

Ndërkohë, Shoqënia Biblike vendosi të përkthejë Ungjijet shqip. Pa tjetër, ajo ka mendue t' i përkthejë kësaj herë gegënisht, me qi toskënisht gjindeshin, dhe njeri ma të përshtatshëm se Kristoforidhi për këte punë s'kishte. E kërkoi pra Konstandinin dhe me vështirësi e gjet. Kristoforidhi këte priste: ia menjiherë shkollën dhe Tunizinë dhe, me gjith fëmijë, zbriti në Stamboll. Këtu, lidhi kontratën me përfaqësuësin e shoqënisë, Aleksandër Thompson, për tridhjetë sterlina në muejt, dhe ia hyni punës me zell (27).

Në Stamboll, Kristoforidhi u njoh me patriotët shqiptarë të kohës, të cilët kishin fillue të lëvizin për çashtjen kombëtare. Pas dëshmisë së Vretos, ai u përpoq ahere t' i organizojë shqiptarët e Stambollit për «shkronja e për mësonjëtore shqip», dmth për libra dhe shkolla shqip (28). Në këte kohë, në Turqi flitet për reforma dhe liri, po gja e madhe nuk bahet. Shqiptarët mundohen të rimarrin vehten nga humbja qi pësuen sidomos mbrenda viteve 1822-47, po bashkimi i patriotëve dhe i qëllimeve asht i pakët. Kështu, për çashtjen e alfabetit nuk merren vesh lehtë, se bejlerët myslimanë e kanë vështirë të heqin dorë nga shkronjat turke, edhe kur u pëlqen ta shohin shqipen me libra dhe shkolla, kurse tregtarët ortodoksë nuk shkëputen akoma prej shkronjave greke. Kristoforidhi vetë asht për shkronjat latine. Gja nuk përfundohet pra më 1864. Sidoqoftë, dëshmia e Vretos ka randësi: ajo na mëson se Kristoforidhi qe iniciator i lëvizjes kombëtare në Stamboll, se, me të shkue ai në këte qytet, ajo lëvizje bani përpjekjen e sajë të parë për t'u organizue. Iniciativa e Kristoforidhit ka randësi të madhe, po të kujtojmë rolin qi do të luente ma vonë nji shoqëni kulturale, si ajo e Stambollit qi u formue më 1879.

Më 1864, duket se Kristoforidhi ndejt vetëm pak muej në kryeqytetin e perandorisë. Shpejt, atij i u desh të vijë në Shqipni, për të stu-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

diue në vend dy dialektet kryesore të gjuhës sonë, duke ndejtë dy vjet në Shkodër, Berat dhe Elbasan. Kristoforidhi nuk se s'e njihte shqipen apo e kish harrue, qi e bani këte mundim. Po lërimit të gjuhës së vet ai desh t'i hyjë si duhet, duke e studiue në vend gjuhën e popullit, në paraqitjen aktuale të saj. Kemi të bajmë këtu me nji krifer të shëndoshë shkencor. Nga ana tjetër, Kristoforidhi e ka mendue që ahere, me sa kuptohet, se nuk do të bante mirë sikur t'i përkthente Ungjijet në gegënishten e Elbasanit, po në nji gegënishte të përgjithshme, qi ta kuptonte tanë veriu. Kjo del nga nji vëzhgim i thjeshtë i botimit të tij të parë (1866). Nga ana tjetër, njohja e toskënishtes ishte dhe ajo e nevojëshme për të pasë nji ide sa ma të plotë të shqipes dhe për t'i çelë rrugën auktorit për punimet e tij të mapastajme. Le të shënojmë edhe se Kristoforidhi njohu ahere shkrimet gegënishte dhe toskënishte të kohës, ato të G. Gualiata-s, V. Basile-s me shokë, si dhe ato të Grigor Gjinokastritit. Këte të fundit, pa dyshim, duhet ta ketë njohtë kohë përpara, në Janinë, po dhe n'Elbasan, ku s'pat mungue nëpër kishat tona. Influenca e auktorëve të masipërmë diktohet në librin e parë të Kristoforidhit, sikundër do ta shohim.

Kristoforidhi nis nga botimet e tij më 1866, me përkthimin gegënisht të *Katër Ungjillave dhe Punëve t'Apostuive*. Këte mot ai asht rikthye në Stamboll, për t'u kujdesë për librin e tij. Asht e ditun se Kristoforidhi u kujdes për gjith botimet e veta dhe asnjana prej tyne nuk duket të ketë dalë pa qenë ai vetë prezent. Viti 1866 asht nji mot me randësi të madhe në historinë e letërsisë dhe të lëvizjes sonë patriotike në shekullin e kaluem. Ate mot, De Rada dhe Camarda botuen përmbledhjet e tyne të famëshme të kangëve popullore arbëreshe t'Italisë, kurse Dora d'Istria botoi shkrimin e saj po aq të famëshëm, *Kombësia shqiptare sipas kangëve popullore*. Gjith ahere, folkloristi shkodran Jubani pat fatin e zi të humbi nji përmbledhje të madhe kangësh popullore të veriut. Gjuha dhe populli jonë më 1866, nga arbëreshët e Italisë, Dora d'Istria dhe Kristoforidhi, kanë qenë manifestue si asnjëherë ma parë, në mënyrë fort të denjë dhe të bujëshme, me katër botime. Ushtima qe e thellë n'dër shqiptarët e kohës. Për sa i takon Kristoforidhit, ai nisi të njihet dhe të çmohet menjiherë. Dy vjet ma vonë, shohim se nji i ri enthusiast, patrioti i Misirit Spiro Dine, ia ze emnin me ngburrje nëpër vjershat e tij (29).

Që më 1867, Kristoforidhi bante nji hap vendimtar në zhvillimin e gjuhës së tij, pasi njohu shkrimet e klasikëve të letërsisë sonë, ato të Budit dhe Bogdanit, siç do ta shohim ma tej. Më 1867, 68, 70 dhe 72, ai botoi, radhazi, edhe katërmbëdhjetë vëllime të tjera, tue përparue gjithmonë në gjuhën e tij dhe tue provue edhe toskënishten me përkthimin e *Psalltirit* (1868). Në mes këtyne librave janë edhe dy *Abëtare*, njana gegënisht dhe tjetra toskënisht (1870), të cilat do t'i shërbejnë përhapjes së

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

shkrim-këndimit të shqipes. Nga gjith këto botime, shqiptarët e kohës nuk do të shohin vetëm, me mburrjen e kuptueshme, se për ta lindi nji shkrimtar i math, po dhe se ky njeri po u zbulon nji të vërtetë qi ata nuk e njihjin mirë apo e kishin në dyshim: se të dy dialektet e mëdha të shqipes nuk qenkëshin aq lark prej njani-tjetrit sa thuhej, se gegë dhe toskë, sado të përçamë, ishin ma afër shoqi-shoqit nga ç'pandehej dhe pretendohej prej anmiqëve të popullit tonë. Me gjith këte, shenja e përçamjes së tyne nuk u zhduk prej librave të Kristoforidhit asnjiherë, jo sepse ky nuk bani dot nji gjuhë të përbashkët, sikundër deshën ta krijojnë artificialisht njerës si Camarda (30), gja qi ish e pamundun për kohën, po sepse Kristoforidhi përdorte për gegënishten alfabetin latin dhe për toskënishten alfabetin grek, sikundër patën bamë, zakonisht, shkrimtarët e maparëshëm. Po a ish e mundun për Kristoforidhin të përdorte nji alfabet të vetëm për të dy dialektet, alfabetin latin qi ai pëlqente? Ishte fort e vështirë, për të mos thanë e pamundun. Dy-tri tentativa qi u banë para vitit 1879 për nji alfabet të vetëm të shqipes, tentativa në të cilat ai qe iniciator, siç e pamë dhe do ta shohim, — dështuen. Nga ana tjetër, Shoqënia Biblike nuk donte t'u apë toskëve libra me nji alfabet qi rrallëkush e përdorte prej tyne. Kristoforidhi, qi u përpoq për afrimin e gegëve dhe të toskëve me anë të gjuhës dhe t'organizimit të tyne, nuk mundi të krijojë ai vetë nji alfabet të përbashkët. Kjo asht me randësi për t'u shënue, sepse reflekton përçamjen ende fort të madhe në mes patriotëve të kohës. Nga ana tjetër, çashtja e krijimit të nji alfabeti të përbashkët hasi në vështirësi të mëdha, qi ende njihen pak, si më 1879, kur u arrit nji rezultat provizor, si ma vonë, gjer kur mori fund pas Kongresit të Manastirit (1908), ku ndeshja në mes opinioneve të përkundërta qe edhe ma e madhe.

Vitet 1866-72 kanë qenë vite pune të palodhun për Kristoforidhin. Më 1870, ai ka nisë edhe nga redaktimi i veprës së tij ma të randësishme, të *Fjalorit*, për të cilin, simbas mendimit qi do të çfaqim ma poshtë, ka punue të pakën që më 1854.

Më 1867, në Turqi ka nji qeveri qi shpall qëllime reformash, të cilat, si zakonisht, nuk venë lark. Asht qeveria e Aali Pashës, qi do të jetë në fuqi gjer më 1871. Edhe nji herë, Kristoforidhi, i cili s'ka shum kohë qi asht kthye nga Shqipnia, përpiqet t'i bashkojë patriotët me mendimet e tij, sidomos për nji alfabet të përbashkët. Në mbledhjet e organizueme prej tij, gjejmë Jani Vreton, Vaso Pashën, Hoxha Tasimin, Ismail Qemalin etj. Vretua qi na dëshmon edhe për këte tentativë, ku iniciator asht për së dyti herë Kristoforidhi, na thotë se shumica deshën alfabetin turk, po se, ma në fund, përfunduen për të zgjedhë në mes alfabetit latin dhe atij grek. Fjala u përhap dhe foli shtypi. Kristoforidhi me shokë vendosën të venë te Aali pasha dhe biseduen me te. Po sërish nuk u mbarue gja. Qeveria turke qi, në dukje, tregoi se ish gati t'i

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

ndihmonte patriotët tanë, e pengoi punën e tyne, tue dashë t'i përçajë në myslimanë e të krishtenë: me shqipen, lejonte ajo, duhej të merreshin vetëm të krishtenët, sepse myslimanët ishin «turq» (31).

Aali pasha vdiq në vjeshtë 1871, kohë në të cilën Kristoforidhin e gjejmë gjithmonë në Stamboll. Më 1872, si mbaroi së shtypuni përkthimet e tij, Shoqënia Biblike e pushoi. Tani, Kristoforidhi e pat krye gjith punën për të cilën ish ngarkue: pat përkthye *Dhiatën e re*, gja qi ishte puna kryesore, diçka prej *Dhiatës së vjetër (Psalterin)*, nji *Histori të shkronjës së shenjtë*, dhe ndonji vogëlimë si *Katër kateqizmat*. Pat botue edhe *Abetaret* qi do të shërbejin posaçërisht edhe për leximin e librave. Të gjitha gegënisht dhe toskënisht.

Pa punë, Kristoforidhi u gjind ahere fort ngushtë në Stamboll. Vërtet ai pat fitue shum, po nuk qe i zoti ta mbajë paren: ate qi merrte, e prishte. Ka mbetë e njohtun nji fjalë e tij e kohëve të vështira: «Un jam ai Konstandini qi prishja nji lirë inglizi në ditët, un jam ai qi prish dy beshlëke» (32). Me anë të miqësive qi pat lidhë dikur në Tiranë, erdh për së dyti herë mësues në shkollën greqishte të këtij qyteti, më 1872. Po edhe këtu hoq shum, sepse mësuesit ahere paguheshin tepër pak dhe nuk duket te ketë pasë gjithmonë punë. Mbeti aq keq, sa u shtrëngue të hapi nji mejhane për të fitue bukën e gojësi Ishte tregtia ma e lehtë, qi nuk donte kapital. Gjith ahere, e shohim të shkojë në Tunizi dhe të shesi pasuninë e grues. Gja me randësi: në të kthyem, qëndroi dy muej në Kalabri, doemos për të njohtë në vend gjuhën arbëreshe, sipas zakonit qi kishte. Këtë udhëtim e ka bamë rreth viteve 1873 ose 1876, sepse, në maj 1874, Dozoni e ka gjetë në Tiranë (33); më 1875 e shohim në Berat, ku, bashkë me mikun e tij të Stambollit, Hoxha Tasimin, dhe patriotin vendas, Jorgj Karbunarën, bajnë mbledhje e mundohen t'organizohen për çashtje të gjuhës; sukses nuk patën (34); në qershor 1877, nji patriot i Misirit, Thimi Krei, na mëson se Kristoforidhi ka hapë nji shkollë shqipe ne Tiranë: asht fjala për mësimet shqipe qi ai e kishte zakon t'u epte, vjedhazi, nxanësve të tij, se shkollë shqipe Kristoforidhi nuk hapi dot asnjiherë (35). Kështu pra, si ne Stamboll, si në Shqipni, Kristoforidhi tentonte radhazi t'organizojë patriotët për shqipen, dmth për çashtjen kombëtare, sepse për të dhe shkët e tij gjuha ishte kryet e punës. Si propagandist a' filiste kudo për këto gjana dhe guxonte të mësojë shqip nëpër shkollat greqishte, nji të cilat qëndronte si kuçedër Fanari me dhespotlerët e tij, në nji kohë kur librat ia mallkojin dhe ia digjin në kishën e Ligjes së vet Kala t'Elbasanit, i luftuem e i përbuzun prej klerit dhe fanatikëve si i pabesë, sepse pat përkthye Ungjijet shqip dhe për protestanët.

Më 1877, Shoqënia Biblike vendosi të ribotojë toskënisht *Dhiatën e re* dhe të vazhdojë përkthimin e *Dhiatës së vjetër*. Çoi e thiri Kristoforidhin, i cili, me gjith familjë, la menjiherë Tiranën, tue lanë për nji

BIBLIOTEKA KOMBËTARE "MARIN BARLETI" SHKODËR

kohë edhe mjerimin. Që më 1878, nisi botimet me *Ungjillin pas Mattheut*. Të plotë, *Dhiatën e re* do ta botonte nji mot ma vonë. Më 1880 gjer më 1884, u botuen disa pjesë të *Dhiatës së vjetër* dhe tani Kristoforidhi u shkëput fare prej Shoqënisë Biblike, pa e mbarue punën qi pat nisë për te. Se si ngjau kjo shkëputje nuk dihet. Sipas Aleksandër Thompson-it, ai qëndroi pesëmbëdhjetë vjet në shërbim të Shoqënisë Biblike (36), dmth mbrenda viteve 1866-72 (tetë vjet) dhe 1877-84 (shtatë).

Në fund të dhjetorit 1874, kur Kristoforidhi asht akoma në Tiranë, kryeministri xhonturk, Midat Pasha, shpalli nji kushtetutë qi u premton popujve të shtypun të Turqisë reforma dhe liri të ndryshme, të cilat mbesin në kartë. Kristoforidhi enthusiaset për këte kushtetutë: miqëve të tij Tiranas u thotë me gëzim se tani «luelëm në selamet». Kristoforidhi pat besim se diçka do të dilte nga xhonturqit. Po këta mendojin si e si të shpëtojnë perandorinë nga shkatërrimi, gja qi s' ishte aspak n' interes të popujve të robnuem nga Turqia. Më 1877, kur erdhi sërish në Stamboll, Kristoforidhi shkoi dhe u takue me Midat pashën (37) për çashtje të shqipes, dhe ky e përcolli me premtime. Si duel s' andejmi, Kristoforidhi mbiodhi disa shqiptarë myslimanë dhe u muer vesh me ta për t' ia hymë punës. Katolikë shqiptarë kishte pak ahere në Stamboll dhe ortodoksët nuk i afroheshin. Po kur u kthye sërish te pasha qi të flasi me te për nisjen e punës, ky nuk e priti mirë e i tha se myslimanët nuk duhej të përzjeheshin n' ate çashtje, po vetëm të krishtenët.

Më 1879, Kristoforidhi mori pjesë në mbledhjet qi përgatitën Shoqëninë e Stambollit, bashkë me shokët e tij të vjetër, Vreton dhe Vaso Pashën (38), po nuk e shohim të nënshkruejë kashkë me ta *Kanonizmën* (Regulloren) e asaj shoqënie (39). Çashtja nuk spiegohet lehtë për këte iniciator t' organizimit të shqiptarëve të Stambollit. A mos mungoi ahere, për nji kohë të shkurtën, Kristoforidhi nga kryeqyteti? Se dhe të shkëputun prej anëtarëve të shoqënisë, nuk e shohim, të pakën gjer më 1882. Kështu, më 1881, ai na thotë se ka ndihmue Vreton qi të niset për Bukuresht (40), ku ky themeloi degën e Shoqënisë së Stambollit; duket se bashkë me te janë nisë edhe nji djalë e nji vajzë të Kristoforidhit, Aleksandri me Anastasinë, për të studiue në Bukuresht, ku Vretua asht kujdesë për ta (41). Më 1882, Shoqënia e Stambollit vendosi ta botojë *Fjalorin* e Kristoforidhit dhe u muer vesh për shpenzimet me degën e saj në Bukuresht; letrën zyrtare të shoqënisë e ka nënshkrue edhe Kristoforidhi (42). Gjith ate mot, Naimi nënshkruen për Kristoforidhin lejen e botimit të *Gramatikës* së këtij (43) dhe dy vjet ma vonë merret prej Komisionit të Çensurës, ku Naimi që anëtar, leja për botimin e *Fjalorit* (44). Ja shenjat e marëdhanjeve të mira të Kristoforidhit me themeluesit e Shoqënisë së Stambollit. Asht e vështirë të thuesh pra se, më 1879, ai ndejti mënjanë lëvizjes së shqiptarëve të Stambollit për t' u organizue. Dhe nuk duhet mbështetë te fakti se Kristoforidhi nuk shkoi mirë ma

BIBLIOTEKA PUBLIKE „MARIN BARLETI" SHKODËR

vonë me udhëheqësit e Shoqënisë së Stambollit, me gjith se me Vreton nuk duket te jetë prishë kurr, qi të thomi se më 1879 ai ndejti mënjanë. Me ta, Kristoforidhi u zemërue pasi nuk i botuen *Fjalorin*, siç e kishin vendosë më 1882. Asht e drejtë me gjith ate të thomi se Kristoforidhi nuk ishte për nji alfabet të përziem, si ai qi zgjodhën Vretua, Vaso Pasha, Sami Frashëri dhe Koto Hoxhi me shokë. Ai ishte për nji alfabet ma të thjeshtë, të cilit mund t'i gjindeshin germat kudo, pra qi t'ishte ma praktik e të mos kërkonte shpenzime të mëdha për të derdhë shkronja, si kërkonte alfabeti i Stambollit. Kristoforidhi donte alfabetin latin (45). Për sa i takon marëdhanjeve të tij të ngushta me Nikolla Naçon, qi ishte kundërshtar i degës së Shoqënisë së Stambollit në Bukuresht, kjo spiegohet nga fakti se ai bashkohej jo vetëm me pikëpamjet e Naços për nji alfabet latin, po dhe me përpjekjen e tij për të bashkue në lëvizjen kombëtare edhe shtresat ma t'ulta të shqiptarëve, gja qi nuk e bante dega e Bukureshtit. Më 1888, Kristoforidhi kërkon të bashkëpunojë me Naçon dhe të botojë me te libra (46).

Mosmarrja pjesë e Kristoforidhit zyrtarisht në formimin e Shoqënisë së Stamboltit, ka të bajë ndofta dhe me akuzat e fanatikëve qi e përbuzin këte përkthyes t'Ungjijeve për protestantët, tue qenë të bindun edhe se ai qe bamë protestan. Vretua e ka mprojtë Kristoforidhin kundër këtyne akuzave, me gjith se dhe ai fanatik ortodoks ishte (47). Ka randësi të kujtohet këtu se Kristoforidhi i shërbeu Shoqënisë Bibilke vetëm si përkthyes: më 1871, kur ai mbaroi punën e shoqënisë, kjo e pushoi; më 1884, kjo e pushoi pa mbarue së përkthyemi *Dhiatën e vjetër*. Që më 1879, shoqënia paguente njerës për të përhapë librat e saj ndër shqiptarë dhe mbrenda në Shqipni; më 1884, kur shoqënia e pushoi, Kristoforidhi mbeti keq në Stamboll, po përhapës i librave të saj nuk u ba, si Qiriast ma vonë. Dihet se përhapësit e librave të Shoqënisë Bibilke qenë zakonisht edhe agjentë t' Anglisë ose t'Amerikës nëpër Ballkan e kudo. Kristoforidhi këte gja e dinte dhe ia pat thanë Vretos, qi shkruen në nji nga letrat e tij se, sipas fjalëve të Kristoforidhit, shoqënitë protestane amerikane dhe angleze e kanë ndamë botën më dysh në mes tyne dhe se, me anë të «dogmës» (fesë), ato luejnë politikën, tue shtue se nga kthetrat e tyne bullgarët i shpëtoi «Sllavi i math» (Rusia), se nga protestanët mund të kishin marrë fe dhe dituni, «po lici kurrë me sy s'kishinë për të parë». «Këtë të mirë kërkonënë të na bënjënë dhe neve», shprehet me ironi Vretua më 1895, kur Qiriast e kanë shtue propagandën protestane në Shqipni, tue hapë edhe nji shkollë në Korçë dhe tue botue libra (48). Asht Kristoforidhi ai qi i ve në roje patriotët kundër qëllimeve të fshehta të protestanëve anglo-saksonë, emisarë t' imperializmit të tyne në Ballkan.

Në se Kristoforidhi u kthye protestan (49), kjo qe për te nji çashtje edukate dhe besimi: ai me protestanët asht në kontakt që fare i ri dhe

BIBLIOTEKA RAJONALE SHKODËR "MARIN BARLETI"

duket se nji seminar të tyne kreu në Maltë; nga ana tjetër, ritet fetare i duken gjana të kota dhe qi dëshmojnë për paqytetni ose prapambetje; për te, Perëndia i kristianizmit asht te Ungjijet dhe jo te kreshmët e kungimet dhe gjana të tjera të llojit. Këto ai i quente «kashtë» dhe fjalën e Ungjillit «grunë», kur fliste me njerëzit. Asht kuptimplote nji anekdotë nga ato të shumtat qi tregohen për te: Nji ditë, nji nga Toptanasit e Tiranës e pyeti Kristoforidhin për kreshmët dhe ramazanin; Konstandini i u përgjegj se kreshmët e ramazanin ua vunë njerëzve mbi kurris qi t' i hypin majë nji kodre, po se i mençëm asht ai qi i lëshon. Kjo nuk do të thotë se Kristoforidhi pat qenë skeptik ose nuk pat besue, gja qi do ta vinte në kundërshtim me vetvehten, si përkthyes t' Ungjijeve. Po me ritin dhe klerin nuk pat qenë mik, nuk i donte.

Më 1880, kur lëvizja patriotike në Shqipni dhe në Stamboll asht e madhe, kur patriotët kanë shtrue çashtjen e krijimit të nji Shqipnie autonome qi të përmbledhi vilajetet e Shkodrës, Shkupit, Manastirit dhe Janinës, asht interesante të shohim se cilat qenë ahere mendimet e Kristoforidhit. Ate mot, në korrik, i dërguemi i posaçëm i Anglisë në Stamboll deshi të ketë mendimin e nji shqiptari mi lëvizjen e populli tonë, dhe Aleksandër Thompson-i i dërgoi Kristoforidhin. Për bashkëfjalimin qi patën, i dërguemi i shkroi qeverisë së vet në Londër dhe letra u botue ma vonë në *Librin e kaltër* britanik. Dokumenti, me shum randësi jo vetëm për Kristoforidhin, po dhe për lëvizjen e rilindjes, na mëson se Konstandini i ka ndjekë me kujdes ngjarjet, i ka çmue drejt dhe ma realisht se disa shokë të tij të kohës. Mënjanë, Kristoforidhi çfaq besim dhe simpati për lëvizjen kombëtare qi synon autonominë e vendit; nga ana tjetër, ai nuk asht për Shqipninë me të katër vilajetet rrumbullak, sepse shum tokë të hueja do të bajin ashtu pjesë në te, gja qi ish n'interes të feudalëve shqiptarë qi nuk dojin të humbin çifligjet e tyne të Maqedonisë e gjetiu; Kristoforidhi nuk tregohet për Shqipninë e madhe qi kërkojnë edhe njerës si Vaso Pasha, Sami Frashëri etj, nuk asht shovinist dhe i padrejtë; çashtjen e minoriteteve shqiptare qi mund të mbesin te fqijt grekë, ai e sheh fare drejt: minoriteteve t'u respektohen të drejtat e tyne kombëtare. Ka mundësi qi mendimet e tij për Shqipninë autonome qi kërkohej më 1878-81, mendime qi ishin në kundërshtim me kërkesat e feudalëve tanë, nga të cilët shum muerën pjesë në formimin e Shoqënisë së Stambollit, të kenë bamë qi Kristoforidhi të mbesi mënjanë veprimtarisë së themeluesve të kësaj shoqënije. Ma vonë, ai pajtohet nuk do të merret vesh me disa prej tyne, posaçërisht me Vreton, për çashtjen e mbështetjes së lëvizjes sonë kombëtare nga Rumania: si edhe Nikolla Naçoja, Kristoforidhi mendonte se te Rumania mund të mbështeteshim pa frikë, sepse kjo nuk mund t'ushqente mendime të liga për Shqipninë, me të cilën nuk kishte kufij të përbashkët; kurse Greqia dhe Serbia vendit tonë ia kishin me të pa-

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR

besë, dojin ta copëtojnë. Edhe kësaj radhe, Kristoforidhin e gjejmë realist, pa na u çfaqë urrejtës i fqijve dhe shovinist, po vetëm i druejtun, dhe me shum të drejtë, kundër klikave të tyne qeveritare të kohës (50). Afërisht, mendime të tilla kanë çfaqë edhe Samiu me Naimin ma vonë, duke dashë të merren vesh edhe me gjith bailkanasit dhe populli ynë të jetojë miqësisht me ta.

Më 1884, kur u gjind keq pa punë në Stamboll, Kristoforidhi i shkroi parisë së lagjes Kala t'Elbasanit qi ta marrin mësues në shkollën e tyne greqishte. Paria u mbloth: shumica e deshën, po pat edhe kundërshtime të forta. Së fundi, i dërguen lajm qi të niset. Në mes të gushtit, Kristoforidhi shkarkonte në Durrës me gjith fëmijë (51). N'Elbasan, plot qenë ata qi e pritën me nderime. Konstandini la shum kujtime të mira nga vitet e fundit të jetës së tij qi çoi në qytetin e lindjes. Siç pat bamë dikur në Tiranë, edhe këtu ai u mësonte fëmijëve shqipen vjedhazi në shkollë, tue rritë kështu filiza të rij patriotësh, nga të cilët disa u dalluen ma vonë në lëvizjen kombëtare. Gjithmonë propagandonte idetë kombëtare të kohës dhe vazhdonte punën e tij të gjuhës, tue përmirësue *Fjalorin* qi nuk pati fat me e botue për së gjalli, dhe tue vazhdue përkthimin e *Dhiatës së vjetër*. Veçse tani kish marrë nji ves të keq, i cili siç duket u ba shkaktar të vdesi para kohe: pinte shum. Duket se rakinë e vuni që në Tiranë, kur hapi mejhanen për nevojë.

Më 1888, Kristoforidhi e la punën e tij në shkollë dhe u ba anëtar i gjyqit të paqit n'Elbasan. Si i tillë, paguhej ma mirë dhe nuk e ndjente vehten nën mikqyrjen e klerit qi i kishte shkollat greke nën urdhën. Ashtu e gjet, në gusht 1889, albanologu gjerman Gustav Weigand, i cili na flet me admirim për *Fjalorin* e Kristoforidhit. Gjith po Weigand-i na mëson se ishte në gjendje fort të mjerueshme dhe se, ma mirë i pëlqeu të flejë në hant, se në shtëpi të Kristoforidhit (52). Kush kujton hanet e vjetra t'Elbasanit, mund t'imagjinojë seç jetë e zezë çonte Konstandini.

Pas nji sëmundje të shkurtën, vdiq n'Elbasan, nga hidropizia, më 23 shkurt allaturka, ose 7 mars 1895. E pat lanë me gojë ta varrosin në manastirin e Sh. Jon Vladimirit, vend i bukur prapë Elbasanit, ku i pëlqente ngaherë të shkojë. Kur ish gjallë, thoshte: «Kur të vdes, të më shtini në Sh. Jon, e vorrin të ma bani në bakçet, ke furra, qi, kur të vijnë njerëzia të shofin nji vorr të vetëm, të pyesin: ç'asht ky vorr i vetëm? Ju t'i thoni: «Ky asht vorri i Konstandin Budailit!» Diçka si nji dëshpërim, ma shum se tjetër gja, ndihet te ky epitet qi i vinte vehtes buzagas Konstandini: dëshpërim se nuk mundi të bajë ma shum e ma mirë në jetë, po sidomos se kishte mbetë në gjendje të vështirë ekonomike dhe fëmijët do t'i linte të vuejnë. Po gjindja qi e çmonte dhe e donte, për zemrën e tij bujare, dijen e madhe, shërbimet e ralla qi i pat sjellë Shqipnisë, i bani gjith nderet e mundëshme. Fjalën s'ia

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MIRIT BARLETI" SHKODËR

çoi dot në vend, qi ta dërgonte në Sh. Jon, sepse bani mot fort i keq, po e vorrosi në fushën e kishës Sh. Mëri të lagjes Kala, prapa kungës, aty ku pat vorrosë të parët e fesë, dhespotlerët. Kjo ndofta qe nji ironi për Kristoforidhin, qi dhespotlerët s'i deshte; veç për popullin bestar qe nderi ma i math qi munt t'i bahej. Nxanësi tij, mësuesi patriot dhe lërues i shqipes, përkthyes i Sofokliut e i klasikëve, Tush Pina, mbajti nji fjalim mallëngjyes, i cili filloηte me këto fjalë: «Qani ju male të Shqipnisë...» Gjindja vështruen njani-tjetrin për guximin e mësuesit, qi shprehte ashtu dhimbjen e të gjithëve për vdekjen e «babait të shqipes», t'asaj shqipeje qi sundimtarët turq aty prezent nuk lijin të dilte në dritë.

Në kondikun e Esnafit të Bojaxhijve t'Elbasanit, asht shkrue: «1895, në shkurt 23. Vdiq Kostantini Anastas Neikos (Kristoforidhi). Ka vdekun e mur Zoti në parrajs, ku asht babai gjith shqiptarvet qi ndriçoi gjuhën ton.» (53) Njeriu mallëngjehet kur lexon këto fjalë të bojaxhiut patriot, Losh Papamihali, shok i vjetër i Konstandinit, i cili shpreh ashtu dhimbjen dhe nderimin e popullit të thjeshtë, qi Kristoforidhin e pat dashë me zemër dhe e pat kuptue. Edhe Kristoforidhi vetë, në vegjëlinë e pat shpresën dhe besimin. Ja se si i shkruente, disa vjet para se të vdesi, nji patrioti tjetër qi shpresën dhe besimin te vegjëlia e kishte, Nikolla Naços: «Ndë thënç për bejlerët, për agallarët e për zotëritë, ata nuk apin ndihmë, sepse kanë frikë nga «dera e lartë» mos kallëzojnë keq për ata e u vjen ndonjë rrezik mbi krye... As të parët e krerët e të gërshterëve nuk apin ndihmë. Ata që e duanë shqipen, janë nga dora e dytë...» (54). Këta qenë ma t'afërmit e tij në jetë dhe qi e deshën ma shum dhe i desh.

II. BOTIMET

Qëllimet tona në këte pjesë të studimit, janë dy:

E para, me saktësue bibliografinë e Kristoforidhit, e cila njihet pak dhe keq — sidomos kur asht puna për botimet pjesërishte, ribotimet dhe dorëshkrimet e tij. Këto të fundit, ka mundë me i njohë vetëm kush i ka pasë pronë, zakonisht tue i fshehë prej syut të studiuesve. Edhe nji bibliograf si Emile Legrand-i, nuk pat rastin t'i gjejë dhe t'i përshkruejë gjith botimet e Kristoforidhit. Pasunimi i math i Bibliotekës Kombëtare, lejon me njohtë pjesën ma të madhe të tyne. Prap se prap, me gjith qi konsultuem edhe bibliotekat e Elbasanit dhe Korçës, nuk na qe e mundun t'i njohim të tana. Për disa prej tyne, do të flasim simbas

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

bibliografëve të tjerë, apo shënimeve qi kemi gjetë nëpër kapaqet e librave të Kristoforidhit. Nji herë do të rrjeshtojmë botimet e bame nën kujdesin e auktorit vetë, botime qi mbarojnë më 1884, pastaj ato qi s'u banë nën kujdesin e tij dhe postumet; së fundi do të flasim për dorëshkrimet. Botimet qi s'u banë nën kujdesin e tij, i kemi krahasue me botimet orgjinale për të shëkue ndryshimet, të cilat janë të shumta, gjer në defigurimin e veprës. Për veprat qi përshkruen Legrand-i, do t'apim referencë.

E dyta, me dhanë nji ide konkrete të zhvillimit të gjuhës së Kristoforidhit, t'influencave qi ky pësoi dhe ushtroi, nëpërmjet teksteve të krahasueme. Transkriptimi jonë s'e ka ruejtë aspak theksimin, për arsye teknike. Rallëherë kemi prekë edhe pikësimin.

a) Botime të bame nën kujdesin e Kristoforidhit

1) KATËR UNGJILLAT E ZOTIT EDHE SHËLBYESIT TONË IESU KRISHTIT EDHE PUNËT E APOSTUIVET, KETHYMUN PREI GREQISHTES VIETËR SHQIP NDË GJUHË GEGËNISHTE PREI KONSTANTINIT KRISTOFORIDHIT, ELBASANASIT, KONSTANTINOPOL. Stampumun për BRETANIKEN & TË HUJËN SHOQËNINË E BIBLËS, Prei A.H. BOJAGIAN 1866. (55)

Në 16, fq 420, + 3 fl të panumërueme. Mbrendia: Ungjilli mbas Mattheut, Ungjilli mbas Markut, Ungjilli mbas Llukës, Ungjilit mbas Gjionnit, Punët e Apostuivet. Në verso të fl 3 të panumërueme: «Çilsi i letrave» (shkronjave); për *dh*, *th*, *y* dhe *z*, jep korespondetet e alfabetit të klerit katolik të veriut, gja qi tregon se botimet e tyne i ka njohë; fjalët qi ep si shëmbulla, i spiegon italisht.

Asht botimi i parë i Kristoforidhit. Gegënisht. Shoqënia Biblike pat nevojë ta përkthejë *Dhiatën e re* në këte dialekt, mbasi toskënisht e pat botue Grigori. Kristoforidhi pat parasysh punën e këtij, gja qi del prej krahasimit në mes tyne (56). Po ndryshimi asht fort i math, e para se Kristoforidhi shkruen gegënisht, e dyta se gjuha tij asht ma e re, ma e zhvillueme dhe ma e pastërt. Ky studioi edhe shkrimtarët kishëtarë të veriut t'asaj kohe, si italianët Gualata dhe Basile etj, influencën e të cilëve e shohim te shkodranizmat e shumta qi përdor, te mos përdorimi i rëndomtë i zanores *ë*, te italianizmat. Po Kristoforidhi kërkon të shkruejë nji gegënishte të përzieme, qi të mund ta kuptojnë gjith gegët; nga ana tjetër, ai asht mundue ta spastrojë sado pak, gjuhën nga barbarizmat Po japim disa copa qi të shihet konkretisht përparimi i shqipes me Kristoforidhin më 1866 dhe influencat qi ky pësoi.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

GRIGORI 1872.

Ahiere trjmat' e lgjemonit, e muar-rē (58) Insunē, ntē Pretorio e mbējuadhē mbi atē gjithē shoqētē. E si e sveshnē, i vunē sipēr njē hlamidhē tē kuqe. E pleksnē kurorē nga gjēmba, e vunē mbi krie tē tij, e i dhanē edhe kallam mbē dor-rē tē djathētē tē tij, e bijnē mbē gjunjē pērpara tij, e pērqeshnē atē e i thoshnē, gēzou mbret i çifutet. E si pēshtijnē nte ai, muar-rē kallamnē, e i bijnē mbē kokē tē tij. E si e pērqeshnē atē, i nxuarē hlamidhēnē, e i veshnē rrobat'e tij, e e shtunē ta mbērthejnē ntē Krujq. E si duallē gjenē njē njeri nga Qirini, qē e thoshnē Simon, atē muar-rē angari, qē tē ngrerē Kryjqn' e tij. E si erdhi ntē vēnt qē quhaetē(60) Golgotha, ai ēshtē qē thuhaete vēnt i krerēvet, I dhanē atij tē pij uthullē trazuarē me me vērer, e si e vuri ntē gojē, nukē duaij tē pij. E si e kryqiasnē atē, ntaijtēnē rrobat' e tij, si shtunē shortē...

KRISTOFORIDHI 1866.

Atēhere simenēt (57) e guvernatorit murēn pretorio (59) (ndē shtēpi tē guvernatorit), edhe mbēlodhēn mbi atē gjithē tubēn e seimenvet. Edhe e shdeshēn, e i veshēn nji kllamidē (kaftan) tē kuqe. Edhe gērsheshtun nji kunorē ferrash, e ia vun mbi krye t'ati, edhe i dhan nji kallam ndē dorē tē diathtē: edhe ran ndē gjui pērpara ati, e luishin me atē, tue thanun, Falemi, Mbreti i Gjiudevet. Edhe si e pēshtyn, murēn kallamin, edhe i bijshin ndē krye. Edhe mbasi luitēn me atē, i shdeshēn kllamidēn, edhe i veshēn petkat e ati, edhe e çun pēr me e kryqēzumun. Edhe tue dalun, gjetēn nji nieri Kyreneas, qi e kishte emnin Simon: kētē e zun angari pēr me ngritun kryqin e ati. Edhe kur erdhēn ndē nji vend, qi quhet Golgotha, ai asht qi thohet vend i kresē, i dhan me pimun ufull trazumun bashkē me t'amēith: por ai si e vuni ndē buzē, uuk deshti me pimun. Edhe si e kryqēzun, shtin shortē, e dan petkat e ati...

GUALIATA 1856.

O lumnuoshm e ngushuoshm apostul i Indit sh'Françesk Xaveri, ti mme nji zel fort i nezun punnove me mpsue dottrinen e kershten: ti praa mer ket libr nnen t'dalunit-zot tan: ty ma mir se tietrit do t'shiugurohet. Nnimo edhe gjith ata qi munnohen me mpsue dottrinēn: jep atynvet t'durim, zel, t'qindrim n'ket vievshm zannat. Shikio mme sy t'dashtun fmiit: shtie n' krahnorin atynvet dashtniin e gjithmonshme me zan dottrinen e shejtē.

BASILE 1873.

Peennessa qi t'ka dhan rfyesi do t'bahet sa ma shpeit munet: mos e harro, pērse asht borxh i madh me e ba. Por mos u nnat o i kershten n'peenness, qi t'iep rfyesi: due me than, ban edhe peennessen e vulnecme; çdaire nuk asht nētēr çdaire pēr me pague munnimin e sosm t'mkatit, se me u munue ktu n'durnja. Oh i lumi ti, se kee kastigue korpin n'dheel Munesh sakt me shpnessue ken libruem prej munnimesh t'purgatorit. Mos t'keesh pritese me njinue...(61)

BIBLIOTEKA PUBLIKE MIRIN BARLETI SHKODER

2) Në kapakun e *Katër Kateqismave* (1867), për të cilat do të flasim ma poshtë, në faqen e fundit, Kristoforidhi ka reklamue librat gegënishte qi pat botue ma parë : këto janë *Katër Ungjillat* për të cilat u fol, dhe nji ABETAR SHQIP ME FIGURE qi shitej «1 grosh». Për këte libër nuk asht folë prej asnji bibliografi, me sa dimë ne, dhe s'e kemi pamë kundi. Cila qe data e botimit, 1866 apo 1867 ? Ka të ngjamë të jetë e para, për arsye se Kristoforidhi duhet të ketë mendue të botojë nji herë abetaren e pastaj përkthimet. Pra munt të jetë ky i pari botim i Kristoforidhit ose të ketë dalë bashkë me *Katër Ungjillat*..

3) KATËR KATEQISMA për ÇUNAT E VOGJILË. Dy për Emnat' e Shkronjës', dhe Dy për Dotrinën' e Krishtenë edhe Duverinë. Këthyem prej Konstanin Kristoforidit, Elbasanasit. KONSTANTINOPOL. Stampa A. H. Bojagian. 1867.

Në 16, fq 32. Në fq 2 dhe 3 të kapakut, ka «Truvezën e letrave», ku shkronjave të tij latine u ve përballë ato qirilike. Libri ka figura.

Kjo vepërzë e Kristoforidhit ka rëndësi të madhe për zhvillimin e gjuhës së tij. Që tani, auktori ka përparue shum në shkrimin e gegënishtes, pasi ka njohtë Budin dhe Bogdanin. Nën influencën e tyne, ai përgjithson përdorimin e zanores *ë* mbrenda dhe në fund të fjalëve, gja qi e afron prej toskënishtes gegënishten. Përgjithson gjithashtu përdorimin e diftongut *ue*, duke braktisë trajtat verbale qi mbarojnë me *un* (te verbat e klasit të parë). Largohet mjaft prej shkodranishtes dhe e pastron shum gjuhën nga barbarizmat (vetëm tri fjalë të hueja në gjith tekstin). Shembull :

«Cili ishte Davidi ?

Nieri mbas zemrësë Perëndisë, edhe tue qenë bari, uba mbëret' i Israelit : i cili shkroi të shumat' e psallmavet, edhe prej farës' ati Ieu Krishti, përandai ai quhet' i bir' i Davidit.

Cili ashtë duveri yt mbë njerëzit?

Duveri em mbë nierëzit ashtë, të ndëgjoj përindtë, të flas të vërtetënë përherë, edhe të dem të gjithë.

Si munde me dëftuem dashuninë, qi ke mbë të afrëmit?

Tue nderuem, e tue ndëgjuem ata qi janë ma të mëdhenj se unë : tue folunë të vërtetën', e tue u bamë mirë gjithë nierëzet, miq qofshin'a anëmiq të afrëmë qofshin'a të hujë».

4) PSALLTIRI. KTHYERË PAS EVRAISHTESË VIETËRË SHQIP NDË GLUHË TOSKËNISHTE PREI KONSTANTINIT KRISTOFORIDHIT, ELBASANASIT. KONSTANTINOPOL. Ndë shtypa-shkronjë të A. H. Bojaxhianit. 1868.

Në 12, fq 122, + 5 fl, nga të cilat dy të bardha. (52)

Asht e para vepër toskënisht e Kristoforidhit, pra ka një randësi të

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

veçantë. A mos e përshtati prej versionit gegënisht të Psalliterit, qi do të botojë më 1872? Ka të ngjamë, sepse, në fq e katërt të kapakut të *Katër Kateqismave* (1867), ai shënon se «Shpeit ka me ustampue edhe Psalliteri me ato letra (shkronjat latine) grosh 3». Nji krahasim i thjeshtë me Grigorin dhe Vejiiharxhin, tregon se toskënishtja ka përparue që në këte shkrim të parë të Kristoforidhit. Ky shkruen nji toskënishte të përzieme, siç pat bamë edhe me gegënishten. Që në titull, vihet re forma «gjuhë», arkaike, që dëgjohet te çamët dhe arbëreshët. Me gjith ate, kemi të bajmë me nji toskënishte të mesme dhe qi ka marrë udhën drejt gjuhës së rilindasve, të Naimit me shokë. *Psalmet*, në vetvehte, janë vepra me vlerë të çqueme artistike dhe Kristoforidhit i u desh të bajë edhe nji përpjekje artistike të vërtetë qi t'i përkthejë, duke ia arritun mjaft mirë qëllimit, me gjith se shkruen nji dialekt qi s'asht i veti. Kjo asht përpjekja ma e randësishme artistike qi asht bamë në Shqipni përpara rilindjes.

GRIGORI 1827.

E tek ku vëndoijnë ata, e rrëfeijnë njieri jiatërit, u afërua edhe Insui, e bij me ta bashkë. E sit' e ture u qenë thamposurë, që të mos e njihnë atë. E u thot' ature: ç'kuvënte jianë këto që bëni njierin me jiatërinë tuk' e ecurë, e pse jini të heimuarë? E njieri nga ata që qiuhaeij Kleopë, u përgjeigjq, e i thot' atij, ti vetëmë je i huaij ntë Ierusalim, e nukë di këto që jianë lënë mpë të ntë këto dit. E u thot' ature: ciliatë? Edhe ata i than' atij: punëratë që u bënë rrotullë Insuit Nazareut, që qe profit i fortë, ntë punë edhe ntë fjialë, përpara Perntisë, edhe gji-

KRISTOFORIDHI 1868.

Gjeta Dhavidhë shërbëtorinë t'im: e leva me vaj t'im të shenjtëruarë. Dora ime dot' e forconjë, edhe krahu im dot' i apë fuqi. Arëmik s'ka për të dalë më i fortë se ay: edhe bir pa-udhërie s'i ka për të bërë keq. Edhe kam për të prerë arëmiqt' e ati përpara syvet ati, edhe kam për të thyerë ata që i kanë mëri. Po drejtëria ime edhe përdëllimi im do të jëne bashkë me atë: edhe më emërit t'im do të lartonetë briri ati. Edhe do të ve dorën ati mbë det, edhe të diathtën e ati mbë lumënit. Ay do të thëresë ndek unë, Ti je Ati im, Perëndia im, edhe gur'

VEQILHARXHI 1845.

Gjuha jonë shqipeja, sindëkur e dini se, nga shumë të sjellat e të kthyerat e kohës, edhe më fort që s'ka pasur dritat e të msuarit, ka marë shumë fjalë e kuvise të huaja. Posa soila mbë shëmbëll ëvet sa e si duheshin për këtë gjuhënë tënë, pasdaj, mënjëherë, u vushë të bënj gjith ato fletore që duhen për djelm nismëtorë, duke tërsjellitur nga gjuhë të tjera mbë tënën. E para e punës ish që si të munt të nxjer fjal' e kuviset e huaj, e mbë vënt të tyre të derthtonj të tjera nga veti-me e gjuhësë. Edhe me gjith që, hë për hë, munt të mos tringëlloj-

BIBLIOTEKA PUBLIKE
„MARIN BARLETI"
SHKODËR

thë laoit. Edhe qish të parët e priftëret edhe arhontëtë tanë e dhanë atë të muntonetë me vdekëje, e e mbërthienë atë ntë Kruijq. E navet kemi omuth se ai është, që do të lefterosjë Israilnë. Po ntashti përveçë këture tri dit ka sot që kur u bënë këto. Ma edhe ca gra nga nevet na nxuarë nga mëntë, si vanë që mëngjesënë ntë varr.

i shpëtimit t'ënë. Edhe unë dot' e bënj dialë të parë, të lartë mbi mbëretrit të dheut. Kurdo do të ruanj përdëllimnë t'im për a t ë, edhe dhiata ime dotë jetë e besuar bashkë me atë. Edhe dotë bënj farën' e ati të mbetetë jetë pas jete, edhe fron' e ati posi ditt'e e qiellit. Ndë heqshinë dorë të bijt' e ati prej nomit t'im, edhe ndë mos ecëshinë ndë gjyqet të mi... atëhere do të vështronj me shkop...

në ëmbël mbë të dëgjuarit e veshëve, po kam shpresë se koha do t'i ëmbëlsonjë. E a s h t u, sa që munda, nxora e ndërtova të tjera mbë vënt të tyre. Save që s'ua gjeta sesinë, i lashë ashtu, me shpresë që ju, o djem, do të mundni ta shtoni. Unë prandaj tërtherta kaqë gjëmë kohë aty e njëzet vjet, që t'u bënj *veglën*, e ju tashti e tutje vini pëlhurën. (63)

5) DHIATA E RE E ZOTIT EDHE SHËLBUESIT T' YNË IESU-KRISHTIT, KËTHYEM PREI GREQISHTESË VIETËR SHQIP NDË GJUHË GEGËNISHTE PREI KONSTANTINIT KRISTOFORIDIT, ELBASANASIT. KONSTANTINOPOL. Ndë shtypa-shkrojë të A.H. Bojagjianit. *Shitunë ndë Stamboll, udha Tahta-kaleh, Numëri 52.* 1869.

Në 8, fq 346, + 4 fl të panumurueme. Në fl 3 ep alfabetin shqip, të krahasuem me ate qirilik dhe turk, si dhe alfabetin latin të Shkodrës dhe ate grek qi përdor ai vetë në përkthimet toskënishte. Mbrendia: Katër Ungjijt dhe Punët e Apostujve, qi pat botue më 1867, me këto përkthime të reja: Letrat e Apostullit Paul mbë Romanët, Korinthianët (I dhe II). Galatianët, Efesianët, Filipianët, Kolossianët, Thesallonianët (I dhe II), Timothenë (I dhe II), Titonë, Filomenë dhe mbë Hebrejt; Letera e Përgjithëshime e Apostullit Iakop, E Përgjithëshimeja Ietër' e parë dhe e dytë e Apostullit Pietër, E përgjithëshimeja Ietër' e parë, e dytë dhe e tretë e Apostullit Gjionn, E përgjithëshimeja Ietër e Apostullit Iudë, Sbulesa e Gjionn Hyj-ditunit.

Landa pra asht thuej se dyfish i asaj të botimit 1867. Gjuha asht ajo e *Katër kateqismave* të këtij moti dhe ma e përmirësueme, simbas principeve të përgjithshme qi Kristoforidhi i vuni vehtes ate mot. Me fjalë të tjera, landa e botueme më 1866 ka qenë ripunue sipas këtyne principeve. Kur të fiasim për ribotimin e vitit 1872, do të bajmë krahasimin në mes gjuhës së botimit të parë dhe ate të dy ribotimeve.

6) HISTORIA E SHENJTËSË SHKROJË për dielmt. Përmbëledhunë kah Dhjata e Vietër' edhe kah historia e botësë, edhe *këthyem Shqip*

BIBLIOTEKA PUBLIKE MARIN BARLETI SHKODËR

ndë gjuhë Gegënishte PREJ KONSTANTINIT KRISTOFORIDIT, ELBASANASIT. KONSTANTINOPOL. Ndë shtypa-shkrojë të A.H. Bojagjianit. *Shitunë ndë Stamboll, udha Tahta-kaleh, Numëri 52.* 1870. (64)

Në 12, fq 136, + 5 fl të panumërueme. Fl 2 mban alfabetin të krahasuem, si edhe te *Dhiata e re* (1869). Fl 4 mban nji fjalorth me fjalët e raila ose të ra qi ka përdorë auktori, të spiegueme me korespondentet e tyne greqisht dhe italisht. Libri ka figura.

Gegënishtja e Kristoforidhit ka shkue përpara, asht bamë ma e përgjithshme dhe ma e sigurtë, në bazë të parimeve qi ai vuni më 1867.

6a) Në faqen katër të kapakut të *Historisë së shenjtësë shkrojë* (1870), Kristoforidhi reklamon librat e tij gegënisht dhe toskënisht qi janë për t'u «Shitunë ndë Stamboll, udha Tahta-kaleh, Numëri 52». Në mes atyne gegënisht, gjejmë *PSALLTERIN*, të «lidhunë, grosh 3», të ciliin e pat reklamue te kapaku i *Katër Kateqismave* (1867). Ka të ngjamë të jetë botue më 1868, në të njëjtën kohë qi duel versioni toskënisht. Asnji bibliograf qi njohim nuk flet për te.

7) Në të njejtin kapak, në mes librave toskënisht qi reklamon Kristoforidhi, gjejmë nji ALLFAVITAR, i cili shitet për «grosh 1». As për këte nuk flasin bibliografët. Ka të ngjamë të jetë botue më 1868, përpara ose krahas me të parin libër toskënisht qi njohim prej auktorit, *Psalltiri.*

8) Gjith po n'ate vend, në mes librave toskënisht qi reklamohen se janë në të «shiturë», gjejmë edhe librin DHIATA E RE GËRQISHT EDHE SHQIP, lidhurë, grosh 6». Edhe ky botim asht fare i panjohtun. Munt të jetë i vitit 1869.

9) ABETAR SHQIP PREJ KONSTANTINIT KRISTOFORIDIT ELBASANASIT. KONSTANTINOPOL. Ndë shtypa-shkronjë të A.H. Bojagjianit. 1872. (65).

Në 8 fq 30, + 1 fl. Me figura. A mos asht nji ribotim i parë ose i dytë i *Abetares* së reklamueme më 1867 dhe qi reklamohet prap te kapaku i *Historisë së shënjtësë shkrojë* më 1870?

10) ALLFAVITAR SHQIP. Prej Konstantinit Kristoridhit, Elbasanasit. — Pa datë dhe vend botimi.

Në 8, fq 31, + 1 fq të panumërueme. Me të njejtat figuara dhe tekste qi ka botimi gegënisht. Legrand shënon se ka «mundësi të jetë shtypë në shtypshkrojë të Bojaxhianit, më 1872» (66), po asgja nuk na siguron se nuk asht botimi qi Kristoforidhi ka reklamue më 1870.

Japim nji tekst të dy abetareve, për të pamë se sa pranë asht gegënishtja me toskënishten e Kristoforidhit më 1872.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

GEGËNISHT

Ylli vogël nalt ndë qiell
Duket' porsi ziarrm ndë pyll:
Sipër dheut lark qindron,
Xixa xixa xixëllon.
Dhisku diellit kur perëndon.
Nata hien' e lishon:
Ylli veten' e sbulon,
Xixa xixa xixëllon.
Drit' e yllit kur shkëlqen,
Udhëtarit ç'i pëlqen:
Natën' errët ku do shkon,
Udhën' vetëm s'e harron.
Natën çuni kur shikon,
Sipër dheut fort mendon:
Ment' e veta ç'i habit,
Ylli vogël se si ndrit.

TOSKËNISHT

Yll' i vogël' lart ndë qiell
Duketë si ziar ndë pyll:
Siprë dheut lark qëndron,
Xixa xixa xixëllon.
Dhisku i diellit kur perndon,
Nata hijen' e lëshon:
Ylli veten' e sbulon,
Xixa xixa xixëllon.
Drit' e yllit kur shkëlqen,
Udhëtarit ç'i pëlqen:
Natën' errët ku do shkon,
Udhën, vetëm' s'e harron.
Natën' çuni kur vështon,
Siprë botës, fort mendon:
Mënt' e tija ç'i habit,
Yll' i vogël' se si ndrit. (67)

11) PSALLTERI, KËSHYEM MBAS EBRAISHTES VIETËRË SHQIP NDË GJUHË GEGËNISHTE prej KONSTANTINIT KRISTOFORIDIT, ELBASANASIT. KONSTANTINOPOL. Ndë shtypa-shkronjë të A.H. Bojagjianit. *Shitunë naë Stamboll, udha Filxhanxhiler-jokushu, ndë Magazinë të Biblesë.* 1872. (68)

Në 8, fq 126, + 3 fl të panumërueme. Duhet të jetë botimi i dytë. I pari, që reklamohet që më 1867 se «shpeit ka me u stampuem», më 1870 u reklamue i botuem. Japim një copë të krahasueme të dy versioneve, toskënisht dhe gegënisht.

TOSKËNISHT 1868.

Mbi lumënjt Vavyllonëse, atie ndenjëm edhe qjam, kur kujtuam Sionënë. Mbi shelgjet ndë mes t'asai varëm drurëtë t'anë. Se ata që na skllavosnë, atie kërkuanë prej nesh fjalë kënkësh: edhe ata që na hoqnë udhënë (kërkuanë prej nesh) kënkë gazi, (duke thënë), Na këndoni nga kënkët' e Sionësë. Qysh të këndoimë kënkën' e Zotit ndë dhe të huaj? Ndë të harrofsha, Jerusalimë, m'uharroft' e

GEGËNISHT 1872.

Mbi lumënat të Babylonësë, atie ndeltëm edhe kjam, kur kujtuem Sionënë. Mbi shelqet ndë miedis t'asai varëm qitharatë t'ona. Se ata që na skllavosnë, atie kërkuenë prej nesh fjalë kankësh: edhe ata që na hoqnë udhënë, *kërkuenë* prej nesh kankë gëzimi, *tue thanë*, Na këndoni prej kankash Sionësë. Qysh të këndojmë kankën' e Zotit ndë dhe të huej? Ndë të harrofsha, Ierusalemë, m'uharroft' e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

diathta dorë! M'ungjittë gjuha ndë gurrmast, ndë mos të kujtofsha: ndë mos vënça më përpara Jerusalimënë ndë kryet të gazit t'im! Kujto, Zot, të bijt' e Edhomit, të cilëtë ditën' e Jerusalimësë thoshnë, Rrëzoni, rrëzoni (atë), gjer ndë themelet t'asai. Bij' e Vavyllonësë, që je për të shkretuarë, lum kush të t' apë çpagim, për sa na bëre! Lum kush të rroknjë, e të hedhë foshnjet' e tua mbi gurt!

diathta! Ndë mos të kujtofsha, m'ungjittë gjuha ndë gurmast: ndë mos vufsha ma përpara Ierusalemënë ndë kryet të gëzimit t'em, Kujto Zot, të bijt' e Edomit të cilëtë ditën' e Ierusalemësë thoshinë! Rrëzoni, rrëzoni *atë* ngjer ndë themelet t'asai. Bij' e Babylonësë, qi ke për me ushkretuem, lum kush të api shpagim për sa na bane! Lum kush të rroki, e të hedhi foshnjet' e tua mbi gurt! (69)

12) KATËR UNGJILLAT' E ZOTIT EDHE SHËLBYESIT T'YNË IESU-KRISHTIT, EDHE PUNËT' E APOSTUJVET, KËTHYEM PREI GREQISHTESË VIETËR SHQIP NDË GJUHË GEGËNISHTE prei KONSTANTINIT KRISTOFORIDIT, ELBASANASIT. KONSTANTINOPOL. Ndë shtypa-shkronjë të A.H. Bojagjianit. *Shitunë ndë Stamboll, udha Tahtakaleh, Numëri 52* 1872. (70)

Në 8, fq 287, + 4 fl të panumërueme. Mbrendia asht e njejtë me botimin 1866. Gjuha asht ajo e ribotimit 1869 te *Dhiata e re*, me ndonji ndryshim fare të pakë.

13) DHIATA E RE E ZOTIT EDHE SHELBYESIT T'YNË IESU-KRISHTIT, KËTHYEM PREI GREQISHTESË VIETËR SHQIP NDË GEGËNISHTE prei KONSTANTINIT KRISTOFORIDIT, ELBASANASIT, KONSTANTINOPOL. *Shitunë ndë Stamboll, udha Filxhanxhiler-Jokushu, ndë Magazinë të Biblësë.* Ndë shtypa-shkronjë të A.H. Bojagjianit 1872.(71)

Në 8, fq 491, + 2 fl të panumërueme. Ekzemplari qi kemi në dorë (i Bibliotekës Kombëtare, 89 E 115), vijon me PSALTERIN, të numëruem veç, pa asnji ndryshim nga ai qi përshkruem ma nalt. Mbrendia e *Dhiatës së re* asht e njejtë me atë të botimit 1869. Gjuha asht gjith ajo, me ndonji ndryshim fare të pakë. Bajmë krahasimin e nji pjese ugjillit të botimeve 1866, 1869 dhe 1872.

1866.	1869.	1872.
Nji nieri kishte dy bi: edhe ma i vogëlli prei asish i tha të i atit, At, më nep piesën' e gjasë qi më bije *me marrun*. Edhe *ai* u dau	Nji nieri kishte dy bij: edhe ma i vogëlli prei asish i tha të i atit, Atë më nep pjesën' e gjasë qi më bije *me marrë*. Edhe ai u dau gjanë	Nji nieri kishte dy bij: edhe ma i vogëlli prei asish i tha të i atit, Atë më nep piesën' e gjasë qi më bije *me marrë*. Edhe *ai* u dau gja-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

gjanë. Edhe mbas pak ditç ma i vogëli bir mbëloth gjithë se ç'pat, edhe iku ndë dhe të hujë, mbë *nji* vend të largë, edhe atie shpërdau gjanë e vet, tue shkumun jetë si planprishës. Edhe *ai* si prishi të gjitha, uba nji zi e madhe mb'atë vend, edhe ai filloi me pasun të mangut. Atëherë voiti e ungjit mbas nji gjytetasi t'ati vëndi; edhe *ai* e dërgoi nd'arë të vet me kullotun thitë. Edhe dëshëronte më mbushun barkun e vet me harupat qi hajshin thitë: por kurkushi s'i nepte. — Edhe *ai* si erdhi mbë vetvehten (si ra ndër mend), tha, Sa rrogtarve të tim-et iu teproinë bukët e un po birem prei usël Dotë ngrihem e dotë vete tek im-at, edhe dot' i thom, o At, fieva ndë qiell, edhe përpara tejet, edhe nuk jam ma i vlefshun me uquitun biri yt: më ban porsi nji prei rrogtarvet tu. Edhe u ngrit e erdhi tek i ati vet.

atyne. Edhe mbas pak diç ma i vogëli bir mbëloth gjithë se qish pat, edhe iku ndë dhe të huej, mbë *nji* vend të largë, edhe atie shpërdau gjan' e vet, tue shkuem jetë si plank - prishës. Edhe *ai* si prishi të gjitha uba nji zi e madhe mb'atë vend, edhe ai filloi me pasunë të mangutë. Atëhere voiti e ungjit mbas nji qytetari t'ati vendi: edhe *ai* e dërgoi nd'arat e veta me kullotunë thitë. Edhe dëshëronte me mbushunë barkun' e vet me harupat qi hajshinë thitë: por kurkushi s'i nepte. — Edhe *ai* si erdhi mbë vetëvetëhenë, tha, Sa punëtorëve të t'im-et u tepërojnë bukët', e unë po vdirem prei uniet! Dotë ngrihem e dotë vete tek em-atë, edhe dot' i thom, o Atë, fëjeva ndë qiell, edhe përpara tejet, nuk jam ma i vëjefshim me uqueitunë biri yt: më ban porsi nji prei punëtorëvet tu. Edhe ungrit e erdhi tek i ati vet.

në atyne. Edhe mbas pak diç ma i vogëli bir mbëloth gjithë se qish pat, edhe iku ndë dhe të huej, mbë *nji* vend të largë, edhe ati. e shpërdau gjan' e vet, tue shkuem jetë si plank-prishës. Edhe *ai* si prishi të gjitha, uba nji zi e madhe mb'ate vend, edhe ai filloi me pasunë të mangutë. Atëhere voiti e ungjit mbas nji qytetari t'ati vendi; edhe *ai* e dërgoi nd'arat e veta me kullotunë thitë. E dëshëronte me mbushunë barkun' e vet me harupat qi hajshin thitë: por kurkushi s'i nepte. — Edhe *ai* si erdhi mbë vetëvetëhenë, tha, Sa punëtorëve të t'im-et u tepërojnë bukëtë; e unë po vdirem prei uniet. Dotë ngrihem e dotë vete tek em-atë, edhe dot' i thom, o Atë, fëjeva ndë qiell, edhe përpara tejet, edhe nukë jam ma i vejëfshim me uqueitunë biri yt: ban-më porsi nji prei punëtorëvet tu. Edhe ungrit e erdhi tek i ati vet. (72).

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

14) ISTORIA E SHKRONJËSË SHËNJTËRUARË për diem. Përmbëledhurë nga Dhiata e Vietërë edhe nga istoria e botësë, edhe këthyerë Shqip ndë gjjuhë Toskërishte prei KONSTANTINIT KRISTOFO-

RIDHIT, ELBASANASIT. KONSTANTINOPOLË. Ndë Shtypa-shkronjë të A.H. Bojaxhianit. 1872. (73)

Në 8, fq 143, + 5 fq të panumërueme, + 4 fl të panumërueme. 5 fq e panumërueme mbajnë nji fjalorth («Leksikografia») me fjalët e ralla ose të reja të spiegueme, me korespondentet e tyne greqisht dhe ndonjiherë italisht. Në 2 fl e fundit të panumërueme, asht dhanë tabela e mbretënve dhe mbretënive, si dhe e profitëve t'Izraelit e të Judesë. Gjuha ka përparue që nga *Psalltiri*. Po e krahasojmë me këte.

PSALLTIRI 1868.

Vër-u vesh fjalëvet mia, o Zot: kupëto klithmënë t'ime. Mba-i vesh zërit lutëjesë s'ime, o Mbëreti im, edhe Perëndia im: se tyi dotë falem. Zot, ndë mëngjes dotë ndigjoish zënë t'im: ndë mëngjes dotë rri përpara teje, edhe dotë shikonj. Se ti nukë je Perëndi që do paudhëri: i keqi nukë dotë rrijë përanë teje: as të pa-udhëtë nukë dotë qëndronjënë përpara syvet tu: ti mer mëri gjithë ata që punonjënë pa udhë. Dotë vdierrç gjithë ata që flasënë gënjeshtrënë: Zotit i vien të ndohëtë nga njieriu gjakëruar edhe nga gënjeshtari.

ISTORIA 1872.

Isaaku qe dyzet vieç kur mori Revekënë për grua. Edhe kur ubë gjashtë-dhietë vieç plak, i lintnë dy binjakë. Këta të dy vëllezërë s'i gjaninë njëri jatërit: i pari ishte i egrë si mbë të parët, kështu edhe mbë punët: i dyti ishte i butë e i bukurë. Të parit ia thoshin emërin' Isaf, edhe tiatërit Iakov. Si urritnë ata, Isafi ubë gjatuar, një njeri i fushavet: po Iakovi i gjaiti t'et, edhe ubë bari dhënsh. e rrinte ndër tenda. Isaaku sa-domos, donte Isafn' e egrë, po Reveka donte më fort Iakovn' e butë. (74)

15) Gustav Meyer-i ka regjistrue (75) nji botim pak ose aspak të njohtun të Kristoforidhit, KATËR PËRGJËMIME PËR ÇUNAT E VOGJILË, KONST. 1872. Libri ka qenë reklamue edhe të kapaku i *Istorisë së shronjësë shënjtëruarë*, ku shënohet se asht në shitje për «grosh $1^1/_2$». S'e kemi pamë.

16) TO KATA MATTHAION AGION EVAGGELION PARAFRASTHEN EK TOY ARHETYPOY ELLINIKOY. SHËNJTI UNGJILL PAS MATTHEUT KËTHYERË PREI GREQISHTESË VIETËRË SHQIP ndë gjuhë Toskërishte. KONSTANTINOPOLË. Ndë shtypa-shkronjë të A.H. Bojaxhianit. 1878. (76)

Në 8, fq 92, + 2 fl të panumërueme. Me tekstin shqip dhe greqisht ballaball. Botim (i ripunuem?) nga *Dhiata e re* toskënisht qi pat dalë më 1870 ose ma parë. Pasi u pushue nga puna prej Shoqënisë Biblike më 1872. Kristoforidhi hyni prap në shërbim të saj më 1878 dhe ky qe

BIBLIOTEKA PUBLIKE MARINBARLETI SHKODËR

botimi i parë qi bani. Të vihet re se libri nuk e mban emnin e përkthyesit, siç e kishin botimet e maparëshme. Kështu do të bajë Kristoforidhi edhe me gjith përkthimet e tjera qi do të botojë ma vonë. Nuk dimë përse tani vepron kështu.

17) TO KATA MARKON AGION EYAGGELION PARAFRASTHEN EK TOY ARHETYPOY ELLINIKOY. SHËNJTI UNGJILL PAS MARKUT KËTHYERË PREI GREQISHTESË VIETËRË SHQIP NDË GLUHË TOS KËRISHTE. KONSTANTINOPOLË, ndë shtypa-shkronjë të A.H. Bojaxhianit. 1879.

Në 8, me fq të numërueme nga 93 në 151, + 2 fl të panumërueme. Sipas Legrand (77). S'kemi pamë. Kuptohet nga numërimi i faqeve se asht pjesë e *Dhiatës së re* e botueme e plotë më 1879, dhe qi nisi të dali pjesë-pjesë me *Ungjillin pas Mattheut* qi pamë ma nalt. Ky shkoi gjer në fq 92.

18) TO KATA LOYKAN AGION EYAGGELION. KONST. 1879. Sipas Meyer (78). S'e kemi pamë. Pjesë e *Dhiatës së re* t'atij viti, qi duhet të ketë qenë numërue prej fq 152 në 252.

19) TO KATA IOANNIN AGION EYAGGELION PARAFRASTHEN EK TOY ARHETYPOY ELLINIKOY. SHËNJTI UNGJILL PAS IOANNIT KËTHYERË PREI GREQISHTESË VIETËRË SHQIP NDË GLUHË TOS-KËRISHTE. KONSTANTINOPOLË, ndë shtypa-shkronjë të A.H. Bojaxhianit. 1879.

Në 8, fq të numërueme nga 253 në 329, + 2 fl të panumërueme. Sipas Legrand (79). S'e kemi pamë. Pjesë e *Dhiatës së re* 1879.

20) PRAKSEIS TON AGION APOSTOLON PARAFRASTHEISAI EK TOY ARHETYPOY ELLINIKOY. PUNËT' E APOSTOJVET KËTHYERË PREI GREQISHTESË VIETËRË SHQIP NDË GLUHË TOS-KËRISHTE. KONSTANTINOPOLË, ndë shtypa-shkronjë të A.H. Bojaxhianit. 1879.

Në 8, fq të numërueme nga 327 në 423, + 3 fl të panumërueme. Sipas Legrand (80). S'e kemi pamë. Pjesë e *Dhiatës së re* 1879.

21) TA TESSERA EYAGGELIA KAI AI PRAKSEIS TON APOSTOLON PARAFRASTHEISAI EK TOY ARHETYPOY ELLINIKOY. KATËR UNGJIJTË EDHE PUNËT E APOSTOJVET KËTHYERË PREI GREQISHTESË VIETËRË SHQIP NDË GLUHË TOSKËRISHTE. KONSTANTINOPOLË, ndë shtypa-shkronjë të A.H. Bojaxhianit. 1879.

Në 8, fq 423, + 2 fl të panumërueme. Sipas Legrand (81). Përmban të pesë botimet e masipërme, të cilat u shitën veç e veç, tue dalë njana mbas tjetrës prej shtypit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODËR

22) I KAINI DIATHIKI TOY KYRIOY SOTIROS IMON IISOY HRISTOY, PARAFRASTHEISA EK TOY ARHETYPOY ELLINIKOY. DHIATA E RE E ZOTIT EDHE SHPËTIMTARIT TËNË JISU-KRISHTIT, KËTHYERË PREI GREQISHTESË VIETËR NDË GLUHË TOSKËRISHTE. KONSTANTINOPOLË. Ndë shtypa-shkronjë të A.H. Bojaxhianit. 1879. (82)

Në 8, fq 724, + 4 fl të panumërueme. Në verso të fl 1 të panumërueme, mban lejen e botimit nga Ministria e Arsimit (turqishit dhe greqisht), gja qi duket për herë të parë në botimet e Kristoforidhit. Libri përmban, të numërueme në të njejtën mënyrë, gjith botimet e masipërme të përmbledhuna te nr 20, bashkë me *Letrat e Apostojve* dhe *Sbulesën e Joann Perëndi-Diturit*, si dhe botimi gegënisht i vitit 1872; po *Psalltiri* nuk ka qenë lidhë së bashku si në këte botim të fundit. Përballë tekstit shqip asht ai greqisht. E nisun së rishtypuni më 1878 *Dhiata e re* toskënisht u mbarue më 1979.

23) TË BËRËTË EDHE TË DALËTË KËTHYERË PAS EVRAISHTESË VIETËRË SHQIP NDË GLUHË TOSKËRISHTE. KONSTANTINOPOLË Ndë shtypa-shkronjë të A.H. Bojaxhianit. 1880. (83)

Në 8, fq 188, + 2 fl të panumërueme. Me këte libër, Kristoforidhi vijon përkthimin e *Biblës*, qi pat nisë me *Psalmet* më 1868, dhe qi nuk do ta kryejë. Nuk dihet përse e vijoi vetëm toskënisht. Fakt asht se librat toskënishte qi pat botue Shoqënia Biblike, qenë përhapë ma shum se ato gegënishtet, për arsye të zhvillimit ma të math të Shqipnisë së jugut. Po japim nji copë nga ky përkthim i vitit 1880, të krahasueme me gjuhën qi përdori, n'*Alfabetaren* e Stambollit, nji mot ma parë, Sami Frashëri.

KRISTOFORIDHI 1880.

Edhe Jakovi pa se gjëndej drithë ndë Egjyptëri; edhe Jakovi u tha të bijet, Ç'shikoni njëri jatrinë? Edhe tha, Na tek dëgjova se gjëndetë drithë ndë Egjyptëri: sbritni atie, edhe blini për ne andej, që të rroimë e të mos vdesëmë. Edhe sbritnë të dhietë vëllezërit' e Josifit për të blerë drithë nga Egjyptëria. Po Veniaminën, të vëllan'ë Josifit, nuk' e dërgoi Jakovi bashkë me të vëllezërit: sepse tha, Mos i gjanë ndonjë e keqe. Edhe të bijt' e Israilit erthinë për të blerë *drithë* ndërmest atyreve që vininë

SAMI FRASHËRI 1879.

Njerëzit që rrinë mi dhet janë të ndarë më kombe. Kombet' e dheut janë të shumë. Gjith' ata njerës, që gjëndenë më një vënt, e fiasinë një gjuhë, edhe që kanë një palë zakone e një farë të rroj turi, thuhenë një komp. Nga kombet' e dheut ca janë të mbëdhenj e të shumë, do-me-thënë kanë nga shumë miliunë njerës, edhe ca janë të vegjël' e të pakë. Shqipëtarëtë janë një nga kombet' e vegjëlë të dheut, se gjith' ata njerës, që pushtoin ky komp, nukë janë më te-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

atie: sepse ishte zi ndë dhet të Hanaanit. Edhe Josifi ishte qivernitar i vëndit: ay i shiste gjithë gjëndësesë vëndit: erdhë pra të vëllezërit' e Josifit, edhe i unjnë kryetë gjer përdhe. Edhe Josifi kur pa të vëllezëritë, i njohu: po shtiu vetëhen' e ti të huajë ndër ata, edhe u fliste atyre vrazhëtë: edhe u tha atyre, Nga vini? Edhe ata thanë, Nga dheu i Hanaanit për të blerë drithë. Edhe Josifi njohu të vëllezëritë, po ata nuk' e njohnë atë. Edhe Josifit i ranë ndër mënt ëndërrat që pat parë për ata: edhe u tha atyre, Ju jeni përgjonjës: keni ardhë për të vështruarë shtegjet e vëndit.

përë se dy miliun' e gjymësë. Xhdo komp ka një gjuhë, që flet edhe shkruan, po gjithë gjuhëratë përpara janë folurë, pastaj njerëzit janë menduar', e kanë gjeturë nga ca shënjeza për të shkruarë gjuhëratë, që flisninë. Kështu kanë zënë gjuhëtë, njëra pas jatrësë, të shkruhenë. Po gjithë gjuhëtë nukë janë shkruarë që në kryet; duke hapurë syt' e xhdo kombi, e duke zënë njerëzit' e ti të bëjënë punëra më të mbëdha e më të shuma, kanë parë nevojë të shkruajënë gjuhën' e tyre. (84)

Le të vihet re se gjuha e Samiut, e influencueme prej asaj të Kristoforidhit, asht ma e vetvetishme, për arsye jo vetëm se ai asht toskë po dhe se Kristoforidhi përkthen dhe mundohet t'i qëndrojë ngushtësisht besnik origjinalit.

24) NOM I DYTË, KONST. 1882. Sipas Meyer (85). S'e kemi pamë. Kristoforidhi vijon përkthimin e Biblës toskënisht.

25) GRAMMATIKI TIS ALVANIKIS GLOSSIS KATI TIN TOSKI KIN DIALEKTON SYNTAHTHEIS YPO KONSTANTINOY HRISTOFORIDOY TO EKS ELVASANIOY. ADEIAI TOY YPOYRGEIOY TIS DIMOSIAS EKPAIDEYSEOS. EN KONSTANTINOYPOLEI EK TOY TYPOGRAFEIOY A.H. MPOGIATZIAN. 1882 (86)

Në 4, fq 165 + 2 fl të panumërueme. Pas titullit, para lejës së botimit greqisht (qi shënuem ma nalt), e shkruen këte lejë edhe turqisht. Dimë se kjo pat qenë nënshkrue prej Naim Frashërit vetë dhe mbante datën 14 gusht 1882 (87). Në fl 2 të panumërueme, gjindet një parathanje e shkurtën greqisht e firmueme nga auktori, në të cilën, në mes të tjerash, thuhet: se gegënishtja asht dialekti kryesor i shqipes, ma e pasun dhe e pastër nga dialektet e tjera; pa njohtë atë, njeriu nuk mund të bahet zot i gjuhës shqipe. Nuk dimë arsyen përse ahere Kristoforidhi qi ka mendime të tilla, shkroi gramatikën e toskënishtes dhe jo të gegënishtes.

26) FIALËT' E URTA TË SOLLOMONIT EDHE VIVLIA ISAISË KËTHYERE PAS EVRAISHTESË VIETËRE SHQIP NDË GLUHË TOSKËRISHTE. KONSTANTINOPOLË NDË SHTYPASHKRONJË TË A.H. BOJAXHIANIT 1884. (88)

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Në 8, fq 150, 2 + fl të panumërueme. Pas titullit mban lejen e botimit turqisht. Mbrendia: Fjalë të urta, Isai. Kristoforidhi vijon përkthimin e *Biblës* toskënisht.

27) TË BËRËTË DHE TË DALËTË KËTHYERË PAS EVRAISHTESË VIETËRË SHQIP NDË GLUHË TOSKËRISHTE. KONSTANTINOPOLË NDË SHTYPASHKRONJË TË A H. BOJAXHIANIT. 1884. (89)

Në 8, fq 188, + 2 fl të panumërueme. Ribotim i përkthimit 1880. Pas titullit, ka lejen e botimit turqisht.

28) NOM I DYTË KËTHYERË PAS EVRAISHTESË VIETËRË SHQIP NDË GLUHË TOSKËRISHTE, KONSTANTINOPOLË. NDË SHTYPASHKRONJË TË A.H. BOJAXHIANIT. 1884.

Në 8, fq 70 + 2 fl të panumërueme. Ribotim i përkthimit 1882. Pas titullit, ka lejen e botimit turqisht.

29) TË BËRËTË. TË DALËTË EDHE NOM I DYTË KËTHYERË PAS EVRAISHTESË VIETËRË SHQIP NDË GLUHË TOSKËRISHTE. KONSTANTINOPOLË. NDË SHTYPASHKRONJË TË A H. BOJAXHIANIT 1884. (90)

Në 8, fq 188 + 70, + 3 fl të panumërueme. Përmbleth të dy botimet e sipërme.

30) TË BËRËTË, TË DALËTË EDHE NOM I DYTË, TË URTA, ISAISË, KËTHYERË PAS EVRAISHTESË VIETËRË SHQIP NDË GLUHË TOSKËRISHTE. KONSTANTINOPOLË NDË SHTYPASHKRONJË TË A H. BOJAXHIANIT 1884, (91)

Në 8, fq 188 (*Të Bërëtë, Të Dalëtë*), + 70 (*Nom i dytë*), + 150 (*Të urta, Isaia*), + 3 fl të panumërueme. Përmbleth, me të njejtin numërim, gjith botimet e bame nga *Bibla* më 1884 prej Kristoforidhit, dhe qi u shitën veç e veç. Interesant asht të krahasohet gjuha e këtij viti e Kristoforidhit me ate të Naimit dy vjet ma vonë.

KRISTOFORIDHI 1884.

Pa dëgjoni fialët' e mbëretit math, mbëretit Asyrisë : kështu thotë mbëreti: Mos u gënjenjë juve Ezeqia: sepse nukë do të muntnjë t'u shpëtonjë juve. Edhe mos u bënjë juve Ezeqia të shpëreni mbë Zonë, tuke thënë, Zoti me të vërtetë do të na shpëtonjë: ky

NAIM ERASHËRI 1886.

Një plak duke vdekurë i tha të birit: Biro! kam pshehurë një gjë shumë të vlerë n'arëtë, po mihe sa të munç, më thellë, ta gjesh; se aje dotë bënjë shumë të pasurë. Djali pas fjalësë, q'i la i ati zu e mih shumë theil' arënë edhe si z'gjente do gjë, motnë që vij

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

qytet nukë dot' epetë ndë dorë ndë mbëretët Asyrisë. Mos i dëgjoni Ezeqisë: sepse kështu thotë mbëreti Asyrisë, Ndrequ me të mirë bashkë me mua, edhe dilni tek unë: edhe le të hajë gjithë secili nga vëreshti i ti... e mihte dhe më thellë. Ara sa punohej më mirë, aqë pilite më tepërë. Më dhjetë vjet diali u bë i pasurë nga ara, q'i epte shumë. Ahere e mori vesh fjalën' e tet. (92)

E njëjta verejtje munt të bahet si dhe për krahasimin në mes Kristoforidhit e Samiut.

31) KATËRË KATEQISMA Për ÇUNAT' E VOGJILË. Dy për Emënat' e Shkronjësë, edhe dy për Dotrinën' e Krishtenë, edhe për detyrën' e njeriut. KONSTANTINOPOLË Stampa A.H. Bojaxhian 1884. (93)

Në 16, fq 32. Botue në mënyrë identike me ate të vitit 1867. Gjuha ka qenë ripunue sipas principeve qi auktori caktoi ate vit, duke e përmirësue botimin e parë. Nën titullin, mban lejen e botimit turqisht.

(vijon)

KONSTANTIN NELKO-KRISTOFORIDHI 1830—1895

RESUMÉ

Dans cette monographie, l'auteur parle longuement de la vie privée et patriotique de K. Kristoforidhi, ainsi que de ses oeuvres publiées. A. suivre.

SHËNIME

1) ASH (=Arkiva e Shtetit) 5136. Doreshkrim i Kr. me disa verejtje mbi Dhaskal Todhriu, simbas *Albanesische Studien* të Hahn-it. Mban datën: Durrës 25 maj 1854.

2) ASH 5207, fq 78 (Kondik i kishës Sh. Mëri të lagjes Kala, Elbasan).

3) ASH 5177, fq 21 (kopje e Kondikut t'Esnafit të Gunarëve t' Elbasanit).

4) Ibid fq 22.

5) ASH 5164, fq 161-62 (Kondiku i Esn. t'Argjendarëve t'Elbasanit).

6) Ibid. fq 193.

7) Ibid. fq 149.

8) Ibid. fq 184.

9) ASH 5177, fq 28.

10) Ibid. fq 29.

11) ASH 5005. Diçka ban të dyshosh qi ky Nelko të jetë iis me Anastasiu: djali tij quhet Stefan, siç do të quhet ma vonë djali i Omath i Kr. Emnat ruhen në fist: kështu tre fëmijë të Kr. do të quhen Anastasia, Anastas, Mihal.

12) S. Sueriqi: *Jeteshkrimi i Konstandin Kristoforidhit*, Manastir 1911, fq II. Edhe botimi i versionit në gegënishten e mesme të *Gjahut të malësorëvet*, Korçë 1930, jep si datëlindje të Kr. vitin 1831, tue u bazue, sigurisht, te fakti se ai vdiq 64 vjeç.

13) ASH 5005: i vdiq ma parë e ama (30 prill), pastaj i ati (18 shtator 1853).

14) G. Cassiotis: *L'instruction publique chez les grecs*, Paris 1881, faq 108-9, 425-27.

BIBLIOTEKA PUBLIKE „MARIN BARLETI" SHKODËR

15) Dh. S. Shuteriqi: *Anonimi i Elbasanit*, në «Buletinin e Institutit të Shkencavet», viti III (1949), Nr. 1, fq 54, shënim 34.

16) Duket se pasunia t'et nuk qe gja e madhe, sepse më 13 korrik 1855, e shohim Kr. të ketë 50 grosh borxhë n' Esnafin e Argjendarëve dhe të mos i shlyejë gjer më 1858. Ka të ngjamë qi këto borxhë t'i ketë marrë për t'u nisë për Patras. Në se ka pasë nji vila më 1866, nuk kuptohet se si e shiti pasjen e t'et, po kuptohet përse vuni borxhë.

17) Sipas kondikut privat të familjes Xhufka n'Elbasan, Mima vdiq më 3-XI-1854, tridhjetë e nandë vjeç, në Durrës. Pra, vetëm mbas kësaj date Kr. asht nisë për Patras. Në Krime, ai duhet të ketë qenë nga fillimi i vitit 1855.

18) Cassiotis, ibid.

19) Suteriqi, fq 12.

20) A. Dozon: *Manuel de la langue chkipe ou albanaise*, Paris 1879, fq 7, shënim 5. Në nji traktat të tij greqisht, fort interesant për historinë e rilindjes sonë, dhe qi mban titullin *Skepseis peri grafis tis Skypetarikis glossis* («Mendime mi të shkruemit e gjuhës shqipe» —vepra ka qenë hartue pas vitit 1895 dhe ka përmi 100 fq), Jani Vreto shkruen se Kr. i pat thanë qi «shetiti gjith Shqipninë bashkë me konsullin austriak në Janinë, të quejtun Hahn, i cili e kish marrë apostafat për të mësue gjuhën shqipe, dhe gjatë këtij udhëtimi mblodhi landë për nji fjalor, dhe me këte landë, mbasi shtoi edhe ate qi gjet nëpër librat, përpiloi nji fjalor të gjuhës shqipe, duke punue përmi 20 vjet». Dëshmia ka randësi të madhe, jo sepse na mëson nji herë se si Hahn-i e inicioi Kr. në veprimtarinë shkencore që fare të ri, po se na tregon fillimin e veprimtarisë gjuhësore të Kr. për veprën e tij të madhe, *Fjalorin*.

21) v. shënimin 1.

22) Lajmi i zbulimit ka qenë botue nga Hahn-i te *Sitzungsberichte der Kaiserlichen Akademie der Wissenchaften*, Vienë 1859, fq 262.

23) Sipas botimit të Shoqënisë Biblike, *The Gospel in many Tongues* (centuary edition), fq 2. Prap Vretua në *Skepseis*, na mëson se ky përkthim, i botuem prej Grigorit dhe Shoqënisë Biblike, ka qenë bamë nga Vangjel Meksi Laboviti; me anën e Kr., shoqënia e «kontrolloi përkthimin e Dhiatës së *re* toskënisht dhe e ktheu në gegënisht». Dëshmia rivërteton faktin qi *Ungjilli* i Korfuzit u botue nga protestanët dhe na mëson diçka me randësi për Kr, se ky qe ngarkue ta vështrojë a qe apo jo përkthye mirë. Dëshmitë e tij, Vretua i nxjerr zakonisht nga fjalët qi i ka pasë thanë Kr. vetë.

24) Sipas Losh Papamihalit, «mbeti me 3 lira në xhepi».

25) Sipas dëshmisë së të bijës, qi rron edhe sot, Kleopatra Bibaja.

26) Kjo ma vonë studioi në Rumani e erth mësuese në shkollën rumune të Beratit, ku vdiq rreth vitit 1890. Anastasia qe martue me Apostol Margaritin, nji nga udhëheqësit e lëvizjes arumune të Maqedonisë në shekullin XIX, i lidhun me patriotët shqiptarë të kohës, si Sami Frashëri. Para se të vijë mësuese në Berat, Anastasia u nda prej tij, nuk dihet përse. Kjo martesë, asht nji shenjë ma shum e simpatisë së veçantë qi ushqente Kr. për rumunët, në të cilët, siç i shkruen Naços më 1888, ai pëlqen qi të mbështet lëvizja jonë patriotike, sikundër dhe u mbështet.

27) v. shënim 23.

28) J. Vreto, *Letër Sofir Kolesë*, nga Bukureshti 11-X-1896: «Ju vu e bindi parësinë e Shqipëtarëvet Muhamedanë që gjendeshin ndë Konstantinupolë, të mblidheshin para e të vihesh in ndë një trapezë (bankë), për shkronja e për mësonjëtore shqip, po navagjisë (dështuan)».

29) S. Dine: *Valët e detit*, Sofje 1908, fq 7-9.

30) Këte gjuhë të përbashkët, Camarda e provel te përkthimi i studimit të njohtun të Dora d'Istria-s, *La nationalité albanaise d'après les chants populaires*, Paris 1866. Ja titulli i këtij përkthimi me gjuhë të çuditëshme: *Fyletia e Arbënore prej Kanëkatë të Laoshima*, Livorno 1867. Domosdo, bir shqiptari nuk e mori vesh dhe Camarda mjaftoi me kaq,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

31) Vretua na flet hollë e gjatë mi këto përpjekje, simbas kujtimeve të tij dhe fjalëve të Kr., në *Skepseis*.. Në mbledhjet e para muerën pjesë Mustafa pashë Gjirilliu, Sulejman pashë dhe Selt be Toptani, Rustem pashë Leskoviku, Kristaq Zografi, Ismail Qemali, Pasko Vasa, Hoxha Tahsini dhe Kristoforidhi. Ndërsa feudalët kërkojin alfabetin arab (veç Rustem pashës), dhe Kristaq Zografit (grekoman qi do t'i sillte shum dam çashtjes sonë kombëtare ma vonë) qi shtirej asnjanës, të tjerët ishin për njanin nga dy alfabetet: ate grek ose ate latin. Formueu nji komision dhe shkueu te kryeministri Ali pasha, i cili i priti dhe i përcolli mirë, biles muer pjesë edhe në mbledhjet e matejme të tyne, qi u zgjanuen. Në këto mbledhje të fundit, të cilat baheshin te Hoxha Tahsini në shtëpi, patën marrë pjesë edhe Sheiki Gjinokastriti, Jahja Dineja, Ibrahim Temoja, Jani Vreto dhe, së fundit, Sami Frashëri qi sapo kish mrrijtë në Stamboll (1871). Nga mbarimi, Kr. mungoi, sepse erdhi në Shqipni. Te gjith u banë të nji mendimi qi të vgjidhet njani nga dy alfabetet e sipërme dhe qi alfabeti të ketë për secilin tingull nji germë të thjeshtë, veç Hoxha Tahsinit, i cili ishte për nji alfabet origjinal. Kr. veç çashtjes s'alfabetit të përbashkët, shtroi edhe ate të formimit të nji shoqënie kulturale qi ta përdorte këte alfabet dhe ta përhapte. Për këto përpjekje flet dhe Shahin Kolonja, te gazeta e tij «Drita», Sofje 21 vjesht' e tretë 1903, i cili ve n'epiqendër të tyne Kr.—Kanë folë për to edhe Camarda, në *A. Dora d'Istria gli albanesi*, Livorno 1870, fq 21, shënim 1: «Annunziavano i giornali fin dal principio del corrente anno 1870, che il governo turco aveva nominato una commissione per fissare un alfabeto ad uso degli schipetar»; si dhe Dozon, fq 169, i cili thotë se komisioni qe emnue nga sulltani dhe përbahej nga 3 myslimanë dhe 3 të krishtenë (sipas gazetës «Courier d'Orient» 2 mars 1870).

32) $^1/_{25}$ e lirës turke, afër $^1/_{26}$ e lirës angleze.

33) Dozon, fq 13. Kr. ka pasë të bajë me arbëreshët e Italisë dhe me ata të Greqisë. Dihet se ishte në lidhje me De Radën, i cili i dërgonte revistën e tij, *Fjamuri i Arbërit* (v. këte revistë, 1883, Nr 2, fq 2). Kr. ka përkthye në toskënishten tonë disa nga poezitë popullore arbëreshe të botueme nga De Rada (v. ma poshtë, pjesën ku flitet mi dorëshkrimet e tij).

34) V. K. Gallani: *Jorgj Karbunara*, te gazeta e Bukureshtit «Kuvendi Kombëtar», 3. VI. 1934. Në dorëshkrimet e Kr gjejmë nji shënim me ndihmat qi duket se janë mbledhë apo qenë për t'u mbledhë ahere në Berat për këte çashtje: aty Jorgj Karbunara përmendet për 10 (lira?) dhe Kr. për 5 — ASH 5132.

35) Th. Krei: *Letër greqisht Thimi Brandit*, nga Shibin El Kom (Misir) 15. 8. 1877. Shqipen, Kr. nuk ua mësonte vetëm fëmijëve në shkollë, po dhe të njohtunve të tij: kështu, më 1908, kur u shpall Hyrrieti, shum pleq duelën në Tiranë qi kishin pasë ditë shqip dhe nuk e tregojin i kish pasë mësue Kr.

36) A Thompson: *Letër greqisht Eleni Kristoforidhit*, nga Stambolli 6. IV. 1895. I thotë se të shoqin e saj e ka pasë njohtë që më 1864 dhe kanë bashkëpunue 15 vjet.

37) Sipas Sh. Kolonjës: ibid. Ky ka qenë informue nga nji bullgar qi pat bashkëpunue me Kr. në Shoqëninë Biblike. Mbase me këte njeri Kr. mësoi bullgarishten, të cilën e njihte mjaft mirë.

38) «Kalendari Kombiar», Tiranë 1928, fq 49.

39) Origjinali asht tepër i rallë. Ka qenë ribotue te revista «Dituria», Tiranë 1926, fq 68.

40) K. Kristoforidhi: *Letër Nikolla Naços*, nga Elbasani 25. I. 1888, në të «Përdyjavëshmen e «Gazetës së Korçës», janar 1927.

41) Simbas nji shënimi të Kr. — ASH 5143.

42) Shoqënia e Stambollit: *Letër degës së Bukureshtit* nga Stambolli 23. VIII. 1882. Ja letra: «Zoti Anastas Avramidhi, Zoti Vangjel Geçua, Zoti Llazar Antoni, Zoti Thimi Markua e gjithë shokët e vëllezrët e-dashurië, shokët, e degës shoqërisë për shkronja shqip në Bukuresht, u faremi e u përqafoj më vëllazërisht.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" C E K O D E R

Me ndihmë të Zotit jetësë edhe të së drejtësë, pa ndalja (leja) e fjalëtoresë shqip për të shtypurë u-dha, edhe me shkronjësinë (shkrimtarin) fjalën' e lidhëmë kështu: 6 napoleon' e gjymësë për çdo fletë tetë faqesh të-mëdha, bashkë me kartet e me shkronjëzat (shkronjat) që dotë derthnjë e të bënjë të-ra disa palësh edhe me të palosur e të qepurë; me një fjalë dotë apëmë gjashtë napoleon' e gjymësë për ç' do fletë edhe ay dotë na apë dymijë copë të-shtypura e të-qepura edhe me kartë fort të-mirë. Edhe pesë napolon'e gjymësë do shkronjësi Zoti Kostantin Kristofori bashkë me dy ndihmësitë të-tjerë që dotë punojnë për këtë punë, edhe fjalëtorenë j' a fal shoqërisë pa dashurë të marë pesë q nt copë nga ato, sindëkur u patmë shkruarë përpara. Kështu ç' do fletë dotë qëndronjë dy-mëdhetë napoleonë, dhe si j' a shtjemë, munt të dalë gjashtë-dhjetë fletë a më tepërë, do-me-thënë dotë qëndronjë shtatë-qint e një-zet napoleonë. Kjo sumë është fort m' e-pakë nga sum' e të pesë-qint liravet bashkë me pesë-qint copëtë fjalëtore që dotë merte shkronjësi pas të shkruarit të-parë.

Fjalëtoreja do të jet' e përkthyerë edhe më tri gjuhë të-tjera, greqisht, italisht edhe turqisht, edhe do të dalënë, si shkruajtimë edhe më siprë, dy-mijë copë, edhe çëmimi j' u vu 20 franga t' arta për copë. Prapo kështu shoqëria do të zerë dy-mijë napoleonë kur të shitenë, edhe do të ketë fitim më tepërë se dy për një.

Shkronjë- htypësi do në dorë një-qint e pesë-dhetë napoleonë, se edhe ay dot'apë në dorë për kalëpet e për shtretet të shkronjëzavet edhe për shkronjëzatë që dotë derthnjë edhe për kartënë që dotë porosinjë, edhe pesë-dhetë napoleonë duhenë për ca kohë për shkronjësinë me ndihmësitë, edhe të-tjetratë pastaj duke punuar e duke paguarë.

Shoqëria sot ka më tepërë se sa duhenë, po sindëkur e dini ata t' Evgjitërisë (Misirit) dot' i mendohen gjer sa të shtrohenë punëratë; sot për sot ka në dorë vetëmë të degësë zotërisë suaj, edhe duhetë ta zërë punënë me ato dhe me ç' të përmbledhë prej ndihmërash që dotë hapnjë, edhe shprejmë që sa të mbaiohenë këto do të mblethn' edhe të Evgjitërisë; se nuk munt të shkelenë më tepërë se tri fletë në muajt, për se është puna e shumë.

Andaj u lutemi të na dërgoheně të degësë shoqërisë suaj që janë gati në dorë të kryesitë Zotit Sami-be me anë shkëmbenjëse (çek). U themi çpenguarë vëllezërisht, edhe u lutemi të mos e merni për rëndë, se muntai te na i dërgoni edhe ndër dorë të tjatri të besuari të zotërisë suaj këtu, që t' i apë tek duhetë me dëftim (dëftesë).

Për-së-ri u lutemi vëllezërisht të mos na mënohen' e të mbetetë puna prapa, që e pritnimë me gojë hapëtë edhe kemi hequrë shumë mundime, sikundrë q' e dini sa e prumë në këtë shkallë, se edhe hekuri rrihetë sa është' i nxehtë.

Në të luturitë tanë është edhe të luturit' e djemet zotërisë suaj edhe të tërë kombitë edhe të djemet djemet për gjithë jetën' e jetësë, edhe shprejmë të na dëgjohetë e të na vinjë të përgjegjurite sakaqë-herë.

Nga Konstantinupoja mbë 23 të Korrikut të 1882, Vëllezërit tuaj: (nënshkruhen). Konstantin Kristofori Elbasanasi, Halim i Dalip beut Përmetasit, Ioan Vretua, Pandeli Sotiri, Naim Frashëri, Mehmet Frahëri, Nikollë S. Vasua, Thoma Dusha, Sami Frashëri».

Vula e shoqënisë: «Shoqëri e të shtypuri shkronja shqip» përreth, me një shqiponjë me një kokë në mest dhe me emnin «Konstantinupojë». Shkrimi asht i Samiut vetë.

43) «Kalendari Kombëtar». Tiranë 1926, fq 43, Sipas Vretos (*Skepsen...*), libri u shtyp dhe shtiej nga Shoqëria Biblike.

44) M. Kokolaka: *Naim Frashëri*, Tiranë 1942, fq 19 Kristoforidhi ka pasë një admirim të madh për veprën e Naimit. Loshi i Papamihalit tregonte se, kur erdhën *Lulet e verës* u' Elbasan (1890), tue i lexue, Kristoforidhit i u mbushën sytë me lot. — Ç' ke qi qan, qir Konstandin? e pyeti Loshi. — E more Losh, ku të mos qaj! Unë qeshë konxhe, u bashë traudafil dhe njime u vyshka e më ranë gjethet përdhe. Po ky asht nji trandafil qi nuk do t' i binë gjethet kurr. Këndoje, kondojë Losh!

BIBLIOTEKA UNIVERSITARE „MARIN BARLETI" SHKODËR

45) Letra dërgue Naços.

46) Ibid.

47) Ka dëshmi të ndryshme qi tregojnë se Kr. qe kthye protestan. E tillë asht ajo e Lord Fitzmaurice, i dërguem i posaçëm Anglisë në Stamboll, në raportin qi i ban qeverisë së vet më 17. VIII. 1880, mi nji bashkëfjalim qi ka pasë ma Kr. Në: *Bleu Book*, London 1881, dokument 64: «Mr Christoforides is a protestan». Origjinalin s'e kemi pamë, po vetëm nji kopje të tij n' ASH. v. dhe shënimin 48.

48) J Vreto: *Letër S. Kolesë*, nga Bukureshti 29.XI 1895: «Shoqëri e Protestanëvet Londrësë me Shoqërinë e Protestanëvet Amerikisë e kanë ndarë botënë, më ka thënë Kristoforidhi, që qe bërë Protestan për olofenë e mirë, si eparkhi të njëje mbretërije të tyrenë, edhe Bullgarija i ka rënë Shoqërisë Amerikanëvet, që vërtet duanë të apënë dituri, por e fëlliqnjënë se duanë të apënë dhe dogmënë e tyre bashkë. E Londrësë vetëmë dogmënë. Edhe dogmë ishte për qëllim politiqisë»

49) Me gjith se protestan, Kr. nuk pranoi të shërbejë ma në Shoqëninë Biblike pas vitit 1884, kur kjo ia pat hymë punës politike në Shqipni me anë t' agjentëve të saj, si u pa se forcat patriotike shqiptare ishin rritë mjaft dhe kishte shpresë për nji autonomi ose çlirim të Shqipnisë. Shoqënia përhapi agjenta për të shitë librat e saj në Shqipni që nga viti 1879, sipas njanit prej këtyre, Petro Llambi (*Fjalor' i Kristoforidhit*, në gazetën «Drita», Sofje 22.IV.1905). Ma parë, Kr. vetë i pat sjellë dhe përnapë ato libra në Shqipni, me gjith se kjo nuk qe puna tij. Pas vitit 1889, në nji letër qi i dërgon atij A. Thompson-i dhe qi na ka arritë vetëm pjesë risht, e thëret të bashkohet sërish me shoqëninë, mbas shum fjalësh të mira, lëvdatash e këshillash. E pyet: «while you not come and join with us?» Pse nuk vjen të bashkohesh me ne? Asht koha kur Kr. jeton në mizerje n' Elbasan (sipas G. Weigand: *Die Arumunen*. vol. I, Leipzig 1895 fq 71). Thompson-i, lark e lark, duket se i ka bamë edhe premtime për botimin e *Fjalorit*. Po ai nuk dëgjon të bashkohet ma me protestanët. Duhet kërkue gjetiu arsyeja e largimit të tij prej Shoqënisë Biblike, dhe jo se ra mbas pijes (sikundër mendohet) e nuk ishte ma i zoti për punë, sepse, sikundër do ta shohim, ai nuk pushoi së punuemi për shqipen edhe mbas vitit 18 4.

50) v. shënim 47. Simbas këtij dokumenti Kr. në pyetjet e ndryshme qi Fitzmaurice i bani, asht përgjigjë kështu: Se Shqipnia ka rreth dy milion banorëve. Ajo ndahet në tri pjesë: Shqipnia e sipërme (Shkodra dhe Malësia; Kosova me qendrat Ipek, Gjakovë, Prishtinë), Shqipnia e mesme (me qendra kryesore Prizren, Dibër e sipërme, e poshtëme, Mat, Krujë, Tiranë, Durrës, Kavajë, Peqin dhe Elbasan), Shqipni e poshtëme (në mes Shkumbinit dhe kufinit të ri grek qi ahere arrinte afër Janinës). Janina s' asht e Shqipnisë, po se mbrenda kufijve të ra greke gjinden shqiptarë (afër 15.000 — Kr. i ka çmue pak për kohën) kryesisht në krahinat e Margaritit, Paramithisë dhe Sulit. Me këta grekët duhet të sillen në mënyrë të përshtatëshme dhe jo t'i konsiderojnë si grekë. Manastiri dhe Ohri nuk janë shqiptare, po Korça asht. Në rrethet e Mitrovicës dhe Prishtinës ka mjaft serbë, po Metohia asht thjesht shqiptare dhe muhamedane. Sa për Lidhjen e Prizrenit «ajo asht kryesisht puna e derebejve, mbeturina të bujarisë së vjetër feudale, të cilët i shtyn dhe i mbështet Stambolli» («...the Derebeys, the remains of the old feudal nobility, who are instigated and supported from Constantinople») «Po përjashta («outside») Lidhjes shqiptare dhe në bashkëveprim me te («and acting with it»), ve gjer n'ate shkallë sa qëllimet e tyne janë të përbashkëta, ka nji lëvizje kombëtare autentike dhe serioze («genuine and serious»), e cila edhe pse asht fort e re, po përhapet me shpejtësi të madhe. Derbejt vetëm luejnë me kryengritjen («are only playing with sedition»), tue dashë të zgjasin auktoritetin e Sulltanit dhe në të njëjtën kohë, të rivendosin fuqinë e tyne ashtu siç e patën përpara reformave të Sulltan Mahmudit. Po lëvizja kombëtare e vërtetë, e cila do të bahet shum e fortë për derebejt dhe Portën e Naltë, e ka qëllimin ma lark.» Kr. thotë se kjo lëvizje kërkon «të ruej sovranitetin e Sulltanit dhe asgja ma

BIBLIOTEKA KOMBËTARE

shum», «si fjala vjen ai e ka në Rumelinë orientale» dhe «do të krijojë një Shqipni të madhe, e cila do të përmbllithte të tre vilajetet e përmenduna ma sipër, nën nji princ qi t'i dërgohej nga jashtë, me qenë se do të qe e vështirë të gjindej ndonji i tillë në Shqipni vetë, të cilën ta pranojin gjith partitë nji zani». Qeverimi i Shqipnisë të bahej pastaj simbas krahinave, krye të cilave të qëndronte nga nji qeveritar i fesë qi predominon n'ate krahinë. Në pyetjen qi i ka bamë përmi dallimin në mes toskënishtes dhe gegënishtes, Kr. asht përgjegjë se ky dallim «asht ekzagjerue» dhe se «ato nuk ndryshojnë prej njana tjetrës ma shum se anglishtja me të folmen scotch» («no more than english and brood Scotch»). Etj.

51) Sipas një cope leire turqisht, së cilës nuk i njihet auktori, nisun prej Durrësi më 15 gusht 1884. — ASH. Dhe sipas Kleopatra Bibajës.

52) v. shënim 49.

53) ASH 5197, fq 39.

54) Leira dërgue Naços.

55) E Legrand: *Bibliographie albanaise*, Paris 1912, fq 101.

56) Për krahasimin në mes Grigorit dhe Kristoforidhit, v. dhe revistën «Dituria» Tiranë 1928.

57) Në ribotimin 1869, përdor «trimat», si Grigori; n'ate 1872, «ushtëtorët».

58) Sa herë asht rasti për dy r dhe jo për rr, po vemë vizën.

59) Në ribotimet, fjala «pretorio» asht heqë dhe janë lanë fjalët «shtëpi e guvernatorit».

60) Kjo *ae*, mendojnë se duhet lexue si *e* hundake.

61) Për Grigorin dhe Kr., v. *Mathe* XXVII, 27-36. Zef Gualiata: *Dottrina e kershten*, Romë, botim i Propaganda Fides, 1856, fq 5. Vincenz Basile: *Ruga e Parrisit* Romë, botim i njejtë, 1873, fq 83. Nuk mundëm të përdorim botimet e para të këtyne dy auktorëve. të cilat janë të vitit 1845. Kr. ka mundë të përdori edhe shkrimtarë të tjerë katolikë të veriut qi shkruejtën pas këtyne të dyve dhe para vitit 1866, si E. Radoja: *Jesu Krishti n'zemer t'meshtarit*, Romë 1862; *Udha e sheites kryq*... prei nji frat (=D. Buccìarelli), Romë 1862; *Confessione pratica italo-epirotica*, prej F. B. D. F. (=B. da Francavilla), Romë 1863; G. Brusci: *Moj' i Majit shiuguruum Zeis Bekueme*, Romë 1864; — të gjitha botime të Propoganda Fide-s. Veç Radojës, gjith auktorët e tjerë janë italianë, të cilët shqipen e shkruejnë mjaft keq.

62) Legrand, fq 108.

63) Grigori, *Lluka* XXIV. Kristoforidhi: Psalme 89. Për Veqilharxhin, v. transkriptimin e parathanjes s'abetares së tij te «Kalendari Kombiar», Sofje 1900, fq 60.

64) Legrand, fq 111.

65-66) Id. fq 113

67) *Abetari* fq 10; *Allfavitari*, fq 10.

68) Legrand. fq 115.

69) Psalme 137.

70) Legrand, fq 114.

71) Id. fq 116.

72) *Luka* XV, 12-32.

73) Legrand, fq 114.

74) Psalme 5; *Istoria*, fq 21.

75) G. Meyer: *Etymologisches Worterbuch der albanesischen Sprache*, Strasburg 1891, fq 519.

76) Id. fq 517.

77) Legrand, fq 132.

78) Meyer, fq 517.

79) Legrand, fq 132.

80) Id. fq 131.

81) Id. fq 132.

82) Id. fq 129.

83) Id. fq 135.

84) *Të Bërëtë* XLII, 1-9; *Allfabetare e Gjuhës Shqip*, Stamboll 1879, fq 24.

85) Meyer, fq 517.

86) Legrand, fq 139.

87) v. shënim 43.

88-91) Legrand, fq 146.

92) *Isaia* XXXVI, 13-16; Naim Frashëri: *E këndimit çunavet këndonjëtereja*, copë e parë, Bukuresht 1886, fq 24.

93) Legrand fq. 145,

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MIHAL PRENUSHI" SHKODËR

ENDEMIJA MALARIKE NË KRAHINAT E ELBASANIT, BERATIT DHE VLORËS

nga

Dr. ANTON ASHTA

Krahina e Elbasanit

Kjo krahinë, që përfshin zonën e Elbasanit, të Gramshit, të Librazhdit dhe të Peqinit, me nji populisi kompleksive prej 111.707 banorësh, asht ma tepër krahinë malore dhe e përshkrueme prej lumejve Devoll e Shkumbin. Orizoret, prrojet, moçalishtet dhe përdorimi i keq i ujit për vaditje janë këtu shkaqet për zhvillimin e malarjes.

ELBASANI DHE QARKU I TIJ

Qyteti i Elbasanit asht i vendosun mbi një fushë të qarkueme nga tri anë me male dhe kodrina. Kah ana e Jugut i kalon Shkumbini, në Veri prroj i Zaranikës, në Lindje ay i Manasderës; në Prendim, pakë jashtë tri kilometrave, prroj i Kushës. Prej Veri-Lindjes në Jugë-Prendim shtrihet zona fushore e orizit e punueme mbas nji sistemi të dobët nga pikëpamja e zhvillimit anofelik. Ujt e krojeve të qytetit rrjedhin në kanale të shumta e të hapta të cilat shifen tue kalue kudo nëpër qytet, e shkojnë e bashkohen me kanale të tjera të çilura për të sjellë ujt e lumejve dhe prrojeve për ujitje tokash. Ujt futet ndër të gjitha përmishtet e shumta n'Elbasan dhe, tue kalue nëpër kanale dhe vija, dershet në Shkumbin ase në Zaranikë. Troilli mbi të cilin asht ngrehë qyteti asht pakë në tëposhtë dhe ujt gjen kështu lehtësi rrjedhe, por nji herë mbetet i penguem prej bimve ujëse.

Qyteti asht mjaft malarik. Në vjetin 1930 u vërtetue se 75% të fëmijve vuenin vazhdimimisht nga malarja. Burimet kryesore t'anofeleve janë Shkumbini, sistemi i ndërtuem keq dhe i papërshtatëshëm i vaditjes, orizoret dhe disa moçalishte të shkaktueme prej burimeve t'ujit.

Shkak kryesor i infektimit asht mushkaja *A. superpictua* qi nis të zhvillohet në Korrik-Gusht, por dhe nji shumicë e madhe e llojit *A. maculipennis* gjindet sidomos në periferi të qytetit.

BIBLIOTEKA PUBLIKE MARIN BARLETI SHKODËR

ENDEMIJA MALARIKE NË QYTETIN E ELBASANIT

Indeksi splenik

Vjeti	1938	1945	1947	1948
Numuri i fëmijve të ekzaminuem	1000	1000	628	800
Numuri me shpnetkë të smadhueme	471	333	176	39
% mbi të ekzaminuemit	47.1	33.3	28	4.8
Numuri me shpnetkë normale	529	667	452	761
% mbi të ekzaminuemit	52.9	66.7	62	95.2
Numuri me shpnetkë të vogël P.	259	227	122	26
% mbi të ekzaminuemit	25.9	22.7	19.4	3.2
Numuri me shpnetkë të mesme 1-2	208	101	49	12
% mbi të ekzaminuemit	20.8	10.1	7.7	1.5
Numuri me shpnetkë të madhe 3-4	4	5	5	1
% mbi të ekzaminuemit	0.4	0.5	0.7	0.1

Indeksi parasitar


Vjeti	1938	1945	1948
Numuri i fëmijve të ekzaminuem	500	1000	800
Pozitiva	174	77	12
% mbi të ekzaminuemit	34.8	7.7	1.5
Me P. vivax	137	26	8
% mbi pozitivat	78.7	33.7	66.6
Me P. falciparum	29	51	4
% mbi pozitivat	16.6	66.2	33.3
Me P. malariae	8	0	0
% mbi pozitivat	4.6	0	0

BIBLIOTEKA PUBLIKE
„MARIN BARLETI"
SHKODËR

Ulja e infekcionit prej 47,1% në 4,8% prej vjetit 1938 në vjeshtën e vjetit 1948 i detyrohet masave të marruna mbas Çlirimit në intensifikimin e veprimeve antimalarike tue zhduk folenat e zhvillimit anofelik, tue rregulue vaditjen e tokave, tue spërkat shpijat me insekticidin D.D.T. e tue kurue të smuetit; pjesëmarrja e popullit në këtë drejtim ka qënë e vlefshme.

Grafiku i bashkangjitun pasqyron rezultatin e arritun.

INFEKTIMI MALARIK NE QYTETIN E ELBASANIT «INDEKSI SPLENIK»



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

Morboziteti.— Veprimtarija e Dispenserisë Antimalarike, si qëndër diagnostikimi pranë Qendrës Higjienike dhe Poliambulancës, gjatë vjetëve 1945-48 rezulton të jetë si vijon:

Vjeti	Nr. ekzam.	Pozitiva	%	P. vivax	%	P. falcip.	%	P. malar.	%
1945	212	93	43.8	41	44 0	47	50.5	5	5 3
1946	292	122	41.7	68	55.7	53	43.4	1	0.8
1947	482	202	41.9	77	38.1	84	41	41	20.3
1948	1739	147	8.4	155	78.2	32	21.7	0	0

Në vjetët 1945-48 numuri global i ekzaminimeve nda simbas muajve rezultoa të jetë si vijon:


Muaji	Ekzaminime	Pozitiva	P. vivax	P. falciparum	P. malariae
Janar	4	1	0	1	0
Fror	4	1	1	0	0
Mars	3	1	1	0	0
Prill	115	19	17	2	0
Maj	304	59	42	15	2
Qershor	500	68	50	14	6
Korrik	510	127	73	35	19
Gusht	472	102	56	36	16
Shtator	440	133	35	87	11
Tetor	232	26	8	17	1
Nandor	102	24	15	9	0
Dhetor	39	3	3	0	0

Përqindja e naltë e pozitivave mbi të ekzaminuemit gjatë vjetit 1945 na kallzon burimin e infeksioneve në vjetët e okupacionit, e ulja e infeksionit në vjetin 1948 në 8.4% na tregon rezultatin e masave të marruna në luftimin e malarjes.

Qarku i Elbasanit përbahet prej 105 katundesh të vendosuna në

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

mal e në fushë. Infektimi në banorët e katundeve t'ekzaminuem në vjeshtën e 1948-ës ka qënë masatarisht 12.6%.



BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Llojet e mushkajave janë : *A. superpictus* dhe *A. maculipennis.*

Endemija Malarike. Në vjetin 1945 infektimi i katundit Gostimë ka qenë 63%, i Bellshit 38%, ndërsa në vjeshtën e 1948-ës indeksi splenik pasqyrohej si ma poshtë:

Vendi	Nr. i ekzam.	Nr. me shpnetkë të rritun	%	O	P	1-2	3-4
Shtepaj	120	33	27.5	87	10	22	1
Shirgjan	37	14	37.8	23	7	7	0
Gjergjan	61	30	49.2	31	15	15	0
Labinot	48	13	27.8	35	8	5	0
Bellsh	421	43	73.4	278	29	14	0

ZONA E GRAMSHIT.

Me nji populisi prej 16.542 banorësh, kjo zonë ka fshatra të vendosuna shumica në naltësina. Me gjithë këtë, përqindja e infektimit ndër 415 fëmijë të vizituem në 6 katunde në vjeshtën e 1948-ës del 24. Populisija e shpërndame në banesa të largta njena prej tjetrës merret ma tepër me blektori. Asistenca mjeksore asht përmirsue disi ndër vjetet e fundit dhe janë marrë masa për spërkatjen e banesave të katundeve malarike me D.D.T. si edhe për shpërndamjen e barnave antimalarike ndër të smuetit. Nji dispenseri antimalarike funkcjonon në qëndren e Gramshit pranë spitalit rural. Ekzaminimet e të vizituemve kanë dhanë këto rezultate:

Vjeti	Ekzamin.	Pozitiva	%	P. vivax	%	P. falcip	%	P. mal	%
1946	748	410	54.8	122	29.7	288	70.2	0	0
1947	100	10	10.0	0	0	0	0	10	100
1948	807	89	11.0	53	59.5	12	13.5	24	26 9

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

ENDEMIJA MALARIKE NË ZONËN E GRAMSHIT (VJESHTË 1948)

Indeksi splenik

Vëndi	Nr. i ekzam'n.	Nr. me shpnetkë të rritun	% mbi të ekzaminuem	O	% mbi të ekzaminuem.	P	% mbi të ekzaminuem.	1-2	% mbi të ekzamin.	3-4	% mbi të ekzaminuem.
Gramsh	62	13	21.3	49	78.7	9	14.5	3	4 8	1	1.6
Kushovë	35	11	31.4	24	68.6	6	17.1	5	14 2	0	0
Shmrizë	87	29	33.3	57	66.7	22	25.3	7	8.0	0	0
Galigat	118	21	17 8	107	82.2	17	14.4	4	3.3	0	0
Bulçar	77	15	19.5	53	80.5	11	14.2	4	5.2	0	0
Bersnik	36	11	30.5	25	69 5	7	19.4	4	11.1	0	0
SHUMA	415	100	24.0	315	76.0	72	17.3	27	6.5	1	0.2

Indeksi parasitar

Vendi	Nr. i ekzamin.	Pozitiva	% mbi të ekzamin.	P. vivax.	% mbi të ekzamin.	P. falcip.	% mbi të ekzamin.	P. malar.	% mbi të ekzamin.
Gramsh	62	3	4.8	1	1.6	1	1.6	1	1.6
Kushovë	35	1	2.9	1	2.9	0	0	0	0
Shmrizë	87	0	0	0	0	0	0	0	0
Galigat	118	4	3.4	2	1.7	1	0.0	1	0,8
Bulçar	77	1	1.3	1	1.3	0	0	0	0
Bersnik	36	1	2.8	1	2 8	0	0	0	0
SHUMA	415	10	2.4	6	1.4	2	0 4	2	0.4

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

ZONA E PEQINIT.

Kjo zonë ka një populisi prej 15.251 banorësh të shpërndamë në qytetin e Peqinit dhe në 61 katunde. Indeksi splenik në qytetin e Peqinit ka qenë 85% më 1938, kurse më 1948 ka zbritë në 8.5%. Fotetë ma me rëndësi janë Shkumbini, orizoret dhe disa prroje.

Llojet e mushkajave anofelike janë: *A. superpictus* dhe *A. maculipennis.*

ENDEMIJA MALARIKE NË QYTETIN E PEQINIT

Indeksi splenik

Vjeti	1938	1945	1947	1948
Nr. i fëmijve të ekzaminuem	175	262	398	400
Nr. me shpuetkë të rritun	150	142	52	34
% mbi të ekzaminuemit	85.7	54.2	13	8.5
Nr. me shpuetkë normale	25	120	346	36
% mbi të ekzaminuemit	14 2	45.8	86.9	91.5
Nr. me shpuetkë të vogël P.	49	78	24	16
% mbi të ekzaminuemit	28.2	29.2	6.0	4.0
Nr. me shpuetkë të mesme 1-2	97	61	26	17
% mbi të ekzaminuemit	55.4	23.3	6.5	4 2
Nr. me shpuetkë të madhe 3-4	4	3	2	1
% mbi të ekzaminuemit	2.2	1.1	0.5	0.4

Indeksi parasitar


Vjeti	1938	1945	1947	1948
Nr. i ekzaminimeve	175	262	201	400
Pozitiva	67	8	4	3
% mbi të ekzaminuemit	38 2	3.0	19.9	0.7
Me P. vivax	10	1	3	3
% mbi pozitivat	14.9	12.5	75.0	100.0
Me P. falciparum	47	7	1	0
% mbi pozitivat	70.1	87,5	25.0	0
Me P. malariae	10	0	0	0
% mbi pozitivat	14.9	0	0	0

Me anën e spërkatjes residuale të banesavet me D.D.T., me kujdesin e math në kurimin e të sëmurve dhe me intensifikimin e luftimit antilarvuer, përqindja e t'imfektuemve në këtë qëndër ka zbritë prej 85% në 8.5%.

Morboziteti.— Ekzaminimet e kryeme pranë dispenserisë së qëndrës të Peqinit japin këto rezultate:

Vjeti	Ekzamin	Pozitiva	%	P. vivax	%	P. falcip	%	P. mala.	%
1944	102	90	88.2	28	31.1	55	61.1	7	7.7
1946	242	137	56.6	29	21.1	101	73.7	7	5.1
1947	2430	593	24,4	424	71.5	68	11.4	101	17.2
1948	2157	103	4.7	91	88 3	9	8 7	3	2.9

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R



INFEKTIMI MALARIK NË OVTETIN E DEQINIT INOKUL SPLENIK.)

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D Ë R

Preparatat e ekzaminuame gjatë vjetëve 1946-48, simbis muajve ja-pin këto rezultate:

Muaji	Ekzamin	Pozitiva	P. vivax	P. falciparum	P. malariae
Janar	28	2	2	0	0
Fror	34	4	4	0	0
Mars	66	8	5	2	1
Prill	251	30	23	2	5
Maj	325	82	59	11	12
Qërshor	585	107	67	18	22
Korrik	700	178	79	83	16
Gusht	700	157	94	25	38
Shtator	1066	210	166	28	16
Tetor	768	50	42	8	0
Nandor	257	4	3	0	0
Dhetor	49	1	0	1	0

ZONA E LIBRAZHDIT

Me nji populsi prej 27.072 banorësh, kjo zonë përfshin 38 katunde për ma tepër malore. Infektimi nuk asht dhe aqë i randë përveç ndonji katundi si Qukësi ku në 19.7 përqindja e t'infektuemve ka qënë 51.

ENDEMIJA MALARIKE NË ZONËN E LIBRAZHDIT (VJESHTË 1948)

Indeksi splenik

Vëndi	Nr. i ekzamin.	Nr. me shpretkë të rritun	% mbi të ekzaminu.	O	% mbi të ekzaminuem.	P	% mbi të ekzamin.	1-2	% mbi të ekzamin.	3-4	% mbi të ekzam.
Librazhd	96	16	16.6	80	83.4	5	5.2	9	9.3	2	2.0
Dorez	89	19	21.3	70	78.7	15	16.8	4	4.5	0	0
Babie	54	15	27.7	39	72.3	10	18.5	5	9.2	0	0
Spathar	71	9	12.6	62	87.4	6	8.4	3	4.2	0	0
SHUMA	310	59	19.0	251	81.0	36	11.6	21	6.8	2	0.6

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D R

Indeksi parasitar

Vëndi	Nr. i ekzamin.	Pozitive	% mbi të ekzamin.	P. vivax	% mbi të ekzamin.	P. falcip.	% mbi të ekzamin.	P. malar.	% mbi të ekzam.
Librazhd	96	1	1 0	0	0	1	1.0	0	0
Dorëz	89	4	4.5	2	2.2	2	2.2	0	0
Babie	54	1	1.8	0	0	1	1.8	0	0
Spathar	71	0	0	0	0	0	0	0	0
SHUMA	310	6	1.9	2	0.6	4	1.3	0	0

Krahina e Beratit

Kjo krahinë, pjesërisht malore pjesërisht fushore, përfshin zonën e Beratit, të Kuçovës, të Skraparit dhe të Lushnjes.

BERATI DHE QARKU I TIJ

Qyteti i Beratit qi mer emrin prej kalasë së bardhë, gjindet 68 m. mbi nivelin e detit. Shtëpijat i ka të mbledhuna njena afër tjetrës, me rrugica të ngushta dhe me përpjeta. Qyteti asht mjaft malarik. Më 1931 indeksi splenik i nxansve delte 74%. Burim kryesuer i malarjes asht shtrati i Osumit, qi e ndan qytetin në dy pjesë; burime të tjerë janë prrojet dhe lumenjt qi i kalojnë përbri, disa moçalishte qi vijnë prej shpërdorimit t' ujit për vaditje si edhe orizoret që ndodhen n' afërsit e qytetit. Në vjetin 1938 infektimi, mbas 6 vjet punimi, u zbrit në 32.9%; në vjeshtën e 1945-ës indeksi splenik tregonte se ndër 100 vetë të vizituem 64 ishin me shpnetkë të rritun. Mjekët e qytetit kanë pohue se malarja ka qenë e randë gjatë këtij vjeti, jo vetëm si simptomatologji po edhe si sasi. Vdekjet nuk kanë mungue. Këto mund të shpreheshin me shifra po të kishim nji statistikë të saktë mbi vdekjet prej malarjes. Duhet theksuar se shkak i kësaj epidemije kanë qenë faktorë të ndryshëm: mosramja e shiut në këtë vit, e cila ka pakësue frydhën e lumejve dhe të burimeve tue favorizue formimin e foleve; grumbullimi i personave prej çdo krahine, banesat e djeguna, asistenca mjeksore e dobët, mjekimet e pamjaftueshme. Nga ana tjetër duhet theksue se edhe përpjekja në luftën kundër malarjes nuk ka qënë dhe aqë e madhe për arsye se si Seksioni i Shëndetsisë ashtu dhe puntorija merreshin për të parën herë me këtë shërbim. Zhvillimi i mushkajave ka qenë mjaft i math. Mbas vjetit 1945 u intensifikue veprimtarija antimalarike në këtë qëndër dhe në vjeshtën e 1948-ës indeksi splenik i nxansve zbriti në 19.3%.

BIBLIOTEKA PUBLIKE SHKODER MARIN BARLETI

Përqindja asht ende e naltë, por në këtë mes duhet theksue se shpnetkat e mëdhaja janë çdukë, të mesmet janë pakësue, tue mbetë e naltë vetëm përqindja e shpnetkave të vogla të cilat me masat qi po merren, vijnë tue u-pakësue. Në 1948 endemija malarike ka qenë shum e ultë. Vdekje të shkaktueme prej saj nuk ka pasë dhe raset e infektimeve të rea kanë qenë të kufizueme. Edhe rasat me përsëritje ethesh kanë qenë me simptomatologji të lehtë.

ENDEMIA MALARIKE NË QYTETIN E BERATIT


Indeksi splenik

Vjeti	1938	1945	1947	1948
Nr. i fëmijve të ekzaminuar	1000	1000	1203	580
Nr. me shpnetkë të rritun	329	643	644	113
% mbi të ekzaminuemit	32.9	64.3	53.5	19.3
Nr. me shpnetkë normale	671	357	559	461
% mbi të ekzaminuemit	61.1	35.7	46.5	80,7
Nr. me shpnetke të vogël P.	235	503	396	99
% mbi të ekzaminuemit	23.5	50.3	32.9	17.0
Nr. me shpnetkë të mesme 1-2	94	138	245	14
% mbi të ekzaminuemit	9.4	13.8	20.4	2.3
Nr. me shpnetkë të madhe 3-4	0	2	3	0
% mbi të ekzaminuemit	0	0.2	0.2	0

Indeksi parasitar

Vjeti	1938	1945	1947	1948
Nr. i fëmijëve të ekzaminuem	500	1000	518	580
Pozitiva	74	178	43	3
% mbi të ekzaminuemit	14.8	17.8	8.3	0.5
P. vivax	23	71	33	2
% mbi pozitivat	31.1	39,3	76.7	66.6
P. falciparum	39	104	8	1
% mbi pozitivat	52.7	58.5	18.6	33.3
P. malariae	12	3	2	0
% mbi pozitivat	16 2	1.7	4.6	0

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR




INFEKTIMI MALARIK NË QYTETIN E BERATIT.

(Indeksi Splenik.)

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Mushkajat që shkaktojnë malarjen janë: *A. maculipennis* dhe sidomos *A. superpictus*.



BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Për mprojtjen e qendrës duhet intensifikue spërkatja residuale me D. D. T. e banesavet dhe grazhdeve, me anën e nji pune të vazhdueshme dhe pa ndërprerje.

Morboziteti. — Veprimtarija e dispenserisë antimalarike pasqyrohet si vijon:

Vjeti	Ekzamin.	Pozitiva	%	P.vivax	%	P.falciparum	%	P.malar.	%
1940	540	407	75.3	148	36.3	197	48.4	62	15.2
1945	1342	668	49.7	202	30.2	448	67,0	18	2.6
1947	2251	700	31	391	55.8	284	40.5	25	3.5
1948	1696	217	12.8	150	69.1	32	14.7	35	16.1

Preparatat e ekzaminueme gjatë vjetëve 1945-48 dhe nda sipas muajve japin këto rezultate:

Muaji	Ekzamin.	Pozitiva	P. vivax	P. falciparum	P. malariae
Janar	236	55	25	20	10
Fror	103	21	13	5	3
Mars	208	33	24	5	4
Prill	455	109	89	7	13
Maj	851	230	195	24	11
Qershor	894	190	177	5	8
Korrik	895	271	175	85	11
Gusht	1301	457	135	318	4
Shtator	1362	654	158	487	9
Tetor	501	343	66	264	13
Nandor	308	154	41	110	3
Dhetor	125	34	7	23	4

Prej shifrave të paraqituna del se nga tri trajtat e malarjes që janë çfaqë, ma tepër takohet *P. falciparum* në vitet 1940 e 1945; në vitet 1947-48 kjo trajtë zbret tue u ngrit *P. vivax*. Trajta ma e rallë asht *P. malariae* Malaria ma tepër ndihet në muajt Korrik-Gusht.

Qarku i Beratit ka malarje të randë me gjithse 89 katundet e tij janë vendosur ma tepër në vënde malore. Mund të thuhet se ndër 100 veta të këtij qarku 50 janë të infektuem me malarje.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Vëndi	Nr. i ekzaminuim	Nr. meshpnetkë të rritun	% mbi të ekzamin	O	% mbi të ekzamin.	P	% mbi të ekzamin.	1-2	% mbi të ekzamin.	3-4	% mbi të ekzamin.
Lapardha	97	60	61.8	37	38.2	32	33.0	27	27.8	1	1.0
Qereshnik	52	40	76 9	12	23.1	20	38.4	20	38.4	0	0
Roshnik	43	30	69.7	13	30.3	16	37.2	14	32.5	0	0
Kapinovë	81	27	33.3	54	66.7	22	27.1	5	6.1	0	0
Vodicë	24	17	70.8	7	29.2	12	50.0	5	20.8	0	0
Drobonik	34	25	73.5	9	26.5	14	41.1	10	29.4	1	2,9
Terpan	60	32	53.3	28	46.7	25	41.5	7	11.5	0	0
Plashnik (Molishtë)	53	32	60.3	21	39.7	10	18.8	21	39.7	1	1.8
Paftal-Mbreshtan	152	69	45.4	83	54.6	55	36,1	14	9.2	0	0
SHUMA	596	332	55.7	264	44.3	206	34.5	123	20.6	3	0.5

ZONA E KUÇOVËS

Katundet e kësaj zone janë të vendosuna pjesërisht në fushë pranë knetave dhe orizoreve, pjesërisht ndër lugina të maleve dhe kodrinave. Infektimi arrin në 59%.

Pasqyra e indeksit splenik të disa katundeve të kësaj zone si edhe të Kantjerit të Kuçovës asht siç vijon:

ENDEMIJA MALARIKE NË KANTJERIN E KUÇOVËS

Indeksi splenik

Vjeti	1945	1947
Nr. i fëmijve të ekzaminuem	181	294
Nr. i fëmijve me shpnetkë të rritun	66	65
% mbi të ekzaminuemit	36.4	22.1
Nr. me shpnetkë normale	115	229
% mbi të të ekzaminuemit	63.5	77,9
Nr. me shpnetkë të vogël P.	35	64
% mbi të ekzaminuemit	19 8	21.7
Nr. me shpnetkë të mesme 1-2	30	1
% mbi të ekzaminuemit	16.5	0,3
Nr. me shpnetkë të madhe 3-4	0	0
% mbi të ekzaminuemit	0	0

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Indeksi parasitar

Vjeti	1945	1947
Nr. i fëmijve të ekzaminuem	181	294
Pozitiva	15	8
% mbi të ekzaminuemit	8.3	2.7
Me P. vivax	5	3
% mbi pozitivat	33.3	37.5
Me P. falciparum	10	5
% mbi pozitivat	66.6	62.5
Me P. malariae	0	0
% mbi pozitivat	0	0

Nga katundet e kësaj zone Porani asht i infektuem 55.9% Vokopola 80.4%, Poshnja 59.4%.

Morboziteti. — Pranë dispenserisë së spitalit të Kantjerit të Kuçovës preparatat e ekzaminimeve kanë dhanë rezultatet që vijojnë:

Vjeti	Ekzamin.	Pozitiva	%	P. vivax	%	P. falcip	%	P. malar.	%
1946	268	144	53.7	97	63.3	47	32.6	0	0
1947	591	306	51.7	120	39.2	186	60.7	0	0
1948	823	170	20.6	118	69.4	46	27.0	6	0.5

ZONA E SKRAPARIT.

Në populisin e kësaj zone, edhe pse e vendosun ndër naltësina, malaria asht e randë. Mjeku i Skraparit Tomoricën e cilson si Myzeqe të dytë. Ndër 10280 të vizituem nga mjeku më 1945 rezultuen malarik 4342, d.m.th. 42%.

Përqindja e infektimit të disa katundeve të kësaj zone asht: Çepan 10.4%, Xhepa 14%, Qender 24%, Slatinja 28.7%.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

ENDEMIJA MALARIKE NË ZONËN E SKRAPARIT

Indeksi splenik

Vjeti	1945	1948
Nr. i fëmijve të ekzaminuem	275	100
Nr. me shpretkë të rritur	157	24
% mbi të ekzaminuemit	57.0	24.0
Nr. me shpretkë normale	180	76
% mbi të ekzaminuemit	42.9	76.0
Nr. me shpretkë të vogël P.	148	20
% mbi të ekzaminuemit	53.8	20.0
Nr. me shpretkë të mesme 1-2	9	4
% mbi të ekzaminuemit	3 2	4.0
Nr. me shpretkë të madhe 3-4	0	0
% mbi të ekzaminuemit	0	0

Indeksi parasitar

Vjeti	1945	1948
Nr. i fëmijve të ekzaminuem	275	105
Pozitiva	24	4
% mbi të ekzaminuemit	8.7	3.8
Me P. vivax	4	0
% mbi pozitivat	16.6	0
Me P. falciparum	19	4
% mbi pozitivat	79.1	100.0
Me P. malariae	1	0
% mbi pozitivat	4.1	0

Morboziteti. — Pranë Dispenserisë Antimalarike të Skraparit ekzaminimet kanë dhanë këto rezultate:

Vjeti	Nr. i ekzam.	Pozitiva	%	P. vivax	%	P. falcip.	%	P. mal.	%
1946	957	548	57.2	96	17.5	424	77.3	28	9.1
1948	1031	262	25.4	24	9 1	235	89.7	3	1.1

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S K O D E R

ZONA E LUSHNJËS.

Kënetat dhe malarja mbretënojnë në këtë zonë fushore qi ka nji populisi prej 47.343 të shpërndame ndër 91 katunde. Fusha dikur e begatëshme dhe prodhimtare ka qënë shkretue në kohnat e kalueme por, me përpjekjet e mëdha qi asht tue ba sot Pushteti Popullor, përsëri kthehet në nji zonë të begatshme për bujkun tonë. Tue i heqë malarjen kësaj fushe, populli do t' i rifitojë energjitë e bieruna dhe Myzeqeja do të bahet nji tokë e lulzueme dhe e pasun si qinda vjetë më parë.

Në regjimet e kalueme populisija e këtyne viseve ka pasë mbetë në mëshirën e malarjes. Sot për mprojtjen e kësaj populisije bujqësore; Pushteti Popullor ka marrë masa të gjana; hapësinat kënetare po spërkaten me anën e aeroplanit me larvëmbytësin D. D. T., sikundër banesat dhe grazhdet; të sëmutit kurohen tue u organizue shërbimi në mënyrë t' atillë qi asnji mos të mbetet i përjashtuem. Bujku i mprojtun fle i qetë në banesën e tij pa u pickatë prej mushkajave të cilat përpara ia banin jetën të pa durushme. Ay qi i kujton me tmerr vuejtjet e viteve të kalueme i asht mirënjohës Pushtetit për masat qi e mprojnë.

Llojet e mushkajave janë: *A. elutus* me shumicë, *A. maculipennis*, e në disa zona dhe *A. superpictus* qi nisin zhvillimin në Maj dhe vazhdojnë deri në fund të Shtatorit.

Endemija malarike në zonën e Lushnjës. Në vjetin 1933 në disa katunde të Myzeqesë, si Remas, Karavasta, Babunjë qi ndodhen pranë kënetës, infektimi ka arritë në 96%. Në katundet Hallvagjas, Shënkollas, Dushkë, Grabian e Plemer, pranë kënetës së Tërbufit, infektimi ka qenë 94%; katundet Zhernec, Kryekuq, Kamenicë, Gurë në lindje të kënetës kanë pësue nji infektim prej 91%; në katundet Gumeni-Pasha, Bishcek, Germeni-Çok në prendim të Tërbufit infektimi ka arritë në 88%; Divjaka, 5 km. lark detit pranë kënetës Sulzotaj, e ka pasë infektimin 64%; Libofsha, buzë Devollit, 51%.

Infektimi malarik në qytetin e Lushnjës rezulton si vijon:

Indeksi splenik

Vjeti	1938	1947	1948
Nr. i fëmijëve të ekzaminuem	219	167	500
Nr. me shpuetkë të ritun	104	66	110
% mbi të ekzaminuemit	47.5	39.5	22.0
Nr. me shpuetkë normale	115	101	390
% mbi të ekzaminuemit	52.5	60.5	78.0
Nr. me shpuetkë të vogël P.	37	47	94
% mbi të ekzaminuemit	16.9	28.1	18.8
Nr. me shpuetkë të mesme 1-2	64	19	16
% mbi të ekzaminuemit	39.2	11.3	3.2
Nr. me shpuetkë të madhe 3-4	3	0	0
% mbi të ekzaminuemit	1.4	0	0

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Indeksi parasitar

Vjeti	1938	1948
Nr. i ekzaminimeve	125	500
Pozitiva	15	8
% mbi të ekzaminuemit	12	1.6
Me P. vivax	8	5
% mbi pozitivat	53.3	62.5
Me P. falciparum	6	3
% mbi pozitivat	40.0	37.5
Me P. malariae	1	0
% mbi pozitivat	6.6	0

Përmirësimi i arritur prej masave të marruna për mprojtjen e qytetit të Lushnjës asht i dukëshëm: infektimi prej 47.5% më 1938 ka zbritë në 22% më 1948.

Infektimi malarik në disa katunde të zonës së Lushnjës, nxierun prej indeksit splenik që u krye në vjeshtën e vjetit 1948 rezulton si vijon:

Indeksi splenik

Vëndi	Nr. i ekzamin.	Nr. me shpnetkë të ritun	% mbi të ekzaminuem	O	% mbi të ekzaminuem	P	% mbi të ekzaminuem	1-2	% mbi të ekzaminuem	3-4	% mbi të ekzaminuem
Kryekuq (Zërnec)	73	50	68.5	23	31.5	11	15.0	39	53.4	0	0
Remas Pervas	86	65	75.5	21	24.5	31	36.0	33	38.5	1	1.1
Fier-Seman	122	78	63.9	44	36.1	30	24.6	47	38.5	1	0.8
Bubullimë	199	17	8.5	182	91.4	14	7.0	3	1.5	0	0
Fier-Shegan	125	45	36.0	80	64.0	23	18,4	21	16.8	1	0 8
SHUMA	605	255	42.1	350	57.9	109	18.0	143	23.6	3	0.4

Indeksi parasitar

Vëndi	Nr. i ekzamin.	Pozitiva	% mbi të ekzamin.	P. vivax	% mbi të ekzamin.	P. falcip	% mbi të ekzam.	P. malar.	% mbi të ekzamin.
Kryekuq (Zërnec)	73	6	8.2	4	5.4	2	2.7	0	0
Remas-Pervas	86	9	10.4	4	4.6	3	3.4	2	2.3
Fier — Seman	122	7	5.7	5	4.0	2	1.6	0	0
Bubullimë	199	7	3.5	5	2.5	2	1.0	0	0
Fier-Shegan	125	7	5.6	6	4.8	1	0 8	0	0
SHUMA	605	36	5.9	24	3.9	10	1 6	2	0.3

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODER

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

Morboziteti. Aktiviteti i Dispenserisë Antimalarike në qytetin e Lushnjës qi ka funkcionue pranë spitalit rural asht si vijon:

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Vjeti	Ekzamin	Pozitiva	%	P. vivax	%	P. falcip.	%	P. malar.	%
1940	728	591	81.1	138	23.3	302	51.1	151	25.5
1946	295	158	53.5	40	25.3	116	73.4	2	1.2
1947	225	119	52.8	58	48.7	48	40.3	13	10.8
1948	956	98	10 2	65	66.3	33	30.6	0	0

Preperatat e ekzeminueme gjatë vjetëve 1945-48 në qytetin e Lushnjës japin këto rezultate simbas muajve:

Muaji	Ekzaminime	Pozitiva	P. vivax	P. falcip.	P. malar.
Janar	21	9	9	0	0
Fror	20	6	6	0	0
Mars	6	2	2	0	0
Prill	16	8	3	1	4
Maj	46	18	11	0	7
Qershor	351	85	70	8	7
Korrik	294	55	32	20	3
Gusht	480	193	70	112	11
Shtator	255	85	14	71	0
Tetor	213	61	12	47	2
Nandor	114	38	12	24	2
Dhetor	52	4	1	3	0

Krahina e Vlonës

Kjo krahinë shtrihet ndërmjet lumejve Seman e Osum dhe zbret deri në Porto Palermo. Zona, me një popullsi prej 152.138 banorë, asht ma tepër fushore dhe përfshin liqenin e Nartës, me disa moçalishte përbri, dhe nji seri kënetash, si ajo e Shegit, Mbrostarit, Roskovecit, Muri nës, etj. pranë lumejve Seman e Vjose deri te kënetа e Dukatit. Populisija merret ma tepër me bujqësi dhe blegtori. Disa katunde pranë rrjedhës së lumejve konsiderohen me endemi malarike të randë, në disa të tjera endemia asht e mesme.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODËR

VLONA DHE QARKU I SAJ

Qyteti i Vlonës, me afro 10.000 banorë, asht i ndërtum pjesërisht në ranxat e kodrinave qi e qarkojnë nga ana NNE me nji naltësi prej 630 m. mbi nivelin e detit, pjesërisht në fushë me nji naltësi prej 3—6 m. Qyteti ka qënë nji nder qendrat ma malarike të Shqipnisë. Më 1930, para se të filionte veprimi antimalarik, indeksi splenik i nxansve ishte 86%, ndërsa ndër fëmijt e vizitueme në skelën e Vlonës infektimi arrinte 96%. Shkak kryesuer janë moçalet e gjana qi ndodhen ndërmjet detit dhe qytetit si dhe prrojet me ujët të pakësuem gjatë stinës së verës.

Llojet e mushkajave: janë *A. elutus* qi gjindet me shumicë dhe zhvillohet nga mbarimi i Majit në fund të tetorit; *A. maculipennis typicus* qi nis të zhvillohet nga gjysma e Majit dhe arrin maksimumin e zhvillimit në Qershuer. zbret në Gushi dhe hip pak në Shtatuer; *A. superpictus*, mushkajë e rrallë në zonën e Vlonës.

Mbas veprimeve antimalarike të kryeme në këtë qendër në vjetin 1939, indeksi splenik zbriti në 38%. Gjatë luftës dhe okupacjonit, rrethana të ndryshme nuk lejuen nji luftim antimalarik të rregullt. Në Nandorin e 1945-ës indeksi splenik i nxansve qi qe 55% tregon se nalt nga gjysma e populisisë vuente herë mbas here prej etheve malarike Shkaku i këtij naltësimi ka qenë shrregullimi i ujnave i cili u-ba edhe ma i madh nga rrethanat e luftës e nga pakujdesjia e autoriteteve okupojse. Në pranverën e vjetit 1945 moçalishtet e Vlonës paraqiteshin plot me ujë dhe përbanin kështu nji rrezik të math për zhvillimin anofelik. Për t'a zhduk kë të rrezik Pushteti mori masa dhe installoi dy motopompa të cilat e hudhën ujt e moçalishteve në det, tue i tha këto në javët e para të Majit, para zhvillimit anofelik. Grupe puntorësh u përdoren për pastrim kanalesh e projesh dhe në mbushjen e gropave të hapuna nga bombardimet. Kujdesi i veçantë i u dha hudhjes së larvëmbytësit mbi të gjitha folenat, si dhe spërkatjes residiuale të banesave me D.D.T. Gjatë vjetit 1948 u vendos nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë qi të mbushesin ultësinat qi formojnë këto moçalishte, dhe për këtë qëllim u bënë matjet e nevojshme dhe u filluë hapja e nji kanali i cili, tue çue ujt në liqenin e Nartës. ndalonte ujt e prrojeve të derdhesh në këto moçalishte. Në vjetin 1949 filloi mbushja e këtyne moçalishteve.

Vlona, deri dje nji ndër qendrat ma malarike, gjatë verës së 1949-ës nuk përdori kënupjere mbi shtreten; popullsija muji të fiejë me dritare të hapuna pa u pickatë prej mushkanave. Mjekët qi përpara u lodheshin tue vizitue të sëmuetit, sot e shofin malarjen aqë t'ulun sa mund të thuhet se në qendrën e Vlonës nuk ka pasë infektime të rea; gjatë endemisë malarike të 1948-ës, vetëm pake raste me përsritje ethesh të malarikve të vjetër qi u paraqiten ndër ambulanca për mjekim u konstatu-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

an. Veprimi i intensifikuem i luftimit të malarjes duhet të vazhdohet deri sa të zhduken shkaqet e zhvillimit të mushkajave.

ENDEMIJA MALARIKE NË QYTETIN E VLONËS

Indeksi splenik

Vjeti	1938	1945	1948
Nr. i fëmijve të ekzaminuem	1000	1040	1002
Nr. me shpnetkë të rritur	475	573	357
% moi të ekzaminuemit	47.5	55.1	35.6
Nr. me shpnetkë normale	525	467	645
% mbi të ekzaminuemit	52.5	44.9	64.4
Nr. me shpnetkë të vogël P	265	353	204
% mbi të ekzaminuemit	26.5	33.9	20.3
Nr. me shpnetkë të mesme 1-2	208	197	150
% mbi të ekzaminuemit	20.6	18.9	14.9
Nr. me shpnetkë të madhe 3-4	2	23	3
% mbi të ekzaminuemit	0.2	2.3	0.3

Indeksi parasitar


Vjeti	1938	1945	1948
Nr. i fëmijve të ekzaminuem	500	1040	1002
Pozitiva	57	43	4
% mbi të ekzaminuemit	11.4	9.1	0.4
Me P. vivax	5	18	3
% mbi pozitivat	8.7	41.8	75.0
Me P. falcipasum	66	23	1
% mbi pozitivat	80.7	53.5	25.0
Me p. malariae	6	2	0
% mbi pozitivat	10.5	4.6	0

Përqindja e infektimit asht ende e naltë por dihet se shpnetkat lypin kohë me u zhdukë. Duhet të kalojnë vjete dhe brezi i ri të rritet pa qenë i infektuem për t'u -ulë indeksi splenik në nji minimum. Përmirësim shifet, përveç në uljen e përgjithshme, edhe në uljen e shpnetkave të mëdha.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

INFEKTIMI MALARIK NE QYTETIN E VLORES

(Indeksi splenik)



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S. H. K. O D E R

saj kërkohet trashsija uniforme dhe dredhja e mirë e materialit.

Në malci shpesh shifen vajza të vogla me nji furkë të vogël në dorë dhe me të, si objekt dëfrimi, tjerrin pranë nanës. Nana e kujdesshme e mëson bijën e vet me tjerrë edhe në moshën 10 vjeçe.

Në tjerrje janë tri punë të menjiherëshme: nxjerrja e materialit, dredhja, mbështjellja në bosht.

Me qënë se duert janë vetëm dy, puna nuk munt të bëhet e vijueshme, por me ndërpremje dhe duhen me u kthyem prap.

Nxjerrja e materialit prej shtëllunges bahet me njanën dorë, tue shtimë fijen e re në mes të gishtit të math dhe gishtit dëftues, dhe me këto dy formohet fija dhe i epet dredha e parë. Këto dy gishta herë mbas here shtihen në gojë, me u-lagë me pështymë; ndërkaq dora tjetër siell boshtin dhe e rrotullon fijen e re rreth tij provizorisht. Si të jetë nxjerrë nga nji pash fije, zhvillohet rishtas boshti dhe lëshohet poshtë dhe shtihet në mes të shuplakave të cilat fërkohen njena me tjetrën, dhe fija merr dredhë. Kështu kryhet pjesa e dytë e tjerrjes.

Pjesa e tretë, ajo e mbledhjes, kryhet tue e mbështjellë fijen e dredhun në mes të gishtit të madh dhe gishtit të vogël e rrotullohet dora, deri sa të jetë mbledhë krejt fija dhe boshti të jetë ngjitë nalt. Tashti e mbështjellin definitivisht në bosht. E kështu vijon tue fillue fazën e parë me fijen e re që e nis rishtas.

Bareshat ndër bjeshkë, ndërsa bagëtia kullosin, rrinë mbi nji shkrep të naltë, i cili i lejon me e lëshue boshtin disa metër poshtë, dhe kështu i apin dredhë një gjatësie më të madhe dhe fitojnë kohë.

Në vëndin tonë përdoret edhe nji mënyrë tjetër të tjeruni, ma praktike, e cila fiton kohën e kthesës që pamë sipër: ndërsa me njanën dorë nxjerr materialin prej shtëllunge, me tjetrin sjell boshtin rreth vedi në mënyrë që boshti tue u-sjellë i ep dredhë fijes dhe njiherë mbështillet fija rreth tij. Forma e parë shifet ndër gratë vllehe, vllehe të Shqipnisë së. Jugut, dhe ndër malcorët e Shqipnisë së veriut, ndërsa forma e dytë thuejse u-përgithësue.

Në viset e Jugut, për tjerjen përdorin nji vegël pak ma të zhvilluem, e cila fiton kohë ma tepër, pse dy fazat e fundit të tjerjes, dredhja e mbështjellja, kryhen automatikisht përnjiherë. Kjo vegël që në Korçë thirret *rrodhan* dhe ndoshta asht transformimi i djalës dredhan, prej verbit me dredhë, përdoret vetëm për dredhjen e fijes. Kjo vegël nuk lejon punimin të bahet tue ecë, por gruaja do të merret vetëm me atë punë. Shif fig. 22.

Mbi nji bazament të përbamë prej dy dhogash, të vendosuna paralelisht, me gjatësi mesatare 60 cm. dhe ndërmjetsi afër 20 cm. ngrihen në skaje 4 dhoga të tjera vertikale, të cilat sipër ndër krena kanë nji vrimë, ku përshkohen tranversalisht dy boshta. Ndëmjet dhogave vertikale, mbi boshtat, mbështeten dy rrota: e para e madhe, me diametër

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR




Fig. 22

30 — 40 cm, e tjetra shum'e vogël, me diametër 2—4 cm. Të dy rrotat janë të ngjitura në mënyrë të palëvizëshme me boshtin, dhe çdo lëvizje e rrotës transmetohet edhe në bosht dhe anasjelltas.

Rrathët e rrotave kanë të gryeme nga nji vijë nëpër të cilën përshkohet nji pe i trashë, i cili, tue u kryqzue në mes, i bashkon të dyja rrotat. Çdo lëvizje e rrotës së madhe i trasmetohet së vogëlës. Në krye të boshtit të rrotës së madhe i vehet nji manovelë, dhe t' allj të rrotës së vogël boshti i furkës.

Me nji të sjellun të manovelës sillet edhe rrota e madhe, e cila ja trasmeton sjelljen rrotës së vogël tue ja shumfishue shpejtësinë dhe automatikisht sillet edhe boshti i furkës rreth vedit. Para kësaj, vegle rrin gruaja e cila në gjoks mban nji torbë me nji shtullungë me lesh. Prej shtullungës dredhë nji fije që e lidhë për bosht. Me nji dorë vijon ushqimin e fijes dhe me tjetrën sjell manovelën.

Boshti, tue u sjellë rreth vedit, i ep dredhë fijes dhe e mbështjell. Me këtë vegël fitohet kohë, pse dredhja e mbështjellja, kryhen automatikisht në nji kohë.

Rrodhani u-përhap shumë në Shqipërin' e Jugut, ndër qytete dhe katunde dhe e zëvëndësoi boshtin dhe furkën, kurse në Shqipnin' e Veriut nuk njifet. Në ç'kohë dhe prej kah hyni në përdorim të popullit t'onë asht ende e panjoftun.

Gjithnji pështetë mi principin e rodhanit, deri vonë në shumë qytete të Shqipnis, dhe n'Elbasan dhe Tiranë ende sot, shihej në duer të mjeshtërve që krijuen nji industri primitive nji rodhan ma i madh, i cili përdoret për me tjerrë këmenën. Këmena në dorën e popullit tjerret me bosht e furkë, por ndër duer të mjeshtërve me këtë rodhan të madh. Kjo vegël ngjan shumë rodhanit të përfolun sipër, por asht shumë ma e madhe dhe në vënd të nji rrotës së vogël, ka tri rrota të vogla, dhe në vënd të manovelës ka një mekanizëm të thjeshtë, që e vë në lëvizje automatikisht tue ngrefë nji litar. Kjo vegël që përdoret sot n'Elbasan dhe në Tiranë nuk ka ndryshime të dukëshme në dy vëndet. (Shif. fig. 23).

Rrota e madhe në Dalsas asht me 11 rreze, n'Elbasan me 8 rreze. E para asht me rreth druni dhe e dyta me rreth spage. Ky asht ndry-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR





Fig. 23

shimi kryesor në mes të tyne; ndër pjesë të tjera ka shumë pak ndyshime. Edhe në Tiranë kanë marrë modelin e asaj t'Elbasanit që nisi të përhapej, pse ishte ma e fortë dhe e qëndrueshme (shih. fig. Nr. 24) a e Tiranës; b e Elbasanit.

Spaga trasmitente e rodhanit që lidh rrotën e madhe me të voglën këtu trefishohet: tri spagat që lidhin rrotën e madhe me tri rrota të vogla: nji lëvizje e rrotës së madhe ven në të sjellun të tri rrotat e vogla me njiherë.

Edhe manovela mungon te ky rodhan i madh: në vënd të saj ka dy makara të vume vertikalisht (fig. 24 c) nëpër të cilat kalon nji litar që i sillet për rreth boshtit të rrotës së madhe. Tri rrotat e vogla kanë nji



BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Fig. 24

gremç, si shifet në fig. 24 a. Me këto pika çfaqet ndryshimi në mes të tij dhe prej atij të voglit. Këtu tjerrësi punon në këmbë, dhe në nji krah mban torbën me këmenë. Litarin, i cili nëpër makara përshkohet nën bosht të rrotës së madhe, e lidh për brez. Tjerrësi fillon me dredhe dy fije përnjiherë të cilat kapen për dy grremçat e rrotave të vogla. Gremçi i tretë, në rrugën e parë,sillet pa gja. Tjerrësi, tue ecë nga mbrapa dhe tue ushqye me njanën dorë njanën fije dhe me tjetrën dorë fijen tjetër, tërhek litarin e lidhun për brez, i cili, tue ecë, ven në rrotullim boshtin e rrotës së madhe dhe ven në sjellje këtë, e cila ja trasmeton rrotullimin tri rrotave të vogla, tue u-sjellë rreth vedit, sjellin edhe gremçin, për të cilën janë kapë krenët e fijeve të reja, që prej rrotullimit marrin dredhë. Si i largohot afër 10 m. rodhanit të math, ndalet dhe dy fijet e dredhuna i lidh për gremçin e tretë dhe në të parin dhe të dytin fillon fije të reja, kështu vijon punimi, tue bamë dy fije të reja dhe tue i dredhe në mes të tyne në rrugën tjetër. Me këtë vegël lirohet edhe njana dorë që në rodhanin e vogël do të sillte manovelën dhe kështu tjerrjen dy fije për njiherë dhe nji e tretë që bashkon dy fijet e dredhme.

Këto pra janë shkallët e evolucionit të tjerrjes në vëndin tonë, të cilat janë ende në përdorim të populit:

Boshti dhe furka në përdorim të përgjithshëm.

Rodhani i vogël në përdorim vetëm të viseve të Jugut, ndër qytete dhe katunde.

Rodhani i math, në përdorim vetëm të mjeshtërve për këmenë, n'Elbasan dhe Daijas.

Trashësia e fijes së tjerrjes epet simbas qëllimit për të cilin bëhet tjerrja: ma e hollë ose ma e trashë. Fija simbas përdorimit kalon prej boshtit në : lamsha ose lëmsha, në masur ose masurka; në shtiza, në bokla ose boça dhe në tubza. Si për njanin ashtu për tjetrin, nji fëmi, në dasht çun, në dasht goçë, rri kundruell grues qi do me e mxierrë fijen prej boshtit. Ndër dy rrathët që formojnë gishtat e mëdhenj dhe gishtat dëftorë, shtie krenat e boshtit dhe i mban lirshëm që të rrotullohen rreth vedit. Grueja tërhek fijen dhe boshti tue u-sjellë zhvillohet. Fijën e kalon në:

Lamsha ose lëmshi, fig. 25 (a), zakonisht për trikotazhë, por në disa rasa edhe për thurrje, si do të shofim ma poshtë. Lamshat i mbledhin në dy mënyrë: a) në formë sferike tue e sjellë fijen breza breza a në formë ovale, tue e zbritë gjithherë nga nalt poshtë.

Në masur ose në masurka, prej fijes masë, (b) pështjellet zakonisht për punim në vegjë.

Në shtiza mbildhet fija për kalim në thurje : zakonisht për fijen e trash, mbasi fija e hollë kalon në vegjë ndër masur (c).

Në bokla ose boça dhe ndër tubza mbildhet fija për punim të gajtaneve, të spikut e të tjera kordona ornamentale. Boklat ose boçat janë si rakele prej druni, rreth 15 cm. të gjatë; (d) tubzat mbildhen rreth doras (e).

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Pambuku e mëndafshi që prodhohen në fije nuk e kalojnë këtë proces punimi që pamë deri tash: zakonisht pambuku importohet në shkuja ose dorashka; dhe mëndafshi prodhohet fije dhe mbildhet edhe ay me shtiza, si pamë sipër, ndër shkuja ose dorashka.

Për nxjerrjen e fijes nga shkuli ose dorashka, në përdorim të popullit kemi edhe dy vegla të ndryshme, të cilat janë të lidhuna njena me tjetrën: çekerku ose çikriku dhe endemia ose qerthulli.




Fig. 25

Çekerku ose çikriku asht nji vegël mbledhëse, dhe endemia ose qerthulli ësht nji vegël zhviliuese.

Endemia ose qerthulli në përdorim të popullit tregon dy shkallë nji ma t' ultë dhe nji ma të naltë: të shkallës me t' ultë kemi nji endemi, e cila ruen formën e nji cungut të piramides dhe pështetet mbi një bosht vertikal që e lejon me u-sjellë rreth vendit: ndër faqet e jashtme hapet dorashka ose shkuli, ku pjesa ma e ngushtë rri ma sipër dhe ma e gjana zbret nga fundi i cungut, ku ka trashësi ma të madhe. Tue u-tërhjekë fija, cungu i piramidës sillet rreth vendit dhe lejon daljen e saj; fig. Nr. 26.


Fig. 26

Forma ma e zhviliueme ka trajtën e nji çadrës, që hapet me nji dorëz të sipërme, simbas nevoje, edhe kjo si e parë sillet rreth nji boshti vertikal po të së njajtës mënyrë të sistemit ma primitiv. Fig. 27.

Prej endemisë ose qerthullit kalon fija në veglën mbledhëse ose në çikrikun e çekerkun. Fig. 28

Çikriku ose çekerku ka të njajtën formë me rodhanin e vogël, por gjanësia e tij ndryshon prej rodhanit, pse boshti i kapun për rrota asht ma i gjatë. Me nji të sjellun të manovelës vehet në rrotullim rreth vendi boshti i rrotave.

Në boshtin e rrotës së vogël shtijnë më nji mënyrë të shtërnguet masurin dhe për te lidhin fijen që del nga qerthulli.

Tue sjellë monovelen, sillet rrota e madhe, e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D Ë R

cila e transmeton lëvizjen e rrotës së vogël që sillet tue vu në sjellje edhe boshtin që përshkon masurin. Tue u-sjellë masuri, tërheq fijen dhe vehet në sjellje edhe qerthulli.




Fig. 27

Kështu fija kalon prej shkulit që ndahet në qerthull, në një mbështjellje të re, në masur.

Si në çikrik, ashtu edhe në rodhan, shifen dy tipa rrotash: dy rrafhë të përshkuem me rreze drrasash dhe të kapun me njani tjatrin gjithnji me copa drasash, dhe herë herë me një lëkurë qingji, si çikriku i kucovllehve ose me litar zhuge si në Myzeqe dhe me një rrotë të madhe drrasë me një vijë në periferi. Tipi me rrotë dyfishe përdoret me tepër në viset e Jugut, ndërsa tipi me rrotë njifish asht i zakonshëm në Veri. Rrota dyfishe paraqitet ma e vjetër.

Zakonisht mëndafshi, dhe shpesh edhe pambuku, kanë nevojë edhe për një shërbim tjetër: me e dredhë fijen ose me e dyfishue e me e trefishue.

Dredoja bahet me një çekerk ose çikrik të madh, të cilin në Shkodër e thrrasin çekerk magjyp, pse punohej ndër kovaçë. Ky çekerk i gjan rodhanit të madh, që pamë sipër për tjerrjen e këmenës, por çfaq këto ndryshime.

Mbi bishtin e zgjatun në njanën anë janë të vendume një sasi e madhe rrotash të vogla, 10-20 copë. Për telat e rrotave të vogla lidhen fijet në njanën anë dhe në tjetrën anë lidhen për një dru të bashkuem me një tjetër, në formë «T». Grueja me një shkop të shkurtë që mban në dorë siell rrotën e madhe dhe kjo ja transmeton të sjellmen të gjitha rrotave të vogla që siellen automatikisht. Tue u-sjellë rrotat fieja merr dredhë Fig.29




Fig. 28

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR




Fig. 29

Me këtë punim mbaroa pregatitja e fijes dhe kjo asht gati me kalue në përdorim të ndryshëm, të vegës ose të punës së dorës.

RÉSUMÉ

Dans une série d'articles, qui paraîtront au Bulletin consécutivement, l'auteur presentera une étude sur la façon dont le peuple albanais est habillé et chaussé. Cette étude est divisée en trois parties principales: I. Matériel employé pour l'habillement et la chaussure; II. Coupe et façonnage; III. Parures externes.

Dans le présent numéro il a été procédé à une analyse du matériel employé pour l'habillement du peuple et à celle de sa production; puis du premier traitement du dit matériel; et enfin de la teinture et du filement. C'est ainsi que dans ces chapitres on fait une analyse minutieuse de la technique et des instruments de travail, dont une partie sont encore de nos jours en usage chez le peuple, depuis les procédés les plus arriérés jusqu'à leurs formes les plus perfectionnées, puis on suit la marche du travail jusqu'au complet achèvement du fil.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

MBI POZITËN E QYTETIT OLYMPE T' ILIRISË

nga

HASAN CEKA

Nuk asht gjithnji një punë e lehtë, përkundrazi shpesh herë tepër e vështirë për mos me thanë e pamundëshme, me caktue pozitën e nji qyteti antik ose me identifikue gërmadha antike te soçme me një qytet të moçëm të kumtuem nga shkrimtarët e atëhershëm. Arsyeja e kësaj vështirësije, përsa i përket vëndit t'onë, duhet kërkue në faktin se pothuajse gjithë gjeografët, historianët e shkrimtarët e tjerë antikë nuk kanë qënë vetë në vëndin t'onë dhe gjithë përshkrimi ose edhe vetëm të zanët me gojë e nji qyteti, fisi, lumi, mali, krahine etj. asht ba prej tyne në bazë t'asaj që kanë ndëgjue ose kopjue nga shkrimtarë ma të vjetër. Për këtë arsye kuptohet vetiu se përshkrimi i pozitës që epet shpesh herë prej tyne nuk mund të jetë gjithnji fort i besueshëm; me gjithë këtë, në mungesë të burimeve të tjera, jemi të shternguem të bazohemi, në lokalizimin e këtyne qyteteve, në radhë të parë n'ato që kanë thanë ata. Ndodh pastaj që shpesh herë këta emra të mos jenë shkrue të sakta, sikurse bije fjala në librin e Prokopit, *de aedificiis*, ku na epet një listë e gjatë që ka mbrenda me dhjetra emna kalanash të ndërtueme ose të rindërtueme prej Justinianit në vëndin t'onë, por që nuk jemi në gjëndje t'identifikojmë me emnat që gjejmë në këtë listë, as edhe nji të vetme nga gërmadhat e shumta që kemi nga kohna e vonë antike.

Një pjesë të madhe të qyteteve t'ona antike e kemi identifikue tue u mbështetë, veç përshkrimit të pozitës të dhanun nga literatura antike, edhe në tingëllimin që i përngjan ase që asht identik emni i vjetër me të soçmin si Scodra (Shkodra), Lissus (Lesh), Dyrrhachium (Durrës), Phoenice (Finiq), Buthrotum (Butrint) ose pse na kanë ndihmue mbishkrimet e gjetuna në vënd që kishin emnin antik, si në Byllis (Hekali i

BIBLIOTEKA PUBLIKE „MARIN BARLETI" S H K O D Ë R


Mallakastrës) dhe Scampis (Elbasani); për disa qendra të tjera përshkrimi i dhanun prej shkrimtarëve të vjetër asht aq i kjartë, sa që jemi shumë të sigurtë identifiktmeve t'ona, si Amantia (Pilloça e Vlorës), Oricus (Pashaliman në gjinin e Vlonës), Antipatria (Berat), Antigonia (Tepelenë) etj. Por me gjithë atë, këto identifikime nuk mund të mirren veçse si të përkohëshme dhe presin vërtetimin nga ana e një mbishkrimi. Një grup tjetër të madh e kemi nga ana tjetër, ose në gërmadha që nuk jemi në gjëndje t'i dijmë emnin antik (Zgërdheshi afër Krujës, Petlë afër Tiranës, Margëlliçi afër Patosit, Matohasanaj e Tepelenës) ose na asht kumtue vetëm emni ose përshkrimi i pozitës që e shoqënon nuk asht aq' i qartë sa që të mundemi ta identifikojmë me ndonji nga ndonji nga vendbanimet ose gërmadhat ekzistuese.

Pikërisht në këtë kategoi hyn edhe qyteti Olympe, i cili përmëndet vetëm prej Stephan Byzantit n' Ethnika si OLYMPI POLIS ILIRIAS. Stephan Bizanti e ka nxjerrë këtë qytet, që nuk përmëndet prej kurkujt tjetër, prej historianit të qytetit Herakleia të Bithynisë, Domitius Kallistratus, i cili ka shkrue në kohë romane. Tue qenë se libri i tij nuk ka mërrijtë në ditët tona, nuk dijmë se me ç'farë rase e përmënd qytetin t'onë në përshkrimin e historisë tij, kështu që saktësia e ekzistencës së këtij qyteti ka pasë qenë vue në dyshim prej dijetarëve. 1)

Sigurisht që kjo përmëndje e thatë nuk do t'ishte e mjaftueshme dhe as që mund të na nxiste për të kërkue pozitën e këtij qyteti, mbasi nji ndërmarrje e tillë nuk kishte si t'eptë nji rezultat pozitiv, për arsye se Iliria n'atë kohë nuk përfshinte vetëm Shqipninë Vjosë e përpjetë, por edhe Malin e Zi, Dalmacinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Istrinë dhe pjesë të Kroacisë. Problemi u-shtrue si i tillë, ose të thomi ma mirë, u-ba aktual qysh prej ditës, kur në koleksionin numismatik të Muzeut Arkeologjik-Etnografik u-zbuluen tri moneta bronxi me legjendën: OLYMPASTAN. Më kot kërkojmë në mes të qindra e qindra qyteteve antike që kanë pre pare më vehte ndonji qytet që mund të kishte pre këtë monetë. Më kot edhe pse sikur t'ekzistonte me të vërtetë gjetiu nji qytet me këtë emën. ftgurat e simbolet e përdoruna mbi paret t'ona të shpien pa tjetër n'Iliri të Jugut dhe n'Epir të Veriut, dhe për këtë arsye edhe paret duhet të jenë pre vetëm në këto krahina. Madje kujtoj, tue u-mbështetë mbi sa do të parashtroj ma poshtë, se neve mund të shkojmë edhe ma tej dhe t'a kufizojmë vëndin se ku duhet të ndodhet qyteti Olympe në nji terren fqinj me juridiksionet e qyteteve Apollonia, Oricus, Amantia e Bylis. Arsyet për një lokalizim të tillë jemë në radhë të parë, pse mbi paret me legjendën OLYMPASTAN gjejmë të njëjtat simbole e fytyra si ato të përdoruna në qytetet e sipërpërmëndura si dhe në krahinat e përfshime nga Lidhja Epirotike.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

1) Shif: Pauly — Wissowa, Realenzyklopadie, nën Olympe.



Tip Nr. 1 Faqe: Kryet e Zeusit të Dodonës me kunorë dushku, djathtas.

Shpinë: OLYMPASTAN ndërmjet dy rrjeshtave të mbishkrimit: rrufe. Të gjitha mbrenda kunore dushku.

diam: 18 m.m. Pesha: 5,350 gr.

Tip Nr. 2 Faqe: Kryet e Apollonit me kunorë dafine, djathtas:

Shpinë: OLYMPASTAN Ndërmjet rrjeshtave të mbishkrimit: Obelisk të vendosun mbi bazament. Të gjitha rrethue me kunorë dafine.

diam.: 17 mm. Pesha; 2,630 gr.

Moneta e tretë asht krejt si tipi Nr. 2 vetëm se në vënd t'Apollonit duket që mban kryet e Artemis me stefane. 1)

Sikurse shifet pra që të dy tipet e përshkrueme kanë të njëjtat simbole që hasim n'Ilirinë e jugut dhe Epirin e veriut: tipi i parë s'ka asnjë ndryshim nga ato t'Amantia-s dhe të Lidhjes Epirote, ndërsa tipi i dytë ngjan sikur me qënë kopjue nga paret brouxt t'Apollonisë. Edhe përsa i përket stilit si edhe dialektit dorik të përdorun në to dei i njëjti konkluzion, d.m.th. se Olympe-n duhet ta kërkojmë në nji regjion që gjindej

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MIRIU BARLETI"
SHKODËR

1) Moneta asht shumë e prishun dhe nuk asht e pamundëshme që të kemi edhe këtu po kryet e Apollonit, mbasi obelishu asht nji simbol i këtij Perëndije.

afër influencave t'Apollonisë me nj'anë dhe krahinave të Lidhjes Epirote nga ana tjetër Simbas stilit edhe këto i përkasin të të njëjtës kohë, si ato t'Epirit, Amantia-s, Oricus dhe Apollonisë me të njëjtat simbole e figura d.m.th. III-II shek, para Ep. Re.

Nji vështirësi e vetme që na pengon besoj se mund t'i mvishet Kallistratit ose edhe Steph Byzantit, të cilët nuk e kanë dijtë me siguri si quheshin vëndasit. Asht fjala tek Ethnikon që na ep ky i fundit: OLYMPAIOS ose OLYMPOUS ndërsa nga legjenda e pareve del se vëndasit duhet të quheshin OLYMPASTIS simbas shëmbëllës APOLLONIATIS APCIROTIS etj.

Nga sa u-tha më sipër del më duket e qartë se të tri paret e zbulueme në koleksionin numismatik të Muzeut Arksologjik-Ethonografik të Tiranës, që përmbajnë legjenden OLYMPASTAN nuk ka dyshim që janë pre në vendin tonë dhe pikërisht prej qytetit të panjoftun Olympe, që e gjejmë n' Ethnika të Steph. Byzantit. Tashti na mbetet ta identifikojmë mbrenda mundësive që na epen, me ndonjë nga gërmadhat antike t'epokës helene, nga të cilat nuk jemi kurrsesi të vorfën. Gërmadhat e Zgërdheshit dhe të Petrelës, që të dyja t' epokës helene, nuk vijnë në konsideracion për arsye që këto janë shumë afër Durrësit dhe prandaj nuk mund të mendohet, edhe sikur të kishin pre pare më vetëhe, që në vend të simboleve të Durrësit, influenca ekonomike e së cilës ishte zgjanue gjer në fellësitë e Ungarisë dhe Rumanisë së soçme, të kishin përdorue të tilla t'Apollonisë e t' Epirit. Kjo nuk asht e mundshme edhe për arsye se vetë Apollonija, për një kohë të gjatë ngjanë të ketë qenë, të paktën përsa i përket drahmeve të premë në shek. e III të para Ep.Re, nën mvartësinë e Durrësit. 1) të vetmet gërmadha që mund t'i përgjigjeshin kërkesave tona do t' ishin qytetet antike të Margëlliçit dhe të Matohasanjt. Gërmadhat e Margëlliçit, nja 20 km. në jug lindje të Pojanit (Apollonisë), me një murë rrethimi të nji teknike krejt helene, kanë të njejtat kondita për t' u identifikue me Olympen si dhe ato të Matohasanajt; të cilat përsa i përket hapësinës së qytetit, të rrethueme me mure të te njëjtës teknikë, janë edhe më madhështore se të parat.

Me gjithë këte ka disa shkaqe të randa, të cilat sipas mendimit tem nuk lejojnë identifikimin e Matohasanjt me qytetin Olympe. Pikë së pari Matohasanj ndodhet në bregun e majtë të Vjosës, në nji terren përtej grykës s' Ulunecit e në lindje të malit të Kudhësit, të cilët, së ba-

---

1) Munsterberg, Dr.R.- Zur Silberpraegung von Dyrrhachion und Apollonia në: Monatsbl, der numismatischen Gesellschaft in Wien. Vol. X (1915-1917). fq. 261.

1) Ky kufi sigurisht nuk mund të ketë qenë i qëndrueshëm dhe i vlefshëm për të gjithë kohën antike. Amatia, b.f. tradhëton në paret e saja se ka qenë e lidhun ma tepër me Epirin se sa me Iliriné.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S K O D R

shku me Vjosën e mesme, Malet e Çikës dhe të Liograsë, duhet t'i konsiderojmë si kufinjt e natyrshëm ndërmjet Ilirisë dhe t'Epirit. 2) Matohasanaj duhet të përjashtohet pastaj edhe pse si në monetat e Amantia-s, që e kufizon nga perëndimi ashtu edhe n'ato të Bylis, territori i të cilit shtrihet nga veriu i saj, në bregun e djathtë të Vjosës — që te dyja, simbas shkrimtarëve të vjetër qytete ilirë — gjejmë vetëm simbole e fytyra tipike të Lidhjes Epirote si rrufenë e shqiponjën edhe Zeusin dhe mungojnë fytyrat e simbolet karakteristike Apolloniste si Apolloni dhe Obelisku, që i pamë në njanën nga dy tipet e pareve me legjenden: OLYMPASTAN. Nga kjo del se Olympen duhet t'a kërkojmë, nëqoftë se nuk gabohem, ma afër Apollonisë, por natyrisht gjithnji në nji krahinë qe ndodhet ndërmjet të dy influenceave të përmenduna. Si të tilla vijnë në konsideracion vetëm gërmadhet e Margëlliçit, që duhen të kenë përfshi në territorin e tyne nji rrypë shumë a pak të gjanë toke, që ndante Apollonin nga Bylis dhe kufizohesh me Amantian nëpërmjet Vjosës. Kjo fqinjësi do të shpjegonte ma së miri influencën e ushtrueme nga Apollonia e Amantia në zgjedhjen e figurave dhe simboleve të njilloja mbi paret e Olympes.

Ndërsa mbi sipërfaqen e qytetit të Matohasanjt 2) nuk shifen mdeturina godinash dhe vetëm tepër rrallë takohen fragmente vazash helene t'importueme, Margëlliçi 3) paraqitet edhe nga kjo pikëpamje, shumë ma i pasun dhe tregon kështu influencën e nji kulture dhe arti helen mjaft të shëndoshtë; edhe kjo më duket mue të jetë nji arsye ma shumë për të përforcue tezën, se Olympe duhet të lokalizohet në Margëlliç dhe jo në Matohasanaj, aq më shumë kur stili i pareve asht në nji shkallë me monetat e preme në qendrat ma të mira t'influencuem nga kultura e arti grek.

---

2) Në një ekspesitë ekreologjike të kryeme nga Muzeu i jonë në lugjinën, e Vjosës në Shtator të v. 1949, u-studjuan edhe gërmadhat Matohasanajt; me këtë rasë u konstatue mungesa e plotë e pjesëve arkeologjike, që nuk shifen të mirosuna as në shtëpijat e fshatit; në fragmente enësh mbulojnë sipërfaqen e qytetit vetëm copë enësh prej balte të pjekun me një karakter lokal, ndërsa vazat e tipit helen duhet sikur mos me qenë përdorue kurrë këtu. Për t'u çudit asht edhe se fshatarët nuk gjejnë pare të vjetra nëpër arat që lërojnë mbrenda mureve të qytetit, ndërsa këto janë të renomëta në qytete si Bylis, Amatia. Apollonia etj. Të gjitha këto sjellin ndërmend gërmadhat e Zgërdhesnit ka ndihen pothue të njëjtat mungesa. Si skulpturë e vetme nga ky qyetet ruhet në muzen e Tiranës një gur vorri në nji stil kreti-barbar, me ornambishkrim grek plot gabime ortografike, që vërtetojnë se arti e kultura helene kishte depërtue në këtë qytet epirot shumë e përciptë.

3) Mbi përfundimet e studimeve arkeologjike të sipërfaqëshme të Margëlliçit shif: Praschniker-Schober, archalog Forschungen in Albanien u Montenegro, f. 76 e vazhdim. Wien 1919.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Fjala e fundit mbetet për të thanë sigurisht nji mbishkrimi që mund të gjejmë rastësisht ose në gërmime; atëhere do të shofim nëse qofte se ato që thamë ma sipër i përgjigjen të vërtetës apo jo.

RÉSUMÉ

Se référant à une monnaie de bronze inédite, à légende OLYMPASTAN de la collection numismatique du Musée Archéologique et Ethnographique de Tirana, l'auteur de l'article s'efforce de prouver non seulement que la dite monnaie doit être attribuée à la cité illyrienne d'Olympe, dont nous parle Etienne de Bysance (Stephanus Byzantinus), mais aussi de fixer, en se basant sur les ruines existantes, la situation géographique de la cité. Les deux types différents de la monnaie en question, Jupiter-Foudre et Apollon-Obélisque, parlent d'eux-mêmes pour la recherche de la cité dans une région limitrophe de l'Epire et de l'Illyrie ou, pour être plus précis, entre les villes d'Amantia et d'Apollonie, dont les monnaies semblent avoir été copiées sur le modèle d'Olympe. Des deux tas de ruines, entourés de murs antiques helléne, qui ont été pris en considération en vue d'une telle identification, du village de Matohasanaj, au sud-est d'Amantia, et du village Margëlliç (Marguellitch) situé au nord de cette dernière et au sud-est d'Apollonie, l'auteur, pour les raisons qu'il expose dans son article, exprime l'opinion que les dites monnaies proviennent de Margëlliç qui est le nom actuel d'Olympe.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

SHËNIME ARKEOLOGJIKE

I.

PAS GJYRMAVE TË UJËSJELLËSIT ANTIK TË DURRËSIT

nga

Ing. JOVAN ADAMI

Sipas shkrimtarit antik Polybios, brënda në Durrës kishte shumë burime me ujë të pijëshëm. Duket, se përveç pozitës topografike edhe ekzistenca e këtyre mburimeve ka qenë një nga shkaqet për themelimin e Durrësit. Mbase një nga ato mburime është kroi i Curileve, i cili gjindet në perëndim të qytetit. Se kishte ujë të mjaftë për të pirë në Durrës që në fillim të historisë së tij, këtë na e tregon prap Polybios kur na tregon një intrigë që lojtnë ilyrët për të zaptuar qytetin. Nënë pretekstin se do të merrnin ujë për të pirë. ilirët zbritnë në tokë me stomna dhe amfora, në të cilat kishin fshehur armët e tyre. Kështu të armatosur, ata sulmuan dhe i vranë rojtarët e portave, po s'ja harinë dot qëllimit, passi u muntnë prej qytetarëve,

Duket se këta mburime mjaftonin gjer sa qyteti ishte i vogël; por ku filloj të smadhohet, edhe populata e tij të shtohet, uji i mburimeve nuk i mjaftonte më për nevojat e qytetarëve. Kështu në sundimin e Romës, Durrësi u pajis me një ujësrellës, të cilin e goditi perandori Hadrian dhe e riparoi perandori Aleksandër Severus. Vibius Sequester shkruan se uji mireshe prej lumit Lineus për të cilin Heuzey thotë se eshtë Erzeni i tanishëm. [1]) Pranë çezmes së katundit Arapja, gjindesh një pllakë mermeri. Kjo pllakë, e cila tani ndodhet në Louvre të Parisit [2]) ka këtë mbishkrim:

BIBLIOTEKA PUBLIKE SHKOLLORE MARIN BARLETI

1) I. Jireçek, III-Alb-Forshungen I — 1916, faqe 157
2) C. I. L. III. 709

imp (erator) Caes (ar)
M (arcus) Aurelius Sever (us)
Alexander, pius.
felix Aug (stus) aquae —
ductum divi
Hadriani parentis
Sui liberalitate Dy-
rachinis factum et
vetustate pluribus
in locis vexatum resti-
tuit, set et viam a co-
lonia pēr mil (l) ia passum
quattuor, voraginibus[1])

(Imperatori Qesar Markus Aurelius Severus Aleksander i pērshpirtēshmi fatbardhi August, e rinovoj ujēsjellsin e stērgjyshit tē tij Hadrianit tē hyjnishmit, e ndērtoi pēr dursakēt me shpenzimet e veta, i cili prej vjetēve ishte i dēmtuar nē shumē vise, ay rindērtoj gjithashtu rrugēn qē vinte prej kollonisē, pēr 4 mila).


Ky mbishkrim i kēsaj pllake vērteton ato qē kanē thēnē shkrimtarēt antikē pēr ujēsjellsin e Durrēsit; dhe na tregon, deri diku, se afēr vēndit ku gjindesh ajo pllaka e mermertē do tē ketē kaluar ay ujēsjellēs duke ardhur qē nga Erzeni. Çēshtja tani ishte se ku do tē ishte vendi nē Erzen, qē ku mireshe uji, dhe si kalonte kanali i ujēsjellēsit, sa i math ishte dhe ç'konstruksion kishte ay.

Shenjat e para tē kētij kanali u zbuluan prej meje nē çezmen qē ka ngrehur nē pērruan e Memajt njē katundar prej Pjeshkēza, Dalip Mema. Kjo çezme gjindet midis dy katundeve Pjeshkēzē dhe Memaj. Nē faqen e prrojt nē fjalē duket profili i kanalit. Dalip Mema e mbylli ate me beton dhe kēshtu pjesa e tjetēr e kanalit, nēnētokē, mbushet me ujē shiu dhe shērben si depo pēr çezmen, Korita. nēnē sylynjarin e çezmes ku pinē ujē kafshēt, ēshtē pjes e poshtēme e kanalit i cili vazhdon edhe nē faqen tjetēr tē pērrojt. Konstruksioni i kanalit ēshtē me mure me llaç, i veshur pērbrenda me tulla trikēndēshe tē rregullta dhe pērjashta me gurē tē thjeshtē. Kanali ēshtē 1,15 m. i naltē dhe 0,57 m. i gjerē me njē kubē nē formē segmenti' mbulesē.

Passi edhe n'anēn tjetēr tē pērrojtē Memaj dukeshin shēnja tē kananalit antik, i ramē prapa atyre shēnjave dhe duke i ndjekur ato, harrimē gjer nē pērruan e Gjonasit; m'at anē tē kētij pērroi, dhe afēr fshatit Romanat, duken brēnda nē shtratin e Erzenit pjesē muresh. Kēta mure kanē konstruksionin me tulla trikēndēshe si tē kanalit dhe me gurē tē

1) Mision archéologique de Macedoine, L. Heuzey dhe H. Daumet, faqe 387.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D R




thjeshtë dhe të lidhur me llaç këlqereje. Përtej këtij gumbullimi muresh nuk duken gjurma të kanalit antik; kështu shtërngohemi të pranojmë se n'atë vend ka qenë depoja ku miresh uji prej Erzenit. Një katundar nga Memaj na tha se para disa vjetëve dukeshe pas ledheve të Erzenit arka e kanalit. Gjyrma të pakëta duken edhe tani pas ledhit të majtë të lumit.

Që nga përroj i Memajt me drejtim për Durrës dhe gjer afër fshatit Arapaj. kanali ka kaluar me doemos pas anës së kodrave, atje ku kalon tani rruga publike Durrës—Ndroq—Tirane dhe nënë kishën e Pjeshkëzës, passi natyra e vendit nuk lejon një rrugë tjetër; po nuk munt të thuhet asgjë me siguri se ç'drejtim do të ketë patur kanali që nga fusha e Arapajt për të kapërxyer kodrat e Rashbullit që të zbriste në Shkozet

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

KANALI I UJËSJELLËSIT TË MOÇËM TË DURRËSIT



PROFILI I KANALIT

për të arritur në Durrës. Nga pikëpamja teknike, nuk do të ishte shumë zor që të fiksoheshe ky drejtim passi me anë gërmimesh, tërthore në disa vënde munt të caktohesh drejtimi.

Në Pllajat veriore të kodrave të fundit, që ulen për Shkozet dhe afër rrugës komunale, kam gjetur dy të çelura në formë si puse, të cilat të dyja janë të kthisura me mur me tulla. Njëri quhet *Pus' i Deriçit* dhe është gati 25 m. i thellë dhe tjatri *Pus' i Valiev* dhe është nja 20 m. i thellë; dukesh se puset kishin nga pak ujë. Sipas të thënave të katundarëve, uji punuaka nëpër ata puse. Që të konstatohet kjo thënje e katundarëve, duhesh që të zbritesh në këta puse, po neve nuk ishim të pregatitur për një vepërim të tillë.

Nga konstruksioni i veshjes në mur të katyre puseve dhe nga forma e tyre, ata duken si antike; mbase kanë qënë vrima sipër kanalit ujësjellës që shërbenin për të kontrolluar dhe vëzhguar rrjedhjen e ujit nëpër atë. Po të jetë se vërtetohet kjo, ahere lehtësohet shumë cakëtimi i trasesë së ujësjellësit antik të Durrësit d.m.th. në se ay ka kaluar që

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SH. K. O. D. E. R.

nga Arapaj drejt për Shkozet ose, ka vazhduar rrëzën e kodrave gjer në Qafa e Rashbullit dhe që këtu ka zbritur për në kënetë, për të harrirë në qytet. Nga pikëpamja teknike, supozimi i fundit është m'i natyrtë, passi këtu kapërcimi i kodrave me anë të një tuneli është m'i lehtë dhe me më pak shpenzime, se kodrat janë më të ngushta se sa ato pranë Arapajt. Si e thamë edhe më nalt, për fiksimin e trasesë së vërtetë të ujësjellësit antik të Durrësit duhen të bëhen gërmime në vend duke marrë drejtim që nga Përroji i Memajt.


II

KISHA E MAMËLIT

Në luginën flyshore midis vargut të maleve këlqerorë të Krujës, të Dajtit, të Priskës dhe të Krrabës gjinden një tok katunde, në të cilët duken gërmadha kishësh si: Kisha e Brarit, e Shërminës, e Priskës, e Pëllumbasit, e Skëterës dhe, në anën jugore, ajo e Mamëlit. Për kishën e Brarit ka shënime prej shkencëtarësh të huaj, ajo e Shërminës u vizitua dhe u studjua vjet prej një ekipi të Institutit të Shkencave. Gërmadhat e kishave të Skëterës dhe të Mamëlit janë vizituar prej meje. Kurse prej kishës së Skëterës duken vetëm themelet dhe varret afër saj, dhe nuk shënohet asnjë karakteristikë për studim, ajo e Mamëlit, është më interesante, prandaj kësaj i kushtohen këto radhë.

Katundi Mamël gjindet në pllajat jugore të Qafës së Krrabës dhe ndahet në Mamël i sipërm dhe në Mamël i poshtëm; banorët janë sot të gjithë myslimanë dhe ndahen në vllazni si vijon: Lekaj, Mollas, Skoraj, Bashaj, Gogaj dhe Taçaj. Në jugë të katundit dhe në lagjen Lekaj, duken gërmadhat e një kishe. Vëndi mbi të cilën ngrihen këto gërmadha është një kurriz kodre e cila vetëm nga ana perëndimore lidhet me malin më të naltë, kurse nga të tri anët e tjera bie gati thikë për në përrua; mbi këtë kurris-sheshtirë çquhen shënja muresh të dy ose tri godinave të ndryshme dhe në lindje të këtyre janë gërmadhat e kishës, murret e së cilës janë krejt të rrëxuar dhe të mbuluara me driza dhe ferra dhe vetëm kambanarja qëndron edhe më këmbë. Sipas shënjave që duken pas buzëve të kurrizit-sheshtirë, si kisha ashtu dhe godinat duhet të kenë qenë të rrethuara me mure në formë kalaje. Kambanorja është ndërtuar me mure me gurë të pa-gdhendur, ku vetëm qoshet janë të latuara; në llaçin e mureve shikon dhe pjesë tjegullash. Kambanorja është gati 9 m. e naltë dhe është një katror me masat 3 me 3 m. Porta e saj dhe penxheret janë me qemer të kthyer me gurë smërshi. Kambanorja është me dy kate: kati i poshtëm duket se është m'i vjetër se ay i sipërmi; ky si materjali ashtu dhe nga puna, duhet të jetë goditur më vonë.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI"



Kampanila e kishës
„Sh. Pjetri"
Mamël-Lekaj.
1:100

Pamja perëndimore



Kati i parë



Kati i dytë

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R

Muret e kishës mezi çquhen prej gurëve dhe prej drizave që janë sipër; sipas një matje aproksimative, gjatësia e kishës ishte 14 m. dhe gjërësia e saj 4,50 m.; edhe muret e kësaj, janë prej guri me llaç këlqereje dhe afër themeleve ata janë 1.20 m. të gjërë. Passi dyshemeja e kishës është shumë m'e thellë se ajo e kambanares, duket se kisha ka qënë për një pjesë e futur në toke. As në kambanoren, as nëpër gërmadhat e kishës nuk u·pa ndonjë mbishkrim ose ndonjë shënjë arhitektonike sipër tokës, po ka mundësi që nëpër muret e rrëxuar të gjënden pjesë arhitektonike. Po të marim parasysh konstruksionin dhe formën e kambonares munt të themi se ajo falëtore është e ngrehur sipas stilit romanik.

Prej banorëve të Mamëlit kjo kishë thirret «Kisha e Lekajt» dhe nuk mbahet mënt emëri i shënjtit, të cilit i ishte kushtuar; po prej shënimeve të dy udhëtarëve, Franco Bianshi më 1635 dhe D. Shtjefen Gaspari më 1671, mësojmë se ajo thirrej «Kisha e Sh. Pjetrit». Prej këtyre shënimeve, ne mësojmë se ajo kishë eksistonte që në shekullin e XVII-të. Bianchi na tregon dhe emrin e priftit të atëherëshëm, e një Fra Nicolo Mecani, dhe se ahere në Mamël ka patur vetëm 94 të krishtere. D. Shtjefen Gaspari thotë se kur e vizitoj ay, në Mamël ishte prift D. Pal Broska dhe se nga të krishterët kishin mbetur vetëm 30 vetë, po, vazhdon D. Gaspari, «*gjindej edhe më këmbë dhe e fortë kisha e Sh, Pjetrit dikur katehrale e ipeshkvit Alban*» 1). Nuk dimë se ç'Alban ka patur ndërmënd D. Gaspari, mbase ka dashur të thotë për Elbasanin, i cili në disa shënime historike hishëtare të asaj kohe quheshe «*La cita di Albano sita preso il fiume di Scumbino*». (F. Cordignano, «Geografia Ecclesiastica dell' Albania, Rome, faqe 35.) Munt të jetë diçka e vërtetë në shënimet e D. Gasparit, passi konstrukcioni ashtu dhe forma e kishës dhe e kambanares tregojnë se ajo nuk duhet të ketë qënë e destinuar vetëm për një kishë fshati, dhe se në atë kohë vëndi ka pasë njohur një kulturë ma të ngritur.

RÉSUMÉ

Dans les temps antiques, Durazzo possédait un aqueduc qui avait été construit pa l'Empereur Adrien. L'eau provenait de la rivière Ulucus (l'Erzen actuel). L'auteur a découvert dans la plaine de Shijak, près du village Pjeshkëzë, une partie du canal de l'aqueduc et, près du village Romanat, le lieu où l'aqueduc puisait l'eau de la rivière.

Au sud du village Mamël, dans le col de Kiraba, on a découvert les restes d'une église qui a été indentifiés dès le XVIIe siècle. Le style et la construction de cette église prouvent cependant qu'elle est plus ancienne encore et qu'elle a été quelque chose de plus qu'une simple chapelle de village.

1) H. Dritës vjeti VIII, Nr. 10, faqe 532.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

MBLEDHJA E SESIONIT TË III-të TE ASAMBLESË SE INSTITUTIT TE SHKENCAVET

Më 17 e 18 Mars 1950 u-mbajt në Sallën e madhe të Bibliotekës Kombëtare në Tiranë Sesioni i III-të i Asamblesë së Përgjithëshme të Institutit të Shkencave.

Salla qe zbukuruar me flamuret e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të Bashkimit Sovjetik, me portretet e Komandantit Gjeneral Armate Enver Hoxha, të Gjeneralisimit Stalin, të Marksit, Engelsit, Leninit si dhe të lëvronjësve të gjuhës dhe literaturës shqipe Kostandin Kristoforidhit, Naim Frashërit, etj.

Në sallë zunë vënd Presidiumi i Asamblesë i përbërë nga zz. Kol Paparisto, sekretar, Aleksandër Xhuvani, Sotir Angjeli dhe Aleks Buda, anëtarë. Gjithashtu zunë vend dhe anëtarët e rregullt të Institutit të Shkencave, si dhe bashkëpunëtorët. (1)

Në këtë mbledhje asistonin: shoku Tuk Jakova, N-Kryeministër i R.P.SH., shoqja Nexhmije Hoxha, anëtare e Komitetit Qëndror të Partisë së Punës së Shqipërisë, dhe të ftuar të tjerë.

Pikërisht në orën 9,15', z. Kol Paparisto, Sekretar i Presidiumit të Institutit, në emër të Presidiumit deklaron të hapur Sesionin e III-të të Asamblesë së Institutit të Shkencave, duke njoftuar rendin e ditës si vijon:

1) Referat mbi aktivitetin e Institutit të Shkencave.
2) Diskutime.
3) Rezolucjoni dhe vendimet.

Presidiumi caktoi për drejtimin e Seancës së I-rë të këtij Sesioni z. Aleksandër Xhuvani, Shef i Seksionit të Gjuhësisë dhe Letërsisë.

Në emër të Komitetit Qëndror të P.P.SH. dhe të Qeverisë, shoku Tuk Jakova përshëndet Asamblenë me këto fjalë:

SHOKË,

Në emër të Komitetit Central të P.P.SH. dhe të Qeverisë sonë Demokratike përshëndes përzëmërsisht anëtarët dhe bashkëpunëtorët që marrin pjesë në këtë Asamble dhe i uroj asaj punë të frutëshme për organizimin më të mirë të punës shkencore në vendin tonë dhe për mobilizimin sa më të gjërë të forcave tona në fushën e aktivitetit shkencor.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
SHKODER
MARIN BARLETI

1) Në këtë Sesion mungon Presidenti i Institutit, Dr. Manol Konomi, i cili ndodhet në mbledhjen e Komitetit të Përhershëm të Kongresit Botror të Paqës në Stokholm.

Përpara çlirimit të Shqipërisë dhe ngritjes së Pushtetit tonë Popullor puna shkencore në vëndin tonë bëhesh po thuaj ekskluzivisht nga njerëz të huaj, të cilët dërgoheshin me qëllime të caktuara, nga imperialistat grabitqarë dhe kolonizator. Asnjë herë përpara çlirimit nuk ka ekzistuar në vëndin tonë një qëndër studimi serioze që të merrte përsipër studimin e pasurive tona materiale e spirituale, për t'i ardhur kështu në ndihmë ngritjes së nivelit ekonomik e kultural të popullit tonë. Asnjë konditë nuk u krijua në të kaluarën për kuadrot tona shkencore që bënin studime jasht Shtetit, për të zhvilluar talentet e tyre, për t'u dhënë mundësinë të vënë zotësitë e tyre në shërbim të popullit tonë të shum-vuajtur. Populli i jonë nuk i njohu kurrë pasuritë e vendit të tijë. Çdo zbulim mbetej sekret në dorën e imperialistave. Zbulimet e pasurive të nëntokës tonë nga shkencëtarë të huaj shtonin lakmitë e imperializmit për zaptimin e vendit tonë. Prapa shpinës së popullit Shqipëtarë imperialistët bënin pazarllëqe me pasuritë e Shqipërisë, për të cilat populli i jonë nuk njoftohej kurrë. Kështu ndodhi me bitumin, me naftën, me zbulimet arkeologjike etj.

U desh lufta heroike N.Çl. e popullit tonë, i grumbulluar në frontin N. Çlirimtar nën drejtimin e Partisë Komuniste dhe të shokut Enver, që t'i jepej fund okupasionit të imperialistëve dhe klikave reaksionare, dhe populli të bahet zot i fateve të veta.

Lufta N.Çlirimtare e popullit tonë, si në të gjitha fushat e aktivitetit të jetës tonë si popull e si shtet i hapi perspektiva të shkëlqyeshme dhe shkencës sonë të re. Duke përjashtuar disa përpjekje individuale, që tregojnë gjallërinë dhe patriotizmin e popullit tonë, përpjekje që ka bërë ay për të shkuar përpara, me gjithë pengesat e pa numurta që ka hasur, munt të themi se në lëmin e shkencavet Pushteti i ynë Popullor gjeti një teren virgjer. Prandaj që mbas çlirimit të Shqipërisë Partija i vuri vehtes si detyrë të krijojë sa më parë kondita të nevojëshme për të filluar në vëndin tonë një punë sistematike për të vënë baza të një punë shkencore të domosdoshme, e cila t'i shërbejë popullit si një armë e shëndoshë në përpjekjet që bën ay për ngritjen e tij shoqërore, ekonomike e kulturale. Kështu u krijua Instituti i Shkencavet, i cili me organizimin e tij në Janar të vitit 1947, hyri në udhën e realizimeve me rëndësi në lëmin e gjuhësisë historisë dhe shkencave të natyrës, duke marrë parasysh gjëndjen e këtyre shkencave në vendin tonë.

Eshtë e vërtetë, si kudo gjetkë, puna trockiste e organizuar në vëndin tonë nga vegla më e ndyrë e imperializmit amerikan, banda e Titos me anën e agjentëve të tyre të brendëshëm Koçi Xoxe etj., filloi të penetrojë edhe n'aktivitetin tonë shkencor të porsa lindur, për ta goditur dhe shtrëmbëruar atë. Por kjo nuk zgjati shumë kohë, se me demaskimin e bandës së Titos dhe agjentëve të tij, Partija e jonë e Punës u vu prap në kondita të vazhdojë udhën e saj Marksiste-Leniniste në

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

shkenca, të cilën u munduan ta shtrembërojnë shërbëtorët e imperializmit.

Në Kongresin e saj të Parë Partija e jonë e Punës dhe Udhëheqësi i saj i çquar shoku Enver Hoxha dhanë vijën e drejtë marksiste në të cilën duhesh të ecte dhe të zhvillohesh shkenca e jonë. Më von Komiteti Central i P.P.SH. dhe Qeverija e jonë Demokratike muarën një seri vendimesh që çmojnë punën shkencore të bërë në vëndin tonë, si dhe përpjekjet që bëjnë njerëzit tonë të shkencës, me gjithë konditat e vështira në të cilat janë shumë herë të detyruar të punojnë. Këto vendime urdhërojnë organet Shtetnore të marrrin masa për të ndihmuar sa më shumë punën shkencore dhe për të trajtuar më mirë nga ana ekonomike njerëzit që punojnë në këtë teren. Me gjithë këtë mund të themi se nuk ka pasur gjithmonë një mirëkuptim nga ana e organeve Shtetrore për të vënë në zbatim si duhet këto vendime. Instituti i Shkencave ka gjetur shpesh herë rezistencë të pa-justifikuarshme në çështje konkrete përsa i përket pajisjes me materialet e nevojshme për ekspeditat shkencore, me laboratorët dhe aparatet për të vënë në praktikë rezultatet e punës së tij teorike, ay ka hasur në vështirësi për gjendjen e kuadrove të kualifikuara, për aktivizimin e kuadrove që punojnë në komisionet e tij të ndryshme, për përfitimin sa më shumë nga eksperienca e shkencës Sovjetike, për pregatitjen e kuadrove të rij shkencore etj. Instituti nuk ka mundur të vejë në jetë si duhet vendimin e Partisë dhe të Qeverisë mbi trajtimin më të mirë material t'antarëve dhe bashkëpunëtorëve të tij që punojnë dhe prodhojnë në lëmin e shkencës. Prandaj duke marrë në shqyrtim punën e Institutit të Shkencave, Sekretariati i K.C. të P.P.SH. konstatoi punën pozitive të institutit, rezultatet e harritura në fushën e shkencës si dhe të metat e pengesat në punën e tij dhe me qëllim që Instituti i Shkencave të bëhet një faktor me rëndësi në udhën e ndërtimit të Socializmit në vëndin tonë, me qëllim që puna shkencore të forcohet sa më mirë për t'i shërbyer sa më mirë popullit tonë, mori një seri vendimesh mbi organizimin më të mirë të punës në Institut mbi orientimin sa më shumë të aktivitetit të tij shkencor drejt problemeve të mëdha të vëndit tonë, mbi zgjerimin e fushës së studimeve të tij dhe mbi krijimin e mundësive për një punë eksperimentale sa më të gjerë. Për këtë të krijohet pranë Institutit Seksioni i Bujqësisë me organ mbarës për punën eksperimentale, Stacionin eksperimental të Ministrisë së Bujqësisë. Të krijohet Laboratori i Shtetit që do të plotësojë nevojat e Shtetit në punën e aktivitetit të tijë, dhe do të fillojë një punë të frutëshme kërkimesh shkencore. Sekretariati i K.C. të P.P.SH. mori vendim mbi masat që duhet të merren për plotësimin e nevojave materiale të Institutit, për plotësimin me kuadro shkencore, për mundësinë e përfitimit nga eksperienca e shkencës Sovjetike dhe Demokracive popullore me anë shkëmbimi kuadrosh etj., për t'u krijuar kondita të favorëshme pune në lëmin

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

e shkencave anëtarëve e bashkëpunëtorëve të Institutit që zhvillojnë aktivitetin e tyre kryesor në dikastere e ndërmarrje të ndryshme. Sekretariati e pa të domosdoshme të krijohen kondita për edukimin ideologjik marksist-leninist të anëtarëve dhe bashkëpunëtorëve të Institutit si dhe të njerëzve të tjerë të shkencës në vendin t'onë duke bërë njëkohësisht një luftë të ashpër kundër pikëpamjeve idealiste borgjeze dhe reaksionare në fushën e shkencave që kanë për qëllim ta bëjnë shkencën një instrument shfrytëzimi të njerëzve dhe popujve dhe një mjet lufte e shkatërrimi. Shkenca e jonë duhet të orientohet këtu nga shkenca e madhe Sovietike e cila është vënë në shërbim të masave punonjëse, për lumturinë dhe prosperitetin e tyre, në shërbim të paqës dhe kundër nxitësave të luftës.

Shkenca e jonë i shërben zhvillimit paqësor të të gjithë aktivitetit të ekonomisë dhe kulturës së vëndit dhe popullit tonë, prandaj ajo duhet të gjejë përkrahjen e merituar e të gjitha organeve Shtetrore, pa të cilën ajo nuk munt të shkojë përpara, nuk munt të përmbushë misionin e saj të math që i ngarkon Partija në Pushtetin tonë Popullor, pa të cilën ajo nuk mund të bëhet motori i fuqishëm i përparimit të kulturës dhe ekonomisë së vëndit tonë.

Le të bëhet sesioni i kësaj Asambleje një faktor me rëndësi për ta vënë Institutin e Shkencave në udhën e zhvillimit të tij, me një hov më të shpejtë dhe më të drejtë.

Të rrojë dhe të forcohet shkenca në vendin tonë, në shëmbullin e shkencës së madhe Sovjetike, pararojë e shkencës përparimtare botërore.

Të rrojë P.P.SH. dhe udhëheqësi i saj shoku Enver Hoxha inisjatori dhe drejtonjësi i të gjitha fitoreve të popullit tonë.

Të rrojë Pushteti i jonë demokratik popullor.

Pastaj bëhet apeli i anëtarëve të rregullt të Institutit të Shkencave që përbëhet nga:

1. Ing. Spiro Koleka
2. Ing. Gaqo Tashko
3. Kostaq Çipo
4. Petraq Fundo
5. Sotir Kuneshka
6. Gjergj Canco
7. Petraq Peppo
8. Ing. Shinasi Dragoti
9. Dr. Medar Shtylla
10. Dr. Eqrem Çabej
11. Andrea Nathanaili
12. Shefqet Musaraj
13. Dhimitër Shuteriqi

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

14. Zini Sako
15. Mark Ndoja
16. Sefulla Malëshova
17. Hasan Ceka
18. Ingj. Gjovalin Gjadri
19. Dr. Frederik Shiroka
20. Dr. Fejzi Hoxha
21. Ing. Koço Theodhosi
22. Naum Stralla

Mungonin Zz. Ingj. Gjovalin Gjadri, Dr. Frederik Shiroka. Dr. Fejzi Hoxha, Naum Stralla e Ing. Koço Theodhosi.

Në emër të Presidiumit të Institutit të Shkencave, shoku Kol Paparisto raporton mbi aktivitetin e Institutit të Shkencave gjatë vitit 1949 dhe shtron vijat e përgjithëshme të planit për vitin 1950

Shokë,

Rregullisht, në fillim të çdo viti, Presidiumi i Institutit të Shkencave i raporton Asamblesë rezultatet e aktivitetit të vitit të kaluar, bën kritikën e punës dhe shtron për diskutim e aprovim planin e vitit në vazhdim. Siç dihet gjatë vitit 1949 Asambleja e Institutit nuk u thirr në mbledhje plenare dhe si konsekuencë nuk u vu në dijeni dhe nuk diskutoi punën e vitit të kaluar, prandaj po shtrojmë këtu në vija të përgjithëshme, se çfarë problemesh i paraqiteshin Institutit të Shkencave për vitin 1949 dhe ç'bëri Presidiumi për t'i shtruar këto në planin e Institutit.

Shkenca në vëndin tonë është akoma në hapat e saj të para. Vetëm prej pakë kohësh ka tek ne një aktivitet shkencor t'organizuar dhe sistematik. Studimet shkencore të bëra mbi vëndin tonë, përgjithërisht nga të huajt, nuk kanë qenë të drejtuara dhe nuk u përgjigjen as qëllimeve dhe as nevojave për të njohur sistematikisht vëndin tonë nga ana e mundësive dhe e zhvillimit ekonomik e kulturál të tij. Ato mund të vlejnë vetëm si një ndihmë për të lehtësuar studimet tona që kanë qëllime të caktuara mirë. Parimi që ndjek sot Instituti i Shkencave në udhën e tij është të vejë rezultatet e aktivitetit të tij shkencor në shërbim të popullit, për të ngritur sa më parë nivelin e mirëqënies së tij materiale dhe të zhvillimit të tij kulturál. Prandaj tek ne për vitin 1949, në lëmën e gjuhësisë natë të historisë dhe të shkencave të natyrës, shtroheshe problemi i vënjes së themeleve të forta, problemi i krijimit të veprave bazë, institucioneve me rëndësi ku të zhvillohet një punë eksperimentale teorike dhe të mblidhen elementet e nevojshme për të ndërmarë me sukses studime në një shkallë më të gjerë dhe

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

me një dobi gjithmonë më të madhe për ekonominë dhe kulturën e masave të popullit tonë.

Mungesa totale e qëndrave të studimit, mungesa e mjeteve të punës: librave, dokumentave, veglave, aparateve dhe laboratorëve ka pasë detyruar të mbeten inaktivë shumë kuadro të vëndit tonë me një kapacitet të mjaftuarshëm shkencor dhe që dëshëronin të punonin në fushën e shkencavet për të dhënë kontributin e tyre në ndërtimin e atdheut. Institutit i paraqitej pra problemi i krijimit në vendin tonë të një ambjenti të përshtatshëm për një punë studimi serjoze, duke bërë përpjekje për të pajisur studjonjësit me mjetet e nevojshme, si dhe problemi i aktivizimit të kuadrove shkencore të vëndit tonë, duke zgjuar tek ata me një punë t'organizuar, interesin për punë shkencore dhe duke shtruar probleme me rëndësi teorike dhe praktike, që mund të zgjidheshin me mundësit tona.

Mungesa e eksperiencës së njerëzve tonë të shkencës në çështjet e organizimit dhe të metodave të punës, mungesa e njohurive të mjafta mbi përparimet e shkencës jashtë vëndit tonë, mungesa e kontaktit me institute të tjerë shkencorë për të mujt me u orientue drejt në zhvillimin e aktivitetit tonë shkencor në dobi të masave të popullit, i shtroi Institutit tonë problemin e përfitimit nga eksperienca e shteteve me një shkencë të përparuar dhe në radhë të parë nga eksperienca e shkencës sovjetike. Të forcohen marëdhënjet me botën e jashtëme, të bëhen shkëmbime me institute të huej, të sillen shkencëtarë të huaj me eksperiencë për të punuar n'Institutin tonë dhe për të ndihmuar njerzit tanë të shkencës, të sillet nga jashtë literaturë shkencore për të bërë të mundëshme studimet tona dhe për të ndihmuar në çështje organizative, këto ishin disa nga mënyrat e përfitimit nga eksperienca e huej.

Që të ishte në dijeni të problemeve që shtron zhvillimi ekonomik e kultural i vëndit tonë dhe për të mujtun të lidhi aktivitetin e tij shkencor me këto probleme, në mënyrë që të jepte një ndihmë konkrete dhe direkte në zgjidhjen e tyre, Institutit të Shkencave i duhej të krijonte kontakte të vazhdueshme me dikasteret dhe entet e tjera me rëndësi për aktivitetin e tyre ekonomik dhe kulturor. Veç kësaj, duke qënë përpara një zhvillimi të vrullshëm të ekonomisë sonë, Institutit i shtrohej problemi i dirigjimit sa më shumë t'aktivitetit të tij drejt studimeve të lidhura me këtë zhvillim ekonomik dhe me çfrytëzimin e pasurive tona të nëntokës.

Përcaktimi i këtyre problemeve dhe detyravet për Institutin e Shkencavet, ishin konsekuenca e politikës së drejtë të Partisë sonë të Punës dhe Pushtetit tonë Popullor, përsa i përket udhës së zhvillimit të shkencës në vëndin tonë.

Vija që dha Kongresi i I-rë i Partisë sonë në lidhje me orientimin e punës shkencore dhe me rëndësinë që duhet t'i jepet asaj në vëndin tonë, e ndihmuan shumë Institutin e Shkencavet për të vënë në një

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
SHKODËR

udhë më të drejtë aktivitetin e tij dhe për të shtruar si duhet problemet e tij shkencore.

Si i konkretizoi Presidiumi i Institutit të Shkencave këto probleme në planin e Institutit për vitin 1949?

Në lëmin e gjuhës dhe të letërsisë, duke parë se si problem kryesor këtu paraqitet puna për vënien e bazave të gjuhës sonë me anë veprash themelore, që nuk kanë qënë punuar ndonjë herë në mënyrë sistematike dhe për të cilat ndihet nevojë e madhe për të dhënë një vijë të saktë dhe per të ndihmuar zhvillimin e gjuhës, u vendos që të vazhdohet punimi i fjalorit shqip, i cili do të përmbajë rreth 22.000 fjalë të shoqëruara me një frazeologji mjaft të pasur dhe do të jetë një vepër themelore për gjuhën tonë. Të punohet, të diskutohet në mbledhje të gjërë personash që merren me studimin e gjuhës dhe pasi të ketë marrë formë definitive, të botohen ortografija e gjuhës shqipe e cila do të japë mendimin e Institutit mbi këtë çështje dhe do të ndihmojë shumë për t'i dhënë orthografisë një formë të prerë në gjuhën tonë. Të hartohet dhe të botohet gramatika e gjuhës shqipe, e cila do të bëjë një studim më të thellë të rregullave gjuhësore se sa veprat e kësaj natyre të botuara gjer më sot, do të zgjerojë njohuritë tona në këtë lëmë dhe do të jetë një mjet i vlefshëm për studimin e gjuhës.

Të punohet për një terminologji t'unifikuar duke filluar nga ajo e disiplinave shkollore, e cila ka një rëndësi të veçantë sot që kuadrot e arësimit tonë të mesëm, të cilët merren me përkëthimin ose hartimin e teksteve për shkolla, kanë kryer studimet e tyre të larta në vënde të ndryshme t'Evropës dhe përdorin terma të ndryshme për kuptime të njëjta.

Paralelisht në këtë aktivitet kryesor u pa e nevojshme të punohet gjithashtu për çështje të tjera që paraqiten urgjentisht nga ana e dobisë që sjellin për masat punonjëse të vëndit tonë. Një nga këto ishte punimi i fjalorit rusisht-shqip, që do të ndihmojë shumë për mësimin e gjuhës rusisht, e cila studjohet sot nga një shumicë e madhe punonjësish e nxënësish të vëndit tonë. Me rëndësi paraqitej gjithashtu për studjonjësit tonë bibliografija shqipe, e cila do të shërbejë si një mjet i domosdoshëm për punime shkencore.

Në lëmin e folklorit u vendos të vihen bazat e mbledhjes sistematike të folklorit tonë. Për këtë, të kryhet një punë paraprake e domosdoshme për të bërë të mundëshme përdorimin e materialit të botuar e të pabotuar që gjëndet n'Institut, duke pregatitur inventare, skedarë etj. Të punohet kryesisht për mbledhjen e folklorit që rrezikohet të humbasë, siç janë: këngët e luftës n. çl., legjenda e Skënderbeut, këngët e kurbetit etj, dhe për këtë të formohen ekipe shetitëse. Të punohet

BIBLIOTEKA PUBLIKE E HKODËS "MARIN BARLETI"

për një antologji të folklorit duke filluar nga Lirika, të bëhen përkëthime veprash të njohura të shkencëtarëve sovietikë për t'u orientuar drejtë në punën e folklorit.

Në lëmin e shkencave të natyrës, me anën e Komisionit të Hidraulikës dhe atij të Mjekësisë Sociale, të përbërë nga anëtarë e bashkëpunëtorë t'Institutit, të bëhen studime të ndryshme në lidhje me problemet aktuale që preokupojnë pushtetin tonë, siç janë: studimi i ujravet, i bonifikimit, i observacionevet meteorologjike, i sëmundjeve sociale etj. Të ngrihet *Shërbimi Hidrometeorologjik* me një rrjetë stacjonesh hidrometrike dhe meteorologjike në gjithë Shqipërinë, simbas planit të hartuar nga Komisioni i Hidraulikës. Të punohet për grumbullimin e materialit që do të shërbejë për hartimin e një atlasi fito-gjeografik të Shqipërisë, i cili do të vlejë shumë për studimin e shpërndarjes gjeografike të florës së Shqipërisë. Të hartohet një atlas forestal, i cili do të ndihmojë për njohjen dhe përhapjen e drurëve dhe shkurreve të vëndit tonë si edhe për dobinë që i sjellin ekonomisë së vëndit. Të punohet për pasurimin e skedarit të bibliografisë shkencore shqiptare me vepra të reja dhe të bëhen përkëthime të rëndësishme për një orientim të drejte ideologjik e shkencor në shkencën biologjike.

Në Muzeumin e Shkencave të Natyrës, përveç punës së koleksionimit e pregatitjes për pasurimin e Muzeut dhe punimeve të brëndëshme për të bërë të përdorshëm materialin shkencor, të bëhet një punë studimi e lidhur me problemet e ekonomisë dhe çfrytëzimit të pasurive tona, siç është studimi i mineraleve e shkëmbijve, studimi i florës medicinale, studimi i insekteve të dëmshëm për bujqësinë dhe i peshqeve. Për këtë, t'organizohen ekspedita shkencore në vënde të ndryshme të Shqipërisë që paraqesin interes nga kjo anë; të porositen jashtë Shtetit laboratore për studimin e shkëmbijve dhe mineraleve, për analizimin e principeve aktive të bimëve medicinale, në mënyrë që të arrihen rezultatet praktike të vlefshme dhe të fillohet sa më parë një punë kërkimesh shkencore, pa të cilën ne nuk mund të shkojmë përpara në studimet tona. Të krijohen lidhje me institute dhe shkencëtarë jashtë vëndit tonë, me qëllim që të ndihmohet puna shkencore dhe të fitohet eksperiencë, të bëhet çkëmbim materiali shkencor dhe të pajisemi me literaturën e nevojshme për punën tonë. Të sillet nga jashtë një paleontolog për vënien e bazave të një pune të tillë tek ne dhe të bëjë studime në vëndet e ndryshme të Shqipërisë që paraqesin një interes nga ana paleontologjike.

Në lëmin e historisë e të sociologjisë të fillojë puna për hartimin e historisë së Shqipërisë 1878-1939. Për këtë, të bëhet mbledhja e materialit, hartimi e diskutimi i tezave dhe një studim mbi reformën agra-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

re në vëndin tonë. Të bëhet përkëthimi dhe botimi i një serije veprash me rëndësi të klasikëve të marksizmit.

Në Muzeumin Arkeologjik-Etnografik të vazhdohet puna e pastërimit dhe të bëhen ekspedita e gërmime në vënde të ndryshme për të mbledhur objekte dhe vizituar krahina interesante me qëllim studimi nga ana arkeologjike dhe etnografike.

Të ngrihet *Arkivi i Shtetit* në drejtori më vehte dhe të punohet për krijimin e skedarëve të nevojshëm për të bërë të mundëshme shfrytëzimin sa më parë të materialit arkival të mbledhur. Të mblidhen dokumenta nga duart private, të bëhen përpjekjet e nevojshme për të krijuar mundësitë e çfrytëzimit të arkivave të huaja më interesante për materialin burimor të historisë sonë dhe të bëhen përkëthime dokumentash nga gjuhët e huaja.

Biblioteka Kombëtare të punojë për pasurimin e saj me libra, revista etj., që t'u përshtaten nevojave të zhvillimit ekonomik e shoqëror të vëndit, të bëjë sa më parë të përdorshëm të gjithë materialin bibliografik me plotsimin e skedarëve dhe të vejë n'indeks të gjitha veprat e dëmshme për publikun e gjërë.

Instituti i Shkencavet shtroi gjithashtu problemin e lidhjeve më të ngushta me institutet shkencore të Bashkimit Sovietik dhe demokracive popullore, duke krijuar pranë Presidiumit një seksion për lidhje me botën e jashtme.

Kjo ishte në vija të përgjithëshme puna që kishte marrë përsipër Instituti i Shkencavet të kryente gjatë vjetit 1949, duke pasur parasysh gjëndjen e shkencës në vëndin tonë, kuadrot shkencore që disponojmë dhe mundësitë tona materiale.

Cilat janë rezultatet e punës s'Institutit për realizimin e planit të vitit 1949?

Në lëmin e gjuhësisë e të letërsisë është vazhduar me sukses puna për hartimin e fjalorit shqip. Janë punuar gjithsejt rreth 22.000 fjalë, definicioni i të cilave është shoqëruar me një frazeologji mjaft të pasur. Këtu është bërë një punë shkencore e kujdesëshme dhe e kualifikuar.

Është kryer gjithashtu një punë e kujdesëshme dhe e përpiktë për hartimin e fjalorit rusisht-shqip, i cili do të përmbajë rreth 25.000 fjalë. Deri në fund të vitit 1949 u krye përkufizimi i 10.000 fjalëve.

Një tjetër punim i kryer në këtë sektor është orthografia e gjuhës shqipe, e cila mbasi u hartue, diskutue dhe ripunue, është gati për t'u botuar. Kjo përpjekje e parë për të hartuar një ortografi të vetme, me

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D R

gjithë të mirat që mund të ketë, është një sukses për ne dhe një mbështetje e mirë për punimet e ardhëshme n'udhën e stabilizimit të gjuhës sonë. Është hartuar gramatika e gjuhës shqipe, e cila është një hap përpara në krahasim me veprat e këtij lloji të botuara deri sot. Këtu është trajtuar në mënyrë speciale pjesa e fonetikës dhe janë bërë zgjerime në morfologjinë, të cilat janë rezultati i një studimi të mirë të gjuhës. Është punuar për caktimin e terminologjisë së disiplinave shkollore dhe është kryer matematika, fizika, kimija dhe një pjesë të shkencave të natyrës.

Mungesa e një kontrolli rigoroz dhe të vazhduarshëm në këtë sektor ka shkaktuar që plani të mos kryhet plotësisht ose në kohën e duhur. Terminologjia shkollore nuk u krye brënda vitit 1949 siç qe caktuar në plan, për arësye se anëtarët dhe bashkëpunëtorët e Institutit që ishin ngarkuar me këtë punë nuk iu përgjigjën si duhet angazhimevet të marruna dhe nuk u vunë me kohë përpara përgjegjësisë. Nga ana tjetër nuk ka qënë ndjekur një metodë e shpejtë dhe e sigurtë për caktimin e termave që duhen përkëthyer në gjuhën shqipe. Nuk u kryen në kohën e parashikuar othografia dhe gramatika e gjuhës shqipe. Parashikimet në fjalorin shqip kanë qënë të gabuara në një masë të madhe, për arësye se ka munguar një plan me hollësi dhe kjo ka penguar gjithashtu kontrollin e ritmit të punës.

Në lëmin e folklorit është bërë një punë e kujdesëshme përsa i përket rregullimit dhe punimit të materialit folkloristik të mbledhur; Është inventarizuar dhe skeduar materiali folkloristik i botuar dhe i mbledhur nga seksioni, është punuar për antologjinë e folklorës (pjesa e Lirikës), është punuar për një bibliografi të folklorit dhe është bërë një studim mbi Legjendën e Skënderbeut te Arbreshët; janë organizuar ekspedita për të mbledhur material folkloristik etj.

Për arësye të mungesës së eksperiencës janë bërë parashikime jo të saktë për hartimin e antologjisë së folklorës, pjesa e Epikës, punimi i sëcilës nuk u fillua fare dhe pjesa e Lirikës, e cila u punua pjesërisht. Një tjetër e metë në punën e këtij sektori ka qënë mungesa e një organizimi të mirë dhe me kohë, t'ekspeditave që kanë rëndësi në këtë fushë, për të mbledhur sa më parë dhe me kujdesin e duhur folklorin që rrezikohet të humbasë.

Në lëmin e shkencave të natyrës është bërë një punë e mirë dhe e frutëshme në *Muzeun e Shkencave të Natyrës*, ku plani vjetor në mjaft pika është tejkaluar, si në pasurimin e reparteve dhe në studimet që janë kryer në repartin e botanikës dhe të zoologjisë. Me gjithatë ka mbetur pa u realizuar pjesa e studimeve gjeologjike, e cila ishte e kondicionuar me ardhjen e laboratorit gjeologjik nga jashtë. Gjithashtu mbeti pa u kryer një pjesë e vogël e ekspeditave të para-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BERATI" GJIROKASTËR

shikuara, nga mungesa e automjeteve dhe e ekipit. Nuk u bënë përpjekje të mjaftuarshme për të sjellur në kohën e duhur laboratorin gjeologjik dhe atë të bimëve medicinale, të cilët do të na jepnin mundësi të nxirrnim rezultate praktike nga studimet tona gjeologjike e botanike, që kanë një interes për ekonominë e vëndit dhe do të na lejonin të fillonim sa më parë nga puna e kërkimeve eksperimentale që kanë një rëndësi të madhe për të shkuar përpara në shkencë.

Shërbimi Hidrometeorologjik, megjithse nuk e ka realizuar plotësisht planin për ngritjen e stacioneve të parashikuara, ka kryer një punë të madhe, duke marë parasysh pengesat e mëdha materiale dhe mungesën e personelit të specializuar. Ngritja e këtij Shërbimi, me rrjetin e stacioneve hidrometrike dhe meteorologjike, është një sukses për Institutin, po që t'arrihen rezultate të kënaqëshme në vrejtimet e matjet, duhen bërë edhe këtu përpjekje më të mëdha për pajisjen e stacioneve me aparatet e nevojshme, përndryshe nuk mund të justifikohen shpenzimet e mëdha që bën me të drejtë shteti jonë për ngritjen e këtij Shërbimi kaqë me rëndësi.

Pengesa të mëdha janë hasur në ngritjen e stacionit meteorologjik të Tiranës, ku vonesa e ngritjes së kursit për formimin e kuadrove të nevojshëm ka paralizuar punën.

Një pjesë shumë e vogël është realizuar nga plani i Komisionit të Hidraulikes dhe pothuaj as gjë nuk është paraqitur nga studimet që kishin marë përsipër të kryejnë anëtarët e Komisionit të Mjekësisë Sociale pranë *Seksionit të Shkencave të Natyrës,* për vitin 1949. Dy studimet e paraqitura mbi «Mortalitetin Infantil në Tiranë» dhe mbi «Malarjen në Shqipëri», kanë qënë punime që figuronin në planin e vitit 1948. Shkaqet kryesore të këtij rezultati të dobët janë: mos parashikimi mirë i gjërësis së problemeve që ishin zgjedhur për t'u studiuar, mos interesimi sa duhet dhe negligjenca e anëtarëve të komisioneve, të cilët me gjithë që kanë marrë angazhime përpara komisioneve të tyre, nuk e kanë konsideruar vehten të detyruar që t'i kryejnë këto angazhime, duke marrë pjesë rregullisht në mbledhjen e komisioneve, siç është rasti i anëtarëve të Komisionit të Hidraulikës, ose duke i kushtuar kohën e nevojëshme studimeve që kanë marrë përsipër të kryjnë siç është rasti i anëtarëve të Komisionit të Mjekësisë. Një tjetër shkak ka qënë gjithashtu mungesa e kontrollit të rregullt dhe vënia përpara përgjegjësisë me kohë nga ana e Seksionit të Shkencave të Natyrës. Studimet shkencore që bëhen nga ana e komisioneve kanë një rëndësi të madhe për ekonominë e vëndit tonë, ato zgjidhin shumë probleme që kanë të bëjnë me punën e përditëshme të dikastereve dhe janë njëkohësisht një kontribut i çmuarshëm në lëmin e njohurive, mbi vëndin tonë, mungesa e të cilave sjell pengesa për realizimin e planevet për mirëqënien e përgjithëshme. Prandaj një punë serioze kërkohet nga anë-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

tarët e Komisioneve në kryerjen e detyrave që na imponon sot nevoja e ndërtimit të vëndit. Nuk është mbajtur gjithashtu angazhimi për punimin e Atlasit Forestal, për të cilin është bërë vetëm një punë paraprake, si dhe ay i përkthimit të veprës «Agrobiologjija» e akademikut T. D. Lisenko, e cila do t'ishte një ndihmë e madhe për orientimin e drejtë teorik e praktik në çështjet e agrobiologjisë.

Në lëmin e historisë dhe sociologjisë një sukses është ngritja e *Arkivit të Shtetit* në drejtori më vehte, ku është bërë një punë e mirë për grumbullimin e skedimin e dokumentave që do të shërbejnë si material burimor për historinë e Shqipërisë. Janë krijuar skedarët: regjesti, kronika, nomenklatori dhe skedari analitik; janë punuar gjithësejt 20.000 dokumenta dhe janë bërë përkthime materiali dokumentar. Mungesa e një ndërtese të përshtatëshme ka shkaktuar që një pjesë e planit, e kondicionuar nga kjo çështje, të mos realizohet.

Muzeumi Arkeologjik-Etnografik ka punuar për pasurimin e tij me objekte të rij, për sistemimin e materialit të mbledhur, për ta bërë të përdorëshëm dhe të vlefshëm për studimin dhe ka kryer një seri ekspeditash e gërmimesh me qëllim studimi. Eshtë bërë një riorganizim i repartit të Etnografisë për të paraqitur më mirë objektet që disponon Muzeu. Në punën e Muzeut ka munguar një organizim i mirë për sa i përket gërmimeve, të cilët mbetën pjesërisht pa u kryer dhe nuk është bërë një punë e mirë për aktivizimin e rretheve shkencore dhe për shkëmbimet me botën e jashtëme.

Për hartimin e Historisë së Shqipërisë 1878-1939, është mbledhur material nga shtypi i kohës, nga botime historike të huaja, nga goja e popullit, nga Arkivi i Ministrisë së Jashtëme të Bashkimit Sovietik, nga Sofja, nga Bukureshti e Budapesti. Eshtë punuar dhe koordinuar një sasi materiali i akteve diplomatike. Për përhapjen e literaturës marksiste janë përkëthyer ose botuar një seri veprash nga klasikët e marksizmit: «Për Historinë e Lidhjes Komuniste», «Origjina e Familjes Pronës Private dhe Shtetit», «Ludwig Feuerbach» dhe «Fundi i Filozofi së Klasike Gjermane» të F. Engles, «Shteti dhe Revolucioni», «Imperializmi Faza e fundit e kapitalizmit», «Ç'të bëjmë?», «Një hap përpara dy hapa prapa», «Dy Taktikat e Social-Demokracisë Ruse», «Cilët janë armiqt e popullit», «Revolucioni proletar dhe renegati Kautsky» të Leninit dhe «Çështje të leninizmit», «Çështja nacionale dhe koloniale» të Stalinit. Nga plani i *Seksionit të Historisë* mbetën pa u diskutuar tezat mbi Historinë e Shqipërisë, gjithashtu nuk u organizua mirë puna me Komisionin e bashkëpunëtorëve që do të pregatiste një studim mbi reformën agrare. Komisioni nuk ka funksionuar fare gjatë vjetit 1949 dhe puna e tij, që ishte diskutimi dhe aprovimi i tezave si dhe mbledhja e materialit të nevojshëm mbeti pa u kryer.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Siç shifet, në përgjithësi Instituti ka zhvilluar një aktivitet shkencor mjaft të gjërë, por ka pasur dhe mjaft të meta në punën e tij. Ay nuk ka bërë sa duhet për të krijuar lidhje të rregullta me dikasteret e tjerë, për t'u bërë atyre të njohur punën e tij dhe për të qënë në dijeni të punës që zhvillohet në vëndin tonë, në mënyrë që t'orientojë sa të jetë e mundur më shumë aktivitetin e tij drejt studimit të problemeve me rëndësi për zhvillimin e ekonomisë së vëndit. Instituti nuk ka bërë sa duhet për të angazhuar plotësisht kuadrot e tij të larta në punë shkencore, duke i lehtësuar sa të jetë e mundur nga okupacionet administrative. Ky është rasti i shefave të seksioneve dhe i drejtorave të institucioneve mvartëse të Institutit. Nuk është bërë sa duhet për aktivizimin e anëtarëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm t'Institutit, të cilët, megjithëqë akoma jo në një nivel të lartë shkencor, janë një potencial i mjaftë për vëndin tonë dhe mund të japin një kontribut të math për ta çuar shkencën përpara tek ne. Instituti nuk ka bërë mjaft përpjekje për të përfituar nga eksperienca e Bashkimit Sovietik dhe për të ngritur nivelin shkencor të anëtarëve dhe bashkëpunëtorëve të tij, duke dërguar disa prej tyre në Bashkimin Sovietik për të parë në vënd organizimin e instituteve që punojnë lëmin tonë, për të parë metodat e punës dhe orientimin në shkencë, për të marrë kontakt me shkencëtarë të njohur, të cilët mund t'u sugjerojnë gjëra me rëndësi në lidhje me punimet tona në dobi t'ekonomisë së vëndit. Instituti mund të përfitonte gjithashtu mjaft nga sjellja në vëndin tonë e njerëzve sovietikë me eksperiencë në fushën e punimeve t'Institutit, kjo do të shpejtonte ritmin e punës dhe do të orientonte më mirë aktivitetin tonë shkencor në hapat e tij të para. Nuk janë bërë sa duhet përpjekje për të pasuruar bibliotekën e Institutit me libra e revista që janë mjete të domosdoshëm për të mbajtur punonjësit e shkencës në kontakt me përparimet kolosale që bën shkenca jashtë vëndit tonë, dhe pa të cilat nuk mund të shkohet përpara. Instituti mund të bënte më shumë për popullarizimin e aktivitet të tij, duke organizuar konferenca nga anëtarët e bashkëpunëtorët, ku të paraqiteshin të studjuar problemet më me rëndësi t'Institutit, të lidhura me njohjen e pasurive e të mundësive materiale e kulturale të vëndit tonë. Instituti duhet të bënte më shumë përpjekje për të forcuar lidhjet me botën e jashtëme, duke krijuar më shumë kontakte me institute dhe shkencëtarë, duke bërë shkëmbime materiali shkencor, duke kërkuar ndihmën e eksperiencës së tyre më të madhe etj.

Këto kanë qënë problemet, aktivitetet, suksesët dhe të metat e punës së Institutit për vitin 1949. Eksperienca e fituar vjetin e kaluar duhet të na ndihmojë për të shtruar më mirë problemet që na paraqiten sot dhe për të bërë një punë më të organizuar dhe më prodhonjëse për vitin që po fillon.

BIBLIOTEKA PUBLIKE SHKENCORE "MARIN BARLETI"

Cilat janë parimet ku u mbështet Instituti për hartimin e projekt-planit të vitit 1950 dhe çduhet të bëjë në gjendjen e sotme të shkencës në vëndin tonë për ta çuar atë përpara?

Lufta e ashpër që bëri populli ynë për shkatërrimin e fashizmit, i cili është, siç dihet, imperializmi në fazën e tij më t'egër dhe grabitse, që shtyp pa mëshirë masat e gjëra të popullit, hodhi bazat e demokracis sonë popullore dhe i dha mundësi shprehjes së lirë t'aspiratave të popullit tonë për një zhvillim të shpejtë ekonomik e kultural. Fitorja e luftës mbi fashizmin dhe vendosja e demokracisë popullore i dhanë mundësi shkencës tek ne që të ecë n'udhën e parimeve marksiste d.m.th. të vihet vullnetarisht në shërbim të popullit, t'i japë atij të gjitha të mira e fitoreve të saj. Shoku Stalin, njeriu më i math i shkencës së kohës sonë, në pritjen e kolaboratorëve të shkollave superiore më 1938, e ka karakterizuar shkencën përparimtare si shkencën që «nuk ndahet nga populli, që nuk largohet nga ay, por e ndjen vehten të gatëshme t'i dorëzojë popullit të gjitha fitoret e saj, që i shërben popullit, jo me përdhunë, por vet-vetiu dhe vullnetarisht, që u hap gjërësisht portat forcave të reja shkencore të vëndit dhe u jep atyre mundësinë të pushtojnë majat më të larta të shkencës». Ke ne shkenca nuk ka as një lidhje me përfitime spekullonjëse por zhvillohet nga populli në përfitim të tij.

Dihet se në një shtet ku është në fuqi sistemi kapitalist, me gjithë që ka dijetarë, shkenca dhe puna e të cilëve është përparimtare zhvillimi i shkencës nuk mund të bëhet lirisht, shkenca nuk mund të shkëputet nga spekullacioni deri sa ekziston çfrytëzimi i njeriut prej njeriut. Në vëndet kapitaliste zhvillimi i shkencës, që sjell rritjen e prodhimit, është në kundërshtim me përmirësimin e konditave të jetesës së masave të popullit. Në sistemet e prodhimit të bazuar mi çfrytëzimin, «çdo përparim në prodhim - thotë Frederich Engles - përfaqëson një ulje në gjëndjen e klasave të shtypura d.m.th. të shumicës së madhe...»

Po shkenca shkon përpara dhe në vëndet kapitaliste, me gjithë pengesat e panumurta që has nga kontradiktat e brendëshme të sistemit kapitalist dhe ajo është një nga faktorët më rëndësi vendimtare për shkatërrimin e këtij të fundit, kurse në sistemin socialist çdo përparim i shkencës, çdo formë e re zotërimi e njeriut mbi natyrën, i shërben interesave të punonjësve të krahut dhe të mendjes. Në vëndet ku ka triumfuar sistemi socialist, njeriu që është forca prodhonjëse kryesore, nuk është më skllav i forcave prodhonjëse materiale, që ay vetë ka krijuar, por i dominon ato dhe i drejton n'udhën e interesave dhe mirëqenies së tij. Në vëndet socialiste përpjekja për një prodhim sa më të madh pajtohet krejtësisht me tendencën e një zhvillimi të pakufi të

BIBLIOTEKA PUBLIKE SHTETËRORE "MARIN BARLETI"

shkencës dhe teknikës. Këto pikëpamje marksiste mbi zhvillimin e lirë e të pakufishëm të shkencës në vëndet ku janë vendosur marëdhëniet socialiste në prodhim, janë vërtetuar në një mënyrë të shkëlqyeshme në Bashkimin Sovietik, i cili brënda pak dhjetra vjetësh mundi të likuidojë mbrapambetjen shekullore të Rusisë cariste dhe të arrijë e të kalojë nga shumë anë shtetet kapitaliste më të përparuar. Karakteristika e shkencës së përparuar është se ajo lidhet ngusht me jetën, me problemet aktuale të masave të popullit, zgjidhja e të cilave u jep atyre mundësi të reja për të shkuar përpara.

Vëndi ynë ka hyrë n'udhën e marëdhënievet socialiste me një herë mbas shpartallimit të fashizmit e reakcionit të brendëshëm dhe ngritjes së pushtetit popullor në vëndin tonë. Këto marëdhënie përcaktuan njëkohësisht edhe karakterin e shkencës tek ne. Ato lejuan një organizim të shpejtë e të drejtë të punës shkencore dhe i sigurojnë asaj të gjitha mundësitë e një zhvillimi të vrullshëm, relativisht me konditat ekonomike dhe kulturale të vëndit tonë. Puna shkencore e organizuar, që sapo ka lindur tek ne, ka perspektiva të kjarta zhvillimi të shpejtë, sepse Republika e jonë popullore i përmbush plotësisht konditat e nevojëshme të një pushteti thellësisht popullor. Vendimet dhe masat që kanë marrë Partija dhe Qeverija jonë për të ndihmuar sa më shumë shkencën, janë një provë e kjartë e vullnetit të popullit tonë për të likuiduar sa më parë gjëndjen e mjeruarshme materiale e kulturale në të cilën e lanë atë sundonjësit feodalo-borgjezë dhe okupatorët e huaj. Konditat janë krijuar sot për një shkencë përparimtare tek ne, duke pasur gjithmonë parasysh shëmbëllin e shkencës sovietike, e cila lot rolin e pionierit të përparimit dhe zhvillimit

Në këtë situatë, një përgjegjësi bije mbi njerëzit tonë të shkencës, për të shtruar drejtë dhe me guxim problemet e zhvillimit shkencor, në vëndin tonë dhe të lozin një rol aktiv në organizimin dhe mobilizimin e forcave tona për të shkuar përpara.

Prandaj problemi kryesor i Institutit, për vitin 1950 është të zgjerojë aktivitetin e tij shkencor në lëmin e gjuhës, të folklorës, të historisë dhe sidomos n'atë të shkencave të natyrës. Këto të fundit, që janë të lidhura drejt për së drejti me problemet ekonomike kanë qënë lënë krejt mbas dore nga regjimet e kaluara, të cilët nuk kishin krijuar as konditat më elementare për një punë të tillë. Për këtë arësye në këtë fushë vëndi ynë nuk ka as një traditë dhe puna për hedhjen e bazave të shëndosha në këtë terren, është mjaft e vështirë, mbasi na është dashur të fillojmë nga zero. Por këtu edhe ne duhet të koncentrojmë më shumë forcat tona dhe të krijojmë sa më parë mundësitë materiale të domosdoshme, pa të cilat nuk mund të shkohet përpara. Duhet të bëjmë çështë e mundur për të krijuar mundësitë e një pune eksperimentale sa më të gjërë, duhet të fillojmë të punojmë në fushën e kërkimeve shkencore, që janë një faktor esencial për kontributin e tyre në mirë-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

qënien e popullit. Krijimi i konditave për një punë të tillë është udha më e mirë dhe më e shpejtë për të pregatitur kuadrot tona shkencore dhe për të zbuluar talentet që mund të humbasin nga pamundësija e zhvillimit të tyre. Pa filluar me kohë një punë kërkimesh shkencore ne nuk mund të nxjerrim dedukcione praktike nga studimet tona teorike, nuk mund të shkojmë përpara në shkencat e natyrës. Kjo është udha e vetme për të realizuar me sukses lidhjen e aktivitetit të Institutit me problemet që shtron dhe do të shtrojë me një forcë gjithmonë më të madhe në t'arthmen, zhvillimi i shpejtë ekonomik e industrial i vëndit.

Një problem tjetër me rëndësi është ay që përmbleth aktivitetin për të organizuar më mirë punën që zhvillohet sot n'Institut. T'organizohet dhe të kontrollohet puna me komisionet e anëtarëvet dhe bashkëpunëtorëve t'Institutit: Komisionit të Hidraulikës, të Rezistencës së Materialeve, të Mjekësisë Sociale, të Reformës Agrare, komisioneve të fjalorëve etj., si edhe atyre që janë krijuar gjatë vjetit 1950. Këta komisione, ku bëjnë pjesë njerëz të zgjedhur në fushën e aktivitetit tonë shkencor, kanë detyra me rëndësi, qoftë përsa i përket problemeve që kanë në studim, qoftë përsa i përket marëdhënieve dhe lidhjeve të ngushta në të gjithë aktivitetin që zhvillon Instituti me organet e tij të brëndëshmë. Mungesa e kuadrove të mjaftuarshme, që t'i dedikohen kryesisht punës shkencore, na detyron sot që të kërkojmë një ndihmë të madhe nga njerëz që zhvillojnë aktivitetin e tyre kryesor në dikastere ose ndërmarrje të ndryshme. Është e domosdoshme që këtyre njerëzve t'u krijohen kondita të nevojëshme dhe t'arësyeshmë për t'i vënë në gjëndje që të zhvillojnë një aktivitet të rregullt në lëmin e shkencës për të cilin ata kanë aftësi të mjaftuarshme, pa dëmtuar në mënyrë të ndieshme punën në sektorin e aktivitetit të tyre kryesor.

Të sillen sa më parë laboratorët e nevojshëm për punën eksperimentale dhe të kërkimit si dhe aparatet e mjetet e nevojshme për funksionimin e rregullt të shërbimit Hidrometeorologjik. Kësaj pune duhet t'i kushtohet një kujdes i veçantë, mbasi mungesa e tyre deri më sot ka shkakëtuar humbje kohe dhe pakësimin e rezultateve të studimeve tona.

Të pajisen më mirë dhe të pregatiten me kujdes me anën e një studimi paraprak më të thellë ekspeditat tona, mbasi ato janë baza kryesore e punës sonë shkëncore në sektorët ku organizohen. Të bëhet një punë sistematike për një orientim të drejt marksist në lidhje me problemet që i paraqiten Institutit në fushat e ndryshme t'aktivitetit shkencor, duke përkëthyer nga rusishtja për të vënë në dispozicion t'antarëve dhe bashkëpunëtorëve, vepra fondamentale që paraqesin parimet themelore, bazën e shëndoshë mbi të cilën duhet të mbështeten punonjësit tonë të shkencës.

Të punohet me kujdes për eliminimin e të gjitha të metave të konstatuara në punën e Institutit gjat vitit 1949.

BIBLIOTEKA PUBLIKE „MARIN BARLETI" SHKODËR

Këto janë në vija të përgjithëshme, për vitin 1950 orientimi dhe problemet e Institutit të Shkencave të konkretizuara në projekt-planin e tij.

Të gjithë anëtarët dhe bashkëpunëtorët e kanë studjuar dhe shqyrtuar në hollësi këtë projekt-plan, prandaj ne këtu do të paraqesim çështjet kryesore për çdo sektor, që hyjnë në planin e 1950-ës si elementë me rëndësi dhe që vënë në evidencë udhën që ndjek Instituti për këtë vit.

Elementet kryesorë me rëndësi të planit për vitin 1950.

Në Seksionin e gjuhësisë, përveç punimeve të vitit të kaluar që vazhdojnë edhe gjatë këtij viti siç janë: *Fjalori Shqip, Fjalori rusisht-shqip, Bibliografia Shqipe* dhe *Sindaksa Shqipe,* Instituti do të shtrojë çështjen e hartimit të një *Atlasi gjuhësor,* që do të regjistrojë të gjithë pasurinë e gjuhës sonë në format e saja dialektale më të ndryshme. Mbledhja e një pasurije të tillë do të lejojë një sëri studimesh me rëndësi për zgjidhjen e shumë problemeve të gjuhës sonë. Natyrisht përpara se të filiohet një punë e tillë, e cila do të kërkohet disa vjet për t'u kryer, do të nevojitet një punë studimi paraprak që do të bëhet gjatë këtij viti bashkë me një pjesë të kuestionarit, që është puna fillestare për hartimin e Atlasit gjuhësor.

Një tjetër çështje me rëndësi i paraqitet Institutit në lëmën e gjuhës: të punojë për zhvillimin e gjuhës shqipe në mënyrë që kjo t'i përshtatet nevojave të zhvillimit tonë ekonomik e shoqëror. Industrializimi i shpejtë i vëndit tonë, ngritja e një sasije të madhe punishtesh, fabrikash e kombinatesh, ka krijuar nevojën e një nomenklature për të gjitha veglat e aparatet e ndryshme që përdoren në këto qëndra- pune. Kjo nomenklaturë është krijuar si ka mundur, zakonisht me terma të gjuhëve të huaja, por shpesh herë inekzakte ose që nuk ekzistojnë fare në këto gjuhë. Në raste të tjera termat janë përkthyer shqip, por duke mos respektuar natyrën e gjuhës sonë. Një tjetër rast është përdorimi i termave të ndryshme në vëndet e ndryshme për të njëjtin objekt. Të gjitha këto anomalira jo vetëm që sjellin një perturbacion në zhvillimin e gjuhës, por shkaktojnë edhe dëme ekonomike dhe humbje kohe, kur është rasti për të specifikuar porosirat e qëndrave të ndryshme për importim veglash shkëmbimi. Për t'i dhënë një zgjidhje sa më të shpejtë këtij problemi, Instituti i Shkencave do të krijojë një komision pranë Seksionit të Gjuhës, i cili do të punojë për të vendosur një terminologji të saktë teknike industriale.

Instituti do të fillojë gjithashtu të punojë për hartimin e *Historisë së Letërsisë Shqipe,* duke proçeduar gjatë gjitit 1950, në mbledhjen e materialit të nevojshëm dhe do të caktojë vijat e përgjithëshme për punimin e tij.

Seksioni i Gjuhësisë e Letërsisë ka shtruar për vitin 1950 përkë-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI"

thimin në shqip të veprës së madhe të Pushkinit «Eugjen Onegin», nga e cila do të vihen në shtyp rreth 3.000 vargje.

Komisioni i folklorit, përveç punës së mbledhjes së materialit folkloristik me anë ekspeditash e forcash të tjera dhe rregullimit të tij për ta bërë të përdorëshëm, do të punojë për të pregatitur *Antologjinë e Epikës*, do të bojë *Antologjinë e Lirikës* dhe atë të *Folklorit të Luftës N.Çl.* dhe do të bëjë tre studime mbi Folklorin dhe lëvizjet e fshatarëve, mbi Legjendën e Skënderbeut dhe mbi këngët e kurbetit.

Në Seksionin e Historisë dhe Sociologjisë në vjetin 1950 do të kalohet nga faza e mbledhjes së materialit burimor, i cili do të vazhdojë akoma deri në trem. II-të, n'atë të hartimit të monografive dhe të redaktimit të parë të tekstit të *Historisë së Shqipërisë*. Për këtë, mbasi të jenë diskutuar dhe aprovuar tezat, do të hartohen, nga një grup bashkëpunëtorësh, monografitë e ndryshme dhe më në fund tërë puna do të kalojë nga një Komision redaktonjës, i cili do të fillojë punën për redaktimin e tekstit të parë të kësaj historije në dhjetor të vitit 1950. Historia e Shqipërisë 1878-1939 do të jetë i pari studim me rëndësi dhe me baza të shëndosha i historisë sonë kombëtare, ajo do të jetë një hap i sigurtë përpara dhe një mbështetje e shëndoshë për studime të mëtejshme mbi historinë e Shqipërisë për këtë periodë. Një tjetër studim me rëndësi do të jetë ay i *Reformës Agrare* që mbeti pa u realizuar vjetin e kaluar nga komisioni i krijuar për këtë qëllim.

Seksioni i Historisë e Sociologjisë do ta zgjerojë aktivitetin e tij me krijimin e Komisionit Juridik, i cili do të bëjë një sëri punimesh siç janë: përpunimi i indeksit të legjislacionit shqiptar 1912-1949, hartimi i monografive dhe i kapitujve për Historinë e Shqipërisë mbi statutet që ka pasur Shqipëria dhe mbi historinë e administratave gjyqësore; do të punojë për të mbledhur të drejtën zakonore shqiptare, dhe do të merret me studimin e problemeve të së drejtës internacionale në historinë diplomatike të Shqipërisë.

Puna e përkthimeve dhe e botimeve të veprave të klasikëve të marksizmit do të zgjerohet. Për këtë do të formohet pranë Seksionit një komision me dhjetë përkthenjës dhe redaktorë, që do të marrin përsipër përkëthimin dhe redaktimin e një sërije veprash me rëndësi.

Muzeu Arkeologjik-Etnografik, përveç punimeve të brëndëshme për studimin e objekteve, për sistemimin dhe paraqitjen e tyre, do të ndërmarrë një sëri ekspeditash me qëllim mbledhje materiali dhe studimesh si dhe një sëri gërmimesh arkeologjike. Për këto të fundit do të formohet një brigadë kulturale me nxënës e studentë të shkollave tona, të cilët në kohën e pushimeve të tyre do të ndihmojnë mjaft për të kryer

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

një punë të kujdesëshme dhe do të përfitojnë njëkohësisht njohuri të vlerëshme nga teknika e gërmimit dhe nga studimi i objekteve të zbuluar. Kultura materiale e popullit tonë është mjaft e madhe dhe Muzeumit Arkeologjik-Etnografik i bije barra ta mbledhë, ta konservojë dhe ta studjojë atë me kujdes, pse është një pasuri e çmuarshme për historinë e zhvillimit të popullit tonë.

Arkivi i Shtetit do të zgjerojë aktivitetin e tij me mbledhjen dhe sistemimin e materialeve arkivale të dikastereve, të qarqeve etj., duke dhënë kështu një kontribut të math për mbledhjen e vlerësimin e materialit burimor të historisë sonë.

Biblioteka Kombëtare do të punojë për pasurimin e saj me vepra të vlefshme, që t'u përgjigjen sa më mirë nevojave të zhvillimit tonë ekonomik dhe kultural dhe do të bëjë të përdorëshme sa më parë tërë materialin bibliografik që ndodhet në të.

Në lëmin e shkencave të natyrës përpjekjet e Institutit duhet të bëhen më të mëdhaja për të shtruar më me forcë problemin e punimeve në fushën eksperimentale e të kërkimeve dhe për të zgjeruar punën e studimeve në lidhje me problemet e ekonomisë sonë bujqësore dhe të çfrytëzimit të pasurive tona nayrale. Për këtë, Presidiumi i Institutit i paraqet Asamblesë për të diskutuar dhe aprovuar propozimin që mendon t'i bëhet qeverisë së Republikës sonë Popullore, për krijimin pranë Institutit të Shkencave të një *Seksioni Bujqësor*, për këto arësye: në fazën e sotme të zhvillimit të bujqësisë sonë e cila po ecën drejt kalimit nga një bujqësi primitive në një bujqësi të mekanizuar, studimet, kërkimet dhe eksperimentet e ndryshme agrologjike, janë elemente të domosdoshëm për aplikimin me sukses të metodave dhe rregullavee të përshtatëshme për kushtet lokale t'ambientit tonë fizik bujqësor. Bibliografia e jonë bujqësore, për sa i përket studimeve që trajtojnë gjërësisht argumente bujqësore në lidhje me ambientin tonë fizik, është shumë e varfër dhe nuk lejon t'arrihet në konkluzione me rendësi në fushën e praktikës bujqësore. *Stacioni Eksperimental* pranë Ministrisë së Bujqësisë, sa po ka filluar një punë eksperimentale të dobishme por i mungon akoma një aparat më i gjërë studimesh bujqësore. Për të përmbushur sa më parë nevojat e shumta për studime sistematike të lidhura me problemet imediate dhe urgjente të bujqësisë sonë, një qëndër studimesh bujqësore pranë Institutit të Shkencave, do t'ishte më se e nevojshme. Disa nga problemet që do të shtroheshin për t'u studjuar nga ky seksion do t'ishin:

1. Studimi i ambientit fizik bujqësor në bazë të çfrytëzimit të literaturës ekzistonjëse dhe të vrejtimeve me vënd.

2. Studime gjeologjike, floristike, klimatike, si komplement i stu-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

dimit pedologjik që ka ndërmarë Stacioni Eksperimental për rajonizimin e kulturave.

3. Studimi i varieteteve të kulturave dhe përcaktimi i varieteteve më të përshtatëshme për ambientin tonë fizik (me anë provash e vrejtimesh në vënd dhe të literaturës ekzistonjëse).

4. Përcaktimi i tipave të qarkullimit për çdo tokë bujqësore në bazë të natyrës s'ambientit fizik dhe të nevojave të vëndit.

5. Përcaktimi i llojeve të plehrave kimike për çdo tokë bujqësore, në bazë të studimit t'ambientit fizik.

6. Përcaktimi i metodave agroteknike më të përshtatëshme për kulturat e tokat tona (me anë të çfrytëzimit të literaturës së huaj agroteknike dhe në bazë të njohurive t'ambientit tonë fizik bujqësor).

7. Përcaktimi i kulturave të vlefshme të reja që mund të zhvillohen në vëndin tonë (soja, çaj etj.) dhe i varieteteve më të përshtatëshme të këtyre kulturave për ambientin tonë fizik.

8. Përcaktimi i esencave të vlefshme pyjore që mund të zhvillohen më mirë në vëndet e caktuara për pyllëzim.

9. Përcaktimi i llojeve të barnave që formojnë shoqërimet vegjetale më të përshtatëshme për kullotat tona.

10. Studime fitopatologjike: studimi i cikleve evolutive t'agjentëve që shkaktojnë sëmundjet e bimëve; përcaktimi i mënyrave më të përshtatëshme për luftimin e këtyre sëmundjeve etj.

Kjo qëndër studimesh bujqësore do të krijojë lidhje të ngushta me Ministrinë e Bujqësisë për të konkretizuar së bashku më mirë problemet e studimit për të koordinuar punën e bashkëpunimit me agronomë e njerëz të tjerë të bujqësisë në qarqe dhe për t'i dhënë Ministrisë për aplikim rezultatet e studimeve të saja. Lidhje të ngushta do të kishte Seksioni i Bujqësisë s'Institutit edhe me Stacionin Eksperimental, të cilin do ta ndihmonte me njohuri e të dhëna të ndryshme në lidhje me ambientin tonë fizik bujqësor dhe do të përdorte rezultatet e kërkimeve të tij për të kontrolluar e plotësuar studimet e tij teorike. Përndaj edhe për shkak të natyrës së punës dhe të problemeve që ndjek, do të ishte e arësyeshme që Stacioni Eksperimental të kalonte nën mbartësinë direkte të Seksionit të Bujqësisë; kjo do të lehtësonte koordinimin e punës dhe do ta lidhte më mirë Stacionin dhe studimet shkencore. Qënja e Seksionit Bujqësisë pranë Institutit do t'i vlente atij për të kombinuar punën me sektorët e tjerë që punojnë në lëmin e shkencave të natyrës dhe për të përdorur mjetet e tyre të punës si laboratoret, bibliotekën shkencore etj. Puna e këtij seksioni do të ndihmohet vazhdimisht nga Komisioni për Pyllëzimet kundër Thatësirës dhe Erozionit që është ngritur n'Institut pranë Seksionit të Shkencave të Natyrës dhe që me krijimin e Seksionit të Bujqësisë do të lidhet me këtë të fundit.

Në lidhje me punën eksperimentale dhe të kërkimeve që duhet të zhvillojë Instituti, Presidiumi i parashtron Asamblesë për diskutim

BIBLIOTEKA PUBLIKE
MARIN BARLETI
SHKODËR

dhe aprovim, një tjetër propozim për Qeverinë e Republikës sonë Popullore mbi ngritjen pranë Institutit të një *Laboratori të Shtetit,* për këto arësyena: për një shtet që ka hyrë n'udhën e industrializimit dhe zhvillimit ekonomik e kultural, puna eksperimentale dhe e kërkimeve shkencore është e domosdoshme. Veprimtarija e prodhimit duhet të shoqërohet pa tjetër me ngritjen e qëndrave eksperimentale dhe shtimi i prodhimit është lidhur në mënyrë të pa ndarë me kërkimet shkencore, pa të cilat ne nuk mund ta çojmë përpara shkencën në vëndin tonë. Qëndrat eksperimentale që eksistojnë sot ke ne janë të pakta, jo t'organizuara mirë dhe të pamjaftuarshme për nevojat e vëndit, dhe qëndrat ku të zhvillohen kërkime shkencore nuk ekzistojnë fare. Paraqitet pra nevoja e një qëndre eksperimentale me rëndësi që të jetë në gjëndje të përballojë kërkesat e ndryshme shtetërore (studimi i vetive të produkteve, matja e rezistencës së materialeve, analiza e përbërjes së disa materialeve tj.) dhe të ndërmarrë kërkime shkencore në lidhje me probleme aktuale në dobi të ekonomisë së vëndit tonë.

Kjo qëndër do të formonte Laboratorin e Shtetit ku në fillim do të ekzistonin: 1) *Reparti i kërkimeve shkencore, 2) Reparti kimik* dhe *3) Reparti i rezistencës së materialeve.* Më vonë këto reparte mund të zgjeroheshin dhe të shtroheshin sipas nevojave dhe mundësive tona.

Laboratori i Shtetit duhet të plotësojë kërkesat e dikastereve dhe të koordinojë punën për plotësimin e tyre në mënyrë sa më të drejtë, nga ana tjetër ay mund t'u bëjë enteve të ndryshëm sugjerime të vlefshme në lidhje me problemet e tyre të përditëshme.

Avantazhet e çentralizimit të punës eksperimentale në një qëndër të vetme për vëndin tonë dhe në konditat tona do t'ishin evidente: koordinim pune, ndihmë reciproke ndërmjet kuadrove shkëncore dhe reparteve, kursim mjetesh dhe kursim kuadri të kualifikuar.

Lidhja e një qëndre të tillë eksperimentale me një qëndër studimi siç është Instituti i Shkencavet, do t'ishte shumë e frutëshme, mbasi natyra e punës, lidhja me kuadrot shkencore, kontakti më i afërt me Bibliotekën e Institutit, do t'ia lehtësonin mjaft punën Laboratorit dhe do ta shpinin atë shpejt përpara.

Komisioni i Hidraulikës dhe Rezistencës së Materialeve do të kryejë gjatë vjetit 1950 punimet e paplotësuara vitin e kaluar dhe do të shtrojë punime të reja siç janë: Hartimi i një projekti për ngritjen e një centrali hidroelektrik në Bicaj, Borsh ose Labinot; çaktimi i terminologjisë së hidraulikës; punimi për një vepër me temë: «Teori dhe aplikacion në urat me beton arme»; punimi për një vepër me temë: «Metodat e ndryshme për themelimin e urave, me konsiderime teorike dhe shëmbulla praktike të zbatuara në Shqipëri»; një studim mbi përdorimin në maksimum të materialit të vendit në ndërtime; një studim mbi «Teorinë e di-

BIBLIOTEKA PUBLIKE SHKODËR "MARIN BARLETI"

mensionit të konstruksioneve me beton arme në stadin plastik». Këto studime të kryera siç duhet, do të jenë një kontribut i vlefshëm n'udhën e ndërtimit të vëndit.

Komisioni i Mjekësisë Sociale do të vazhdojë punën për plotësimin e angazhimeve të vjetit të kaluar dhe do të kryejë një seri studimesh të tjera mbi problemet që preokupojnë sot Ministrinë e Shëndetësisë për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullit.

Komisioni për Pyllëzimet kundër Thatësirës dhe Erozionit do të fillojë studimet preliminare për hartimin e një projekti mbi mbrojtjen e zonave fushore të kultivuara, nga thatësira dhe erozioni, me anë brezash pyjorë dhe sistemimesh e pyllëzimesh malorë. Kjo do të jetë një hap i parë n'udhën e gjërë të studimeve bujqësore me dobi të madhe për vëndin tonë.

Pranë Seksionit të Shkencave të Natyrës do të krijohen komisione teknologjike me karakter provizor, të përbërë nga anëtarë e bashkëpunëtorë të Institutit; të ndihmuar nga ekspertë të ndryshëm, të cilët do të meren me shqyrtimin dhe studimin e sugjerimeve dhe propozimeve me karakter teknik e industrial, të vlefshme për aplikime praktike në dobi të zhvillimit teknik dhe ekonomik të vëndit tonë.

Seksioni i Shkencavet do të vazhdojë punën e fitogjeografisë së Shqipërisë, do të punojë për hartimin e Atlasit Forestal dhe t'Atlasit të bimëve medicinale.

Muzeumi i Shkencave të Natyrës që është sot një bazë e mirë studimesh shkencore, e cila duhet të forcohet dhe të zgjerohet me shpejtësi, do të ndërmarrë për vjetin 1950, përveç punimeve të zakonshme muzeale mbi organizimin e ekspeditave, koleksionimin, determinimin dhe sistemimin e materialit shkencor, edhe studime të posaçme në lidhje me problemin e mineraleve të kromit në Shqipëri, me studimin e shpërndarjes së bimëve medicinale, me problemin e kultivimit të peshkut, me studimin e cikleve biologjike t'insekteve të damshme për bujqësinë, me problemin e ruajtjes dhe shtimit të kafshëve t'egra të dobishme etj. Muzeumi do të marrë në studim dhe do të bëjë projektin për themelimin e një *Stacioni Sismik* në Tiranë për vjetin 1951. Këto studime që janë të lidhura me probleme ekonomike të vendit tonë, do ta orientojnë Muzeun më shumë drejt një qëndre me rëndësi eksperimentale.

Shërbimi Hidrometeorologjik do të vazhdojë punën për plotësimin, ngritjen e riparimin e rrjetit të stacioneve hidrometrike e meterologjike në të gjithë Shqipërinë, siç është parashikuar në planin dy vjeçar; do të bëjë matjet e regjistrimet e nevojshme dhe publikimin e tyre do të pajiset me aparatet e nevojshme që janë të domosdoshme për të kryer një

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

shërbim të rregullt, i cili ka një rëndësi të madhe për industrinë bujqësinë, botoren, shëndetësinë e të tjerë sektorë t'aktivitetit tonë shtetëror.

Me qëllim që të bëhen të njohura dhe të popullarizohen problemet e studimet e Institutit të Shkencavet, me qëllim të bëhen të njohura pasuritë materiale dhe shpirituale të vendit dhe popullit tonë, Instituti i Shkencave do të organizojë me anën e anëtarëve dhe bashkëpunëtorëve të tij, një seri konferencash për nji rreth të gjërë ndëgjonjësish me tema, mbi gjuhësinë, folklorën, historinë, etnografinë, arkeologjinë dhe shkencat e natyrës.

* * *

Ky është, në vija të përgjithëshme, aktiviteti që duhet të zhvillojë Instituti i Shkencave për vitin 1950. Projekt-Plani i këtij viti, është i bazuar në forcat tona shkencore dhe në mundësit tona materiale, ay hap perspektiva për zhvillim të shpejtë dhe të drejtë të shkencës në vëndin tonë. Por që të kryejmë ne sukses detyrat që na ngarkohen, që të arrijmë rezultatet e parashikuara, ne duhet të bëjmë përpjekje më të mëdhaja, t'i kushtojmë më shumë kohë dhe kujdes studimeve dhe punimeve tona, t'organizojmë dhe të kontrollojmë më mirë punën tonë, të çfry tëzojmë në maksimum të gjitha mundësitë tona materiale e kulturale dhe të shtrojmë me guxim problemet e reja për një zgjerim sa më të drejtë të punës sonë shkencore.

Të mbështetur në parimet e pavdekëshme të shkencës marksiste leniniste dhe të udhëhequr me urtësi nga Partia e Punës së Shqipërisë, me në krye Sh. Enver Hoxha, frymëzonjësin e të gjitha fitoreve tona, ne duhet të jemi të sigurt se përpjekjet tona do të kurorëzohen me suksesin e merituar.

Pas referatit të Kol Paraisto, bëhen 10 minuta pushim.

*Fillon pika e dytë e rendit të dit*e*s:* DISKUTIME.

Këtu poshtë po japim një përmbledhje të diskutimeve:

SOTIR ANGJELI *Shef i Seksionit të Shkencave të Natyrës pranë Institutit të Shkencave* — Diskuton mbi kontributin e Institutit të Shkencave në fushën e ekonomisë popullore. Së pari numëron disa nga detyrat që i cakton Institutit rregullorja e përkohëshme dhe thekson rëndësinë e studimeve paraprake për zgjidhjen e problemave të rëndësishme. Dëshmon se Instituti është orientuar drejtë punës shkencore që lyp zgjidhja e disa problemeve ekonomike, por nuk është thelluar në këtë drejtim.

Pastaj ekspozon rezultatet e arritura nga Instituti i Shkencave në fushën ekonomike të vëndit gjatë tre vjetëve të fundit dhe projektet që ka për këtë vit numuron rezultatet e arritura në repartet e gjeologjisë të florës dhe të faunës të Muzeumit të Shkencave të Natyrës i cili është bërë kështu një qendër studimesh e kërkimesh në dobi të jetës

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SH. K. O. E. R.

ekonomike të vëndit; thekson rëndësinë ekonomike të shërbimit Hidrometeorologjik dhe vështirësitë që has ky në fazën e mëkëmbies e të organizimit të tij; cek gjithashtu kontributin që u ka dhënë e do t'u japë Dikastereve dhe enteve ekonomike; parashtron rezultatet e arritura në gjirin e Seksionit të Shkencave të Natyrës nga aktiviteti i komisioneve dhe i bashkëpunëtorëve duke e gjetur këtë aktivitet të kufizuar në raport me punën e shtruar në planet vjetore; vë në dukje projektet e sivjeçëm të Seksionit dhe iniciativën e fundit që ky ka marrë në lidhje me përdorimin e mazutit si lëndë djegëse për funksionimin e lokomotivave dhe të makinerisë së kantjerit të Kuçovës.

Pastaj tregon konditat që i duhen Institutit për t'u thelluar në problemet ekonomike të vëndit, duke analizuar: 1) organizimin dhe zhvillimin të mëtejshëm të Sektorit ekonomik të Institutit (krijimi i Seksionit të Bujqësisë dhe i Laboratorit qëndror të Shtetit, perspektiva për krijimin e Seksionit të Ujrave dhe atij të Mjekësisë Sociale, forcim i marrëdhënjeve me sektorët ekonomikë të Shtetit dhe krijim lidhjesh të reja, organizim më i mirë i punës së brëndëshme të Institutit); 2) Forcat shkencore mbi të cilat duhet të mbështetet veprimtarija e mëtejshme e Institutit (forca të brëndëshme të pakëta, bashkëpunim i forcave të jashtëme shkencore me kuadrot e brëndëshme të Institutit, aktivizim i anëtarëve dhe bashkëpunëtorëve të Institutit, duke u krijuar kondita pune më të favorëshme, të cilat Instituti është përpjekur t'i krijojë por ka gjetur pengesa, dhe konkretisht: kohë të lirë të mjaftushme për të kryer brënda orarit zyrtar një pjesë të angazhimeve të tyre, trajtim moral e materjal konform me vendimet e Komitetit Central dhe të Këshillit Ministrial, shpërblim i punës shkencore si një punë e kualifikuar); 3) Mjetet shkencore të nevojëshme për zhvillimin e kësaj veprimtarije (aparate dhe instrumenta shkencore, libra e rivista shkencore e teknike).

Përfundon duke thënë se janë krijuar konditat për perspektiva të gjera të punës shkencore në vëndin tonë dhe se me ndihmën e Partisë dhe të Pushtetit Instituti i Shkencave do të bëhet shpejt një qendër studimesh e kërkimesh për të mirën e kulturës dhe në shërbim të ekonomisë popullore.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BARLETI" SHKODËR

ING. ISMAIL TOPÇIU *Bashkëpunëtor shkencor. — Drejtor'i Shërbimit Hidrometereologjik.* Diskuton në radhë të parë mi rëndësinë e këtij shërbimi në lidhje me një numur të madh problemesh tekniko-ekonomike të jetës moderne siç janë ato të bujqësisë, të blegtorisë, të peshkimit, të luajdrimit detar ose ajror, të ndërtimeve, të bonifikimeve, të energjive hidro-elektrike, të shëndetit të njeriut, etj. Vuri në dukje nevojën e madhe për ta përhapur kuptimin e këtij Shërbimi deri në masat e gjera të popullit me anën e një propagandimi intensiv, për të vëzh

guar mi ndryshimet e fenomeneve të ndryshme - sidomos ndër zona tepër të izoluara ku shkollat ndodhen lark pikave të observacionit.

Gjithashtu theksoi se fusha e veprimtarisë është e gjerë dhe plot me vështirësi, porse përkrahja e organeve të larta drejtonjëse të Partisë e të Pushtetit ka qënë krejt e pa kursyer e kështu puna ka hyrë në rrugën e mbarë. Kur u bë fjalë mi aktivitetin e vitit 1949, rezultoi se me gjithë kohën e ngushtë të punimeve prej 5-6 muajsh, janë korrur relativisht mjaft suksese të cilat munt të përmblidheshin shkurtimisht në sa vijon, duke u kufizuar natyrisht në pikat më kryesore që synojnë sidomos punën në terren.

1. — Në *Hidrometri:* janë krijuar 10 stacione hidrometrike të reja: janë reparuar ose translokuar 10 hidrometra ekzistonjëse, janë themeluar 34 pika fikse të rregullta me kuota relative, janë bërë matje të shpejtësisë së ujrave dhe të profilave të lumenjve për qëllimin e gjetjes së prurjeve përkatëse në 28 vënde të ndryshme, janë ngritur ose janë afruar fazës së përfundimit — nga ana e Komiteteve Ekzekutive përkatëse — ndërtesat për 6 stacione hidrometrike të klasës së parë.

2. — *Në Meteorologji:* janë mëkëmbë 21 stacione pluviometrike të reja duke u stërvitur kujdestarët përkatës; janë kontrolluar, nga 1 deri më 3 herë, 41 stacione pluviometrike duke u dhënë njëkohësisht kujdestarëve përkatës udhëzime teknike plotësonjëse në formë praktike; është plotësuar rrethimi i 26 stacioneve pluviometrike; janë pajisur 4 stacione të klasës së tretë; janë plotësuar 2 stacione të klasës së dytë në Durrës e Gjirokastër; është siguruar lokali i përshtatëshëm për stacionin meteorologjik të Vlorës dhe është bërë instalimi përkatës; është siguruar lokali për stacionin meteorologjik të Kuçovës; janë kontrolluar stacionet e klasit të dytë në Shkodër e Korçë; është pregatitë n'aeroportin e Shkodrës lokali i stacionit të ri duke u reparuar një ndërtesë e vogël e shkatrruar që ndodhej n'atë vënd; është kapur një kurs orientimi për vrejtuësat e stacioneve të klasit të dytë ndër qarqe si edhe për vrejtuësat dhe teknikët ndihmës në stacionin e klasit të parë të Tiranës, në lidhje me organizimin e afërm të shërbimit të Sinoptikës për parashikimin e kohës në vëndin tonë.

Më në fund, duke u marrë me vitin 1950 folësi vuri në dukje se plani i punës së këtij viti është relativisht tepër i ngarkuar - sidomos për punën në terren ku ekipeve do t'u duhet shpesh herë që të punojnë edhe në ditët e' pushimit për të fituar kohë: një mas'e tillë imponohet prej nevojës së domosdoshme për ta plotësuar rrjetin hidrometeorologjik jo më vonë se deri në fund të vitit në udhëtim.

Nga mungesat që duhen plotësuar me urgjencë më të madhe u theksuan veçanërisht dy pika kryesore:

BIBLIOTEKA PUBLIKE
SHKODËR

I.- Çështja e veglave, instrumenteve dhe mjeteve të punës që duhen importuar.- Për këta duhet një nxitje e veçantë mbasi deri më tashti Organet e Ministrisë nuk kanë kontraktuar kurrgjë as nga plani i vitit 1949, as nga ay i vitit 1950. Gjëndja paraqitet mjaft serioze mbasi zhvillimi i punës ka arritur tash në një fazë t'atillë që po të mos sigurohen shpejt disa artikuj të domosdoshëm, atëhere nuk do të justifikoheshin asnjë pjesë e mirë e shpenzimeve të tjera shumë të mëdhaja që bëhen, për këtë shërbim.

II.- Çështja e kuadrove të larta.- Për qëllimet imediate është posaçërisht e nevojëshme që të vijnë dy kuadro të larta nga jasht - mundësisht nga Bashkimi Sovjetik: - një inxhiner meteorolog (Sinoptikant) i specializuar në problemet e parashikimit të kohës, si edhe një inxhiner hidrolog, për një periudhë prej një mot. Gjithashtu u cilësua se, përpara volumit të madh të punës, sektori i hidraulikës në Shërbimin Hidrometeorologjik ndodhet shumë i varfër në personel teknik. e kështu është e nevojëshme që të sigurohet edhe një inxhiner hidraulik vëndas duke u shkëputur nga ndonjë Dikaster tjatër, mbasi fruti që do t'u korrte në këtë mënyrë do të ishte relativisht m'i madh dhe do të vlente për tërë aktivitetet e tjera Shtetnore.

Më së fundi, duke përfunduar diskutimin e tij, folësi vuri veçanërisht në dukje nevojën që të akordohen 5 (pesë) bursa të jashtëme (në Bashkimin Sovjetik) për studime të larta qysh në këtë vit. ashtu siç parashihet në planin që i është shtruar Asamblesë së Përgjithëshme për shqyrtim.

Dr. INJAC NDOJA *Bashkëpunëtor shkencor (Muzeu i Shkencave të natyrës)* — Diskuton mi rëndësinë e kërkimeve gjeologjike në Shqipëri: kuadri gjeologjik i vëndit tonë, pakë a shumë është i njohur në shpërndarjen stratigrafike-litologjike dhe tektonike në përgjithësi. Përfundimisht sot ne kemi një hartë stratigrafike-litologjike me shkallë 1:200.000, një tjetër tektonike 1:400:000 dhe disa të tjera në shkallë të ndryshme si p.sh. ajo e Shqipërisë së Veriut prej Nopcës, e Korcës prej Bourcart, e Vlorës prej Martelli-t si edhe të një numuri të math monografësh natyre gjeologjike, paleontologjike, tektonike e paleogjeografike të disa krahinave me interes shkencore e minerare.

Gjithashtu kemi edhe disa plansheta, të po kësaj natyre në bazën topografike në shkallë 1:50.000, të cilat pasqyrojnë mjaft me saktësi orizontet stratigrafike, sidomos të Shqipërisë së Mesme. Mi bazat teorike të gjeologjisë së Shqipërisë, janë zhvilluar një sëri punimesh me karakter praktik me qëllim që të çfrytëzohen rezervat minerare të nëntokës sonë. Të kësaj natyre janë p.sh. çfrytëzimet e petroleve, të thëngjilloreve e deri diku të bitumeve. Mineralet metalorë përkundrazi janë zbuluar rastësisht prej studjozësh që shoqëronin ushtritë në ko-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

hën e luftës së parë botërore (Austriakë në Veri, Francezë në Jugë dhe Italjanë në krahinën e Vlorës - Mëmaliaj) prej ekipeve topografë dhe prej kërkuësash tjerë privatë dhe pa u studjuar mirë shpërndarja, është filluar çfrytëzimi i tyre.

Përjashtim në këtë rast deri diku, përbëjnë mineralet e bakrit, kalkopiritet për të cilat janë bërë studime me karakter prospektiv, përsa u përket gjenezës, shpërndarjes dhe evolucjonit të tyre.

Për minerale të tjerë, kromë, hekër, grafik, surfull, bauksit etj. studimet minerale me baza shkencore munt të themi se janë vetëm në fazën embrionale.

Pasi bën një analizë të hollë mi gjeologjinë e Shqipërisë shtresave të nëntokës, mënyrat e studimit dhe të çfrytëzimit të tyre duke marrë bazë studimet që kanë bërë të huajt dhe shqiptarët përfundon se puna e deri tashme e repartit të Gjeologjisë të Muzeut të Shkencave të Natyrës ka qënë me karakter më fort zbulonjës se sa rilevonjës. Me fjalë të tjera objektivi i parë i punës sonë, ka qenë gjetja e mineraleve ose e formacioneve litologjike me interes, mbledhja e kampionaturës dhe projektimi ekzakt në hartë i afioramenteve së bashkut me rregjistrim vrejtesh fillestare. Kjo fazë pune, të cilën mundemi ta quajmë fazë gjurmimi, është kaluar. Tani do të hyjmë në fazën e studimeve të vërteta, me objektiva të caktuara në numur e në kohë.

Për t'i arritë më konkretisht këtyre objektivave, lipset një bashkëpunimi i ngushtë me Ministrinë e Industrisë. Instituti i ynë, me Repartin e Gjeologjisë, në shumë raste ka pasë mbetë dorë-jashtë në punime të këtilla, aq më tepër në kërkime. Jam i mendimit që ato pak elementa gjeologë që kemi sot për sot në vëndin tonë, me ndihmën e gjeologëve sovjetikë, duhet të bashkëpunojnë më ngushtë, duke i bërë të punojnë në çdo sektor - secili në degën e tij - për t'i a arritë sa më parë e sa më mirë objektivat ekonomike së cilëve Instituti i ynë duhet t'i kushtojë punën e tij shkencore.

ALEKSANDER XHUVANI *Shef i Seksionit të Gjuhësisë dhe Letërsisë pranë Institutit të Shkencave.*— Diskuton mi aktivitetin e Seksionit të Gjuhësisë, mi punën dhe perspektivat e tij dhe përfundon se gjuha është një krijesë e shoqërisë së njerëzve dhe si e tillë ndiek këmba-këmbës zhvillimin e shoqërisë, duke pësuar ndryshimet e mëdha fonetike, morfologjike, etj. në gojë të popullit. Çdo epokë e historisë së një populli ka dhe fazën e saj në zhvillimin e gjuhës.

Për mi zhvillimin e gjuhës veprojnë faktorë të ndryshëm: gramatikanët, teoricienët, linguistët, shkollat me profesorët e me tekstet e tyre, shtypi me gazetat e të përkohëshmet. Por mi gjithë këta, mi gjuhën veprojnë shkrimtarët e ndryshëm: novelistët, romancierët, poetët, etj. Këta me veprat e tyre i japin gjuhës një zhvillim e drejtim përsëmbari.

Në historinë e çdo populli janë bërë kurdoherë përpjekje për zhvi-

BIBLIOTEKA PUBLIKE SHKODËR MARIN BARLETI

llimin e gjuhës e për pastrimin e saj nga elementët e huaja, që hynë në të pa nevojë të madhe. Në këtë punë marrin pjesë gjithë punonjësit e studimtarët e gjuhës së një populli. Por edhe shtresat e tjera të popullit marrin pjesë në shkrimin e përdorimin e drejtë të gjuhës. Kjo ndodh në Bashkimin Sovjetik.

Këtë shëmbëll duhet të marrim edhe ne duke u përpjekur që për zhvillimin e drejtë dhe për pastrimin e saj të marrin pjesë gjithë masat punonjëse të vëndit.

U diskutua që nga Asambleja të dërgohet një delegat për në Komisionin e zgjedheve në Kuvendin Popullor. Si delegat, mi propozimin e Kol Paparistos, u pranua me unanimitet Z. Aleksandër Xhuvani.

Seanca e parë u mbyll në orën 12,15'.

SEANCA E II-të

17-III-1950 ora 16

Në këtë seancë mungojnë: ZZ. Ing. Gjovalin Gjadri, Dr. Frederik Shiroka, Dr. Fejzi Hoxha, Naum Stralla e Ing. Koço Theodhosi.

Diskutimet vazhdojnë

KOSTAQ CIPO *Anëtar i Institutit, (Komisjoni i Fjalorit Shqip).*— Në diskutimin e tij tha se gramatika e shqipes dilte nga shtypi ato ditë, se tani kish nëpër duar sindaksin dhe kish filluar të gatitë një edicion kritik të veprave të Naimit dhe se po punonte bashkë me tre shokë të tjerë rreth një fjalori shqip.

Ky hov për punë i detyrohet, tha ay, klimës së ngrohtë që u krijua me çlirimin e Shqipërisë. Këto kushte të favorëshme linden nga lufta Nac. Çl., e cila me një Parti të fortë homogjene në krye, dhe e udhëhequr nga një bir i popullit që e kishin kasnecuar shëlbimës të vëndit u mbyll me një fitore të çkëlqyer që habiti botën. Kjo fitore u përshëndet nga malet e fushat e Shqipërisë si mëngjesi më i bukur i Rilindjes sonë. Ay tha se ideja «Shqipëria e Lirë» e ëndëruar nga patriotët, e kënduar nga vjershëtorët dhe e propaganduar nga apostujt e Rilindjes vetëm tani e shohim të veshur me trajta të kjarta e të kthjellta. Vetëm tani filloi të mbrujturit të një shpirti të ri të gatuarit të një karakteri të ri në bazë të mësimeve të pavdekura të ndërtonjësve të socializmit. Gjuha shqipe, që kish pësuar fatin e pëlkurës së Penelopës, bëj e çqep, po bëhet tanï organ qytetërimi për të çfaqur idera të bukura, për të zgjuar ndjenja të holla, për të frymëzuar mendime. Pastaj foli për veprat që e kish ngarkuar Instituti të punojë: 1) *Gramatika.* Kjo është ndarë në fonetikë e morfologji. Fonetika është shtruar e punuar gjer e gjatë dhe

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

e bazuar mbi shqipen e popullit e të folklorit. Morfologjia është plot me pikëpamje të reja dhe me zbulime që hapin rrugën për studime të mëtejëshme; 2) *Sintaksi,* një pëlhurë me krehër të gjerë, ka shumë kapituj të ri që nuk diheshin më parë. Aty janë shtruar aspektet e pjesëvet të ligjeratës dhe për herë të parë bëhet fjalë për *aspektin e verbit shqip* që është një zbulim i vërtetë. Sintaksi mbarohet në Vjeshtë të I-rë ose nga mesi i gushtit; 3) Edicioni kritik i veprave të Naimit; kjo punë ka filluar me *Istorinë e Skënderbeut* që del nga Vjeshta dhe do të vijojë për veprat e tjera; 4) Ay tha se bashkë me tre shokë po punon rreth një fjalori që do të jetë një ndihmë e madhe për shkollat e për zyrat. Është një fjalor që ka një të thurur e një ton të veçantë. Çdo fjalë ka definicionin e saj të punuar e të stilizuar bashkë me shprehjen e frazeologjinë, kur e ka dashur puna. Fjalës i është dhënë kuptimi konkret, kuptimi abstrakt dhe ai i fytyruar kur e ka pasur. Brënda gjën det terminologjia e lëndëve të mësimit dhe ajo e disa Dikastereve. Kemi shtënë aty fjalët e gjuhës letrare dhe ato të gojës popullore qofshin dhe prej origjine së huaj siç janë p.sh. fjalët turqisht të folklorit. Aty do të gjejnë zyrtarët e nxënësit fjalë me kuptim të zgjeruar dhe asosh me kuptim të kufizuar, shprehje të kësaj ose të asaj krahine. Dy - treqint fjalë të fushës politiko-shoqërore do të pajisen me definicione që do të mirren nga fjalorët më të rinj sovjetikë.

Mbi këto baza gramatikore e leksikore do të mbështeten studimet e pastajmë në këtë fushë.-

ZIHNI SAKO *Anëtar i Institutit, (Lidhja e Shkrimtarëve).*— Puna për folklorin tonë, me gjithë që fillimi për mbledhjen e tij është shumë i lashtë, gjer vonë ka qënë më shumë një punë diletante se sa shkencore.

Studjonjësit e huaj, më të shumtën konsuj, ose njerës të dërguar me mision të caktuar politik, materjalin folkloristik që kanë mbledhur e përdorën më shumë për studimin e gjuhës, ose për të rilevuar çështje sensacionale të kohëve primitive akoma në ballkan në shekullin e XIX e XX se sa për të rilevuar vetijat shpirtërore të popullit tonë. Prapa këtyre punëve gjoja prej studjonjësi kanë bërë më shumë punë armiqësore, me qëllim që ta lehtësonin dhe ta legjitimonin okupacionin nënë maskën e qytetëronjësve.

Një karakteristikë tjetër për mbledhjen ka qënë edhe mbledhja e tij në mënyrë okazionale.

Vetëm në kohën e Rilindjes, Thimi Mitko, Spiro Dine, De Rada, Jubani punuan në mënyrë më shkencore. Kështu që puna e tyre nuk mbetet vetëm brënda kuadrit të patriotizmit, po është edhe një punë deri diku shkencore në ndarjen, në mbledhjen e saktë. Ky material ne na shërben shumë sot dhe ne i nderojmë. Me gjithë këtë puna e këtyre nuk është e plotë. «Racconta di una rapsodia albanese» ka nevojë për

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

e bazuar mbi shqipen e popullit e të folklorit. Morfologjia është plot me pikëpamje të reja dhe me zbulime që hapin rrugën për studime të mëtejëshme; 2) *Sintaksi,* një pëlhurë me krehër të gjerë, ka shumë kapituj të ri që nuk diheshin më parë. Aty janë shtruar aspektet e pjesëvet të ligjeratës dhe për herë të parë bëhet fjalë për *aspektin e verbit shqip* që është një zbulim i vërtetë. Sintaksi mbarohet në Vjeshtë të I-rë ose nga mesi i gushtit; 3) Edicioni kritik i veprave të Naimit; kjo punë ka filluar me *Istorinë e Skënderbeut* që del nga Vjeshta dhe do të vijojë për veprat e tjera; 4) Ay tha se bashkë me tre shokë po punon rreth një fjalori që do të jetë një ndihmë e madhe për shkollat e për zyrat. Është një fjalor që ka një të thurur e një ton të veçantë. Çdo fjalë ka definicionin e saj të punuar e të stilizuar bashkë me shprehjen e frazeologjinë, kur e ka dashur puna. Fjalës i është dhënë kuptimi konkret, kuptimi abstrakt dhe ai i fytyruar kur e ka pasur. Brënda gjën det terminologjia e lëndëve të mësimit dhe ajo e disa Dikastereve. Kemi shtënë aty fjalët e gjuhës letrare dhe ato të gojës popullore qofshin dhe prej origjine së huaj siç janë p.sh. fjalët turqisht të folklorit. Aty do të gjejnë zyrtarët e nxënësit fjalë me kuptim të zgjeruar dhe asosh me kuptim të kufizuar, shprehje të kësaj ose të asaj krahine. Dy - treqint fjalë të fushës politiko-shoqërore do të pajisen me definicione që do të mirren nga fjalorët më të rinj sovjetikë.

Mbi këto baza gramatikore e leksikore do të mbështeten studimet e pastajmë në këtë fushë.-

ZIHNI SAKO *Anëtar i Institutit, (Lidhja e Shkrimtarëve).*— Puna për folklorin tonë, me gjithë që fillimi për mbledhjen e tij është shumë i lashtë, gjer vonë ka qënë më shumë një punë diletante se sa shkencore.

Studjonjësit e huaj, më të shumtën konsuj, ose njerës të dërguar me mision të caktuar politik, materjalin folkloristik që kanë mbledhur e përdorën më shumë për studimin e gjuhës, ose për të rilevuar çështje sensacionale të kohëve primitive akoma në ballkan në shekullin e XIX e XX se sa për të rilevuar vetijat shpirtërore të popullit tonë. Prapa këtyre punëve gjoja prej studjonjësi kanë bërë më shumë punë armiqësore, me qëllim që ta lehtësonin dhe ta legjitimonin okupacionin nënë maskën e qytetëronjësve.

Një karakteristikë tjetër për mbledhjen ka qënë edhe mbledhja e tij në mënyrë okazionale.

Vetëm në kohën e Rilindjes, Thimi Mitko, Spiro Dine, De Rada, Jubani punuan në mënyrë më shkencore. Kështu që puna e tyre nuk mbetet vetëm brënda kuadrit të patriotizmit, po është edhe një punë deri diku shkencore në ndarjen, në mbledhjen e saktë. Ky material ne na shërben shumë sot dhe ne i nderojmë. Me gjithë këtë puna e këtyre nuk është e plotë. «Racconta di una rapsodia albanese» ka nevojë për

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

një studim të thellë për të gjetur ku është shtrati popullor, ku është dora e artistit, që mbase ka rënë në influencën e Ossian-it. Po sido që të jetë këto e shumë të tjera, si prallat që ka mbledhur Pedersen-i, disa këngë e pralla të Hahn-it, prallat e Dozon-it studimet e Lambertzit, Jarnikut mbeten një kontribut i vlefshëm për historinë e folklorit shqiptar.

Mirëpo pas 1912 në vënt që puna për folklorin të ngrihej në një kuadër më të gjërë, më sistematik, më shkencor mbeti gjer këtu. Tendenca reaksionare e nënëvleftësimit të vetijave artistike të popullit tonë u bë modë edhe nga njerës të mësuar shqiptarë të kohës së përpara-luftës. Ca mësonjës që punuan me ndërgjegje dhe dashuri për të mbledhur folklorin, s'u kënaqën asnjë herë. Punën e tyre e bënë pré Karl Gurakuqi, Filip Fishta, etj. me botimet e 25 Vjetorit. Z. Sako pasi përmënt fazat nëpër të cilat kaloi studimi i folklorit tha se, vetëm pas çlirimit me ndihmën e Partisë e të Pushtetit popullor iu hoth dora dhe Instituti e zhvilloi si një sektor të veçantë. Por nga mungesa e një eksperience shkencore u çfaq nevoja e një studimi të plotë për shkencën folkloristike. Për të evituar pikëpamjet idealiste në interpretimin e tij u përkthyen artikuj nga folkloristë të dëgjuar sovjetikë si J. Sokolov, Çiçerov, Gipius. Këta artikuj u bënë një mbështetje e madhe për një punë më të thelluar dhe me baza shkencore marksiste. Pasi përmënt punën që po bëhet nga studjonjësit folkloristë shqiptarë dhe kalimi nga format diletante në ato shkencore, tha, edhe se Instituti përveç poezisë ka marrë në studim edhe çështjen e mbledhjes së prallave. Për këtë propozon që për mbledhjen e poezisë dhe të prozës do të ishte mirë sjellja e një aparati manjefon, me të cilin mbledhja bëhet më preçize se sa duke e shkruar me dorë. Kjo do të ndihmojë edhe për folklorin muzikal, që është aq i pasur sa dhe orali.

Ministria e Arsimit e ka futur mësimin e folklorit në shkollat. Kjo është një punë e madhe. Po që të plotësohet akoma më tepër kjo punë e parë mendoj se do të ishte mirë që të futej në librat e këndimit, si domos proza, se nxënësit do të mësojnë të flasin mirë e bukur shqipen që është aq e bukur.

DHIMITER SHUTERIQI.— *Anëtar i Institutit (Udhja e Shkrimtarve)* — Diskuton rreth problemit të bibliografisë dhe doreshkrimeve në gjuhën shqipe. Kam vënë re tha sh. Shuteriqi, se në studimet tona hasim pengesa të mëdha për mungesë të informacionit bibliografik. Disa gjëra mungojnë në Bibliotekat tona, por më tepër na mungojnë informacionet mi tekstet që kanë Bibliotekat. Shtrohet pra nevoja për përpilimin e një bibliografije. Ka njerës që kanë punuar në këtë drejtim, por puna e tyre nuk është e plotë. Bibliografia më e mirë që kemi sot është p.sh. ajo e Legrand-it, po edhe asaj i mungojnë shumë gjëra. Legrand-i gjer më 1866 shënon tridhjet e ca libra mi letërsinë

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

shqipe, kurse janë vetëm pesëdhjetegjashtë tekste. Legrand-i si bibliofil ka të meta të mëdha, i mungojnë vepra si të Varibobës, etj. Nuk po zë në gojë botimet e tjera se këto janë të dobëta. Ne kemi mundësira të mëdha të merremi mi këtë çështje. Biblioteka Kombëtare si edhe ato të krahinave janë shumë të pasura. Sh. Shuteriqi mendon të krijohet një bibliografi shqipe jo e përgjithëshme po duke u nisur nga monografira speciale si p.sh. duke u marrë me studimin e florës të krijohet për te një bibliografi etj. Ay propozon që pranë Institutit të këtë një zyrë që të merret me drejtimin e kësaj pune.

Duke folur mbi dorëshkrimet e shqipes shoku Shuteriqi tha se përpjekja e popullit për të shkruar gjuhën shqipe në të kaluarën është mjaft e madhe. Gjer më 1830 ka pasë dyfish vepra të shkrojtura nga ato që njohim. Mbledhja e tyre është e zorshme; por ne munt të bëjmë një punë të madhe me anë të Legatave tona jashtë Shtetit. Ne duhet t'u japim indicet. Kjo punë është me rëndësi të madhe, sepse mbledhja e këtyre teksteve do të hithte dritë mi historinë tonë. P.sh., gjetja e Anonimit na vë në një rrugë të re: rëxon mendimin se Akademia e Voskopojës ka qënë qendra e aktivitetit kultural të Shqipërisë. Pra janë bërë përpjekje që të shkruhet shqipja me një alfabet të veçantë.

Duke bërë fjalë për inciativën e Institutit për të ribdtuar të komentuar Historinë e Skënderbeut, ay është i mendimit që Instituti, duke filluar nga fundi i këtij viti, të interesohet edhe për botimin e disa veprave që kanë mbetur vetëm në dorëshkrim, siç është ajo e Kristo foridhit p.sh. i cili ka studjuar fjalët turqishte në shqipe, italishte, etj.

ALEKS BUDA. *Shef i Seksionit të Historisë, Sociologjisë dhe Ekonomisë pranë Institutit të Shkencave.* Diskuton mbi problemet e historisë dhe tha se problemi kryesor i Seksionit të Historisë është hartimi i historisë së popullit tonë, i cili është një popull me një histori të shkëlqyer por pa një histori të shkruar. Kjo mungesë e historisë ndihet mbasi mungon plotësisht një vepër, sado e thjeshtë edhe pa preteza, mjaft që të përmbledhë materjalin ekzistonjës. Aqë më e madhe bëhet mungesa kur kërkojmë nga një histori jo vetëm materjal por edhe renditjen shkencore të tij.

Në fillim të këtij shekulli u dukën disa histori të Shqipërisë si të Tef Curanit, Nikajt, dhe më vonë ajo e Gekrezit; po këto janë vepra fare primitive mbasi u mungon njohja e materjalit dhe nga ana tjetër nuk janë në gjëndje të zbërthejnë nyjet e historisë sonë. Zbërthimi i tyre donte një dorë të shëndoshë që ata nuk e kishin, aqë më tepër kur në veprat e tyre pasqyrohen influenca të ndryshme antipopulloca të parregullta në shumë pika në kundërshtim me parimet shkencore. Broshura e Jorgës me gjithëse kish qëllime të ndihmojë përpjekjet shqipëtare për të siguruar lirinë, është fare e dobët dhe e pakënaqësh-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

me. Nuk flasim këtu për veprat e Gianninit dhe Swires që janë njerëz të imperializmit italian dhe anglez. Përgjithësisht veprat e gjertanishme mi historinë e Shqipërisë, e veçanërisht ato mi fazën e re, nuk njohin aspak materjalin dhe metoda e tyre është e historiografisë borgeze, prandaj edhe rezultati është fals. Neve i caktuam vehtes si periodë historike për të trajtuar, fazën që shkon prej 1878 gjer në 1939 se për këtë fazë materjali është pak a shumë në dorën tonë, bile mund të themi se historia e kësaj faze ose do të shkruhet me materjalin që gjindet në Shqipëri ose nuk mund të shkruhet fare. Po me gjith'atë mbledhja e materjalit burimor për këtë fazë nuk është problem aq i lehtë. Nga botimet e huaja dhe shqipëtare ne kemi nxjerrë një sasi të madhe aktesh dhe dokumentash, kemi çfrytëzuar botimet e dokumentave diplomatike të qeverive të ndryshme, si të qeverisë austro-hungare, gjermane, angleze, austriake, sërbe, botimin e akteve të qeverisë cariste që bëri qeverija sovietike, dhe kemi arritur në një materjal mijra e mijra faqesh, siç nuk e ka pasë si bazë gjer tani as një punim historik mbi Shqipërinë. Po me gjithatë nuk mund të themi se e kemi materjalin të tërë. Një pjesë e madhe është e pabotuar nëpër arkivat e qeverive të ndryshme të huaja që kanë pasë interesa në Shqipëri, dhe që duhen çfrytëzuar me doemos. Vjet kemi marrë nga Bashkimi Sovietik 700 dokumenta mi kryengritjet shqipëtare 1910-1912. Për fazën e Rilindjes dhe të jetës shtetërore materjali gjëndet në vënd, pjesërisht n'Arkivin tonë, po pjesa më e madhe e shpërndarë nëpër dikastere të ndryshme. Këtij materjali i mungon renditja në mënyrë që të gjindet e të çfrytëzohet lehtë. Këtu është një nga detyrat e mëdhaja të Arkivit tonë, themelimi i të cilit është një hap i math në drejtimin e pregatitjes së hartimit të historisë. Po akoma nuk mund të themi se këtë punë e ka zgjidhur. Po gjithë ky materjal nuk mjafton akoma. Vetëm duke aplikuar metodën marksiste-leniniste, fushë në të cilën neve jemi akoma të rinj dhe duhet të mësojmë shumë pas shëmbullës së shkencës sovietike, ne do të jemi në gjëndje të japim më tepër se një renditje kronologjike ose një skelet të ngjarjeve, do të jemi në gjëndje të japim kuadrin real të jetës së popullit tonë në këtë fazë. Prandaj duhen studjuar në mënyrë të saktë raportet e prones e të prodhimit, duhet studjuar zhvillimi i forcave prodhonjëse në vendin tonë. Prandaj është vënë në plan një seri monografish që do të shërbejnë si bazë për hartimin e historisë: si historiku i industrisë, i zanateve, i klasës sonë punëtore, i fshatarësisë, i financavet, taksave, buxheteve shtetërore, i tregëtisë së jashtëme dhe të brendëshme, i rrugave etj. Jemi të sigurtë se puna jonë do të këtë të meta, prandaj ne kemi menduar që skicën që do të hartojmë, t'ia dërgojmë Akademisë së Shkencave të Bashkimit Sovietik (Institutit të Historisë) dhe jemi të sigurtë se prej tyre do të kemi sugjerime dhe këshilla të vlefshme. Gjer tani e kanë punuar historinë e Shqipërisë të huaj, pa marrë parasysh e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

pa pyetur popullin shqiptar. Vetëm sot, në saje të Pushtetit Popullor, për herë të parë po shtrohet si problem studimi i historisë së Shqipërisë në baza me të vërtetë shkencore.

ZEF MALA — *Drejtor i Arkivit të Shtetit* — Diskuton mi aktivitetin e Arkivit të Shtetit dhe mbi qëllimin që synon të arrijë ky Arkiv. Ay tha se një nga realizimet më me rëndësi të Institutit të Shkencave gjatë vitit 1949 ka qënë pa dyshim edhe krijimi i Arkivit të Shtetit si Drejtori më vehte, themelimi i të cilit do të vlejë shumë për përpilimin e Historisë së Shqipërisë. Ay vuri në dukje se gjatë regjimeve të më parëshme nuk i është dhënë rëndësija e duhur punës kulturale në përgjithësi, dhe veçanërisht grumbullimit, ruajtjes e mirëmbajtjes së dokumentave që kanë të bëjnë me historinë tonë kombëtare. Gjatë sundimit të Zogut dhe gjatë pushtimit fashist nuk ka ekzistuar një Arkiv shteti dhe ruajtja e materialit arkivist u ishte lënë në mëshirën e çdo dikasteri ose enti ku, shpesh herë, nga çkujdesija e nëpunësve të paaftë e të papërgjegjshëm, materialet e ndryshme dokumentare kanë pësuar humbje e keqpërdorime. Sidomos periudha e parë e jetës sonë si shtet, në pikëpamje dokumentare, ka pësuar shumë dëmtime sepse nga një anë ka munguar zelli e kujdesi për mbledhjen e ruajtjen e dokumentave që ilustrojnë këtë periodë, nga ana tjetër shumë persona të ngatruar me ngjarjet famëkeqe kanë qenë të interesuar të injorojnë ose dhe të çdukin arkiva e dokumenta. Pastaj tha se një pjesë e madhe e materjalit sot ndodhet i shpërndarë nëpër arkivat e huaja sepse sikundër dihet vëndi ynë për shekuj me radhë ka qënë i pushtuar nga sllavët, venecianët e turqit dhe i lidhur administrativisht me kryeqendrat e këtyre shteteve. Kështu që burimet për historinë e Shqipërisë duhen kërkuar edhe nër arkivat e Stambollit, të Venetikut, të Raguzës, etj. Pastaj përmëndi punën që po bëhet në Arkivën e Shtetit për rregullimin dhe sistemimin e materialit që është grumbulluar. Gjithashtu Arkivi i Shtetit do të grumbullojë të gjithë materialin që sot ndodhet i shpërndarë nëpër dikasteret e ndryshme, nëpër krahina si edhe do të blejë materjale dhe dokumenta që ilasin mbi Shqipërinë e që kanë një interes për historinë tonë, nga persona të ndryshëm privatë. Gjer më sot në Arkivin e Shtetit janë mbledhë e punuar rreth 30.000 dokumentave.

ANDREA NATHANAILI. — *Antar i Institutit, (Kryetar i Gjykatës së Lartë)* — Vuri në dukje kontributin e pakët që kanë dhënë juristët anëtarë e bashkëpunëtorë të Institutit gjatë vitit që shkoi. Puna jonë, tha sh. Nathanaili, ka konsistuar në terminologjinë juridike si edhe në disa artikuj. Kontributi i juristëve për vitin 1950 do të jetë më i math. Sipas projekt-planit të Seksionit të Historisë, pranë këtij Seksioni do të krijohet një komision juridik i cili do të merret me studimin e statu-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

teve e tema të tjera që kanë lidhje me jurisprudencën. Kemi mungesa dokumentash dhe kjo u a vështirëson juristëve punën për të studjuar tekstet juridike mbi bazat e shkencës marksiste. Shkenca sovjetike është shumë e pasur në studimin e këtyre problemeve sipas marksizmë-leninizmit. Kjo shkencë për juristët tanë është e zorshme sepse këta studimet e tyre i kanë bërë në shtetet kapitaliste dhe për këtë ju mungon teorija materialiste; gjithashtu na mungojnë përkthime nga rusishtja; por me gjithë këtë ne do të përpiqemi dhe do t'i përvishemi kësaj pune në mënyrë që kjo të dalë si duhet. Ne duhet të kemi sa më parë të përkthyer «Teorinë e Shtetit e të së Drejtës» që është hyrja në këtë shkencë. Nga koncepti i kësaj vepre shumica e juristëve tanë janë profanë. Kjo do t'i vlejë historisë, gazetarisë dhe gjithë njerëzve të kulturës. Një propozim të përkthimit të kësaj vepre e kam ngritë edhe në vitin e kaluar dhe unë sot e përsëris. Sh. Nathanaili vuri në dukje rëndësinë e madhe që ka mbledhja edhe studimi i së drejtës zakonore, e cila do t'i ndihmonte punës për historinë tonë. Ay propozoi që simvjet të përpilohet një kestionar për mbledhjen e këtij materjali me anë të juristëve dhe me anë të njerëzve të tjerë.

Dr. HAMDI SULÇEBEGU, *mjek* — Duke folur mbi studimit që ka ndërmarrë Instituti në lëmin e mjekësisë Dr. Sulçebegu tha se këto nuk janë shkencë e thjeshtë po studime që do të konstatojnë gjëndjen, shëndetin, plagët e popullit, faktorët që kanë shkaktuar këto plagë, masat që duhen marrë për t'u bërë ballë etj. Kërkimet në këtë fushë bëhen në një tokë krejt të djertë; do të ishte gabim po të kujtojshim se këto studime munt të kryhen vetëm nga mjekët. Këtu duhet dhe munt të kontribuojë i gjithë populli: që nga historiani që di epidemitë që kanë rënë e gjer tek mësuësi e plaku i fshatit që di se si ushqehet populli dhe sëmundjet që i kanë rënë këtij. Duhet të studjohen bestytnitë. Fëmijëve në Shqipëri gjatë motit të parë nuk ja presin thonjt, sepse thonë se del hajdut! Një pjesë e fëmijëve vdesin nga ushqimi i papërshtatshëm, nga enë jo të pastërta, nga frika e madhe prej të ftoftit ose të nxehtit, etj. Këto duhet t'i zbulojë ai që i ka parë.

Përpara nesh kemi një tokë virgjine. Në vëndin tonë kemi edhe një lloj mjekësie popullore: p.sh. janë bërë operacione bile mjaft të rënda. Në një fshat të Përmetit bëheshin operacione të syrit, nxirshin gurin nga mëshikëza, etj.

Në punën tonë do të kemi parasysh sëmundjet, ushqimin etj. Unë apeloj jo vetëm në mjekët por në të gjithë që nga historiani e gjer tek mësuësi më i largët i vëndit tonë që të kontribuojnë në të gjitha fuqitë e mundësitë e tyre për të mirën dhe dobinë e shëndetit të popullit.

*

Për përpilimin e rezolucionit, Sekretari i Presidiumit, propozon

BIBLIOTEKA PUBLIKE SHKOLLORE "NAIM BERATI" KORÇË

një komisjon të përbërë prej zz. Aleks Buda, Sotir Angjeli e Dhimitër Shuteriqi — i cili u pranua me unanimitet.

Seanca e dytë mbyllet.

SEANCA E III-të

18-III-1950 ora 9.15

Në seancën e tretë mungojnë zz. Ing. Gjovalin Gjadri, Dr. Frederik Shiroka, Dr. Fejzi Hoxha, Naum Stralla, Ing. Koço Theodhosi.

Vazhdojnë diskutimet

HASAN CEKA *Anëtar i Institutit, (Muzeu Arkeologjik-Etnografik.* — Në planin e sivjetshëm të gërmimeve arkeologjike janë paraparë, sikundër dihet, gërmime me një stil më të gjërë se vitet e kaluara, kështu në Durrës, Apoloni (Pojani i Fierit) dhe sondazhe në Pllogë të Vlorës (Amantia antike). Nga këto qëndra antike, dy të parat kanë qënë kolonizuar nga Helenët dhe Romanët. S'ka dyshim se në këto gërmime e sondazhe do të zbulojmë skulpëtura e monumente me vleftë artistike e historike që do të na ndriçojnë mi të kaluarën e tyre, mi zhvillimin artistik e shoqëror, mi strukturën administrative, politike e kulturale me të cilat do të pasurojmë sallat e vitrinat e Muzeut tonë. Po ta marrim çështjen nga pikëpamja jonë nacionale do të shohim se kjo kulturë materiale që nxjerrim nga këto gërmime nuk është e jona, — është e huaj, e importuar dhe nuk ka shumë ndryshim nga ato të sënjëjtës epokë e kulturë të zbuluara në Bullgari, Greqi, Itali, Krime, etj. Krahas me këto duhet të zhvillohen kërkime dhe gërmime edhe në sektorin prehistorik, sektor ky që nga pikëpamja nacionale ka shumë më tepër rëndësi për neve, sepse është e lidhur me kulturën e popullsisë autoktone dhe me atë të Ilirëve, të cilët i konsiderojmë si stërgjyshërit tanë. Duhet pohuar se në këtë lëmë s'është bërë asgjë deri më sot, as një kërkim seriöz, as prej të huajve as edhe prej nesh vetë. Për të gjitha zbulimet e deri-tashme prehistorike që janë bërë në vise të ndryshme të Shqipërisë i detyrohen zbulimeve të rastit. Diskutuësi pasi përmënt periodat prehistorike duke nisur që nga koha e neolitikut e gurit të punuar e tëhu, më të cilat dëshmohen zbulimet e bëra në thellësitë e vëndeve tona malore, etj., vë në dijeni edhe një zbulim të ri të bërë këto kohët e fundit. Nër monedhat e bronxit që u gjetën vetëm në tre eksemplare tri pare, që kanë një legjendë, një emër qyteti krejt të pa njohur në literaturën numismatike. Gjer tani dihesin se kanë patur pare vetëm qytetet antike si Durrësi e Apollonija, monedhat e të cilëve gjënden në krejt gadishullin e Ballkanit gjer thellë në Rumani , Shkodër, Lesh (Lissus i vjetër), Oricum (Pasha Liman në fushën e Dukatit të Vlo-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

rës), Byllis (Hekali), Amantia (Plloça), Phoinike (Finiqi) dhe Butrinti, por për një qytet Olympas, siç rezulton nga paret e zbuluara, nuk kemi patur dijeni. Një qytet Olympas në Iliri e përmënt vetëm Stefan Ribantini, që e ka marrë nga historiani i pa njohur i kohës romane Domitius Kalistratus. Paret e gjetura na vënë tashi përpara pyetjes se ku gjëndet ky qytet. Stili i pareve rrëfen shekullin e II-të p. erës së re dhe simbolet e përdorura në 'të tregojnë se duhet ta kërkojmë në një vënt brënda zonave të influencës epirote dhe apollonje, sepse përmban po ato simbole të përdorura prej këtyre dy qëndrave. Dy janë gërmadhat që munt të identifikohen e munt të vihen në konsideracion, për të lokalizuar Olympën e pareve tona: o Margëlliçi, ose Matohasanaj në malësitë e Tepelenës. Duke qënë se kufiri ndërmjet Ilirisë dhe Epirit është rregullisht Vijosa dhe Matohasanaj është përtej lumit, kujtoj më tepër se do të jetë Margëlliçi. Me gjithë këtë fjalën e fundit e kanë gjithmonë gërmimet që munt të nxjerrin në dritë ndonjë mishkrim.

PETRAQ PEPPO. *Anëtar i Institutit (Profesor në Institutin Pedagogjik).*— Plani i Seksionit të Historisë dhe Sociologjisë, këtë vit është mjaft i pasur dhe i zgjedhur mirë; puna kryesore e këtij plani del në pregatitjen e Historisë së Shqipërisë, me fazën e saj të re. Shqipëria konsiderohej si një shprehje gjeografike, si një vënt me një popull pa histori, kështu L. Jaray boton një vepër «L'Albanie inconnue» dhe një tjetër boton veprën «Albanien, Vergessenes Land»; por sot puna ndryshon, Shqipëria po ngrë socializmin dhe në arenën ndërkombëtare lot rolin e saj si një shtet i vogël po i fortë. Përsa i përket grumbullimit dhe mbledhjes së materialit për Historinë e Shqipërisë dhe të popullit shqiptar e shof të nevojëshme të mblidhen e të studjohen testamentet e ndryshme të dhuronjësve për vepra kombëtare e kulturale. Ay përmënt disa nga testamentet që plotësojnë lëndën e periodës historike të zgjimit kombëtar, si p.sh. ato të Josif Banga, Anastas dhe Dhimitër Lakçe, Dhimitër Çiçko, Vëllezërit Duro, Gjergj Doko si edhe atë të Grigor Nukos që la 2000 lira të Misirit për të paguar mësonjës të gjuhës shqipe në shkollat greke të asaj kohe, si edhe testamenti i Thimi Brandit a Thimi Kapedanit që la 600 lira engleze për t'i ngritur një monument Skënderbeut. Rëndësi të madhe kanë tha sh. Peppo edhe kodiket e fshatrave; atje vështrojmë vuajtjet e fshatarësisë, shtypjen e tyre nënë bejlerët, më vonë nënë sulltanin dhe më në funt gjejmë shpjegime të mjaftë, kur si këto katunde e kanë blerë të drejtën e tokës së tyre nga Sulltan Hamiti. Sh. Peppo vuri në dukje se Instituti nuk ka vënë në plan një studim mi zhvillimin e artit Bizantin në Shqipëri. Për këtë ay propozon që një studim i tillë të vihet në planin e Institutit për vitin 1950, mbasi ka rëndësi të madhe për historinë e zhvillimit të kulturës në vëndin tonë. Shoku Peppo shtroi gjithashtu çështjen e ndihmës që duhet t'i japi Instituti i Shkencavet Ministrisë së

BIBLIOTEKA PUBLIKE NARODNA BIBLIOTEKA SHKODËR

Arësimit përsa i përket përpilimit të teksteve shkollore dhe organizimit të ekspeditave me qëllim që të ndihmohen kuadrot studjonjëse të Ministrisë në punimet e tyre origjinale. Për këto sh. Pepo propozoi që në mbledhjet e Seksioneve të Institutit për hartimin e planeve të ftohen për të bërë sugjerime edhe përfaqësonjës të Min. Arsimit

SHEFQET MUSARAJ. *Anëtar i Institutit, President i Lidhjes së Shkrimtarëve* — Kjo është një histori e vjetër që ka pasë filluar kohë më parë me anë të disa komisioneve por deri më sot nuk është bërë asgjë. E vërteta është se do të ndeshej në pengesa deri sa nuk kemi pasur një histori të Shqipërisë. Për vitin 1950 do të grumbullohet materiali për fazat e letërsisë sonë. Rreth këtyre do të punojnë edhe shokë të tjerë; më parë do të bëhet bibliografija e më vonë tezat. Një farë pune është bërë gjatë kësaj kohe, jubileu i rilindasve do ta pasurojë edhe më tepër. Sot është rasti të kontribuojmë në këtë fushë se është mjaft me rëndësi. Shoku Musaraj diskutoi gjithashtu mbi dy çështje të tjera: 1) Shkenca duhet të ndihmojë në ngritjen e ekonomisë; 2) Ç'bën kolektivi për edukimin e tij ideologjik. Kam parasysh një vizitë që bëra në Akademinë Timiriazef, atje më ra në sy se si ekonomija kolektive i kërkon Akademisë të marë në studim dhe të zgjidhë probleme që e ndihmojnë atë për realizimin e planit. Akademija ato që mundet i studjon dhe për këtë punë merr edhe njerës që s'dinë teori por kanë eksperiencë. Praktika është kriteri i së vërtetës. Dënohen njerëzit që janë të mbyllur: Gjithashtu bëhet edhe autokritika me anën e së cilës korigjohen bile edhe konservatorët. P.sh. Akademiku Zhukovski, kishte pasë ndjekur teorinë idealiste në biologji. Gjatë vitit 1949 ay e bëri rishtazi botanikën e tij dhe kjo është botanika më e mira. Pa eksperiencën sovjetike nuk bëjmë dot. Ç'kemi bërë ne për ngritjen ideologjike? Po të na dëgjonte njeri këtu brënda do të çuditej për kordim pikëpamjesh. Ne s'jemi të çveshur nga influenca e shkollës sonë Ka në mes nesh që nuk dinë origjinën e gjuhëvet, nuk njohin Marrin, nuk e kanë të kjartë dallimin e demokracisë popullore nga ajo e demokracisë së Platonit. Ne duhet të jemi në luftë me pikëpamjet e së kaluarës. Partia dhe Komandanti na japin çdo ndihmë, prandaj na duhet të bëjmë çmos që ta meritojmë konsideratën që ata kanë për neve.

ZIAUDIN KODRA. *Bashkëpuntor shkencor (Drejtor i Shkollës Pedagogjike Tiranë-* — Diskuton mbi shtojcën e planit të vitit 1950, vecanërisht mi atë të historisë së letërsisë shqipe. Gjer tani mbi këtë çështje kanë punuar vetëm të huaj dhe shqiptarë të bazuar në të huaj. Historia e letërsisë e Petrottës, ka rëndësi kronologjike, si dokumentar (histori e romancueme e letërsisë sonë). Shkrimtarët janë të çkëputur, s'ka lidhje me konditat e shkaqet ekonomike në shoqëri. Këtë Petrotta s'munt ta thoshte se qe prift; por ne duhet t'ia themi populli.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Njerëzit që do të merren me këtë punë duhet të kenë parasyshë kohën, shkaqet, konditat, etj.

Letërsia arbëreshe të mos merret e çkëputur nga ajo e Shqipërisë. Ka shkrimtarë të sinqertë, lëvizje të sinqerta, të përfaqësuar nga De Rada. Petrotta nuk i thotë këto. Buzuku ka lidhje me Matrangën, shkrimtar fetar, dhe Naimi me De Radën, shrimtar kombëtar. E gjithë letërsia popullore arbëreshe dhe ajo artistike, si figurë centrale kanë atë të Skënderbeut, p.sh. «Kenka e sprasme e Balles». Në letërsinë shqiptare vetëm Naimi e përmënt Skënderbeun, kurse në këngët arbëreshe popullore kemi një cikël të tërë. Ajo e Darës e pabarazuar ka epopenë e Skënderbeut. Pra letërsia arbëreshe nuk do të merret e çkëputur. Flamuri i arbërit gjen anonime edhe atje. Me gëzim e pret De Rada çeljen e shkollës shqipe në Korçë.

Edhe diçka tjetër: Kristoforidhin e njifshin fare pak, vetëm si letrar dhe jo në politikë. Propozoj që në Buletin të botohen dokumentat ndriçuëse.

Dr. Ing. GAQO TASHKO. *Anëtar i Institutit (Ministër i Bujqësisë dhe Pyjeve.* — Instituti i Shkencave paraqitet me një plan pune të pasur. Dje na u vunë në dukje perspektivat për suksese në të arthmen. Këto janë bërë e po bëhen me mjete, forca kuadro modeste aqë sa edhe të huajt çuditen. Konkluzioni është ky: në vëndin tonë është krijuar një atmosferë pune që na shtyn në çdo lëmë të aktivitetit, për punë që në kohët e errëta të Zogut s'munt të mendohej fare. Në radhët e nëpunësave të asaj kohe përhapesh me qëllim të caktuar parulla dekurajonjëse «mos puno se do pushohesh» dhe ajo pak punë që bëhej vihej në shërbim të luftës kundër popullit. Ajo që na jep kurajo që të bëjmë këto punë që shohim në planin e Institutit të Shkencave është besimi në të arthmen tonë, sigurija për forcën tonë të Kampit ku jemi radhitur, vendosmërija, shëmbulli i Bashkimit Sovjetik. Në këtë vit aktiviteti i Institutit po pasurohet me një Seksion të ri: me Seksionin e Bujqësisë. Në ekonominë tonë bujqësija zë një vënd të rëndësishëm. Bujqësija jonë ka nevojë që të përparojë , ajo duhet të vihet në bazat e shkencës marksiste. Puna që është bërë në bujqësi është fare e paktë dhe njerëzit që merren me' të nuk kanë qënë në gjëndje të bëjnë një punë të madhe. Këto kohët e fundit është bërë një riorganizim i Stacionit të kërkimeve bujqësore; në krye të këtij stacioni është vënë një i ri që ka studjuar në Bashkimin Sovjetik, agronom A. Deliu. Gjer tashi është punuar në kampin praktik, por me krijimin e këtij Seksioni, sigurisht që punët do të bëhen më mirë. Nuk duhet të anojmë sot vetëm në anën teorike. Duhet që teorija të kombinohet me praktikën. Si detyrë e rëndësishme e Seksionit të Bujqësisë do të jetë ajo e studimit të eksperiencës Sovjetike dhe të vënies në zbatim për bujqësinë tonë. Të kombinohet puna e Stacionit. Praktikisht duhet menduar

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

edhe përdorimi i përbashkët i disa specialistëve që duhet të punojnë në të dy anët; kjo shtrohet për të gjithë nëpunësit e dikastereve. Për Institutin është një punë e rëndësishme formimi i Komisionit kundër Thatësirës dhe Erozionit funksionimi i të cilit është i domosdoshëm sepse vit për vit rezikohet pakësimi i prodhimeve tona. Kjo është një punë e madhe dhe e gjatë, por ne duhet t'i bëjmë rezultatet e këtij komisioni sa më të shpejta në bazë të eksperjencës të B.S. Të plotësojmë të metat duke çfrytëzuar ato që di populli. Ne duhet të dijmë t'i kërkojmë këto, sepse populli i ynë i njeh efektet e dëmëshme të erërave të Jugut, di drejtimin e tyre. Bashkimi Sovjetik në këtë punë na jep një lehtësi të madhe. Në B.S. u bë realitet lufta kundër thatësirës. Mbas studimeve që janë bërë gjatë kohëve të fundit është konstatuar se me anë të brezave pyjore shtohet prodhimi bujqësor.

Komisionet teknologjike kanë një rëndësi të madhe për pakësimin e importimeve. Ne duhet të bëjmë vetë shumë materjale, që në të kaluarën i sillnim nga jashtë. Duhet të vihet në dukje se sa rëndësi ka puna e Institutit për jetën tonë ekonomike. Duhet të bëhet një propagandë më e madhe për punën që bën Instituti. Që të plotësojmë detyrat tona, duhet të kemi preokupacionin që studimet tona të lidhen me praktikën. Fjala e Stalinit duhet të na qëndrojë parasyshë: «Shkenca e vërtetë është ajo që s'ndahet nga praktika». Në studimin e bimëve industriale u pa se sa rëndësi ka kjo punë për ekonominë tonë. Që të bëhet shkenca pararojë duhet të bashkëpunojmë me popullin.

Përsa i përket formës praktike të krijimit të rretheve shkencore, mjerisht kjo ka mbetur formale dhe ne na bije të mendojmë se si duhet t'i aktivizojmë këto rrethe.

Bëhen 10 minuta pushim.

ING. SHINASI DRAGOTI. — *Anëtar i Institutit, N/ Ministër i P. Bo-tore.* — Diskuton mi probleme hidraulike. Çështja e sistemimit të hidraulikës në përgjithësi ka një rëndësi të madhe. Sistemimet malore, erozione, hidraulike, etj. janë një kompleks me rëndësi. Duhen mbledhë elementet prë ngritjen e barrazheve për hidrocentral. Një problem aktual është edhe çështja e bonifikimeve. Këtu janë dy probleme: 1) mbledhja e elementave, 2) sugjerimet që duhet të bëjmë. Pushtetit, popullit për dëmet kolosale që bëjnë lumejtë tanë. Komisioni munt të propozojë masat që duhet marrë për ndalimin e tyre. Duhen koordinuar planet e komisionit të hidraulikës me atë të meteorologjisë. Çështja e barazhit të Erzenit dhe Devollit duhet të merret në shqyrtim.

Projekt plani i Institutit të Shkencave parashtron ngritjen e Laboratorit të Shtetit. Ky do të na japë një ndihmë të madhe për ekonominë tonë, sepse ky është autoriteti më i lartë që jep të dhënat ekzakte mbi materjalet; ay do të japë ndihmë të madhe edhe për institucjonet e tjerë. Ekonomitë tona parashtrojnë disa probleme që nuk fi-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

gurojnë në planin e Institutit. Në qendrat e punës bëhen përpjekje të mëdha që me punën e teknikëve të arrihen përfundime të çkëlqyera; amoniaku p.sh. mungon dhe asnjeri nuk e çoi mëndjen në zëvëndësimin e tij, ndërsa teknikët vrasin mëndjen dhe bëjnë shumë prova për ta pregatitur, kurse këtë një farmacist munt ta bënte menjëherë. Për çështjen e gomës punëtorët gjejnë vështirësi, ata përpiqen por nuk arrijnë zgjidhjen; kurse me anë të teknikëve kjo punë munt të bëhesh fare mirë. Funksionimi i rretheve shkencore ka një rëndësi mjaft të madhe dhe që këto rrethe të japin një ndihmë efikase duhet të zgjerohen me elemente të rinj.

Seanca e tretë mbyllet.

SEANCA E IV-të

18-III-1950 ora 16

Në seancën e katërtë mungojnë zz. Dr. Frederik Shiroka, Dr. Fejzi Hoxha, Naum Stralla e ingj. Koço Theodhosi.

Diskutimet vijojnë:

ING. SPIRO KOLEKA. *Anëtar i Institutit, President i Komisionit të Planit të Shtetit. Në* diskutimin e tij bën kritikën e punës dhe autokritikën. Nga referatet e Kol Paparistos, Sotir Angjelit etj, ne shohim, tha shoku Spiro Koleka, se Instituti i Shkencave ka korrur një seri suksesesh. Sukseset më të mëdha janë në Seksionin e Letërsisë. Kjo lidhet edhe me traditat tona; kemi p.sh. shokun Xhuvani, Cipon, etj. që janë marrë me letërsinë shqipe. Pastaj vetë populli ka punuar në këtë drejtim. Edhe në Seksionin e Historisë kemi bërë mjaft. Më të dobët si përparim jemi në shkencat e natyrës. Këtu duhet të prekupohemi një çik më tepër. Komisioneve iu bë një kritikë me vënt. Kjo është e vërtetë. Unë vetë nuk kam dhënë aq sa duhet gjatë 1949. Kjo s'është e mirë aspak për mua. Duhet të bëjmë një autokritikë. Edhe Komisioni i Mjeksisë Sociale kështu ka vepruar. Kjo s'do të thotë se s'është bërë asgjë, por plani nuk është realizuar. Duhet të parashikojmë më mirë mundësitë tona që të bëjmë plane reale. Në sektorë të tjerë vihet re se puna ka shkuar mirë. Komisioni i Hidraulikës dhe ay i Mjeksisë duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha. Hartimi i planit është pjesa më e vogël siç e thotë Stalini. Ajo që ka rëndësi është realizimi i tij. Duhet të diskutojmë dhe të kritikojmë. Të kritikohet Komisioni i Planit se nuk e ka pajisur Institutin e Shkencave me mjetet e nevojëshme, por duhet të kritikohet edhe Instituti i Shkencave se nuk e ka ndjekur çështjen aq sa duhet. Rëndësija e

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BERATLIU" SHKODËR

Asamblesë qëndron në aprovimin e planit të vitit 1950. Ne duhet të mendojmë punën, kohën, etj. që ky plan të realizohet. Duhet të kritikojmë Asamblenë se nuk është mbledhur në kohën e duhur. Ka dy vjet që mbledhja nuk u bë, kurse duhesh të bëhesh të paktën brënda një viti ose munt të bëhej edhe dy herë në vit për të kontrolluar punën. Në këtë plan që po na paraqitet shohim se puna e Institutit të Shkencave sa po vete po shtohet. Janë krijuar kaq seksione, po krijohet edhe një seksion i ri: ay i Bujqësisë, etj. Plani i 1950 është më i math se ay i 1949, prandaj duhet të preokupohemi më tepër.

Mi planin kam disa vrejtje të përgjithëshme: shoh disa problema që nuk kanë interes imediat për ekonominë. Këto janë p.sh. probleme që ka marrë për studim Ing. Gjadri, Këlliçi, Noçka si teorija mi aplikacionin për ndërtimin me beton të uravet. Sot për sot këto studime nuk lidhen me nevojat imediate. Ajo e Dragotit është me vënt. Problemet që lidhen me nevojat tona kanë një rëndësi të madhe, kurse ato që lidhen me perspektivat tona nuk munt të themi se sot për sot janë shumë të rëndësishme. Nuk duhet të zgjidhen probleme që duam ne, por ato që i nevojiten imediatisht ekonomisë sonë. Në planin e Seksionit të Historisë një monografi mi lëvizjen e Haxhi Qamilit do të ishte me rëndësi sepse kjo është e freskët. Kështu edhe për testamentet që ngriti shoku Peppo. Në lidhje me shëndetësinë ka një plan të gjerë. Por ne na duhet më tepër edhe edukimi i të rinjve. Pra duhet të organizohen konferenca nëpër qendrat e punës, etj. Konferenca mi higjenën në punë, në kantier do të kishte rezultate mjaft të mira; kështu edhe për higjenën në fshat. Përsa i përket bujqësisë jemi shumë të kënaqur për krijimin e një seksioni të bujqësisë. Edhe komisioni i pyllëzimit është me rëndësi të madhe. Pyllëzimi ka një rëndësi të madhe për jetën tonë; sepse pa pyllëzim nuk munt të kemi ekonomi të përmirësuar. Çështja e olivikulturës mendoj se duhet të studjohej prej Institutit të Shkencave, për arësye se që prej dy vjetç nuk kemi ullinj.

Nuk shoh asnjë pikë ku të jetë parashikuar studimi për planet perspektive. Ky do një kohë, prandaj duhet të parashikohet një plan. Nuk ka gjithashtu preokupacion për pregatitje kuadrosh. Për kuadro teknike të kualifikuara nuk thohet asgjë. Plani sa po vete po shtohet prandaj do sakrifica të mëdha prej të gjithëve.

Këtu u shtrua çështja e kohës për bashkëpunëtorët e Institutit të Shkencavet që këta të lirohen një deri në dy ditë në javë nga punët e tjera. Partia dhe Qeveria e njeh këtë nevojë. Po ne munt të arrimë rezultate duke planifikuar punën tonë jashtë orarit zyrtar. Plani që kemi kërkon koordinim midis Seksioneve. Instituti duhet të ketë lidhje të ngushta gjithashtu dhe me dikasteret. Duke pranuar kritikën që iu bë Komisionit të Planit nga Instituti i Shkencave

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARNBARLETI" SHKODËR

dojmë për bilancin e planit. Ky duhet të parashikohet me hollësira, dhe të na sinjalohet me detaje. Të thuhen p.sh. se filan aparat gjindet në X vënd, ka pasë kushtuar para luftës kaq, etj. Këtu shoku Sotir Angjeli tha se kërkesat për Laboratorin nuk u muarën parasyshë. kështu edhe Ing. Topçiu. Po ne me gjithë mungesat duhet të luftojmë për realizimin e planit me mjetet që kemi. Në referatin e tij Sotir Angjeli foli për kudronin e Kuçovës që ta përdorim për djegje. Këtu kanë ardhur kaqë inxhinjera dhe s'e kanë shtruar këtë problem. Ne duhet të studjojmë ato çështje që kanë mundësi realizimi.

Ka shokë që munt të japin më shumë dhe duhet të interesohen më tepër; p.sh. Ing. Gjadri mungoi dje dhe sot para dreke. Kjo mungesë s'ka qënë e mirë.

Konferencat shkencore: gjëndja shëndetësore, burimet e hidroenergjisë, burimet e minierave, etj. janë me rëndësi. Partia e Qeveria i ka pasë parasyshë dhe ka menduar me kohë për këto probleme, po do të ishte më mirë që të kapen probleme që e interesojnë më tepër popullin, p.sh. uji i pijshëm, uji i hidro-centralit të Selitës, etj.

Për një konferencë problemi i bonifikimeve është mjaft gjenerik; duhet të kapim probleme më të kufizuara, më konkrete që të vlejnë për divulgimin e shkencës. Kjo munt të thuhet edhe për problemet pyjore që janë shtruar. Edhe këto janë probleme mjaft të gjera. Duhet të kapim probleme konkrete me karakter imediat, divulgativ që lidhen me jetën e popullit.

Premtoj se do të mobilizoj forcat e mija që të jap ndihmën në realizimin e planit të Institutit të Shkencave.

VANGJEL MEKSI. *Bashkëpunëtor shkencor, Nd-Prokuror i Përgjithëshëm.* — Në diskutimin e tij ve në dukje se aktiviteti i juristave ka qënë i pakët mbasi ata nuk kanë qënë të pajisur me teorinë marksiste-leniniste dhe nga ana tjetër nuk kanë qënë të organizuar. Në lidhje me monografitë, tha shoku Meksi, jam i mendimit që të shtohet edhe studimi i privilegjeve në vëndin tonë, privilegje të cilat janë trashëguar nga koha e perandorisë Otomane. Studimi i privilegjeve duhet të bëhet objekt studimi për të plotësuar materialin që do t'i shërbejë historisë. Edhe e drejta zakonore ka rëndësi të madhe. P. sh. Kanuni i Lek Dukagjinit, do të kontribuojnë material të ri për veprën mi origiinën e familjes së Engles-it. Nga ana tjetër do të njohim zakone të ardhura nga jasht, si pagesa e vjeljes; këtë e gjejmë në të drejtën romake. Ligja më e vjetër romake ka ardhur këtu dhe është përzier me zakonet iliriane. Për të nxjerrë këto konkluzione duhet një studim shkencor.

RROK ZOJZI. *Bashkëpunëtor shkencor (Muzeu Arkeologjik — Etno-*

BIBLIOTEKA PUBLIKE
E MARIN BARLETI

grafik. — Vleftësimi i kulturës tradicionale i popullit tonë zë fill me Rilindjen Kombëtare. Nënë forma të ndryshme, si fragmente të shkëputura, gjejmë ,aty këtu ndër botimet tona tentativa për mbledhjen dhe ruajtjen e vlsareve të Kombit. Por puna sisematike, me baza shkencore, mungoi në vëndin tonë gjersa mungonte edhe një institucjon i veçantë me një aparat puntorësh të pregatitur.

Ndërsa për kulturën abstrakte të popullit, për folklorin e tij, gjejmë tentativa pune edhe në të kaluarën, qofshin këto edhe nënë formën e diletantizmit kultura konkrete apo materiale e popullit tonë ngeli gjer më sot si një fushë djerrë. Ndërmarja e madhe e Institutit, e lavrimit të kulturës materjale të popullit, u kurorëzua me sukses me inaugurimin e repartit të Etnografisë në Muzeun tonë.

Në vitin e parë të punimit në këtë fushë u synua vetëm mbledhja e materjalit dokumentar dhe shpëtimi i tij nga çdukja, ndërsa në vitin e dytë, krahas me grumbullimin e tij, shoqërohet edhe studimi i tij shkencor, duke dalluar unitetet apo tipet kryesore, prej varianteve apo moterzimeve të tyre; duke dokumentuar prototipet dhe derivantet e tyre; krijesat origjinale dhe influkset e jashtëme.

Puna sa vjen e po bëhet më e vështirë, veçanërisht për ne që na mungon një eksperiencë kërkimesh dhe studimesh shkencore. Fusha e gjer. e studimeve etnografike të vëndit lyp kuadro të shëndosha, dhe kjo kërkesë vit për vit vjen duke u bërë më e ndjeshme. Prandaj, siç e tha edhe shoku Hasan Ceka për arkeologji, Instituti duhet të dërgojë jashtë Shtetit me bursë të rinj, që me studimet e tyre do të vijojnë punën tonë që gjithmonë ngel vepër pioneri. Çdo objekt në dorë të popullit e ka historinë e vet: tregon origjinën, qëllimin dhe nevojat që e kërkuan. Gjurmimi i tyre plotëson fletët e pashkruara të historisë së popullit.

Lufta e rreptë për jetë a vdekje që prodhimet industriale i bënë prodhimeve të vëndit, zbritën fuqinë krijuese shqiptare. Mjeshtër shqiptarë, dolën nga skena, emër-haruar dhe veglat e punës së tyre ngelën si armët e vjetra të një lufte së bjerun. Vegla shqiptare që për mija vjetësh veshi popullin tonë, ndali të rrahurat e veta si një zëmër e plakur dhe zbriti ndër bodrume pse bezja «Made in Japan» zëvëndësoi pëlhurat e linit edhe tek kasolla më e largët e Atdheut. Motivet e bukura, krijesë e shijes sonë kombëtare, ngelën të haruara dhe të përbuzura dhe në vënd të tyre u vunë motive me të cilat nuk na lith as tradita, as kuptimi i tyre në objektet tona. Timbri karakteristik i Kombit shkoi gjithkund duke u zbe.

Sot Kooperativat e Artizanatit Shqiptar gjejnë në Muzeun dhe në studimet e Institutit gurrat e pastërta të shijes sonë popullore. Nesër kombinati ynë i tekstilit, me prodhimet e veta do të kthejë në vënd motivet tradicionale tonat.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

SKENDER ANAMAL. *Bashkëpunëtor Shkencor (Muzeu Arkeologjik-Etnografik.* — Ç'ka kemi trashëguar nga e kaluara në arkeologji? E them me plot gojën: shumë pak. Në të kaluarën e gjithë pasuria arkeologjike e vëndit tonë ish në duart e të huajve dhe çfrytëzohej prej tyre. Kërkimet e gërmimet bëheshin me qëllime të ndryshme dhe populli as që e dinte dhe as që munt të mësonte për këtë. P.sh. gërmimet italjane nuk kishin vetëm qëllim grabitjeje por ato kishin për qëllim të pregatitshin opinionin publik e terrenin për pushtimin e Shqipërisë. Ata trumbetojshin me të madhe kontributin e arkeologëve italianë në Shqipëri. Duke spjeguar historinë e qytetit të Butrintit të lidhur me profecinë e legjendës së Eneut, të poemit të Virgjilit, fashistat italianë kërkuan të vërtetojnë se qysh në kohrat antike fati i përbashkët i brigjeve të kundërta të Adriatikut ishte përcaktuar nga Eneu-Krejt ndryshe është historia e vëndit dhe e banorëve tonë. Ajo është një luftë e vazhduarshme kundër pushtonjësit të huaj. Karakterin luftarak të kësaj popullsije e faktojnë gërmadhat e kalave e të fortesave të shumta që gjënden në vise të ndryshme të vëndit tonë. Po ju citoj vetëm një fakt: në luginën e Viosës ekzistojnë jo më pak se 8 kala antike, mbeturinat e të cilave duken edhe sot. Duke pasë trashëguar një të kaluar të tillë, puna jonë paraqitej e vështirë. Të udhëhequr nga mësimet e mësonjësit tonë të dashur Enver, me ndihmën e Partisë e të Pushtetit, pa eksperiencë të madhe por me një dëshirë të flaktë ne filluam nga puna. Përveç ngritjes së Muzeut dhe vënies së tij në shërbim të popullit, ekipi i arkeologjisë ka në aktivin e tij më se 20 ekspedita e fushata gërmimesh të vogla. Gjatë këtyre dy vjetëve janë zbuluar qëndra arkeologjike gjer më sot të panjohura, i janë shtuar koleksionevet të Muzeut materiale dokumentare të reja. Përveç ekspeditave tona, jemi ndihmuar edhe nga zbulimet e rastit. E kam fjalën tek materiali i rëndësishëm i gjetur në Maliq. Ky material pret ende dorën e specialistit. Me gjetjen e këtij materiali është përmbysur një herë e mirë mendimi i çfaqur nga Rey se vëndi i jonë nuk ka qënë i banuar në kohën para-helenike, në kohën e komuniteteve primitive .

Me gjithë se ligji për mbrojtjen e monumentave kombëtare ka dalë, mjerisht shohim se ky ligj nuk është respektuar kudo. N. L. Ndërtimi e Vlorës p.sh. ka përdorë muret e kalasë antike të Margëllicit për gurore. Në Elbasan fusha e Namazgjahut shërben për grumbullim gurësh e dheu dhe Kisha e Shën Jahit në Boboshticë është ndruar në haur.

Duke shtuar kontaktet me shkencën arkeologjike sovjetike dhe të republikave popullore simbas shëmbullit të tyre ne do të ecim të sigurtë në të arthmen.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MIRDITA BARLETI" SHKODËR

MARK NDOJA *Anëtar i Institutit (Lidhja e Shkrimtarëve).* — Asamblea jonë po u jep fund punimeve të saj të Sesionit të III-të vjetor. U pa rruga që kemi bërë, të metat që kemi patur, dhe perspektivat që na hapen për të arthmen e shkencës në vëndin tonë. Po që ne të kuptojmë mirë se si shkenca bëhet në dobi të popullit duhet t'i përvishemi një pune të madhe sistematike për pastrimin e saj nga mbeturinat e ideologjisë borgeze. Borgezia ka bërë dhe bën gjersa të ketë fuqi skllevër të sistemit të saj çfrytëzonjës jo vetëm proletarin, me mëditje, po edhe juristin, edhe poetin dhe shkrimtarin edhe shkencëtarin. Zinxhiret e saj pra rëndojnë mi të gjithë veprimtarinë njerëzore gjatë sundimit të saj, i cili përmbyset vetëm me revolucjon, me violencë. Është gabim i math të kujtojmë se mbasi ta kemi përmbysur borgezinë nga pushteti i kemi larë të gjitha hesapet me 'të. Lenini na mëson se «Diktatura e proletariatit është një luftë e rreptë, me gjak e pa gjak, violente dhe paqësore, ushtarake dhe ekonomike, pedagogjike dhe administrative, kundër forcave dhe traditave të shoqërisë së vjetër». Këtë mësim të math të Leninit edhe ne njerëzit e shkencës duhet ta kemi gjithmonë parasysh që të mos gabojmë në punën tonë krijonjëse në fushën e shkencës, të artit e të kulturës. E gjithë puna shkencore e së shkuarës duhet revizionuar, duhet punuar me metodën e kritikës marksiste-leniniste. Duhet flakur poshtë çdo gjunjëzim dhe adhurim; gjunjëzimi dhe adhurimi për shkencën e së shkuarës dhe korifejtë e saj shpien në pikpamje idealiste, jo materialiste,, shpien në dogmatizëm.

Në çështje të gjuhës kemi edhe pikëpamje të gabuara; edhe ka njerës këtu tek neve që s'njohin asgjë nga punimet e linguistikës sovjetike, ka njerës që teorin e singularitet të gjuhës e mbajnë për të vërtetë, dhe mprojnë ide si ato, të linguistikës ideo-gjermane, teori me baza idealiste-raciste. Edhe nuk u është bërë një kritikë e guximëshme atyre të, huajve që kanë studjuar gjuhën tonë dhe kanë shkruar vepra mbi 'të. E pra ka ardhur koha të ndahet shapi nga sheqeri me këta njerës dhe me veprat e tyre.

Në histori na mbetet akoma për të bërë me shumë. Në të ashtuqojturat histori të shkruara gjer sot për Shqipërinë nga të huajt, zotëron çpifja, falsifikimi, degjenerimi e salmi kundër popullit tonë. Historianëve tonë u bie barra e rëndë të fillojnë thuajse nga alfa për të shkruar historinë e popullit tonë.

Edhe në shkencat e natyrës munt të themi se ne fillojmë tani.

Për t'i kapërcyer këto një armë ka, një armë të vetëme: teoria marksiste-leniniste, eksperienca e Bashkimit Sovjetik, që si çdo gjë tjetër edhe shkencën e re, e ka ndërtuar mi këtë teori të pavdekëshme, jashtë sëcilës çdo gjë është fallco, jashtë sëcilës nuk munt të shpjegohet asnjë fenomen fizik, as historik, as psikologjik; në çdo akt tonin përpara pa këtë teori ne do të rëxoheshim keq.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Unë do të isha i mendimit të përkthehen edhe broshurat e vogla me përmbajtje shkencore me stil popullor, gjë që e kemi thënë kaq herë, po edhe s'i ka dalë kush zot kësaj pune, përveç nja dy broshura që ka nxjerrë Komiteti i Kulturës, të cilat janë përkthyer me një shqipe të keqe. Kjo do të bëjë një plus me shumë rëndësi në veprimtarinë e sivjetëme të Institutit të Shkencave, një plus që do të ndihmojë shumë për të zbatuar mësimin e shokut tonë të shtrënjtë Enver Hoxha që na ka porositur të punojmë për «më shumë bukë e më shumë kulturë për popullin tonë».

STERJO SPASSE. *Bashkëpunëtor Shkencor (profesor në shkollën Pedagogjike).*— Propozon të pregatiten fletë të veçanta dhe t'u dërgohen gjithë ish partizanëve për të shkruar përshtypjet e tyre të luftës. Kjo do t'i vlejë shumë folklorit. Duhet të kemi një interpretim të drejtë të prallave, këngëve epike, lirike, etj., p.sh. si duhet të interpretohet qerozi, i cili përfaqëson njeriun e ultë dhe të varfër të popullit, por shumë të zgjuar dhe që fiton në çdo rast. Vallë mos populli e ka krijuar këtë tip, sepse klasa e lartë e quante qeros atë fshatarin e varfër. Detyra e Institutit është t'i mbledhë e t'i komentojë këto pralla. Ne nuk kemi dhënë aq sa duhet. Buletini i Institutit duhet të jetë një pasqyrë e gjallë e aktivitetit të tij. Për çdo Seksion të caktohen temat për studim. Instituti duhet të na japë njohuri mi zhvillimin e shkencave në Bashkimin Sovjetik. Bazat e gjallërisë shkëncore janë vënë, këto do të bëhen akoma më të forta, pse këto baza janë lavdija e jonë.

SEFULLA MALESHOVA. *Anëtar i Institutit (Komisjoni i Fjalorit rusisht-shqip).*— Një nga sektorët më me rëndësi të Institutit është, pa dyshim, dhe sektori i përkthimeve të marksizmë-leninizmit. Këtu në vëndin tonë këtë punë Komiteti Qëndror i Partisë ja ka ngarkuar Institutit të Shkencave. Kjo është një detyrë dhe një nder i math për Institutin. Për një organizim më të mirë të kësaj pune jam i mendimit që të krijohet një grup i përhershëm përkthenjësish të kualifikuar. Këta duhet të kenë një përgatitje të mirë teorike dhe speciale dhe të dinë rusishten.

Instituti i Shkencave ka pasur mjaft suksese sidomos në fushën e organizimit dhe të grumbullimit të materialit. Po në lëmin e veprave shkencore origjinale nuk ka një punë të madhe. Fjalori shqip, gramatika e gjuhës shqipe, ortografia, disa artikuj, — ja gjithë bilanci i aktivitetit shkencor origjinal të Institutit. Sivjet po i përvishet me të vërtetë një pune shumë serioze, të shkruarit e Historisë së Shqipërisë dhe të Historisë së Letërsisë Shqipe. Kjo do të jetë një provë e madhe për Institutin, pse është një punë e madhe dhe e vështirë të interpretosh historinë e vëndit tonë shkencërisht, d.m.th. nga pikpamja marksisteleniniste.

BIBLIOTEKA PUBLIKE
SHKODËR
MARIN BARLETI

Një pikë e dobët në punën e Institutit është organizimi i mbledhjeve të seksioneve. Sekcionet mblidhen shumë rallë vetëm për aprovimin e planit. Në seksionet duhet të shtrohen e të rrihen probleme shkencore, ato duhet të bëhen qëndra studimesh, aty duhet të ketë jetë shkencore.

Më duket se ka ardhë koha të mendohet dhe këtu tek ne për dhënjen e titujve shkencorë si doktor etj.

Një pengesë e madhe në punën e Institutit është që njerzit e shkencës nuk e dinë sa duhet teorinë marksiste-leniniste. Shoku Stalin ka thënë se formimi i kuadrove duhet të bëhet sipas specialitetit. Nuk ka nevojë që një specialist në mjekësi të jetë edhe specialist në fizikë ose botanikë dhe anasjelltas. «Po ka një degë të shkencës, që bolshevikët e çdo dege duhet ta dinë me domosdo: është shkenca marksiste-leniniste e shoqërisë, e ligjeve të zhvillimit të shoqërisë, e ligjeve të zhvillimit të revolucionit proletar, e ligjeve të zhvillimit të ndërtimit socialist, e fitores së komunizmit». Në vëndin tonë qarkullojnë pikëpamje të gabuara në fushën e gjuhës, artit, letrësisë, historisë etj. Duhet që problemet të rrihen e të shoshiten në dritën e marksizmë-leninizmit. Këtu në Shqipëri, si kudo, marksizmë-leninizmi munt të çajë rrugën, të sundojë e të përhapet vetëm në luftë parimore me pikpamjet e kundërta.

FONI QIRKO. *Bashkëpunëtor shkencor (Ministrija e Drejtësisë).*— Ne juristat nuk vimë këtu me një punë konkrete. Titullin e antarit e të bashkëpunëtorit duhet ta meritojmë. Mi planin e punës kam dy vrejtje: mbledhja e Asamblesë të bëhet më shpesh, të caktohet një kohë për të shqyrtuar punën e bërë p.sh.: në shtator. Punimi i kestionarëve për mbledhjen e së drejtës zakonore lyp një kohë më të gjatë se sa është parashikuar në plan. Kam disa vrejtje mi përpilimin e kestionarëve, duhet dhënë rëndësi studimit të privilegjeve, që tregojnë në disa konçesione që janë quajtur me të drejtë kështjella të lëvizjes Kombëtare.

Pe[illegible] i përket zakoneve duhet të gjejmë e të dallojmë të mirat e të ligat, si janë «gjaku» dhe «poroda». Poroda formohet prej 20-30 vetësh që ndalojnë gjakun. Për viset e Veriut duhet të nxjerrim një kestionar në bazë të veprës së Engels-it «Origjina e familjes». Këtu konstatojmë se populli i ynë është më i vjetër në Ballkan, mbasi zakonet e hakmarrjes i gjejmë edhe tek grekërit e vjetër.

Monografitë duhen bërë me bàza shkencore, se këto do të vlejnë për të pregatitur më vonë një vepër definitive.

Bjelinski thotë se popujt që kanë jetuar për një kohë të gjatë nën okupacjonin e huaj, kanë marrë zakone të këqija. Ne duhet t'i përcaktojmë këto, se veset e këqia populli i ka marrë nga sundimi i huaj. Po ashtu duhet shtruar studimi i Kanunit të Lekës që duhet të spas-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

trohet nga influenca fetare që janë futur aty dhe që kanë vepruar në dëm të popullit.

Ingj. DHORI LAÇI. *Bashkëpunëtor shkencor (Ministria e Bujqësisë dhe Pyjeve).*— Krijimi i Seksionit të Bujqësisë përshëndetet nga agronomi se krijohet një ambjent që do të zgjidhë shumë probleme me rëndësi. Me krijimin e këtij Seksioni dhe duke u nisur nga orientimi që na ka dhënë Partia e jonë ne do të zgjidhim probleme që na presin, si atë të bonifikimit, i cili është një objekt që do një studim të koordinuar me studimet e komisionit hidraulik. Për ta ngritur bujqësinë e prapambetur do të jetë bara e Seksionit të gjejë metoda më të përparuara për t'i vënë në zbatim. Një problem tjetër është edhe ay i florës spontane, nga e cila munt të dalin bimë që të kultivohen. Ne duhet të krijojmë një bazë të shëndoshë për bagëtitë tona e cila këtu e ka pikën më të dobët. Në diskutimet që u bënë në këtë Asamble u tha se në shumë gjëra jemi në fillim, në bujqësi karshi asaj që duhet bërë jemi prapa. Duhet të organizojmë të gjitha qëndrat dhe stacjonet që kemi sot.

Çështja e aktivizimit të rretheve shkencore ka një rëndësi të madhe. Një ndihmë të çmuarshme na jep në këtë drejtim eksperienca sovjetike. Pranë kolkozeve ka laboratore në të cilat Lisenko-ja shkon e mban konferenca. Eshtë e domosdoshme të bëhet një përpjekje për përkthimin e veprave sovjetike. Vetëm atëhere agronomët tanë që kanë studjuar në viset borgjeze do të gjejnë rrugën e drejtë të punës së tyre. Seksioni duhet të kujdesohet të dërgojë kuadro në B.S. që të shikojnë se si veprohet atje në këtë fushë.

Puna e komisionit të pyllëzimit duhet të çohet më tutje, të hartohet një plan e të ndiqet vazhdimisht zbatimi i tij. Seksioni duhet të angazhohet edhe me probleme blegtorale, sepse vetëm atëhere do të bëhet një mjet i shëndoshë për zhvillimin e bujqësisë sonë.

Dr. SINAN IMAMI. *Bashkëpunëtor shkencor (Drejtor i Spitalit P .Ushtarak).*— Komisioni i mjekësisë nuk përmbushi dot planin dhe për këtë në mbledhjen plenare të Seksionit ay bëri kritikën dhe autokritikën. Për t'i kaluar këto pengesa në vitin 1950, duhet të planifikohet më mirë puna. Duhet të studjohen problemet aktuale. Për të parën herë në vëndin tonë krijohet një leteraturë shëndetësore e cila do të na vëjë në kontakt me shkencëtarët e B.S. Që të dalin këto punime më të frytëshme, mjekët tanë duhet të jenë më të brumosur. Për t'i arritë një qëllimi të tillë është e nevojëshme të përkthehen vepra të leteraturës mjekësore sovjetike. Deri më sot njohim fare pak nga shkenca Sovjetike. Punimet e rëndësishme të Prof. Filatef, i Universitetit të Odesës, për shërbimin e sëmundjes së lëkurës janë me shumë rëndësi.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Mjeku i pajisur kështu me njohuri të rea do ta ushtrojë profesionin e tij më me kompetencë.

Një rëndësi të veçantë ka edhe mjekësia popullore e cila, veç vlerës historike, ka edhe një anë pozitive, ka një bërthamë shkencore që munt të na hyjë shumë në punë për shkencën tonë. Duke punuar në këtë drejtim mjekët tanë do të jenë në gjëndje të zbatojnë detyrat që na ka ngarkuar Partia dhe Qeveria.

Ing. ISMAIL TOPÇIU Sqaron shokun Koleka në lidhje me planin e mjeteve të punës dhe shton se me këto mjete është bërë i pamundur vijimi i punës. Këtë dimër ka patur ujra të jashtëzakonëshme dhe për mungesë mjetesh s'kemi mundur të veprojmë. S'kemi termometra me gjithëse nuk kushtojnë shumë. Në lidhje me konferencat që duhet të bëjë Instituti, bashkohem me mendimin e shokut Koleka se problemet e hidroelektrizimit, bonifikimeve, etj., janë të mëdha por jo me karakter divulgimi popullor. Duhet të kemi tema më praktike, më imediate.

ING. ÇEFO FICO. *Bashkëpunëtor shkencor (Ministria e P. Botore).*— Jam i mendimit që Komisioni i Hidraulikës dhe Rezistencës së Materjaleve të ndahet në dy pjesë: veç i hidraulikës dhe veç i rezistencës së materjaleve. Bonifikimet kanë një rëndësi të veçantë. Më parë elementët e natyrës kanë bërë atë që kanë dashur. Vetëm pas çlirimit kanë filluar veprime me rëndësi si p.sh. ay i Devollit. Duhet krijuar një komision që të udhëheqë komisionet e tjera në aksion.

Përsa i përket sismologjisë në vëndin tonë, në Shqipëri nuk ka ekzistuar një stacjon i tillë dhe në këtë drejtim s'kemi as shënime. Teknikët tanë nuk e dinë se në ç'zona bien tërmetet.

Në fondin e caktuar për ngritjen e Shërbimit Hidro meteorologjik është parashikuar edhe dërgimi i kuadrove jasht shtetit. Por për këtë punë gjer tani s'është bërë asgjë. Një punë shumë e mirë është edhe ardhja e shkencëtarëve nga B.S. por i huaji që të ambjentohet në punët tona do një kohë shumë të gjatë. Eshtë e nevojëshme që disa prej teknikëve tanë të dërgohen në B.S. për të përfituar nga eksperienca sovjetike dhe për ta zbatuar në vëndin tonë.

SOTIR ANGJELI.— Sqaron Shokun Koleka në lidhje me mazutin për të cilin thotë se ka mundësi që të përdoret si lëndë djegëse duke përdorur temperaturën dhe presionin e ujit të lokomotivave si mjete fizike për të ulur shkallën e viskozitetit të këtij nënprodukti. Pra teorikisht dhe praktikisht ka mundësi që mazuti të përdoret si lëndë djegëse.

Dr. EQREM ÇABEJ. *Anëtar i Institutit (Komisioni i Fjalorit*

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Shqip).— Desha të them dy fjalë përsa i përket kritikës që u bëri shoku Ndoja linguistëve mi origjinën e gjuhëve. Si dihet kjo teori u themelua nga Bopp. Në librin e Shorit, libri zyrtar e më i riu në B.S., në një pjesë të veprës flitet për gjuhë hindo-europjane. Ne jemi gati të pranojmë çdo kritikë por kjo të jetë e informuar. Skicat e Schleiher-it dhe Schmid-it libri i Shorit i ka shumë të qarta, prandaj studjojeni Shorin në origjinal dhe në përkthimin e tij. Hyrja e folklorit në tekstet shkollore është për t'u përshëndetur. Tek ne kjo punë është bërë relativisht vonë. Ndërsa De Rada nisi që më 1866. Ndarja e folklorit në shkollë sipas klasave duhet të bëhet me kritere didaktike. Në klasat e fundit të shkollës së mesme të bëhen krahasime në folklorin e popujve të Ballkanit për të parë atë që na lith me 'ta me fazën e ballkanistikës.

Në mbledhjen e kulturës materjale, megjithëse u fillua si një punë modeste, është bërë një punë mjaft e madhe. Vetëm theksoj se duhet shpejtuar për mbledhjen e këtij materjali mbasi me modernizimin e jetës këto mjete çduken. Edhe fjalët e mbledhura pranë objekteve kanë përfitim për gjuhën tonë.

Kanuni i Lekës është mbledhur nga Gjeçovi, por duhet të bëhet një mbledhje dhe një studim edhe nga Instituti i Shkencave në bashkëpunim me juristët. Në Himarë ka gjurma të këtij kanuni popullor. Në Toskëri është rezik të humbasë. Të studjohet sa më parë kjo në mënyrë që të dalë në shesh ay unifikim shpirtëror i Kombit tonë që të huajtë shpesh herë e kanë mohuar.

ZIHNI SAKO.— Sqaron Çabeun në lidhje me librin e Shorit duke thënë se Meshçaninovi bën fjalë edhe për Shorin, i cili në fillim ka pasë pikëpamje të Sosiurit, por pastaj është vënë në pikëpamje të drejtë. Pikëpamja e grupit hindo-europjan të shpie në racizëm. Në lidhje me çështjen e gjuhës sonë është mirë që të diskutohen këto probleme dhe të shikohen me hollësi.

ALEKS BUDA.— Jep disa shpjegime mbi problemin e origjinës së gjuhëve duke thënë se fakti që Shorr zë në gojë familjen indoeuropjane nuk do të thotë se Shorr dhe gjuhësia Sovjetike kanë pranuar pikëpamjet e shkollës indoeuropjaniste. Egzistenca e një grupi gjuhësh në një sërë fenomenesh të përbashkëta që justifikon përmbledhjen e tyre në një grup, nuk vihet në diskutim. Po problemi qëndron pikërisht këtu, si shpjegohet dhe nga rjedh ky grupim. Koncepti indoeuropjanist se familja gjuhësore indoeuropjane zbret nga *një* gjuhë e vetme primitive, e cila nuk ka dhe nuk mund të ketë asnjë lidhje me një familje tjetër gjuhësore, të shpije në një koncept metafizik dhe racist, sepse supozon qënien e një gjuhe irreducible dhe të lidhur me një racë; kurse përkundrazi Marr dhe gjuhësia Sovjetike

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

thonë se gjuhët e soçme indoeuropjane si dhe gjuhë të tjera nuk zbresin në formën e një piramide nga *një* gjuhë por janë formuar prej një shumicë të madhe foljesh e gjuhësh si një piramidë që vjen duke u thjeshtësuar me majën tatëpjetë. Gjuhët indoeuropjane janë një grup gjuhësh që kanë së bashku një varg ndryshimesh në lidhje me ndryshime të mëdha ekonomike-sociale, dhe me këtë mënyrë janë larguar nga një bazë më e vjetër, paraindo-europjane ose jafetike, si e quan Marri. Me fjalë të tjera, gjuhë të lidhura me raca të veçuara nuk ka. Nga doktrina e Marrit një grumbull faktesh mund të na ndihmojnë edhe për historinë e lashtë të gjuhës dhe të popullit tonë. Po të mbështetemi në teorinë e gjuhëve indoeuropjane, shqipja nuk mund të ketë asnjë lidhje me gjuhë më të vjetra, jo indoeuropjane. Kurse sipas Marrit gjuhët trako-ilire dhe vazhdimi i tyre sot, gjuha shqipe, përfaqësojnë një fazë kapërximtare nga një fazë më e vjetër, para-indoeuropjane, për në familjen indoeuropjane.

* * *

Shoku K. Paparisto mbyll diskutimet duke vënë në dukje se Asambleja rrahu probleme me rëndësi për zgjerimin dhe mbarëvajtjen e punës së Institutit për vitin 1950. Ajo mori në studim dhe aprovim propozimet e bëra për ngritjen e Seksionit të Bujqësisë dhe Laboratorit të Shtetit. Asambleja vuri në udhë të drejtë detyrat dhe të drejtat që duhet të kenë anëtarët e bashkëpunëtorët e Institutit. Ajo i shtroi Institutit si detyrë mbajtjen e kontakteve të rregullt e të vazhduarshëm me dikasteret e institucjonet e tjera që interesohen për punimet që zhvillohen në Institut. Ajo shtroi gjithashtu nevojën e propagandimit të punimeve t'Institutit, ngritjen ideologjike-shkencore të kuadrove, përfitimin nga eksperienca e çmueshme e shkencës sovjetike, çështjen e pajisjes me laboratore e vegla të nevojshme etj. Presidiumi i Institutit të Shkencave do t'i ketë përparasysh këto probleme për vitin 1950.

Sh. Kol Paparisto i u përgjegj gjithashtu propozimeve të bëra prej disa nga diskutantët:

Shoku Peppo shtroi çështjen e bashkëpunimit dhe ndihmës që duhet t'i japë Instituti Min. Arsimit përsa i takon përpilimit të teksteve shkollore dhe organizimit të ekspeditave me qëllim që të ndihmohen kuadrot studjonjëse të Ministrisë në punimet e tyre origjinale. Instituti ka parashikuar një seri marëdhënjesh dhe ndihmë reciproke me Min. e Arësimit. Instituti ka kërkuar ndihmën e arsimtarve përsa i përket punës në rrethet shkencore, anketave folkloristike, shëndetsore etj. Instituti e ndihmon Min. e Arësimit me punën për hartimin e Historisë së shkollave, me hartimin e terminologjisë shkollore, fjalo-

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

rëve etj. Por Instituti nuk mundet sot të shtrojë më gjërësisht punën për hartimin e teksteve shkollore se kjo nuk është një çështje që i përket Institutit as nuk mund të ndërmarrë Instituti ekspedita për probleme të Ministrisë s'Arsimit, e para pse Ministrija nuk ka shtruar një çështje të tillë dhe pastaj kjo nuk hynë në sferën e aktivitetit të Institutit. Përsa i përket studimit të arkeologjisë bizantine Instituti gjindet akoma në fazën e parë të kësaj pune d.m.th. në mbledhjen e materialit, mbas kësaj do të fillojë një studim sistematik. Propozimi për të sjellë kuadro të huaja për probleme të ndryshme të Institutit do të studjohet mirë mbasi kërkesat në këtë drejtim janë të shumta.

Shoku Ziaudin Kodra propozoi që në Buletinin e Institutit të botohen herë pas here dokumenta interesante. Kjo punë ka qënë bërë në të kaluarën por më von u pa e arsyeshme që në Buletin të botohen vetëm studime origjinale që bën Instituti. Me gjithatë për këtë vit është paroshikuar që me rastin e Jubileut të Rilindasve të botohet një numur specjal i Buletinit me dokumenta mbi Rilindjen.

Shoku Nathanaili propozoi që Instituti të marrë përsipër përkthimin e veprës: «Teorija e Shtetit dhe së Drejtës». Me që kjo vepër ka rëndësi jam i mëndjes që të vihet në vendin e ndonjë vepre tjatër që ka Instituti në planin e vjetit 1950 dhe që është më pak urgjente. Sa për mbledhjen e së drejtës zakonore kjo punë është filluar nga Instituti.

Çështja e ngritjes së rretheve shkencore pranë qëndrave të punës që shtroi shoku Shinasi Dragoti, do të ishte një punë e vështirë për t'u realizuar dhe nuk do t'i përgjigjesh natyrës së rretheve shkencore që ka ngritur deri më sot Instituti. Për të mbajtur kontakte me qëndrat e punës mjafton të caktohen komisjone pranë këtyre qëndrave, të cilët do t'i paraqesin Institutit nevojat dhe problemet e tyre dhe do të marrin udhëzime e sugjerime.

Shoku Koleka shtroi çështjen e disa studimeve që janë planifikuar për vitin 1950 nga Instituti, të cilat nuk lidhen me problemet aktuale të vëndit. Këtë çështje mund ta marrë prap në studim Komisjoni i Hidraulikës ku bën pjesë edhe vetë shoku Koleka për të dhënë një zgjidhje më të drejtë. Gjithashtu mund të merren në shqyrtim edhe temat e konferencave që do të mbahen për të bërë të njohur punën që zhvillon Instituti. Eshtë shumë e drejtë që Instituti të ketë një plan perspektiv për formim kuadrosh. Deri më sot është bërë pak për formimin e kuadrove të reja duke vënë asistentë pranë kuadrove të specializuara, por edhe këtë nuk kemi mundur ta bëjmë në shkallën e nevojshme për mungesë kuadrosh.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Shoku Vangjel Meksi propozoi që të bëhet një studim mbi privilegjet që gëzonin vendet ku nuk zbatoheshin ligjët e qeverisë Otomane. Ky studim nuk mund të ndërmerret pa pasë mbledhur më parë materialin e nevojshëm.

Shoku Malëshova shtroi çështjen e titujve shkencorë. Ne sot kemi vetëm titullin e anëtarit dhe të bashkëpunëtorit. Më von mund të shohim mundësinë e titujve të tjerë në se do të paraqitet nevoja. Malëshova tha gjithashtu se në Institut nuk bëhet punë origjinale. Kjo nuk më duket e drejtë. Në Institut bëhet punë origjinale në të gjitha degët e aktivitetit shkencor, qoftë në gjuhësi, qoftë në shkencat e natyrës, në Muze, në Shërbimin Hidrometeorologjik, qoftë në histori, por puna origjinale do të kualifikohet dita ditës me ngritjen dhe zhvillimin e kuadrove dhe mundësive të tjera. Çështja e diskutimeve të problemeve shkencore me rëndësi nga anëtarët e bashkëpunëtorët e Institutit është e domosdoshme dhe në këtë pikë duhet të shpejtohemi mbasi nuk kemi bërë asgjë deri më sot.

Shoku Fico shtroi çështjen e ndarjes së komisjonit të Hidraulikës nga ay i Rezistencës së Materialeve. Kjo mund të bëhet më von kur të krijohen konditat për një komisjon të Rezistencës me ngritjen e Laboratorit të Shtetit. Sa për krijimin e një Komisjoni të Bonifikimeve i cili do të përmblithte dy komisjonet e Hidraulikës dhe Pyllëzimit për të koordinuar punën në mes tyre, kjo nuk më duket e arsyeshme mbasi puna mund të koordinohet edhe pa qënë nevoja e krijimit të një komisjoni tjatër. Përsa i përket ngritjes së një stacjoni sizmik, Instituti ka ngarkuar Muzeun e Shkencave të Natyrës për të hartuar projektin gjatë vitit 1950 dhe ka filluar me anën e stacjoneve të Shërbimit Hidrometeorologjik një anketë mbi tërmetet në vëndin tonë.

Të gjitha sugjerimet e tjera Presidiumi do t'i marrë në studim dhe do t'i zbatojë mbrënda mundësive tona.

Në emër të Presidiumit shoku Kol Paparisto i propozon Asamblesë tre anëtarë dhe 16 bashkëpunëtorë të rij.

Anëtarët që i propozon Asamblesë janë:

1) MEHMET SHEHU. — me këtë motivacjon: «*Organizator dhe udhëheqës i çquar në luftën e çlirimit i mbështetur mi parimet e shkencës marksiste-leniniste, udhëheqës në ndërtimin e Shqipërisë së Re. Autor i një sërë veprash dhe analizash historike mi fazën më të çkëlqyer të historisë sonë. Si Antar i Institutit do të japë një kontribut të vyer në punimet historike*».

2) BEDRI SPAHIU. — me këtë motivacjon: «*Organizator dhe udhëheqës i çquar në luftën e çlirimit; i mbështetur mi parimet e shkencës*

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

marksiste-leniniste, udhëheqës në ndërtimin e shoqërisë dhe kulturës së re socialiste. Autor i një sërë analizash të holla në lëmin teorik. Si Antar i Institutit do të japë një kontribut të vyer në punimet historike».

3) ISMAIL TOPÇIU. — me këtë motivacjon: «*për kontributin e tij shkencor në punën e Institutit, për cilësitë e tij organizative në ngritjen dhe drejtimin e Shërbimit Hidrometeorologjik. Si Antar i Institutit do të kontribuojë shumë në punimet e Seksionit të Shkencave të Natyrës*» .

Bashkëpunëtorët:

I) Për Seksionin e Historisë

1) Mateo Gjoni
2) Halim Budo
3) Pasko Milo
4) Kol Koçi
5) Alqiviadh Lamani
6) Ndreko Plasàri

II) Për Seksionin e Shkencave të Natyrës

7) Adem Deliu
8) Thoma Harito
9) Nikolla Zadrima
10) Petrit Dakli
11) Selahudin Bekteshi
12) Masar Dervishi
13) Petro Filto
14) Zija Këlliçi
15) Ilia Nako
16) Sherif Toptani,

me këtë motivacjon: «*Nga pregatitja dhe aftësitë e tyre shkencore janë në gjëndje të japin një kontribut të vyer në studimet që ndërmer Instituti i Shkencave.*»

Të gjithë të përmëndurit pranohen me unanimitet nga Asambleja.

Në mbarim të diskutimeve dhe pasi u bë propozimi dhe pranimi i Anëtarëve dhe Bashkëpunëtorëve të rinj të Institutit, shoku Sotir Angjeli lexoi projekt-rezolucjonin e Asamblesë, i cili me pak ndryshime u aprovua me unanimitet ky:

REZOLUCJON

Asambleja, pasi dëgjoi e diskutoi raportin e Sekretarit të Presidiumit të Institutit, ku u analizua puna shkencore e kryer gjatë vitit 1949 dhe ajo e shtruar në planin e vitit 1950, e aprovoi atë plotësisht.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Asambleja, me kënaqësi konstatoi se brënda kësaj periode dyvjeçare, aktiviteti shkencor i Institutit ka ardhur vazhdimisht duke u zgjeruar e u zhvilluar. Asambleja konstatoi gjithashtu se gjatë këtij aktiviteti Instituti i Shkencave ka regjistruar një seri suksesesh të rëndësishme, por ka pasur edhe mjaft të meta në punën e tij.

Sukseset kryesore janë:

— ngritja e Muzeumeve Etnografik-Arkeologjik dhe të Shkencave të Natyrës;
— themelimi i Arkivit të Shtetit;
— krijimi i Shërbimit Hidrometeorologjik;
— botimi shqip i veprave klasike të marksizmë-leninizmit, etj.

Të metat kryesore kanë qënë:

— mungesa e lidhjeve të rregullta me institucjonet shkencore të botës së jashtëme, e në radhë të parë me ato të Bashkimit Sovjetik;
— mungesa e marrëdhënjeve të mjafta me dikasteret dhe qëndrat e mëdha të punës;
— mungesa e afrimit të ngushtë ndërmjet Institutit dhe anëtarëve e bashkëpunëtorëve të këtij, që ka pasur si konsekuencë mosmbledhjen e Asamblesë në vitin 1949;
— mungesa e aktivizimit racjonal në punë shkencore të kuadrove të larta të Institutit dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm të këtij;
— mungesa e interesimit të këtyre të fundit ndaj angazhimeve të marra kundrejt Institutit;
— mungesa e përpjekjeve të mjafta për ngritjen ideologjike e shkencore të kuadrove dhe bashkëpunëtorëve të Institutit, dhe për përfitimin në maksimum nga rezultatet, kuadrot dhe eksperienca e shkencës sovjetike;
— mungesa e një trajtimi moral e materjal të favorëshëm për anëtarët dhe bashkëpunëtorët e Institutit;
— mungesa e sigurimit të konditave dhe mjeteve të mjafta për punë shkencore (libra, aparate, kohë të lirë të mjaftushme, etj.);
— mungesa e orientimit të theksuar të aktivitetit shkencor të Institutit në dobi të jetës ekonomike të vëndit;
— mungesa e përpjekjeve të mjafta për popullarizimin e aktivitetit shkencor të Institutit.

Për mbarëvajtjen dhe zhvillimin e mirë të punës shkencore në Institut paskëtaj, Asambleja ngarkon Presidiumin e këtij me këto detyra:

1) Të çdukë sa të jetë e mundur më shpejt të gjitha të metat e konstatuara më sipër;

2) T'i propozojë Qeverisë së R.P. të Shqipërisë krijimin e Seksionit të Bujqësisë pranë Institutit të Shkencave, me organ mvartës Stacjonin e Kërkimeve Bujqësore që sot është nënë urdhërat e Ministrisë së Bujqësisë e të Pyjeve;

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

3) T'i propozojë Qeverisë së R.P. të Shqipërisë krijimin e Laboratorit qëndror të Shtetit, si organ i Institutit të Shkencave;

4) Të zbatojë planin e punës të Institutit për vitin 1950, duke marrë parasysh edhe ato sugjerime të Asamblesë që munt të vihen në jetë me forcat disponibël të Institutit.

Në mbarim të punimeve të saja, Asambleja e Institutit të Shkencave u bën thirrje të gjithë anëtarëve dhe bashkëpunëtorëve të Institutit që të mobilizojnë tërë aftësitë e tyre për zhvillimin e mëtejshëm të punës shkencore në vëndin tonë, për ngritjen e bazave të ndërtimit socjalist, për mprojtjen e paqës dhe të kulturës, për forcimin e ekonomisë popullore, duke dhënë kontributin e tyre maksimal në realizimin e planit të Institutit.

Pastaj u propozua që t'i dërgohet nga ana e Asamblesë së Institutit të Shkencave një letër-përshëndetjeje shokut Enver Hoxha: ky propozim u aprovua me unanimitet dhe iu lexohet letra të pranishmëve nga shoku Aleks Buda.

Teksti i letrës:

GJENERAL ARMATE ENVER HOXHA

Tiranë

Shoku Komandant,

Antarët e Bas hkëpuntorët e Institutit të Shkencave, të mbledhur në Sesionin e zakonshëm t'Asamblesë për vitin 1950, Ju përshëndesin me dashuri. Punëtorët e shkencës përshëndesin në Ju Udhëheqësin e ndritur të fitoreve të popullit tonë në luftë për ndërtimin e Shqipërisë së re socialiste, përshëndesim me Ju Partinë Tonë heroike dhe Qeverinë Popullore.

Tek ne është rrënjosur thellë bindja se Pushteti Popullor, udhëheqja e Partisë, kujdesi i Qeverisë dhe i Juaji personalisht, janë garante për lulëzimin e punës shkencore në vëndin tonë. Me këtë ndihmë ne jemi të sigurt se do ta kapërxejmë prapambatjen tonë të trashëguar nga regjimet e vjetra, se edhe tek ne puna shkencore do të bëhet një faktor konstruktiv i rëndësishëm në ndërtimin e jetës së re, në Republikën tonë.

Për të përmbushur detyrat e mëdha që na ve përpara ndërtimi i socializmit në vëndin tonë, shembëllën na e jep shkenca sovjetike, shkenca e pararojës. Sipas kësaj shëmbëlle së madhe ne Ju premtojmë se do të dalim nga izolimi dhe kufizimi në të cilin donin ta mbanin punën shkencore regjimet e së kaluarës, do t'i lëftojmë me vendosmëri dhe do t'i flakim tej mbeturinat e ideologjive kallpe borgjeze, do të përvehtësojmë sa më mirë të vetmen metodë shkencore, marksizmin-leninizmin, dhe do të pajisemi me rezultatet e shkencës sovjetike.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "NAIM BERATLLIU" SHKODËR

Të mveshur me këtë frymë, ne do të vëmë gjithë forcat tona që të bëhemi gjithënjë e më tepër një faktor aktiv në udhën e ndërtimit të socializmit në vëndin tonë. Studimet tona do të orientohen gjithnjë e më tepër drejt problemeve jetike, drejt afrimit të teorisë së praktikës për zhvillimin e forcave prodhonjëse të popullit tonë, për zbulimin dhe shfrytëzimin e pasurive të Adheut, për zbulimin dhe vlerësimin e pasurive të kulturës materiale dhe shpirtërore, të gjuhës dhe historisë së popullit tonë.

Duke vepruar në këtë frymë, puna jonë shkencore do të kontribuojë për të rritur thesarin e shkencës së vërtetë, dhe do të jetë një kontribut i shëndoshë në mprojtjen e paqes për popullin tonë, i cili qëndron i vendosur në kampin e paqes dhe të socializmit i bashkuar rreth Partisë, Qeverisë dhe Juve, Udhëheqësit tonë të dashur.

Ju themi nga gjithë zemra, se ne punëtorët e shkencës jemi të lumtur që rrojmë në këtë kohë kur Pushteti Popullor dhe Partia i kapin shkencës perspektiva dhe horizonte kaq të mëdha, kur shkencës dhe shkencëtarëve nga Partia, Qeveria dhe Ju personalisht i-u jepet një kujdes dhe një ndihmë kaqë e madhe.

Ju sigurojmë se këto detyra të mëdha ne punëtorët e shkencës i kemi kuptuar dhe ju premtojmë se do t'i përmbushim dhe do të tregohemi të denjë për konsideratën e madhe që gëzon puna shkencore në Shqipërinë e Re, se do ta meritojmë ndihmën e madhe që na jep Komiteti Qënror dhe Qeveria.

NGA ASAMBLEJA E INSTITUTIT TE SHKENCAVE

Në përfundim të punimeve të Asamblesë, z. Kol Paparisto, midis një atmosfere së përzemërt të të pranishmëve, deklaron të mbyllur Sesionin e III-të të Asamblesë së Përgjithëshme të Institutit të Shkencave.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

AKTIVITETI SHKENCOR I INSTITUTIT

Seksioni i Gjuhësisë e Letërsisë.

Aktiviteti kryesor i Seksionit të Gjuhësisë e letërsisë që nga fillimi i këtij viti gjer në funt të muajit Qërshor është përqëndruar në vazhdimin e punës për fjalorin shqip dhe për fjalorin rusisht-shqip. Gjithashtu është vazhduar puna me terminologjinë dhe me bibliografinë shqipe, që ka ndërmarrë ky Seksion

Nga vepra e Pushkinit «Eugjen Onegini» është përkthyer gjer sot thuajse gjysma e veprës.

Komisioni i folklorës gjatë kësaj periudhe ka përfunduar Antologjinë e Folklorës (Lirikën). Kjo vepër ndahet në shtatë kapituj, në të cilët përmblidhen këngë të ndryshme që tregojnë ndodhitë më të rëndësishme të jetës së njeriut.

Gjatë kësaj kohe janë bërë disa ekspedita folkloristike: Prej datës 24 Mars gjer në 8 Prill në Vlorë dhe në rrethet e këtij qyteti (Labëri), ku u mbjodhën këngë të luftës Nacional Çlirimtare, këngë të lëvizjes fshatare (Gjoleka, Rrapo Hekali etj.) dhe këngë të luftës së Vlorës. Kjo ekspeditë ka pasur rezultate mjaft të mira, sidomos me këngët e Selim Hasanit, një nga rapsodët më të njohur të luftës Nacional Çlirimtare. U-mbloth gjithashtu materjal mbi biografinë e Gjolekës.

I tërë materiali i mbledhur përbëhet prej 5 000 vargjesh.

Prej datës 15 Prill gjer më 5 Maj u-bë një ekspeditë për të marrë pjesë, me qëllim çlirytëzimi, në manifestimet folkloristike lokale të këtyre vëndeve: Peshkopi, Burrel, Rrshen, Rubik, Lesh, Pukë, Kastrat, Shkodër. Nga materiali që u-mbloth janë për t'u shënuar këngët e luftës Nacional Çlirimtare, variantet e Ago Ymerit, të ndërtimit të kalasë Ali Borxhalis dhe të ciklit të Mujos e të Halilit, sidomos të krahinës së Hotit dhe këngët historike që shënojnë luftën kundra turqve.

Në këtë ekspeditë u mblodhën më shumë se 11.000 vargje.

Materiali i mbledhur në këto ekspedita u-kontrollua dhe u rreshtua; u regjistruan gjithashtu disa këngë popullore nga një rapsod i ardhur nga Vlora dhe u skeduan përralla, të mbledhuna prej dy ekipeve në Tiranë dhe prej gazetave të vjetra.

Po gjatë kësaj kohe u-shpërnda anketa e parë folkloristike në të gjithë arësimarët e Shqipërisë. Gjer më sot një pjesë e madhe e tyre janë përgjegjur në mënyrë pozitive.

Seksionë i Shkencave të Natyrës:

Reparti i florës, pranë Muzeut të Shkencave të Natyrës gjatë kësaj periudhe ka kryer një seri determinimesh dhe disa ekskursione në rrethet e Tiranës për pasurimin e herbarit dhe të koleksioneve muzeale. Ka kryer gjithashtu një ekspeditë në zonat e Lushnjës dhe të Fierit me qëllim kryesor studimin e bimëve foragjere. Me këtë rast u pasurua reparti me një sasi bimësh, të mbledhura nëpër këto zona.

Ves këtyre ky repart është marrë me studimin e disa bimeve medicinale e industriale dhe me pregatitjen e ekspeditave që do të kryen gjatë verës.

Reparti i Kafunës, përveç punës së zakonëshme si pregatitje materiali etj. ka bërë dhe disa ekspedita: Në zonën e Beratit për studimin e gjëndjes së kaprollit dhe të derrit: t'egër, në bregdetin e Myzeqesë midis Shkumbinit dhe Semanit, në zonën

BIBLIOTEKA PUBLIKE
MARIN BARLETI
SHKODËR

e Divjakës, si dhe në veri, në zonën e Leshit me qëllim studimin e ndiqfikimit dhe shtegëtimit të shpendëve t'egra dhe gjetjen e vëndeve adapte për mbrojtjen dhe shtimin e tyre; në Berat e Fier me qëllim studimin e krapikulturës ndër orizore; në Vlorë e në Elbasan për të studjuar çfaqjen e mizës së ullirit, e cila dëmton shumë këtë prodhim. Me rastin e këtyre ekspeditave dhe gjatë ekskursionesh në rrethet e Tiranës janë mbledhur insektë te dëmëshme për bujqësinë e insekte të tjera dhe është pasuruar Muzeu me një numur të math prej këtyre. Është pregatitur gjithashtu material entomologjik për të dërguar në Bashkimin Sovjetik.

Reperti i gjeologjisë, po i këtij Muzeu, gjatë kësaj kohe ka filluar punimin e monografrsë të hekurit dhe të kromit dhe studimin e materialit të mbledhur në ekspedidën e muajit Gush 1949 në Zonën e Lurës.

Ka kryer një ekspeditë në Domn, Ura e Shtrejtë e Drishtë, e cila ka dhënë rezultate pozitive me zbulimin e kaoltnës, material shum' i vlefshëm. Një tjetër ekspeditë u krye në Bulqar, me qëllim të përcaktohet në se afloramenti i manjezitit, i zbuluar n'atë zonë gjatë ekspeditave të mëparëshme paraqit interes çfrytëzimi; rezultatet kanë qënë pozitive

Për Drejtorinë e Shërbimit Hidrometeorologjik, nga aktiviteti kryesor i zhvilluar gjatë gjashtë muajve të fundit, vlen të vihet posaçërisht në dukje zgjerimi i rrjetit të stacioneve meteorologjike dhe hidrometrike në të gjithë vëndin; pregatitja e pjesës më të madhe të kuadrove teknike ndihmëse të qendres dhe të qarqeve, si dhe përmirësime ose krijime stacionesh të rea me rëndësi që kanë bërë të mundëshme fillimin e shërbimit të sinoptikës, në lidhje me parashikimin e kohës me afat të shkurtër 24 orësh.

Seksioni i Historisë, sociologjisë e ekonomis.

Në mbështetje të planit vjetor janë kryer nga ana e Muzeut Arkeologjik — Etnografik ekspedita në Lesh, në Vlorë, në Elbasan, në Korçë dhe në Gjinokastër

Këto ekspedita kanë qënë të kombinuara në mes të dy sektorëve të Muzeut: Arkeologjik e Etnografik.

Puna gjatë këtyre ekspeditave ka qënë përqëndruar nëpër qytete dhe ka pasur në radhë të parë këtë qëllim: inventarizimin e objekteve me vlerë arkeologjike, etnografike dhe artistike.

Sektori i Etnografisë është marrë dhe me studimin e grumbullimit të vëndbanimeve në lidhje me zhvillimin e qyteteve dhe zgjerimin e tyre, typet e banesave dhe të mjeshtërive tradicionale të populit. Në këtë mënyrë, me ekspeditat e kësaj natyre të vjetit të kaluar, u plotësua inventarizimi i këtyre objekteve në gjithë qytetet kryesore të Shqipërisë.

Nga këto ekspedita u nxuar një listë e objekteve që do të kalojnë nënë mbrojtjen e ligjës, duke u deklaruar monumente kombëtare; u propozuan masat më urgjente për mbrojtjen e tyre dhe u muarn të gjitha shënimet e nevojshme.

Në Qërshor ekipi i Etnografisë përfundoi një ekspeditë në luginën e Viosës duke përfshirë dhe disa lugina të vogëla t'afluenteve të saja, ku u mbiodhën gjithë informatat me karakter etnografik

Në këtë kohë janë kopjuar një varg afreskash në kishat e vjetra të Beratit e të Pojanit.

Ditët e fundit koleksioni i monedhave mesjetare të Muzeut Arkeologjik-Etnografik u pasurua me 157 para argjëndi. Këto u gjetën në Maqellarë të Peshkopisë në dy tasa, gjithazhtu, prej argjëndi të lara me ar. Prej këtyre monedhave 156 eopë janë prerë prej Car Stefan Dushanit (1331—1355) ndërsa një copë eshtë e Kral Stefan Dragutinit (1272—1275).

Arkivi i Shtetit, ndër të tjera, është pasuruar me një dokument me rëndësi: një gravurë që paraqet Sh. Mërinë e Manastirit të Ardenicës; gravura sipas përshkrimit është e vitit 1731 dhe përmban një mbishkrim shqip.

Gravura në fjalë dëshmon përdorimin e gjuhës shqipe në masa të gjëra të popullisisë, në një kohë, kur botimet shqipe janë të ralla.

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

Konferenca:

Duke filluar një varg konferencash të pregatitura nga Instituti, me datë 27 Qershor në Sallën e Bibliotekës Kombëtare foli ing. J. Adami mi temën «Rrugët në Shqipëri në kohën antike dhe në kohën e mesme».

Botimet:

Që prej fillimit të këtij viti nga veprat klasike marksiste, që janë shtypur nën kujdesin e Institutit, kanë dalë në qarkullim: «Revolucioni preletar dhe renegati Kautsky» dhe «Mbi të drejtën e kombeve për vetëvendosje» të Lenin-it. «Mëditja, çmimi dhe fitimi» e K. Marks-it dhe vepra e madhe, e Stalin-it «Çështje të leninizmit». Dolli gjithashtu në qarkullim dhe «Gramatika shqipe» e K. Cipos.

Janë dhënë për në shtyp veprat marksiste: «Marksizmi dhe çështja nacionale» e Stalin-it dhe veprat e Lenin-it; «Detyrat e proleterïatit në revolucionin tonë», «Katastrofa që na kanoset dhe mjetet për ta luftuar». «Detyrat imediate të pushtetit Sovjetik» «Periudha e reaksionit stolipinian» dhe «Periudha e kapërcimit në veprën paqësore të mëkëmbjes s'ekonomisë nacionale». Veç këtyre janë dhënë për në shtyp studimet origjinale: «Ortografia e gjuhës shqipe» kolektive dhe «Peshqit e Shqipërisë» e S. Kasimati.

Krijimi i Seksionit të Bujqësisë dhe Laboratorit Qëndror të Shtetit.

Me propozimin e Presidiumit të Institutit të Shkencavet Këshilli Ministerial vendosi krijimin e Seksionit të Bujqësisë pranë këtij Instituti dhe të Laboratorit qëndror të Shtetit:

— Seksioni i Bujqësisë, të cilit do t'i aneksohet si organ ndimës eksperimental stacioni i kërkimeve bujqësore, që funksionon pranë Ministrisë Bujqësisë e Pyjeve, do të merret me studimin e problemeve më urgjente. që i shtrohen sot ekonomisë bujqësore dhe kryesisht me studimin e problemeve bujqësore që lihhen me ambjentin tonë fizik. Puna teorike e seksionit vetë do të vërtetohet dhe do të plotësohet nga puna praktike e organit tij eksperimental.

— Laboratori Qëndfor i Shtetit, i cili do t'i aneksohet Seksionit të Shkencave të Natyrës, prauë këtij Instituti, do të plotësojë një mungesë të ndiëshme në vëndin tonë. Ky Institucion do të jetë një qëndër studimesh e kërkimesh praktike në një fushë të gjërë të aktivitetit tonë ekonomik. Në fillim ky laborator do të përbëhet vetëm prej tre repartesh: repartit të kërkimeve, repartit kimik dhe repartit të rezistencës së materjaleve.

Reparti i kërkimeve do të merret vetëm me studime. Si program pune do të ketë studimin e prucipeve aktive të bimëve mjekësore dhe kërkimin e mënyrave dhe procedimeve me karakter teknik e industrial, të vlefshëm për zgjidhjen praktike të disa problemave, ngushtësisht të lidhura me ekonominë e vëndit.

Reparti kimik do të kryjë të gjitha veprimet që kryen sot Laboratori Kimik i Shtetit, me të cilin do të çkrihet (analiza ushqimesh, artikuj industrialë dhe tregëtarë, produkte minerale etj.)

Reparti i rezistencës së matertaleve do të merret me studimin e rezistencës së mëterialeve, që përdorin kryesisht ndërmarjet e ndërtimit: gurë zbukurimi e ndërtimi, dru, hekur, çimento, tulla etj. Nevoja e një pune të tillë ka qënë e ndiëshme prej kohësh në vëndin tonë.

Marrëdhëniet me Botën e Jashtme.

Në lidhje me marrëdhëniet me botën e jashtme, veç shkëmbimeve të zakonëshme botimesh. mendimesh, dhe eksperience, i kanë arritur Institutit letra përgëzimi nga shkencëtarë të çquar, si janë liguistët dhe Albanologët me famë: danezi prof. Dr. Holger Pedersen, gjermani Prof. Dr. Max Lambertz, italiani prof. Angelo Leotti, Austriaku Prof. Karl Treimer.

Institutit i ka arritur gjith' ashtu letër

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" SHKODËR

përgëzimi nga drejtori i Institutit të studimeve slave në Paris slavistit Prof. Andre Mason.

Nga ana e Institutit «Zachodnio-slowiauski» në Poznan është dërguar letër përgëzimi me një vol. të Rivistës «Lingua Posnaniensis», në të cilën është botuar, veç një studimi mbi gjuhën shqipe edhe një recension mbi dy numura të Buletinit të Institutit tonë mbi çështje gjuhësore, me komente mjaft të favorëshme.

Punonjësit e institutit të shkencavet protestojnë për çkarkimin e Fr. Joliot Curie nga detyra

Punonjësit e Institutit të Shkencavet në një mbledhje që patën ditët e para të Majit vendosën t'i dërgojnë Komitetit të Kongresit Botëror të Partizanëve të paqës, në shënjë proteste për çkarkimin nga detyra e Komisarit të Lartë për energjinë atomike, të shkencëtarit të çquar Frederik Joliot Curie, këtë telegram:

«Ne punonjësit e Institutit të shkencavet të Republikës Popullore të Shqipërisë, me indinjatën më të thellë mësuam shkarkimin nga detyra e Komisarit të lartë për energjinë atomike, kryetar i Komitetit të Përherëshëm të Kongresit Botëror të Partizanëve të paqës dhe militan i vendosur kundër çdo tentative për një luftë të re.

Kjo masë e qeverisë reaksionare të Francës, e cila vepron nënë urdhërat direkte të imperialistëve amerikanë, nxitës të tërbuar të një lufte të re, është një akt i turpëshëm drejtuar kundër shkencës përparimtare dhe paqës, jetës dhe sigurisë së popujve.

Ne ngrejmë lart zërin tonë që bashkohet me zërin e fuqishëm të qindra milionë njerëzish paqëdashës dhe protestojmë me energji kundër kësaj mase që është një tentativë e qartë e reaksionit botëror për të futur shkencën në shërbim të luftës, duke persekutuar korifetë e shkencës përparimtare botërore që luftojnë me vetëmohim për ta vënë atë në shërbim të popujve.

Ne jemi të sigurtë se këto tentativa do të dërmohen nga forcat militante të kampit të paqës, që rritet dita ditës dhe ka në krye Bashkimin e pathyeshëm Sovjetik dhe Stalinin e math».

BIBLIOTEKA PUBLIKE "MARIN BARLETI" S H K O D E R

BIBLIOTEKA PUBLIKE
"MARIN BARLETI"
S H K O D E R